

TEORITË NORMATIVE TË BIZNESIT DHE NDIKIMI I TYRE NË TË DREJTËN TREGTARE NË SHQIPËRI

Diana BIBA

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Juridike,
me profil “E Drejtë Biznesi”, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: **Prof. Asoc. Hemion Braho**

Numri i fjalëve: 59.365

Tiranë, Janar 2021

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë e nënshkruara Diana Biba, në përgjegjësinë time të plotë deklaroj se ky punim është punim origjinal i imi, i shkruar prej meje, në përputhje me kërkesat e Shkollës Doktorale të Universitetit European të Tiranës; nuk është prezantuar para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar më parë, plotësisht apo pjesërisht. Gjithashtu ky punim nuk përmban materiale nga persona të tjerë përveç rasteve të cituara dhe të referuara përkatësisht në të.

ABSTRAKTI

Shoqëria tregtare në formën që njohim sot nuk ka qenë e tillë në fillimet e saj. Koncepti i “*personit juridik*” është krijuar dhe përpunuar në rrjedhën e shekujve. E drejta tregtare është dinamike dhe një sistem me tendencë endemike në zhvillim, ku rol të rëndësishëm luajnë vetë komuniteti tregtar dhe institucionet shtetërore të kohës që bënë të mundur dhe zyrtarizim e saj. Shoqëritë tregtare të krijuara në fillimet e tyre si një investim në të mirë publike, tashmë janë një nxitës me një peshë specifike të veçantë në çdo ekonomi. Aktiviteti i biznesit luan një rol jetësor në çdo shtet dhe shoqëri. Çdo shoqëri tregtare vepron një mjedis të dhënë duke iu nënshtruar kuadrit rregullator të shtetit ku vepron. Debati akademik në lidhje me shoqërinë ka në thelb përballjen mes dy teorive të etikës së biznesit dhe përgjegjesisë së korporatës, teoria instrumentale – teoria e aksionarëve e Milton Friedman (1970) dhe teoria integrative – teoria e grupeve të interesit e R. Edward Freeman (1988). Teoritë bashkëekzistojnë, dhe në kohë kanë lindur dhe janë elaboruar mendimet dhe qëndrimet pro e kundër tyre, ashtu si dhe nën teori të rrjedhura prej tyre. E drejta tregëtare në Shqipëri ka qenë subjekt i dy reformave të rëndësishme ligjore. Kërkimi fokusohet te ndryshimet strukturore në kuadrin ligjor të së drejtës tregëtare dhe nëse ato pasqyruan apo u orientuan drejt teorive të përgjegjesisë sociale të korporatës. Me anë të këtij kërkimi synohet që të jepet një kontribut në literaturën që trajton legjislacionin tregtar në vend, sidomos qeverisjen e korporatës dhe përgjegjësinë sociale të korporatës, e vendosur kjo dhe në një plan krahasues me vende të tjera.

Fjalë kyçe: shoqëri tregtare, korporatë, qeverisje korporate, përgjegjësi sociale e korporatës, aksionar, grupe interesi.

ABSTRACT

The commercial company as we know today was not like that in its beginnings. The "legal entity" concept was coined and elaborated over the centuries. The commercial law is dynamic and a system with an endemic tendency to develop, whereas the commercial community itself and the state institutions play an important role. Companies established back in their initial origin as an investment to the public interest are now a promotor with a specific weight in any economy. Business activity plays a vital role in every state and society. Every company operates in a given environment subject to the regulatory framework of the state it operates in. The academic debate about commercial companies has in its core the confrontation between two theories of business ethics and corporate responsibility, the instrumental theory - Milton Friedman (1970) and the integrative theory - R. Edward Freeman (1988). Theories coexist, and over time pro and cons opinion and attitudes have evolved, as well as sub-theories derived from them.

The Commercial Law in Albania has been subject to two important legal reforms. This research focuses on the structural changes in the legal framework of the commercial law and whether it reflects or is oriented towards theories of corporate social responsibility. This research aims to make a contribution to the literature about the commercial legislation in the country, especially corporate governance and corporate social responsibility, placed in a comparative plan with other countries.

Key words: *commercial company, corporate, corporate governance, corporate social responsibility, shareholder, stake holder.*

DEDIKIMI

*Për babin, për dashurinë e tij, mbështetjen, besimin, këmbënguljen, parimet e shëndosha,
për ditët e bukura të fëmijërisë dhe ditët e arta të të qenit shokë.*

FALËNDERIME

Ky kërkim nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen dhe besimin e disa njerëzve të cilët gjej rastin t'i falëndëroj dhe t'iu shpreh mirënjohjen.

Falënderime të veçanta, respekt dhe mirënjohje i drejtohen udhëheqësit shkencor, Prof.Asoc.Hemion Braho, për udhëheqjen e pakursyer në këtë kërkim. Oponenca konstruktive, syri kritik dhe vizioni profesional i ofruar prej tij ndihmuan në përmirësimin e punimit.

Gjithashtu, do të dëshiroja të shprehja mirënjohjen time për Universitetin European të Tiranës dhe stafin e tij, veçanërisht për Shkollën Doktorale, për mundësinë e ndjekjes dhe përfundimit të Doktoratës pranë saj.

Të fundit për nga rradha, por jo nga rëndësia falënderime nga zemra për familjen time dhe miqtë e mi, për kohën e munguar, durimin dhe besimin e pakursyer te unë, nxitjen e vazhdueshme për një punim sa më cilësor.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I: PARATHËNIA	1
1.1 Hyrje	1
1.2 Qëllimi	14
1.3 Pyetja kërkimore	15
1.4 Metodologjia e punimit	16
1.5 Etimologjia e terminologjisë së përdorur.....	20
1.6 Pritshmëritë dhe kontributet e kërkimit.....	25
1.7 Kufizimet dhe vështirësitë.....	27
1.8 Struktura e punimit.....	30

KAPITULLI II: ZHVILLIMI HISTORIK I SË DREJTËS DHE SHOQËRIVE TREGTARE

32

2.1 Historik i shkurtër i “Zotësisë juridike”, “Personalitetit juridik” dhe “Shoqërive tregtare”.....	32
2.2 E drejta romake	32
2.3 Periudha e Mesjetës e më tej	37
2.4 Personaliteti juridik i korporatës.....	42
2.4.1 Qasja e Savigny	42
2.4.2 Qasja e Gierke-s	43
2.5 Themelimi i shoqërive të para.....	44
2.6 Zhvillimi i shoqërive tregtare në shekullin XVIII – XX.....	47

KAPITULLI III: HISTORIKU I SHOQËRIVE TREGËTARE DHE SË DREJTËS NË SHQIPËRI

52

3.1 E drejta tregëtare në periudhën 1912 – 1944.....	52
3.2 E drejta tregëtare në periudhën 1944 – 1990	59
3.3 E drejta tregëtare në periudhën 1990 – 2007 (“Reforma e parë”)	60
3.3.1 Ligji nr. 7632, date 4.11.1992, “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit	

	<i>Tregetar</i> ”.....	63
3.3.2	<i>Ligji nr. 7638, datë 19.1.1992 “Për shoqëritë tregtare” (Ligji 7638/1992)</i>	65
3.3.3	<i>Ligji 7667, datë 28/1/1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”</i>	71
3.4	E drejta tregëtare në periudhën 2007 e në vijim (“Reforma e dytë”)	71

KAPITULLI IV TEORIA E AKSIONARËVE.....74

4.1	Hyrje	74
4.2	Teoritë instrumentale (ose Teoria e aksionarëve e Milton Friedman)	78
4.3	Teoria e Përfaqësuesit (Agjentit).....	84
4.3	Përgjegjësia sociale dhe filantropia në dritën e Teorisë së Aksionarëve.....	86

KAPITULLI V TEORIA E GRUPEVE TË INTERESIT89

5.1	Hyrje	89
5.2	Analiza e Grupeve të Interesit	92
5.3	Analiza e “Grupit të Interesit” si koncept.....	93
5.4	Klasifikimi i kërkesave të grupeve të interesit	94
5.5	Klasifikimi i grupeve të interesit	94
5.6	Doktrina e Kontratës së Ndershme	102
5.7	Tre parimet e Freeman.....	105
5.8	Përmasat e teorisë së grupeve të interesit.....	106

KAPITULLI VI LIGJI 9901, DATË 14.04.2008 “PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE”110

6.1	Hyrje	110
6.2	Lloje të organizimit të aktivitetit tregtar	114
6.3	Shoqëria shtetërore	122
6.4	Aksioni	126
6.5	Aksionarët e pakicës	129

6.6	Praktika gjyqësore në vend në lidhje me shoqëritë tregtare	135
-----	--	-----

KAPITULLI VII QEVERISJA E KORPORATËS.....145

7.1	Klasifikimi i bizneseve	145
7.2	Sistemet e qeverisjes	154
7.3	Mekanizmat në kontekstin e qeverisjes së korporatës.....	156
7.4	Ndarja e pronësisë nga kontrolli.....	157
7.5	Qeverisja e korporatës në Europë - Modelet e qeverisjes në Europë.....	164
	7.5.1 <i>Modeli i sistemit me një nivel</i>	165
	7.5.2 <i>Modeli me një nivel në Mbretërinë e Bashkuar</i>	165
	7.5.3 <i>Modeli me dy nivele</i>	167
	7.5.4 <i>Modeli i sistemit me dy nivele në Gjermani</i>	167
	7.5.5 <i>Modeli Nordik</i>	169
7.6	Qeverisja e korporatës në shoqëritë e palistuara	170
7.7	Detyrimet e raportimit për shoqëritë e palistuara në Bashkimin European.....	172
7.8	Raportimi në ShBA.....	174
7.9	Qeverisja e korporates - Rasti i Shqipërisë.....	175

KAPITULLI VIII PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS (PSK)198

8.1	Përgjegjësia sociale e korporatës.....	198
8.2	Argumentat kundër “Përgjegjësisë sociale të korporatës.....	203
8.3	PSK në Shqipëri	211
	8.3.1 <i>Trajtimi në nivel ligji</i>	211
	8.3.2 <i>Raste praktike</i>	216

KAPITULLI IX PËRFUNDIME DHE SUGJERIME.....229

Shtojca 1

Bibliografi

KAPITULLI I: PARATHËNIA

1.1 Hyrje

Debati akademik sot ne lidhje me shoqerine ka në thelb përballjen mes dy teorive të etikës së biznesit dhe përgjegjesisë së korporatës, teoria instrumentale – teoria e aksionarëve e Milton Friedman (1970) dhe teoria integrative – teoria e grupeve të interesit e R. Edward Freeman (1988). Te dyja teoritë bashkëekzistojnë, dhe në rrjedhën e kohës kanë lindur dhe janë elaboruar mendimet dhe qëndrimet pro dhe kundër tyre, ashtu si dhe nën teori të rrjedhura prej tyre.

Një nga avantazhet e këtij debati është jo vetëm “*mosha*” e tij e hershme tashmë, që në vitet ’70- ’80, po dhe përhapja e gjerë dhe rëndësia që mori qeverisja e korporatave, transparencia, rëndësia e dhënies dhe e cilësisë së informacionit, roli i drejtuesve dhe përgjegjësitë e tyre, sidomos në shoqëritë me ofertë publike e veçanërisht në skandalet e mëdha financiare që shpërthyen në fillimin e viteve 2000 si me Enron, WorldCom etj. Fuqia e sistemit kapitalist qëndron brenda dobësive të tij, çdo krizë i krijon atij mundësinë të reformohet dhe të përsoset, duke çuar në mënyrë të pandalshme drejt prosperitetit të shoqërisë njerëzore (Xhepa, 2010:81).

Teoria e aksionarëve u prezantua nga **Milton Friedman** në vitin 1970 në një shkrim në NY Times duke vënë theksin se detyra kryesore e manaxherëve është maksimizimi i interesave të aksionerëve në atë mënyrë që lejohet ende nga ligji apo vlerat ligjore. Sipas Friedman: “*ka vetëm një dhe të vetme përgjegjësi sociale të biznesit: të përdorë burimet e tij për t’u përfshirë në aktivitete të tilla që rrisin fitimet për aq kohë sa përputhet me rregullat e lojës, që do të thotë, të përfshihet në konkurrencë të hapur dhe të lirë, pa mashtrime dhe hile*”.

Në pikëpamjen e Fridmanit mund të themi se roli i administratorit është ai i një “begatuesi”, “kujdestari” a “mbarështuesi” i interesave dhe pronës së pronarëve të shoqërisë, ku parimi bazë dhe i vetëm është maksimizimi i fitimit për këta të fundit.

Teoria e grupeve të interesit u soll para rreth dy dekadash nga **R. Edward Freeman** në vitin 1988 me artikullin e tij “Teoria e grupeve të interesit e korporatës moderne” (“*Stakeholder theory of the modern corporation*”) me synimin: “*të ringjallë konceptin e kapitalizmit manaxherial duke zëvendësuar nocionin që manaxherët kanë një përgjegjësi (detyrim) ndaj aksionarëve me konceptin që manaxherët mbartin një marrëdhënie besimi me grupet e interesit*”.

“Grupet e interesit” përfshin individët apo grupet të cilët, bashke me të drejtat e tyre, mbështesin, përfitojnë, ose mund të cenohen nga shoqëria dhe veprimet e saj. Këtu përfshihen vetë aksionerët, punonjësit, klientët dhe furnitorët, konsumatorët, komuniteti lokal dhe më gjerë, mjedisi etj. pra përfshin aksionerët dhe është më e gjerë se ta. E thënë ndryshe, është gjetja e një ekuilibri mes interesave të aksionarëve me interesat e grupeve të tjera të interesit, sesa vetëm të fokusimi i përfitimit të aksionarëve.

Teoritë gjejnë zbatim në aktivitetin e administrimit të zakonshëm dhe të përditshëm të shoqërive tregëtare dhe nëse përfaqësuesve ligjorë, në nivel administratori apo përfaqësuesi ligjor është një zgjedhje, parashikimet ligjore në dallim, janë detyruese dhe sesi funksionon mekanizmi ligjor është një çështje që vlen të vlerësohet.

A është e mjaftueshme të marrim të mirëqenë se nëse administratorët veprojnë në përputhje me statutin e shoqërisë dhe ligjet në fuqi, (njohuritë për këto të fundit nuk mund të jenë asesi shterruese), atëherë roli i tij është përmbushur pavarësisht nëse kjo nuk është reflektuar në

rritjen e fitimit të ardhurave dhe/ose vlerës së shoqërise, apo në rritjen e konkurrencës, tregut, përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve etj, - me vete dhe së bashku?

Këtu duhet të dallojmë dhe të hapin një parantezë: Në rastin e shoqërive me ortak / aksionar të vetëm që është njëkohësisht dhe administrator, një konflikt i interesit mes “pronarit – drejtuesit” nuk ekziston, por në momentin që ortakët/aksionarët vendosin të zgjedhin apo të delegojnë zgjedhjen e administratorëve jashtë rrethit të tyre, atëherë janë të gjitha rrethanat e mundshme për një konflikt të tillë.

Pra:

Në të drejten tregtare dhe në praktikë shoqëria dhe administratori si një “*i zgjedhur*” (po aq dhe i besuar) i ortakëve/aksionareve, është i veshur me kompetenca përfaqësimi, ndaj të cilëve ata janë *drejtpërdrejt* dhe *vetëm* përgjegjës për të maksimizuar fitimin dhe mirëqenien e tyre sipas teorisë së aksionarëve të Fridman, apo administratori, i zgjedhur/i emëruar për të drejtuar shoqërinë, dhe shoqëria kanë përgjegjësi dhe janë përgjegjës për grupet e interesit të brendshëm punonjësit dhe organet drejtuese dhe *Grupet e jashtëm të interesit* (Konsumatorët, Furnitorët, Kreditorët, Konkurenca, Komuniteti) me të cilët po aq mbartin dhe një marrëdhënie besimi (sipas Freeman).

Në rrjedhën e kohës e drejta tregëtare në Shqipëri ka qenë subjekt i dy reformave të rëndësishme ligjore. Në këtë kuptim, ky kërkim do të fokusohet te ndryshimet strukturore në kuadrin ligjor të së drejtës tregëtare dhe nëse ato pasqyruan apo u orientuan drejt teorive të përgjegjësisë sociale të korporatës dhe nëse po, cili dhe si qe impakti i tyre. Shembja e komunizmit dhe përhapja e demokracisë në fund të viteve '80, thuhet se njëlloj si përhapja e krishtërimit në shekullin IV të erës sonë, krijuan truallin e lulëzimit të teorive të lirisë ekonomike nga ndërhyrjet shtetërore dhe veprimet të pakufizuar të dorës së padukshme

(Xhepa, 2010:32). Vitet '90 ishin *annus mirabilis* për vendet ish komuniste të Bllokut të Lindjes dhe sidomos për Shqipërinë, vite që shënuan fillimin e një ere të re. Zgjedhjet e para pluraliste në Shqipëri u mbajtën në mars të 1991, ndërkohë që vendi po adaptonte dhe po i nënshtrohej procesit të liberalizimit dhe hapjes së tij me vendet e tjera. Reforma ligjore dhe legislative ishte një kusht i qenësishëm (*conditions sinne qua non*), jo vetëm për marrëdhëniet ekzistuese po sidomos për ato marrëdhënie të reja të cilat kishin qenë të ndaluara deri atëherë. Dora e vdekur e qeverisë, që e kishte çuar ekonominë e gjysmës së botës në rrënim dhe popullsinë e saj në zgrip të urisë dhe të varfërisë, u zëvendësua me eficiencën e rregullit ekonomik të dalë nga kaosi (Xhepa, 2010:32) Nuk ka dyshim se në raportin midis një shteti të ekspertëve që mund të planifikojnë dhe të menaxhojnë gjithçka, apo një shteti të individëve “të lirë që të zgjedhin”, - sic e cilëson nobelisti Friedman, preferenca është për të dytin (Xhepa, 2010:84). Sipërmarrjes private në kuptimin e tregëtisë dhe komercializmit, qoftë për individin dhe/ose si person juridik, iu hap drita jeshile për të zhvilluar vetveten.

Nga vitet '90 deri në vitin 2008, e drejta tregëtare në Shqipëri u rregullua kryesisht nga i ashtuquajti Kodi Tregëtar, ose Tri Ligjet për shoqëritë tregëtare: Ligji nr. 7632, datë 4.11.1992, “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregëtar”, Ligji nr. 7638, datë 19.1.1992 “Për shoqëritë tregëtare”, dhe Ligji nr. 7667, datë 28.1.1992, “Për regjistrin tregëtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregëtare”. Kjo bazë ligjore në fillimet e saj ishte dhe u zhvillua në një lloj “ambienti prove”.

Reforma e dytë e së drejtës tregëtare në Shqipëri që u caktua si synim për disa vjet, shënoi arritjen e saj të parë me miratimin e ligjit nr. 9723, datë 3 maj 2007, “Për Qendrën Kombëtare

të Regjistrimit”, ligj i cili shfuqizoi Ligjin nr. 7667, date 28.1.1992, “Për regjistrin tregëtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregëtare”.

Ligji nr. 9723, datë 3 maj 2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” vendosi parimin “one stop shop” sipas te cilit veprimet në lidhje me krijimin dhe aktivitetin e shoqërive tregëtare ishte tashmë të centralizuara dhe kërkonin më pak kohë. Ligji i ri për shoqëritë tregëtare (**LShT**) i miratuar në 14 prill 2008, hyri në fuqi më 22 maj 2008. Ligji parashikon kuadrin e ri ligjor në lidhje me themelimin, organizimin dhe ushtrimin e aktivitetit tregëtar të tregëtarit dhe të shoqërive tregëtare apo ashtu si i referohet shpesh me termin përgjithësues në Shqipëri, “biznesi.” U deshën jo më pak se 5 vjet për finalizimin e tërë këtij procesi dhe implementimin e tij. Në këto kushte të një kuadri të ri, është me interes të theksohen risitë dhe cili qe impakti i tyre te shoqëritë tregëtare në vend dhe qasja ndaj përgjegjësisë së biznesit.

1.2 Qëllimi

Qëllimi i këtij punimi është parashtrimi i një kërkimi në lidhje me legjislacionin në Shqipëri dhe më specifikisht në të drejtën tregëtare dhe aktet nënligjore të cilat rregullojnë krijimin dhe funksionimin e shoqërive tregëtare (këtu e në vijim “**Korniza Ligjore**”).

Kërkimi synon të shqyrtojë sesi dy teoritë e etikës së biznesit dhe përgjegjësisë së korporatës, teoria instrumentale – aksionarët (Friedman 1970) dhe teoria integrative – e grupeve të interesit (Freeman 1988) kanë ndikuar dhe /ose afektuar Kornizën Ligjore dhe pasqyrimin e tyre në raste praktike. Kërkimi do të përdorë një metodologji të kombinuar të analizës së

dokumentit të Kornizës Ligjore në kuadrin e të dyja teorive, krahasimit mes sistemeve dhe modeleve që i zbatojnë ato dhe shqyrtimi i zbatimit në raste praktike në vend.

1.3 Pyetja kërkimore

Fusha e teorive të etikës së biznesit dhe të përgjegjësisë sociale të korporatës është e gjerë dhe larmishme: mes tyre është teoria e aksionerëve (Friedman M. 1970) dhe teoria e grupeve të interesit (Freeman E. 1988), të njohura si teori normative.

Në këtë kuadër, ishte me interes të shqyrtohet nëse Korniza Ligjore është ndikuar/drejtuar më shumë apo kryesisht nga njëra teori apo tjetra. Hipoteza e këtij kërkimi është se legjislacioni shqiptar i së drejtës tregëtare dhe sidomos ligji për shoqëritë tregëtare është ndikuar nga teoritë normative të biznesit duke anuar kryesisht nga ana formale nga ana teorisë së grupeve të interesit. Ndonëse kërkimi do të përqëndrohet kryesisht në të drejtën tregëtare, do të merren në konsideratë dhe legjislacionet e tjera të lidhura apo që i referohen asaj.

Pyetja kryesore e kërkimit është:

Në cilat mënyra dhe deri ku është ndikuar Ligji për shoqëritë tregëtare në Shqipëri nga teoritë normative të biznesit?

Në vijmë të pyetjes kryesore, mendoj të identifikoj këto nënpyetje/nënçështje:

1.1 Në cilat mënyra dhe deri ku është ndikuar Ligji për shoqëritë tregëtare në Shqipëri nga teoria e aksionerëve?

1.2 Në cilat mënyra dhe deri ku është ndikuar Ligji për shoqëritë tregëtare në Shqipëri nga teoria e grupeve të interesit?

1.3 Si është reflektuar kjo në organizimin dhe qëndrimet e kompanive në vend?

1.4 Metodologjia e punimit

Kërkimi në këtë punim i përket lëmit të shkencave juridike, dhe më saktësisht të drejtës së biznesit. Për vetë natyrën e studimeve ligjore që klasifikohen në gamën e shkencave sociale, metodat cilësore të analizës gjenden më të akomoduar në nevojat e studimit. Ndonëse në këtë kërkim, janë marrë në konsideratë teoritë normative të biznesit, pra, është dashur të “*shkelet*” dhe fusha e shkencave ekonomike, trajtimi i teorive është bërë në planin juridik të tyre dhe në atë që mund ta përkufizojmë si sjellje sociale të shoqërivë tregtare.

Në këtë kërkim është bërë një gërshetim mes analizës së dokumentit të vendosur në një plan krahasimor me modele dhe sisteme në fushën e zbatimit të këtyre teorive në praktikë, në modelet që i kanë zbatuar në botë, modele të cilat mbartin edhe veçoritë e tyre dalluese.

Padyshim që në krye të herës duhet të vendoset rishikimi i burimeve të referimit, ku vendin kryesor e zë literatura¹ në lidhje me kërkimin në fjalë. Për këtë u morën në konsideratë literatura themelore në lidhje me teoritë normative të biznesit, pra për teorinë e aksionarëve të Friedman² dhe teorinë e grupeve të interesit të Freeman³, duke pasur parasysh që të dyja teoritë bashkëekzistojnë, (të klasifikuara më vonë respektivisht si teoria instrumentale dhe teoria integrative), dhe në rrjedhën e kohës kanë lindur dhe janë elaboruar mendimet dhe qëndrimet pro dhe kundër tyre.

¹ Në lidhje me literaturën janë marrë në konsideratë libra, artikuj studimorë shkencorë, studime, të botuar apo të aksesueshëm online.

² Teoria e aksionarëve u prezantua nga Milton Friedman në vitin 1970 në një shkrim në NY Times duke vënë theksin se detyra kryesore e menaxherëve është maksimizimi i interesave të aksionarëve në atë mënyrë që lejohet ende nga ligji apo vlerat ligjore.

³ Teoria e grupeve të interesit u soll para rreth dy dekadash nga R. Edward Freeman në vitin 1988 me artikullin e tij “Teoria e grupeve të interesit e korporatës moderne” (“Stakeholder theory of the modern corporation”) me synimin: “të ringjallë konceptin e kapitalizmit menaxherial duke zëvendësuar nocionin që menaxherët kanë një përgjegjësi (detyrim) ndaj aksionarëve me konceptin që menaxherët mbartin një marrëdhënie besimi me grupet e interesit”.

U shqyrtua jo vetëm teoria e ngritur nga këta autorë, po dhe qëndrimi i tyre ndër vite dhe studimeve vijuese të lidhura drejtpërdrejt me teoritë e tyre. Nisur nga impakti i rëndësishëm që kanë këto teori në fushën e biznesit dhe drejtimit të shoqërive, shqyrtimi i literaturës u shtri dhe te pasardhësit dhe dishepujt e dy themeluesve të këtyre teorive kundërshtare me njëra – tjetrën, duke vënë ne pah dhe risitë që ishin sjellë në vite nga autorët e tjerë, mbështetet apo thellimet ne teori qoftë dhe “*shtrembërimet*” e tyre.

Rishikimi i literaturës në terma studimi, artikujsh studimore shkencorë, sondazhe etj, pavarësisht se bëhej fjalë për dy teori “opozitare”, që në vetvete i bënë kritikë njëra – tjetrës, mori në konsideratë edhe kritikën jashtë teorive për të përcjellë një qëndrim më refraktar ndaj tyre. Padyshim, që analiza dhe rishikimi i literaturës kërkoj kohën e saj, por për të adresuar pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura, ishte e domosdoshme dhe analiza e dokumentit (e përkufizuar në vijim) dhe rastet praktike në plan krahasues mes Shqipërisë dhe sistemeve që përfaqësohen nga modeli anglo – sakson, modeli gjerman etj si dhe rregullimet në nivel BE-je.

Analiza e dokumentit është një metodë kërkimi e cila përdoret gjerësisht në shkencat sociale duke pasur parasysh lehtësinë dhe sasinë e madhe të informacionit që mund të mblidhet nga shqyrtimi i dokumentave të caktuar. Gjithësesi çfarë përmban analiza e dokumentit varet nga mënyra sesi përcaktohet termi dokument dhe çfarë përfaqëson ai. Për qëllime të kërkimit, dokument do të thotë të dhëna në formë të shkruar për njerëz dhe fenomene të krijuara gjatë procesit të jetës (Mathews & Ross, 2010: 277). Në këtë sens, çdo dokument shkruhet apo prodhohet nga një mjet i caktuar komunikimi në një kontekst të dhënë dhe për qëllime të dhëna dhe si tillë dokumenti nuk mund të analizohet pa marrë në konsideratë këto dimensione të tjera të krijimit të tij.

Në këtë kërkim, dokumenti do të thotë kuadri ligjor, ligjet dhe aktet nënligjore që do të shqyrtojnë dhe vlerësojnë ky kërkim, i cili do të vlerësohet dhe interpretohen jo vetëm nga pikëpamja e përmbajtjes po dhe për funksionin në krijimin e mekanizmave të kontrollit dhe operimit në një realitet të prekshëm, së bashku me influencën e tyre në praktikë dhe në diskur. Hapat e parë konsistuan në krijimin e një liste të legjislacionit dhe akteve nënligjore përkatëse⁴ të cilat u bënë pjesë e analizës së dokumentit. Lista ishte gjithmonë objekt i monitorimit të vazhdueshëm për ndryshime të mundshme duke pasur parasysh dinamikën në kuadrin ligjor dhe sesi ato lidhen ose ndikojnë pyetjen e kërkimit. Qëllimi është që të bëhet një analizë e saktë e Kornizës Ligjore, analizë e cila do të (*duhet të*) shtrihet në legjislacionin e lidhur me të jo vetëm në Shqipëri po dhe me legjislacionin e jashtëm të cilin ligji e përdor si referencë ose pas të cilit është modeluar/modelohet përkatësisht.

Duke pasur parasysh harkun kohor të shtrirjes në legjislacion, u synua të jepej një panoramë e evoluimit të reformave të së drejtës tregtare në vend dukë vënë në përdorim metodën historike e kronologjike. Gjithashtu sqarimi dhe interpretimi i dispozitave të caktuara ligjore me interes për këtë punim, u bë nëpërmjet metodës së analizës interpretuese.

Kërkimi nuk u mjaftua me analizën e dokumentit dhe krahasimin e tij, por u zgjerua dhe në praktikë duke marrë në konsideratë praktikën gjyqësore në vend në lidhje me temat me interes për kërkimin. Kërkimi në vendimet e gjykatës, përmbledhja e vendimeve të tyre dhe analiza, janë të rëndësishme për të parë mënyrën e zbatimit në praktikë të ligjit, uniformitetin dhe konformitetin në zbatimin e tij.

⁴ Për legjislacionin u mor në konsideratë faqja e publikimeve zyrtare <http://www.qbz.gov.al/> . Në raste të caktuara u përdorën dhe faqe të institucioneve shtetërore të cilat përmbanin versione integrale të legjislacionit me të gjitha ndryshimet në fjalë, si <http://www.qkr.gov.al/legjislacioni/legjislacioni-per-regjistrimin-e-biznesit/ligje/> etj.

Pjesë e kërimit u bë një shqyrtim i zgjeruar i faqeve zyrtare të internetit të shoqërive kryesore që operojnë në vend, të përzgjedhura sipas fushave të industrisë ku ato operojnë. Nisur nga përzgjedhja e shoqërive në fusha të ndryshme por kryesore të industrisë dhe biznesit në vend, u mbajt në konsideratë dhe “pronësia” e ketyre shoqërive (vendase dhe /ose të huaja, në pronësi publike (shtetërore) dhe / ose private). Eksplorimi i faqeve të internetit synoi të shqyrtonte aspekte të jetën operationale të shoqërive tregtare të cilat ishin me interes për kërkimin:

Së pari transparenca e shoqërive dhe mënyra sesi ato përhapnin informacion nëpërmjet faqes së internetit nisur nga rëndësia e shtuar e internetit dhe përdorimit të tij si mjet i komunikimit publik dhe ndarjes së informacionit.

Shoqëritë u përzgjodhën nga ato fusha të ekonomisë që janë domethënëse dhe me peshë në ekonominë shqiptare, pra nga fusha e komunikimeve elektronike, bankingut, sigurimit dhe risigurimit, energjisë, ujësjellësit, shërbimit postar etj. Përzgjedhja u shtri në disa aspekte:

- i. U shtri në shoqëri me ofertë private – kapital privat;
- ii. Shoqëri me kapital privat domethënës dhe ku shteti zotëron përqindje të vogla që nuk arrijnë të jenë vendimmarrëse;
- iii. Shoqëri me kapital tërësisht shtetëror, pra shoqëri publike ose shoqëri shtetërore që kishin lindur nga transformimi i ndërmarrjeve publike pas viteve '90.

Gjithashtu në këto shoqëri u vu re fakti që në shoqëritë private, në disa prej tyre, aksionari i shumicës, kryesisht ishte person juridik i huaj; në disa raste ai vetë i listuar në tregjet e kapitalit, ose këtë shoqëri ishin pjesë e grupeve ndërkombëtare që operojnë në botë në një sektor të caktuar apo në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, industrisë dhe biznesit.

Për zgjedhjen e shoqërive që i nënshtrohen një kuadri rregullator mbikqyrës, pra që operojnë në tregje të rregulluara apo të mbikqyrura, u përdorën faqe zyrtare të autoriteteve apo agjensive shtetërore të ngarkuara me mbikqyrjen e tregut si faqja zyrtare e Bankës së Shqipërisë (<https://www.bankofalbania.org/>) për shoqëritë që operojnë në sektorin bankar për bankat e nivelit të dytë, faqja zyrtare e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (<https://www.akep.al/>) për shoqëritë e komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar, faqja zyrtare e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (<http://amf.gov.al/>) për shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit etj. Gjithashtu, informacioni i marrë në këtë kuadër u krahasua fillimisht dhe me informacionin e marrë nga Regjistri Tregtar që mbahet nga Qendra Kombëtare e Biznesit (<http://www.qkr.gov.al/>).

Shqyrtimi i faqeve zyrtare të shoqërive synoi të kalonte në revistë edhe përhapjen e informacionit për angazhimin e këtyre shoqërive në praktiva dhe aktivitete të Përgjegjësisë Sociale të Korporatës (PSK): pra, *Sa* dhe *Si* angazhoheshin këto shoqëri në praktika PSK. Në shqyrtim u analizua dhe misioni dhe vizioni i këtyre shoqërive dhe mënyra e qeverisjes së korporatës. Kombimini i metodave çon në adresimin e pyetjes së kërkimit dhe nënpyetjeve të parashtruara më lart.

1.5 Etimologjia e terminologjisë së përdorur

Gjatë punës hulumtuese dhe shkrimit të këtij punimi, një nga elementët e parë, që duhej të qartësohej ishte pikërisht dhe terminologjia e përdorur, koncepte të cilat do të ktheheshin në kryefjalë ose fjalë kyçe të tij. Nisur nga fakti që në vetvete e drejta tregtare në Shqipëri është relativisht e re, krahasimisht me vendet e tjera, si ato europiane, ShBA, si dhe kufizimet që imponohen nga pamjaftueshmëria e literaturës në vend, (kufizim ky i ngritur dhe në seksionin

e Metodologjisë), referencë e hulumtim i zgjeruar është bërë në literaturën e vendimet e gjykatave të huaja.

Nga njëra anë ky hulumtim i erdhi dukshëm në ndihmë këtij punimi për ta bërë atë sa më të plotë, ilustrues dhe krahasues, po nga ana tjetër, mbarti me vete dhe “përgjegjësinë” për të sjellë një shqipërim dhe përdorim të drejtë, të saktë dhe cilësor të përkthimit.

Krahasimisht, mund të themi se fjalori i të drejtës tregtare në vend, ishte disi më i “kursyer” sesa ai i huaj, një element që lidhet ngushtësisht me qenien e të drejtës “rishtare” në këtë fushë. Në përgjithësi, e drejta tregtare moderne në vend, pas viteve '90, i ka ndenjur besnike fjalës shqipe “shoqëri” tregtare për të ilustruar organizatat tregtare⁵. Të njëjtën terminologji ka përdorur dhe më parë Kodi Tregtar i Ahmet Zogut si një burim i rëndësishëm i të drejtës tregtare në vend.

Nga pikëpamja etimologjike, literatura dhe jurisprudenca përdor termin “*corporation*” dhe “*company*” në sistemet e së drejtës, koncepte të cilat ndonëse në disa raste përdoren si zëvendësuese të njëra –tjetrës, në fakt, mbartin dhe ndryshime që lidhen me sistemet të cilave u përkasin. Ndonëse të dyja fjalët i referohen të njëjtit fenomen, ato ndryshojnë në konotacion (Gorezi, 2011). Ndërsa *corporation* thekson idenë e bashkimit që lind nga pluraliteti, duke sjellë trillin e entitetit juridik, dhe duke reflektuar ngjashmëritë mes organizatave të biznesit dhe bashkive e kishave, fjala *company* vë theksin te marrëdhënia njerëzore mes anëtarëve (Gorezi, 2011, cit. Conard, 1976).

⁵ Neni 3 (1) i LShT parashikon: Neni 3 “Shoqëritë tregtare”: “Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj”.

Më parë Neni 1 i ligjit 7638, datë 19/11/1992 “Për shoqëritë Tregtare” përcaktonte: “Shoqëria themelohet nga dy a më shumë persona, që merren vesh nëpërmjet një kontrate për të destinuar në një sipërmarrje të përbashkët pasuritë ose shërbimet e tyre, me qëllim që të ndajnë fitimin ose të përfitojnë nga të ardhurat që mund të rrjedhin prej saj”.

Sipas përkufizimit në fjalor⁶ (Hoti, 2002), *Company* është një shoqëri biznesi e organizuar si person juridik në formën e një shoqërie kapitalesh ose /dhe personash, e cila regjistrohet në librin e shoqërive. Me gjasë libri i shoqërive i referohet një regjistri zyrtar, shtetëror të mbajtjes së të dhënave të organizmave tregtare të biznesit.

Në fakt termi (business) “corporation” përdoret sot gjerësisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke e vënë theksin sidomos te “ndashmëria” e personit juridik në të drejta dhe detyrime nga anëtarët që e kanë krijuar atë, ndërsa termi “company” në vendet Perëndimore. Përjasja e Europës kontinentale ndaj termit “company”, në dallim nga termi amerikan “corporation”, përfshin edhe elementin e shoqërizimit (ortakërisë apo partneritetit) brenda kuadrit të shoqërisë. Theksi i vënë në elementin e shoqërizimit shfaqet qartësisht dhe në etimologjinë e përdorur nga vende të ndryshme Perëndimore, të cilat përfshijnë të gjitha fjalë, kuptimi i të cilave është më afër “kompanisë” sesa “korporatës (Gorezi, 2011: 21, cit Conard 1976: 137). Rëndësia e dallimit mes këtyre fjalëve qëndron në mundësinë e influencimit të mendimit ligjor në lidhje me organizmat e biznesit (Gorezi, 2011: 22). Për shembull, ndërsa juristë francezë kanë theksuar konceptin e *ius fraternitas* në lidhje me kompanitë, gjykatësit amerikanë kanë vënë theksin detyrimet ndaj korporatës (bashkësia) sesa te anëtarët e saj (Gorezi, 2011: 22).

Legjislacioni dhe jurisprudenca shqiptare ndër vite ka përdorur termin “shoqëri”, përdorim ky që është huazuar nga prirja e legjislacionit tonë drejt atij te vendeve Perëndimore,

⁶ Shih Hoti I. “Fjalor enciklopedik për Bankën, Biznesin, Bursën, Ekonominë”, (2002). Hoti thekson dhe përgjegjësinë e kufizuar të individit që e themelon: Individët, me falimentimin e shoqërisë, nuk rrezikojnë të ardhurat personale por vetëm aksionet, kur shoqëria është e kufizuar. Të njëjtin qëndrim e gjejmë dhe në fjalorë të tjerë në lidhje me përgjegjësinë e kufizuar. Shih <https://www.itseducation.asia/dictionary/c.htm>

kryesisht legjislacionit francez, gjerman dhe italian, tek të cilët dhe është mbështetur gjerësisht⁷.

Termi “kompani” nuk gjen përdorim në gjuhën e legjislatorit shqiptar, megjithatë kjo nuk e ka penguar këtë term të gjejë përdorim gjerësisht në të folurën e përditshme, ose në fushën e medias së shkruar dhe vizive si term zëvendësues për “shoqëri”. Vlen të theksohet rregullimi që ka bërë legjislacioni shqiptar në dy nivele të shoqërisë: shoqëria tregtare e rregulluar nga legjislacioni tregtar me katër format e saj, dhe shoqëria e thjeshtë e rregulluar nga dispozitat e Kodit Civil.

Për qëllime të këtij punimi, përveç rastit të Shqipërisë për të cilin referenca në terminologji do të jetë sipas legjislacionit referuar (pra do të përdoret përkatësisht termi “shoqëri” për entitetin ligjor ose kryesisht “shoqëri aksionare”), në rastet e tjera të marra në konsideratë si dhe duke pasur parasysh kufizimin e studimeve dhe literaturës në lidhje me këtë temë në gjuhën shqipe, e cila ashtu si është theksuar dhe në seksionin në lidhje me kufizimet e studimit, kryesisht në përkthim, është bërë përpjekja që të qëndrohet sa më afër terminologjisë së përdorur nga vetë autori përkatës në origjinal.

Në rastet e përdorimit të konceptit “firmë”, është lënë firmë⁸; në literaturë, sipas përkufizimit në fjalor (Hoti, 2002: 629), firma është subjekt biznesi që angazhon, përpunon faktorë prodhimi për të nxjerrë një produkt (mall apo shërbim), me një nivel maksimal fitimi ndaj një mase të pranueshme rreziku, pra një sinonim i përgjithësuar për secilën formë të

⁷ Shënim: Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare (1 dhjetor 1928) i miratuar nga Asambleja Kushtetuese, në Titullin VI, “Të drejtat e Qytetasve”, në nenin 200 parashikonte shprehimisht: “Shtetasit shqiptarë, mbrenda kufinit të ligjëve kanë të drejtë të formojnë shoqnina (*societies*); I frymëzuar nga legjislacioni francez, legjislatori shqiptar përdor terminologjinë e huazuar prej tij “shoqni” nga “societe”.

⁸ Rasti më tipik është ai i E. Freeman i cili në punën e tij përdor fjalën “firmë”, i cili analizohet gjerësisht në vijim.

organizimit të biznesit. Në përkufizime të tjera, në SHBA, një firmë zakonisht përjashton biznesin në pronësi të vetme, pra me një ortak; përgjithësisht i referohet një biznesi fitimprurës të menaxhuar nga dy ose më shumë partnerë që ofrojnë shërbime profesionale në fusha të caktuara, për shembull shërbime ligjore, të kontabilitetit, konsulenacat etj⁹.

Kryesisht për legjislacionin dhe rastet studimore në ShBA, është përdorur termi “korporatë”, ashtu si shfaqet përkatësisht, duke pasur në vëmendje që ky term i referohet shoqërisë aksionare ose është përdorur “shoqëri tregtare”; në rastet kur ka qenë e nevojshme të shquhet shoqëritë aksionare me ofertë publike, aksionet e të cilave janë lirisht të tregtueshme në tregjet e titujve përkatës, është bërë ky përcaktim;

përdorimi i termit “korporatë” është bërë në mënyrë të këmbyeshme me shoqëri aksionare si dhe për lehtësi pasi përqaset më shumë në një frekuencë me termin “qeverisja e korporatës”.

Kryesisht për legjislacionin dhe raste studimore në Europë, është përdorur termi “kompani”, ashtu si shfaqet përkatësisht ose është përdorur termi “shoqëri tregtare”; Në përgjithësi literatura europiane në lidhje me të drejtën tregtare nuk përdor termin “firmë”.

Megjithatë pavarësisht terminologjisë së përdorur, nisur nga fakti se kryesisht qëllimi i këtij studimi ka në thelb të tij shoqërinë aksionare, në kuptim të tij, përgjithësisht termat e përdorur do të lidhen me shoqërinë aksionare me apo pa ofertë publike si objekt kryesor i këtij studimi.

Në rastet e veçanta kur bëhet fjalë për tipe të tjera të shoqërive tregtare, sipas rastit shoqëri komandite, kolektive dhe me përgjegjësi të kufizuar ato do të emërtohen përkatësisht si të tilla duke i dalluar dukshëm dhe për të mos mbartur keqkuptime.

⁹ BusinessDictionary.com e përcakton si një organizatë tregtare që operon mbi bazën e fitimit dhe merr pjesë në shitjen e mallrave ose shërbimeve për konsumatorët. Menaxhmenti i një firme biznesi zakonisht do të vendosë një sërë objektivash organizative dhe strategji për përmbushjen e këtyre qëllimeve për t'i ndihmuar punonjësit të kuptojnë se ku synon të shkojë ndërmarrja dhe si synon të arrijë atje”.

Në lidhje me organet drejtuese, në një plan historik të zhvillimit duke marrë si “gur themeli”, “*Tri Ligjet per shoqëritë tregëtare*” (Ligji nr. 7632, datë 4.11.1992, “*Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregëtar*”, Ligji nr. 7638, datë 19.1.1992 “*Për shoqëritë tregtare*” dhe Ligji nr. 7667, datë 28.1.1992, “*Për regjistrin tregëtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare*”), kanë përdorur termin “administrator” për organin ekzekutiv të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe “anëtar drejtorie” për shoqërinë anonime.

Për shoqërinë anonime, për të cilën opsioni i vetëm i drejtimit që sistemi me dy nivele, legjislacioni i atëhershëm ka përdorur termin “këshill” mbikqyrës.

Në vijim, LShT përdori në mënyrë të unifikuar termin “administrator” për të dalluar organin drejtuese / administrues për të dy llojet e shoqërive. Gjithashtu, në shoqëritë aksionare në varësi të sistemi të qeverisjes u përdor përkatësisht “këshilli i administrimit” për sistemin me një nivel dhe “këshill mbikqyrës” për sistemin me dy nivele.

Në dallim, “*Tri Ligjet per shoqëritë tregëtare*” dhe LShT, përdorin përkatësisht shoqëri anonime dhe shoqërinë aksionare për shoqërinë e kapitalit, kapitali i së cilës është i ndarë në aksione të nënshkruara nga themeluesit.

1.6 Pritshmëritë dhe kontributet e kërimit

Hulumtimet kërkojnë kohë dhe dija bazohet në hulumtime (Langbroek et al. 2017: 4). Me anë të këtij kërkit synohet që të jepet një kontribut në literaturën që trajton legjislacionin tregëtar në vend, sidomos qeverisjen e korporatës dhe përgjegjësinë sociale të korporatës, e vendosur kjo dhe në një plan krahasues me vende të tjera. Historia na dëshmon se sa më shumë është zgjeruar hapësira për sipërmarrjen private, aq më shumë është rritur edhe

prosperiteti i shoqërisë njerëzore (Xhepa, 2010:84). Ndoshta siç e thotë Berlin, akoma duhet të zbulojmë në mendimin e shoqërisë sonë se sa shumë padrejtësi ajo është e gatshme të paguajë për të qenë mirë ekonomikisht (Xhepa, 2010: 84).

Analiza e bërë në këtë kërkim mund të shërbejë si një incentivë për të rritur ndërgjegjësimin në praktika të shëndetshme të qeverisjes së korporatës, në lidhje me PSK dhe angazhimin në praktika të tilla të shoqërive tregare, qofshin këto me kapital privat dhe publik. Në të njëjtën kohë, nisur nga rëndësia e PSK, të ndikojë në konceptimin e PSK jo si një mjet marketimi imazhi por si një angazhim real që përfaqëson një vlerë të shtuar për shoqërinë.

Vlerësimi i një kompanie nuk mund dhe nuk duhet të jetë vetëm në terma dhe tregues financiarë. Përkundrazi, për vetë natyrën e entitetit juridik, ajo duhet të vlerësohet në treguesit e të gjithë aktivitetit të saj, përfshirë përgjegjësinë sociale, të vlerësohen rezultatet dhe rruga e ndjekur për të arritur këtë rezultat. Mirëqenia është e rëndësishme, por po aq të rëndësishme janë dhe liria dhe drejtësia (Xhepa, 2010: 84).

Përgjegjësia sociale nga ana tjetër nuk duhet të shihet vetëm në këndvështrimin e filantropisë por në kuptimin e plotë të përgjegjësisë që mbart fjala. Synohet që ky kërkim të shërbejë për një kërkim të thelluar nga ana sasiore për të matur performancën e shoqërive që angazhohen në PSK në Shqipëri dhe sesi PSK afekton performancën e shoqërive. Besoj se në këtë kuadër është e rëndësishme dhe ja vlen të monitorohet, matet dhe shqyrtohet sesi kërkesat ligjore përmbushen dhe/ose anashkalohen nga ana e shoqërive. Nga ana tjetër, vetë ekzistenca dhe zhvillimi i tregut, evolucioni i tij drejt përsosmërisë dhe perfeksionizmit nuk do të mund të materializohet në kushtet e mungesës së lirisë së agentëve – qytetarëve, bizneseve dhe grupeve të ndryshme të interesave – për të bërë zgjedhje të lira, të vullnetshme dhe të informuara (Xhepa, 201:80).

1.7 Kufizimet dhe vështirësitë

Puna në këtë kërkim pati dhe kufizimet dhe vështirësitë e saj:

Së pari, ishin ndryshimet në legjislacionin e marrë në shqyrtim, çka kërkonte një përditësim të vazhdueshëm në lidhje me to, për të bërë një pasqyrim dhe analizë reale. Kërkimi “ndalon” në kohë në momentin e përmbylljes së punës kërkimore, ndaj **së dyti**, këtu është kufizimi tjetër i tij: “rezerva” për ndryshimet që mund të prezantohen në vijim në fushën e legjislacionit tregtar dhe PSK. **Së treti**, literatura në gjuhën shqipe ishte disi e kufizuar, çka bënte që burimet më të mëdha të referimit përsa i përket teorive dhe kritikave të tyre të ishin nga autorë të huaj. **Së katërti**, jurisprudenca shqiptare në lidhje me të drejtën tregtare në disa raste shfaqej e paktë ose jo konsistente për të njëjtën çështje, duke lënë hapësirë për interpretime. **Së pesti**, ashtu si është theksuar dhe në metodologjinë e kërkimit, nisur nga fakti që operohet në fushën e së drejtës së biznesit, pavarësisht lëvrimit të teorive normative që janë konsideruar dhe nga studimet e manaxhimit, analiza është më shumë cilësore. Shqyrtimi i faqeve zyrtare të shoqërive nuk mund të quhet plotësisht ezaurues nga ana sasiore, ndaj do të ishte me vlerë në të ardhmen krijimi i një mundësie për matjen sasiore të praktikave PSK në vend. **Së gjashti**, mungesa e bursës dhe e shoqërive me oferte publike në vend, nuk e bënte të mundur një krahasim *vis a vis* me praktika ndërkombëtare si përsa i përket qeverisjes së korporatës, zbulimit të informacionit dhe PSK, duke mbetur te shoqëritë me kapital privat. Megjithatë, në shoqëritë e përzgjedhura u synua për të pasur në shqyrtim shoqëri që kishin aksionarë të listuar, apo ishin pjesë të grupeve të ndryshme ndërkombëtare. Gjykohet e udhës që angazhimi në praktika PSK të institucionalizohet në strategji konkrete nga ana e shoqërive dhe nga ana e vetë instrumentave shtetërorë, pasi nëse përqsja e shoqërisë dhe përfaqësuesve ligjorë, në nivel administratori është një zgjedhje, parashikimet

ligjore në dallim, janë detyruese dhe sesi funksionon mekanizmi ligjor është një çështje që vlen të vlerësohet.

Së shtati, në harkun kohor të këtij punimi, po dhe më parë, teknologjia dhe dinamika e saj, mundësoi zhvillimin e formave të reja të të bërit biznes: *start up* – et e famshme, shoqëritë pionere që operojnë në fusha të ndryshme, dhe bizneset sociale sollën një panoramë të re të shoqërive tregtare, dhe organizimit të tyre e cila nuk mund të mos merrej në konsideratë. Shoqëritë e reja gjithashtu shfrytëzuan teknologjitë e reja të cilat i mundësuan të merrnin përmasa globale edhe duke mos qenë vetë të mëdha (The Economist, 2015:9). Këto forma të organizimit të biznesit, ndonëse ende në faza më embrionale dhe jo në nivelet ndërkombëtare e kryesisht në SHBA, po nxiten dhe në vendin tonë, si një formë e re dhe e inovative e sipërmarrjes¹⁰.

Në një vështrim historik, çka është analizuar dhe në këtë punim, shoqëritë tregtare të themeluara si prerogativë e pushtetit mbretëror, kaluan në fazën e bashkimit të pronësisë dhe kontrollit, më pas në ndarjen e këtyre dy të fundit dhe diversifikimin e pronësisë, deri në konceptin e shoqërive me ofertë publike, pronarët e të cilave mbeten thuajse anonimë.

¹⁰ Shënim: Në Shqipëri, Fondi për Start-Up-et u krijua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 593, datë 10.9.2014, “Për mbështetjen e ndërmarrjeve Start-Up”. Fondi synon të mbështesë bizneset e sapoformuara Start-Up në Shqipëri, nëpërmjet subvencioneve të drejtpërdrejta financiare, duke përmirësuar klimën dhe kushtet e tyre të punës, me qëllim krijimin e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik dhe mundësive për punësim. Shuma totale e fondit është 25 milionë lekë për një periudhë 4-vjeçare. Skema mbulon 70% të shpenzimeve të miratuara. Një kompani mund të përfitojë një shumë totale 300,000 lekë për projektin. Sektorët e mbuluar nga ky fond janë:

- Prodhimi dhe sektori i shërbimeve;
- Sektori i industrisë së lehtë;
- Sektori i turizmit;
- Hulumtimi dhe zhvillimi;
- Agropërpunimi;
- Dizenjimi, modelimi, artizanati (marrë nga Vendimi Nr. 246, datë 9.5.2018, “Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2018–2020”, faqe 28; gjendet në <http://efzhr.kryeministria.al/images/DokumentaStrategjik/PKIE%202018-2020.pdf>)

Fragmentarizimi pronësisë është një rrjedhojë jo e qëllimtë e lindjes dhe zhvillimit të shoqërisë me ofertë publike (The Economist, 2015: 22). Ndërkohë duhet marrë në konsideratë dhe krijimi i llojeve të rejave të biznesit në rrjedhën e kohës si biznesi social, start –up, ndërmarrjet sociale etj.

Start up nga ana tjetër kanë funksionuar ndryshe: lidhja midis pronësisë dhe përgjegjësisë është e ngushtë¹¹ (The Economist, 2015:9). Themeluesit, stafi dhe mbështetësit ushtrojnë kontroll drejtpërdrejt (The Economist, 2015:9). Në Shqipëri ka disa ekosisteme¹², që përbëjnë rrjetin e komuniteteve të startup (Monitor, 06/12/2019 10:08 PM).

Parë në këtë aspekt, nëse tendenca e themelimit të bizneseve do të ndjekë shembullin e *start up*- ve të tilla, biznese të themeluar nga një apo pak individë, të cilat nuk kanë nevojë për selitë apo zyrat klasike por mjaftohen me tryeza pune dhe një kompiuter, që iu drejtohen investitorëve alternativë në mungesë të mbështetjes nga bankat, që mbështeten nga akcelerаторët apo inkubatorët e biznesit, atëherë ndjekja me kujdes e zhvillimit të tyre si nga organizimi dhe funksionimi do të jetë një sfidë e re më vete. Së fundmi, por jo edhe të fundit mbeten dhe bizneset sociale, një koncept i ri dhe inovativ i cili mishëron në kuptimin më të ngushtë thelbin e përgjegjësisë sociale, por që në fund mbetet një biznes. Megjithëse nuk ka një përkufizim të vetëm të biznesit shoqëror si një nocion, mungesa e tillë nuk e ka penguar atë të bëhet një fenomen në rritje. Përkufizimi më i spikatur ofrohet nga Muhamed Yunus¹³, i cili e konsideron biznesin social një lloj të ri biznesi kushtuar zgjidhjes së

¹¹ Mjaft të përmendim shembullin e sipërmarrjeve të tilla si Google, apo Facebook, themeluesit e të cilave, drejtuan shoqëritë për shumë kohe para se të ktheheshin në shoqëri publike.

¹² Sipas VKM-në nr. 593, datë 10.9.2014, “Për mbështetjen e ndërmarrjeve Start-Up”, Sipërmarrje e re ose “Start-up” do të konsiderohet një kompani e sapokrijuar dhe në kërkim të tregjeve.

¹³ Profesor Muhammad Yunus, laureat i Çmimit Nobel për Paqe dhe themelues i organizatës së parë të mikro-kreditit Grameen Bank.

problemeve sociale, ekonomike dhe mjedisore që kanë pllakosur prej kohësh njerëzimin - uria, të pastrehët, sëmundjet, ndotja, injoranca, qartësisht qëndron midis organizatave fitimprurëse dhe jofitimprurëse. Biznesi social në Shqipëri është tani një realitet i prekshëm, si zyrtarisht për sa i përket legjislacionit dhe në praktikë, në bizneset sociale që operojnë në treg. Në një biznes social, investitorët apo pronarët mund të marrin gradualisht paratë që kanë investuar, por nuk mund të marrin asnjë dividend përtej kësaj pike. Ky lloj biznesi ka si qëllim investimin dhe arritjen e objektivave sociale përmes operimit të kompanisë dhe nuk kërkohet fitim personal nga ana e investitorëve¹⁴.

1.8 Struktura e punimit

Punimi është ndërtuar i ndarë në kapituj.

Në këtë kapitullin I bëhet një prezantim sintetik i temës, hipotezës dhe pyetjes kërkimore së bashku me metodologjinë në themel të punimit. Kapitulli jep sfondin ligjor, historik dhe praktik ku mbështetet kërkimi, kufizimet e tij, së bashku me rëndësinë që beson të ketë.

Në kapitullin II bëhet një panoramë e zhvillimit historik i së drejtës dhe shoqërive tregtare, përfshirë konceptet kryesore të lidhura ngushtësisht me to. Trajtohet si lindën shoqëritë e para tregtare deri në formën që i njohim dhe i kemi sot të pranishme ai aktorë në treg, dhe roli që luajnë ato.

Kapitulli III i kushtohet zhvillimit historik të të së drejtës tregtare në vend, pasi është pikërisht Korniza Ligjore e Shqipërisë, që është dhe në thelb të këtij punimi. Kapitulli nis me një

¹⁴Shih: Revista Business Mag, 18/04/2019, “6 bizneset sociale më dinamike vitet e fundit në Shqipëri”, gjendet në https://businessmag.al/6-bizneset-sociale-me-dinamike-vitet-e-fundit-ne-shqiperi/?fbclid=IwAR0J4a_OVq5c1LyCMkUSIb66znnJCQNGt9RPvOD5rzZ4VBR6KXQYXPRpDfM

panoramë që nga viti 1912 deri në 1944, duke vënë theksin te arritjet pozitive gjatë periudhës së A. Zogut me zhvillimet e rëndësishme në legjislacion si Kodi Tregtar etj. Trajtohet e drejta tregëtare në periudhën 1944 – 1990, e drejta tregëtare në periudhën 1990 – 2007 (“Reforma e parë”) dhe Reforma e dytë, nga viti 2007 e në vijim.

Në Kapitullin IV dhe V bëhet analiza e dy teorive, përkatësisht në Kapitullin IV, teoria e aksionarëve të Friedman dhe në Kapitullin V, teoria e grupeve të interesit të Freeman, në një rrafsh historik, që nga lindja e tyre, veçoritë, përmbajtja dhe kritika ndaj tyre.

Kapitulli VI bën analizën e Ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” në dritën e teorive normative dhe qasja e tij ndaj tyre. Ky kapitull përmban dhe raste të praktikës gjyqësore në vend për ilustrim.

Kapitulli VII i takon qeverisjes së korporatës dhe përgjegjësisë sociale të korporatës, të cilat janë dhënë në plan krahasues me modelet e vendeve të tjera së bashku me ilustrime të hulumtimeve të shoqërive tregtare në vend.

Punimi mbyllet me Kapitullin VIII i cili përmban përfundimet dhe rekomandimet në dritën e punimit të bërë.

Bibliografia e përdorur dhe e referuar në punim, është vendosur në fund në seksionin “Bibliografia”.

KAPITULLI II ZHVILLIMI HISTORIK I SË DREJTËS DHE SHOQËRIVE TREGTARE

2.1 Historik i shkurtër i “Zotësisë juridike”, “Personalitetit juridik” dhe “Shoqërive tregtare”

Shoqëria tregtare në formën që njohim sot nuk ka qenë e tillë në fillimet e saj. Koncepti i “*personit juridik*” është krijuar dhe përpunuar në rrjedhën e shekujve dhe merr kuptim në kontekstin e juridiksionit që zbatohet. Ndonëse “personi juridik” i organizuar në forma të ndryshme, e gjejmë në të drejtën romake, teoria e personave juridikë nuk është e përpunuar në të drejtën romake¹⁵ (Mandro, 2007). Ajo iu nënshtrua ri interpretimeve të rëndësishme në shekullin XVI dhe ishte subjekt i debateve të zgjeruara teorike në shekullin XIX, ku u shquan veçanërisht studiuesi “*Romanist*” Friedrich Carl Von Savigny dhe “*Gjermaniku*”, Otto von Gierke (Malmendier, 2005), teoritë e të cilëve do të trajtohen më poshtë.

2.2 E drejta romake

Me lindjen e së drejtës romake, *populous romanus* është enti i parë që njihet si i tillë dhe i përjetshëm. Shteti romak¹⁶ (*aerarium*) nga ana tjetër, i cili zuri vendin e fisit, kishte funksione publike dhe private, që nënkuptonte që ai merrte pjesë në marrëdhënie të tilla si shitblerje pasurie, marrëdhënie qiraje etj. Status juridik kishte dhe thesari shtetëror (*fiscus*)¹⁷, si dhe

¹⁵ E drejta romake i referohet rendit juridik të Romës antike, e shtrirë në një hark kohor prej trembëdhjetë shekujsh (753 p.e.s – 565 e.s.).

¹⁶ Juristët e lashtë romakë e kishin përcaktuar shtetin si “*res publica*”, pra si një organizatë që ekziston për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të të gjithë banorëve... (Mandro, 2007).

¹⁷ Pasuria perandorake (*fiscus*), e cila përmbante porotofolin e Perandorit, përfitoi një personalitet të veçantë ligjor. Përmes zyrtarëve të saj mund të ishte e pranishme si palë në procese gjyqësore dhe mund të përfitonte pasuri përmes një varieteti mënyrash, për shembull, përmes konfiskimit të pasurive të trashëgueshme. (Shih A. Borkowski & Paul du Plessis, “E drejta Romake”, UET press, ISBN 978-99956-39-10-5, faqe 135, 136)

komunitete të tilla publike si tempujt, *municipia*¹⁸ e *coloniae* (territoret jashtë Romës) si dhe *collegium*¹⁹ të cilat ishin shoqata të cilat i shërbenin një qëllimi publik, kryesisht me natyrë fetare, politike, profesionale etj.

E drejta e lashtë romake²⁰ nuk dallonte zotësinë juridike publike nga ajo private. Në kohën e Republikës së hershme u bë ndarja e personalitetit publik dhe privat të personave juridikë (Mandro, 2007). Nga njëra anë është fisi, vendin e të cilit më pas e merr shteti romak dhe nga ana tjetër janë disa bashkësi veprimtaria e të cilave duhet të ishte në përputhje me rendin juridik në mënyrë që të legjitimohej ekzistenca e tyre. Për juristët romakë “person” kryesisht nënkuptonte qenie njerëzore, por kishte raste kur entitete jonjerëzore njiheshin si subjekte të drejtash dhe detyrimesh (Borkowski & du Plessis, 2010: 134). Në disa aspekte, këto entitete *trajtoheshin* si persona juridikë, megjithëse nuk *përshkruheshin* në këtë mënyrë (Borkowski & du Plessis, 2010: 134). Dyndja e pasurive në Romë, si rezultat i një vargu burimesh, por sidomos pasuritë e luftës, sollën një varg ndryshimesh në strukturën social ekonomike të vendit (Anastasi, 2004: 106). Pasuritë e krijuara tashmë ndër vite ishin një formë e interesit vetjak pasuror, duke sjellë kështu lindjen e kapitalizmit financiar²¹. Ajo që interesonte

¹⁸ *Municipia* (bashkitë) përfshinin llojet e ndryshme të komunitetit local që gjendeshin në Perandorinë Romake... [] Komuniteti vepronte përmes përfaqësuesve të tij, por shihej si mbartës i një personaliteti juridik të ndryshëm nga ai që kishin banorët e tij. (Shih A. Borkowski & Paul du Plessis, “E drejta Romake”, UET press, ISBN 978-99956-39-10-5, faqe 135).

¹⁹ Këto ishin kryesisht shoqata ose shoqëri private, shpesh të formuara si shoqëri tregatre ose klube funeralesh, dhe që i përkushtoheshin një zoti të caktuar. Numri i tyre u rrit shumë gjatë Republikës, dhe ndoshta mbartën pasoja të rrezikshme në kushtet e trazuara të shekullit të fundit p.e.r. [] nuk është e qartë se çfarë personaliteti juridik zotëronin këto shoqata. (Shih A. Borkowski & Paul du Plessis, “E drejta Romake”, UET press, ISBN 978-99956-39-10-5, faqe 134).

²⁰ Periudha e lashtë përkon me krijimin e Romës, 753 p.e.s deri në shekullin e dytë p.e.s.e cila shquhet për formalizmin, ashpërsinë e normave, dhe karakterin personal të tyre vetëm për qytetarët romakë dhe jo për të huajt.

²¹ Në këtë kohë mjaft shoqëri private u lidhën me njëra – tjetrën duke krijuar truste (trusts) të vërteta. P.sh. në vitin 61 kemi marrëveshjen e Bitinias, që dëshmoi lidhjen në shoqëri të mëdha (shih Anastasi A. “Historia e institucioneve”, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë 2004, faqe 106).

tashmë, ishte jo aq ndërtimi i një jete të qëndrueshme ekonomike, por investimi i parasë dhe i të ardhurave të saj (Anastasi, 2004: 106). Sipas Anastasit (2004): “Kapitalistët në këto shoqëri merrnin kuotat e tyre, *partes*, sipas kontributit që kishin dhënë në shoqëri. Asambleja e shoqërisë mbledhej çdo vit në Romë në mënyrë të detyrueshme. Secili prej anëtarëve të shoqërisë mund të merrte drejtimin e saj në një periudhë të caktuar... shpesh kjo normë bëhej e perealizueshme”. Organizime të tilla ekonomike ishin të zakonshme deri me ardhjen në pushtet të Jul Çezarit i cili nuk i përkrahu më dhe nxiti shpërbërjen e tyre.

Duke filluar nga fundi i shek. II, shoqëritë vepronin të pavarura nga anëtarët e tyre. Ato stipulonin kontrata, zotëronin pasuri, fitonin para (Anastasi 2004: 107). Sipas Ulpianus, “*çdo gjë që i detyrohet korporatës, nuk është për shkak të anëtarëve individualë të saj, dhe as këta të fundit nuk zotërojnë atë çfarë ka e gjithë shoqata*” (Welters, 2013: 419). Për sa më sipër vlen të theksohet një aspekt i rëndësishëm i personalitetit të veçuar të korporatës romake: *parimi i ndarjes së të drejtave dhe detyrimeve të korporatës nga ato të anëtarëve të saj*. Të rëndësishme në këtë periudhë janë dhe shoqëritë e tregëtisë së skllëvërve (*venaliciarii*), shoqëritë bankare (*argentarii*) si dhe bursa e Romës²².

Në periudhën e të drejtës klasike²³, shteti si mbajtës i pushtetit ka tagrin ekskluziv të krijimit dhe themelimit të personave juridikë publikë, me anë të ligjeve, edikteve apo traktateve. Shteti ruante dhe të drejtën e suprimimit të tyre. Përsa i përket personave juridikë të së drejtës

²² Ky tip kapitalizmi e shkëputi tërësinë e popullsisë nga puna prodhuese. Pronarët e vegjël arrinin deri aty sa të shisnin tokat e tyre për të luajtur në bursën që u hap në Romë (mendohet që bursa e Romës të jetë hapur që në vitin 180 por më i sigurt është viti 140). (shih Anastasi A. “Historia e institucioneve”, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë 2004, faqe 108).

²³ Periudha klasike sipas klasifikimit të Arangio Ruiz, ndryshe njihet si periudha e principatit e cila nis me Principatin e Augustit deri në fillimet e shekullit të IV e.s. Në këtë periudhë të gjithë banorëve të Romës iu dha shtetësia romake nëpërmjet Constitution Antoniana në vitin 212 e.s. Në këtë periudhë shkenca juridike njohu zhvillime shumë të rëndësishme.

private, lindja e tyre ishte ose shprehje e vullnetit të organeve shtetërore ose shprehje e vullnetit të personave privatë, e cila duhej më pas të “*autorizohej*” nga organet shtetërore.

Personat juridikë privatë ndaheshin në ndërmarrje ekonomike, në shoqata dhe në fondacione me qëllim plotësimin e detyrave politike, sociale, kulturore, humanitare dhe detyra të tjera jo ekonomike (Mandro, 2007).

Krijimi i personave juridike privatë kërkonte iniciativën e qytetarëve të Romës, vullneti i të cilëve duhej të mbështetej dhe të zyrtarizohej me një leje nga ana e organeve shtetërore. Në varësi të statusit që do të kishte personi juridik privat, kushtëzohej dhe leja që jepej: leje e veçantë kur statusi ishte i veçantë dhe “*sui generis*”, leje e përgjithshme kur statusi i tyre ishte tipik. Mbledhja e anëtarëve kishte të drejtë të suprimonte personin juridik privat. Gjithashtu ai mund të suprimohej edhe në rastin e humbjes së anëtarëve dhe pasurisë. Pas suprimimit, pasuria e personave juridikë ose i kalonte arkës së shtetit ose i dorëzohej personit juridik të ri që do të kishte të njëjtin qëllim ose mund t’i ndahej anëtarëve të tij (Mandro, 2007).

Vlen të theksohet në këtë moment që e drejta romake e periudhës klasike me suprimimin e personit juridik privat, njeh në këtë mënyrë “*shtetëzimin*” e pasurisë së tij kur pasuria i kalon shtetit, suksedimin e të drejtave të personit të suprimuar te një person i tretë, si dhe rishpërndarjen e kësaj pasurie të anëtarët e saj.

Sipas Malmendier²⁴ (2005), forma e organizimit të biznesit në Romë në periudhën klasike ishte nëpërmjet themelimit të *societates*, të cilat ishin një bashkim kontraktual i një grupi

²⁴ Malmendier, Ulrike. “Roman Shares”: W. Goetzmann and G. Rouwenhorst (eds.), *The Origins of Value. The Financial Innovations that Created Modern Capital Markets*. Oxford University Press, August 2005, pp. 31-42, 361-365.

njerëzish për një qëllim të përbashkët, me një kohëzgjatje të caktuar (*vel ad tempus vel ex tempore*) ose të pacaktuar (*in perpetuum*). Krijimi i *societates* (ortakërisë) kërkonte vullnetin e ortakëve për të themeluar *societas*, vullnet i cili mbart interesin e përbashkët për një qëllim të ligjshëm biznesi dhe kontributin e ortakëve. *Socius* (ortaku) duhet të kontribuonte në formë financiare (para), njerëzore (aftësi dhe punë), ose në forma të tjera si mallra, tituj etj (Malmendier, 2005). Ortakët kishin të drejta dhe detyrime ndaj njëri – tjetrit, por nuk ishin në pozitën që të përfaqësonin *societas* si një të tërë (Malmendier, 2005). Kjo bënte që dhe prona të mos i përkiste këtij asociimi në ortakëri por *socii*-t.

Forma e organizimit kushtëzonte dhe jetëgjatësinë e *societas* duke bërë që ajo të përfundonte me vdekjen e *socii*-t, me dorëheqjen e tij nga ortakëria, përmbushjen e qëllimit ose në rastin e themelimit të *societas* me kohëzgjatje të caktuar me përfundimin e këtij afati.

Në interpretim të veprës së Gaius, “Institucionet”, Malmendier (2005) identifikon 4 format kryesore të *societas* të cilat janë:

- (1) *Societas omnium bonorum* – prona e tashme dhe e ardhshme e ortakëve bëhej pronë e të gjithë *socii* (ortakëve);
- (2) *Societas omnium bonorum quae ex quaestu veniunt* – formati tregtar standard sipas të cilit prona e ortakërisë kufizohej te çfarë kishin fituar ortakët duke vepruar për qëllimet e *societas*;
- (3) *Societas alicuius negotiationis* – forma më e zakonshme sipas së cilës ortakëria kufizohej te fitimet e humbjet për një biznes të caktuar;
- (4) *Societas unius rei*, e cila kishte si qëllim vetëm një transaksion të vetëm;

Societas bashkohen në faktin se të të drejtat dhe detyrimet e tyre si rregull i përgjithshëm nuk janë të ndashme nga ato të anëtarëve themeluese të tyre. Një formë e veçantë e organizimit

në Romë është dhe *societas publicanorum* të cilat shërbenin për kryerjen e punëve publike apo mbledhjen e taksave. Për shkak të natyrës së tyre të lidhur drejtpërdrejt me financat dhe thesarin e shtetit, ekzistenca e tyre nuk kushtëzohej nga ortakët individë si në rastin e *sociataes*.

Në të drejtën post klasike , ndonëse nuk kanë një vëmendje të veçantë në Corpus Iuris Civilis, personat juridikë janë:

Universitas personarum – personi juridik me qëllim ekonomik, politik, social, humanitar ose fetar që kishte pasurinë e vetë dhe anëtarë të ndarë (Mandro, 2007).

Universitas rerum - personi juridik që zotëronte pasuri por jo organe të veçanta të cilat kishin më tepër një natyrë sociale apo fetare si kishat, azilet, spitalet etj.

Shoqatat e detyrueshme, anëtarësia në të cilat ishte e detyrueshme dhe e përhershme, si shoqatat e zejtarëve, punëtorëve etj. Qëllimi i shoqatave që krijonte shteti ishte stabilizimi ekonomik dhe forcimi i shtetit (Mandro, 2007).

Ndonëse këto forma ngjasojnë me korporatën (shoqërinë) tregtare, shoqëritë romane nuk kishin dy elemente thelbësore të një shoqërie tregtare: përzgjedhja dhe shkarkimi i drejtuesve dhe mungesa e një mënyre për të marrë pas investimin pa pasur nevojë për të hequr pjesë nga kapitali (Gorezi, 2011: 19).

2.3 Periudha e Mesjetës e më tej

Me rënien e Perandorisë Romake, edhe normat juridike që rregullonin krijimin dhe funksionimin e personave juridikë privatë dhe publikë u dobësuan apo edhe nuk u zbatuan më. Burimet historike tregojnë se fiset gjermane pohonin se entiteti i një grupi, duhet të ketë

një identitet *të ndryshëm* nga ai i anëtarëve të tij (Llaci, 2012), një parim ky që njihej në të drejtën romake.

E drejta tregtare pati periudhën e saj të ndryshimit kryesor në fund të shekullit XI dhe XII (Berman, 1983, përkthim Shehu 1999:60²⁵). Kësaj periudhe i përkasin formimi i koncepteve bazë dhe institucioneve të së drejtës tregtare moderne perëndimore – *lex mercatoria* (ligji i tregtarëve) – dhe ajo që është më e rëndësishme, në këtë periudhë e drejta tregtare filloi të shihej, për herë të parë në perëndim, si një sistem integral, në zhvillim, si një degë e njësuar e së drejtës (Berman, 1983, përkthim Shehu 1999:60).

Pra, shoqëria jotregtare është një formë e hershme, fillimisht e përdorur për qytetet, gildet²⁶ dhe kolonitë në Romë dhe në fillim të Mesjetës edhe për universitetet, urdhërat fetarë dhe të ashtuquajturat organizatat bamirëse të cilat kryenin shërbime civile dhe si të tilla ishin subjekt i autorizimit dhe mbikqyrjes nga shteti (Colley, Doyle, Logan & Stettinius, 2003).

Statusi i personit juridik në periudhën mesjetare i atribuohet gjerësisht kishës dhe institucioneve të saj dhe përpunimit të së drejtës kanonike, e cila lejonte krijimin e tyre si *personae fictae* juridikë në mënyrë që të merrnin dhe zotëronin prona si një mekanizëm për shmangien nga tatimet (Dignam, Galamis, 2016). Kjo bën që në këtë periudhë të dominojnë të organizuara si person juridik, organizmat apo asociimet me natyrë fetare, urdhërat e ndryshëm fetarë, si dhe qytetet e universitetet. Këto ishin organizata kolektive – si një masë mbrojtëse ndaj pushtetit të centralizuar të autokratëve dhe si një mënyrë për të krijuar pasuri dhe pushtet të pavarur nga pushteti mbretëror. Elementët kryesorë që i dallonte këto

²⁵ Shënim: Shkëputur nga libri “Law and revolution: the formation of the western legal tradition”, Harold Berman, Cambridge, Harvard University Press, 1983, botuar pjesërisht në Revista Juridike, Nr.1, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë, Qershor 1999, përkthyer nga Linda Shehu, faqe 60-88).

organizma ishte që ato ekzistonin të pavarura nga anëtarësia e tyre, dhe të gjithë asetet dhe investimet i përkisnin organizmit si njësi dhe jo anëtarevë të saj.

Shekulli XI dhe XII u karakterizua nga shtimi i prodhimit bujqësor, zhvillimi i bujqësisë dhe rritja e numrit dhe madhësisë së qyteteve, ku padyshim zhvillimi i bujqësisë, krijimi i tepricës dhe nevoja për gjetjen e tregjeve për shitjen e tyre, luajti një rol të rëndësishëm. Karakteristikë tjetër e kësaj periudhë është dhe lindja e klasës së tregtarëve profesionistë. Pikërisht, zhvillimi i sistemit të së drejtës tregtare u krye, në rradhë të parë, për të përmbushur nevojat e klasës së re të tregtare (Berman, 1983, përkthim Shehu 1999: 61), klasë e cila ishte parakusht për zhvillimin e kësaj të drejte. Deri para kësaj kohe, figura e tregtarit ishte më tepër në kuadrin e shitësve ambulantë që shkonin nga njëri vend në tjetrin. E drejta tregtare rregullonte jo vetëm shitjen në kuptimin e ngushtë të fjalës, por edhe aspekte të tjera të veprimeve tregtare, duke përfshirë transportin, sigurimin dhe financimin (Berman, 1983, përkthim Shehu 1999: 61).

Konceptet dhe institutet e para të së drejtës tregtare padyshim që i “detyrohen” së drejtës së romake, Kodeve të Justinianit dhe deri diku edhe *ius gentium* - it të cilit e drejta romake i kishte besuar rregullimin e disa veprimeve tregtare. Larmia e çështjeve dhe veprimeve tregtare të Europës në këtë periudhë kuptohet që nuk mund të mjaftohet me vetëm të drejtën romake apo *ius gentium*. Është karakteristikë e kohës që zhvillimi fillestar i së drejtës tregtare iu la në pjesën më të madhe, ndonëse jo tërësisht, vetë tregtarëve, të cilët organizonin panairë dhe tregje ndërkombëtare, formonin gjykata tregtare dhe hapnin zyra tregtare në komunitetet e reja urbane që po shpërthenin në të gjithë Europën Perëndimore (Berman, 1983, përkthim Shehu 1999: 61).

Nga ana tjetër nuk mund të lihet pa përmendur edhe roli i kishës. Kisha së bashku me institucionet e saj ishte zotëruese pronash dhe angazhohej në aktivitete tregtare, ashtu si në të njëjtën kohë kishte vendosur ndalime ndaj spekulimeve dhe fajdesë, apo kishte sanksionuar kategori përjashtimesh të shkeljes së doktrinës çka mundësonte përfitime për të nga aktiviteti tregtar dhe justifikim të shumë praktikave tregtare. Aktivitetet materiale të atyre që angazhoheshin në ndërmarrje tregtare duhej të organizoheshin në mënyrë të atillë që t'i shëronin ata nga mëkati i kopracisë. Tregtarët duhej të formonin gilde që kishin funksione fetare dhe do t'u qëndronin standarteve të moralit në veprimet tregtare (Berman, 1983, përkthim Shehu 1999: 67). Tregëtia do të bazohej të mirëbesimi me qëllim përmbushjen e nevojave të ligjshme. Kështu e drejta e zhvilluar nga tregtarët për të rregulluar marrëdhëniet mes tyre, duhej të reflektonte dhe jo të kundërshtonte të drejtën kishtare, tek e cila tregtarët ishin po aq subjekt duke qenë anëtarë të komunitetit të kishës.

Pra, e drejta tregtare rregullonte një klasë të veçantë njerëzish (tregtarët) në vende të veçanta (panaire, tregje, porte); rregullonte marrëdhëniet tregtare në qytete dhe qyteza (Berman, 1983, përkthim Shehu 1999: 70). Sipas Berman (1983) e drejta tregtare dallohej për objektivitetin, universalitetin, reciprocitetin në raportin mes palëve, gjykimin e hapur me pjesëmarrje të palëve²⁷, integrimin dhe zhvillimin.

Rregullat tregtare të zhvilluara nga tregtarët nisën të mbledheshin dhe qarkullonin mes tyre. Këtu dalluan qytetet italiane të kohës të cilët u shquan për mbledhjen dhe shpalljen

²⁷ Sipas Berman (1983) gjykatat tregtare përfshin gjykatat e tregjeve dhe panairove, gjykatat e gildeve tregtare dhe gjykatat e zonave urbane, ky gjykatësit kryesisht zgjidheshin nga rradhët e vetë tregtarëve. Një lloj tjetër gjykatë tregtare ishte gjykata lokale detare në qytezat portuale, me juridiksion si në çështjet tregtare ashtu dhe mbi ato detare që kishin të bënin me transportin detar të mallrave.

sistematike të rregullave me të cilat rregullohej veprimtaria tregtare, derisa nisi kalimi gradual në përcaktimin më të saktë të të drejtave dhe detyrimeve të palëve dhe qasjen e tyre në formën e legjislacionit të shkruar. Bashkë me to nisën të shfaqen dhe format e reja të gjykatave tregtare.

Rregullat nisën të jenë më uniforme, më të përgjithshme dhe më pak diskriminuese, duke i dhënë atyre një karakter më universal. Përsëri u shquan qytetet italiane e më pas Anglia e Gjermania, të cilat nisën të lidhin traktate dypalëshe ku njihnin të drejtat e qytetarëve në lidhje me vendosjen në territoret përkatëse, zotërimin e pronave, angazhimin në tregti, liri besimi etj., kurse shqyrtimi i mosmarrëveshjeve bëhej nga komisione tregtarësh.

E drejta kishtare theksonte parimin e ndershmërisë dhe barazisë në lidhjen e kontratave. Jo vetëm që i bëri të detyrueshme marrëveshjet gojore joformale, por edhe refuzoi të bënte të detyrueshme shumicën e marrëveshjeve formale nëse ishin rezultat i një mashtrimi ose edhe i një keqkuptimi (Berman, 1983, përkthim Shehu 1999: 75). Me disa ndryshime apo përshtatje, këto parime u përfshinë dhe u përvetësuan edhe në të drejtën tregtare ku tregtarët tashmë ishin një komunitet që qeveriste veten, i ndarë në vëllazëri fetare, gilde e shoqata të tjera (Berman, 1983, përkthim Shehu 1999: 76).

Në fund të shekullit XIII, e drejta tregtare mori karakterin e një sistemi të integruar parimesh, konceptesh, rregullash dhe procedurash. Të drejtat dhe detyrimet e ndryshme që rridhnin nga marrëdhëniet tregtare filluan në mënyrë të ndërgjegjshme, të interpretoheshin si pjesë përbërëse e një të tërë, e një trupi ligjor, e *lex mercatoria-s* (Berman, 1983, përkthim Shehu

1999: 79). Sipas Berman (1983), nga shekulli XI deri në shekullin XIII, e drejta tregtare pati disa karakteristika dalluese²⁸ si:

- Pranimin e vlefshmërisë së marrëveshjes joformale gojore për efekt të blerjes dhe shitjes së pasurisë së patundshme;
- Zhvillimin e instrumentave tregtare si kambiale dhe premtim pagese;
- Krijimin e markave dhe patentave;
- Dhënien me shumicë të huave publike, të siguruara nga obligacionet dhe letrat e tjera me vlerë;
- Zhvillimin e institucioneve bankare që shfrytëzonin depozitat;
- Zëvendësimin e konceptit individualist Greko – Romak të shoqërisë (*societas*) nga një koncept më shumë kolektivist, i cili bazohej mbi bashkëpronësinë. Pronësia vihej në dispozicion të të shoqërisë njësi dhe të drejtat dhe detyrimet një ortaku mbijetonin në rast se vdiste ortaku tjetër;
- Zhvillimin e ndërmarrjes së përbashkërt (*commenda*), si një lloj shoqërie anonime, ku përgjegjësia e çdo investitori kufizohej në vlerën e investimit të tij;

2.4 Personaliteti juridik i korporatës

2.4.1 Qasja e Savigny

Për Friedrich Carl Von Savigny një marrëdhënie juridike mund të ekzistojë vetëm mes personave si subjekte të cilët në angazhimin e tyre e konsiderojnë njëri – tjetrin të aftë që të

²⁸ Për më shumë shih: libri “Law and revolution: the formation of the western legal tradition”, Harold Berman, Cambridge, Harvard University Press, 1983, botuar pjesërisht në Revista Juridike, Nr.1, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë, Qershor 1999, Botues Horizont, përkthyer nga Linda Shehu, faqe 60-88).

marrin përsipër rolin e subjektit juridik. Në mënyrë natyrore, njerëzit janë subjekte në një marrëdhënie juridike. Njerëzit për Savigny, dallojnë nga personat e tjerë të cilët nuk janë të vërtetë, sepse ekzistojnë në mënyrë natyrore. Këto entitete sipas Savigny mund të jenë gjithashtu subjekte juridike ose persona juridikë, por vetëm sepse e drejta i bën të tillë (Dignam, Galamis, 2016). E drejta iu jep atyre këto attribute që iu lejojnë atyre të njihen si subjekte në marrëdhëniet juridike (Dignam, Galamis, 2016). Pra e thënë ndryshe, personi juridik është një krijesë fiktive, artificiale e cila ekziston vetëm për shkak të së drejtës e cila e njeh atë si të tillë, e legjitimon duke i mundësuar në këtë mënyrë ekzistencën dhe funksionimin e tij. Pa një të drejtë që të njohë këtë person dhe të sanksionojë jetën e tij, personi juridik nuk ekziston. Në të kundërt, e drejta e bën atë subjekt në marrëdhënie juridike, të ketë të drejta dhe detyrime, dhe njëkohësisht të ketë të garantuar në këtë kontekst dhe njohjen e tij nga subjektet e tjera me të cilët ndërvepron. Në këtë kuadër *shoqëria është një krijesë fiktive, artificiale që ekziston në kontekst të së drejtës*. Por nëse e drejta është e lidhur ngushtësisht me shtetin, atëherë veprimtaria e shoqërisë duhet parë dhe në kontekstin e shtetit, interesin dhe investimin e këtij të fundit në shoqërinë si person juridik dhe si person qënia e të cilit kushtëzohet direkt nga e drejta dhe indirekt nga vetë shteti.

2.4.2 Qasja e Gierke-s

Si një alternative ndaj teorisë së shoqërisë si krijesë fiktive, realizmi korporativ ishte mbase më i rëndësishmi, i advokuar nga Otto von Gierke (1841-1921) (Kribbe 2014:15). Studiuesi gjerman von Gierke e shihte shoqërinë (korporatën) si një entitet tërësisht i pavarur nga anëtarët e tij. Ky entitet sipas Gierkes është një person real. Argumenti është që në të gjitha shoqëritë kur individët bashkohen në grupe dhe shoqata, bëhet një kompromis mes

individualizmit dhe kolektivizmit (Dignam, Galamis, 2016). Grupi do të ketë qëllime dhe interesa të cilat nuk do të ndikohen nga ndryshimet e individëve anëtarë të tij, përkundrazi do të jenë këto qëllime dhe interesa të cilat do të kushtëzojnë anëtarësinë në të. Më e rëndësishmja, pasi u mbështet në nocionin e grupit si agjent, teoria duhej të shpjegonte se si shoqatat mund të kishin një vullnet që do të veçohen nga vullnetet e anëtarëve të tyre individualë, pa u mbështetur në ndihmën e fiktives ose përfaqësimit (Kribbe 2014:15). Realizmi i korporativ donte të rivendoste ekuilibrin duke theksuar se personaliteti i grupit ekzistonte në mënyrë të pavarur nga ligji (Kribbe 2014:15).

2.5 Themelimi i shoqërive të para

Korporata nuk do të ekzistonte pa konceptin e pronës private (Monks, Minow, 2003), pronë e cila nën “*tutelën*” që i ofronte korporata, zotërohej në kapërcim të prerogativave dhe pushtetit mbretëror. Kjo lloj ndërmarrje kolektive e një entiteti që mund të kufizonte ndërhyrjet nga monarku ishin bazat e korporatës modern (Monk, Minow, 2003). Me anë të këtyre organizimeve kolektive janë individët të cilët krijojnë pasuri për vete, e cila bëhet në të njëjtën kohë dhe një burim pushteti për ta. Lindja e një “*sektori privat*” kërcënonte jo vetëm pushtetin e trashëgueshëm të monarkut po dhe pasurinë e kishës (Monk, Minow, 2003), një kërcënim që shpejt do të kthehej në aleat të fuqishëm të vetë qeverisë, e cila nga njëra anë do të lejojë pronën private dhe nga ana tjetër do ta mbrojë atë. Shteti do të ruajë në duart e tij për një kohë të gjatë prerogativën për të “legjitimuar” organizimet tregtare kolektive nëpërmjet dhënies së lejesë së themelimit madje në situata të caktuara shteti do të

ndërhyjë për të shmangur dështime financiare të cilat dëmtonin vetë atë si dhe shtresa të caktuara të shoqërisë²⁹.

Në fundin e shekullit të XI, në disa vende të Europës, si në Itali, Angli etj, hasim në përdorimin e një lloji të ri të marrëveshjes tregtare: *commenda*. Në këtë marrëveshje e cila që marrëveshje ortakërie për një ndërmarrje / veprim të vetëm, angazhohej kapital për tregëti në distanca të gjata kryesisht detare³⁰, zakonisht një udhëtim vajtje – ardhje. Njëri nga ortakët, *stans*, ofronte kapitalin kurse ortaku tjetër, *tractator*, ndërmernte udhëtimin³¹. Si shpërblim për këtë rrugëtim të vështirë, ortaku udhëtues merrte ¼ e fitimit, ndërkohë që ortaku që vinte kapitalin e tij, merrte ¾ që mbeteshin (Berman, 1983, përkthim Shehu 1999: 84)³².

Commenda dhe *Societas Maris* ofronin avantazhin e madh që përgjegjësia e ortakëve kufizohej në masën e investimit të tyre fillestar (Berman, 1983, përkthim Shehu 1999: 85), por duhet pasur parasysh që ortakëria ishte vetëm për një udhëtim të caktuar dhe kohëzgjatja e ortakërisë zgjaste sa zgjaste udhëtimi. Në këtë mënyrë kjo formë ortakërie ndonëse

²⁹ Në vitin 1720, Parlamenti Britanik miratoi ligjin e njohur si Bubble Act i 1720, i cili erdhi si një masë mbrojtëse pas spekulimeve në shoqërinë East India. Ligji ndalonte themelimin e shoqërive aksionare pa një akt nga ana e vetë Parlamentit. Sipërmarrjet tregtare të cilat donin të përfitonin kapital nga emetimi i aksioneve duhet të pajiseshin paraprakisht me një akt themelimi të tillë. Nga ana tjetër, në të njëjtën kohë, Franca më 1720 i ndaloi shoqëritë aksionare. Compagnie de L'occident bleu borxhin e qeverisë franceze në këmbim të monopolist të tregtisë me Luizianën. Shoqëria emetoi aksione dhe rriti vlerën e tyre, stimuloi kërkesën për investime, cka rriti vlerën e tyre dhe po ashtu dhe kërkesën në të njëjtën kohë. Kjo “flluckë” shpërtheu më 1720. (për më shumë shih Monks, Minow, 2003, “Early Concepts of Corporation”, faqe 101; dhe Morck, Lloyd, “The Global history of Corporate Governance”, faqe 11).

³⁰ Një variant tjetër i *commenda-s* ishte *societas maris* (“shoqëria detare”), në të cilën *tractator*-i furnizonte 1/3 e kapitalit, *stans*-i 2/3 dhe fitimi ndahej midis të dyve në mënyrë të barabartë (Berman, 1983, përkthim Shehu 1999: 85).

³¹ *Stans* dhe *tractator* mund të këmbenin rolet në ndërmarrje të tjera, ose *stans* mund të angazhohej në pjesën e shitjes së mallrave /produkteve të blera. Në disa raste në rolin e *stans*, pra të investitorit mund të ishte një person pa përvojë në biznes.

³² Sikurse Lopes vë në dukje: “Kjo marrëveshje mund të duket e padrejtë, por në shekujt e dymbëdhjetë dhe trembëdhjetë, jeta ishte e lirë, ndërkohë që kapitali ishte i shtrenjtë” (Berman, 1983, përkthim Shehu 1999: 85).

ngjasonte me një shoqëri anonime, dallon si një marrëveshje me afat të shkurtër dhe të përcaktuar.

Teksa *commenda* përdorej kryesisht për udhëtimet tregtare detare, *compagnia* ishte formë ortakërie që përdorej për tregëtinë afatgjatë që bëhen nëpërmjet tokës, e cila fillimisht nisi si një “sipërmarrje” familiare, pra persona nga e njëjta familje. Në kontrast me *commenda*-n, *compagnia* nuk kishte përgjegjësi të kufizuar; secili ortak përgjigjej pa kufizim ndaj të tretëve për detyrimet e shoqërisë (Berman, 1983, përkthim Shehu 1999: 85). Gjithashtu, një dallim tjetër ishte angazhimi në më shumë se një aktivitet tregtar, të shtrirë në një hark kohor disa vjeçar, çka bënte që *compagnia* të hapte degë për të qenë e pranishme në disa qytete.

Në bazë të këtyre marrëdhënieve ishte parimi më kryesor i mirëbesimit nga secili ortak dhe personaliteti kolektiv: ortakët vepronin së bashku në emër të shoqërisë dhe përgjigjeshin bashkarisht për detyrimet e saj, ashtu si dhe çdo ortak mund ta angazhonte shoqërinë vetëm dhe të përgjigjej personalisht për detyrimet e saj. Së bashku, ata përbënin një korporatë, në të njëjtin kuptim si dioqeza dhe famullia ishin korporatë, si edhe universiteti dhe gildi ishin korporatë; domethënë ata përbënin një trup vetëqeverisës, një komunitet, personaliteti i të cilit ishte si transhendent ashtu edhe imanent, domethënë, edhe i veçantë nga personat anëtarë të tij, ashtu edhe i lidhur me ata (Berman, 1983, përkthim Shehu 1999:86).

Pretendohet se korporata më e vjetër komerciale në botë të jetë *Stora Kopparberg Mining Community* në Falun, Suedi, e cila mori aktin e themelimit nga mbreti Magnus Ericsson në vitin 1347 (Llaci, 2012). Në Europë, shoqëritë e para aksionare lindën në Britani dhe Holandë në fillimet e shekullit XVII, si një përgjigje ndaj tregjeve në zhvillim të Indisë Lindore dhe Indisë Perëndimore (Monks, Minow, 2003), për të ndërmarrë misione tregtare (Blair, 2004:8). Muscovy Company në 1555, Kompania Spanjolle në 1577 dhe East India Company

në 1601 ishin shoqëritë e para të cilat u pajisën me statutet e para të themelimit si biznese gjatë mbretërisë së Elisabetës I (Colley, Doyle, Logan & Stettinius, 2003). Më 1623, Dutch East India Company³³ u pajis me statut mbretëror me kapital dhe aksione të përhershme me kohëzgjatje të pacaktuar (Monk, Minow, 2003), kurse British East India Company krahas kohëzgjatjes së pacaktuar, kishte dhe të drejtën e plotë të transferimit të aksioneve (Blair, 2004: 9). I njëjti shembull u ndoq në vijim dhe në ShBA.

2.6 Zhvillimi i shoqërive tregtare në shekullin XVIII - XX

Në shekullin XVIII dhe XIX pavarësisht ekzistencës së pak shoqërive aksionare të mëdha, të krijuara për të nxitur tregtinë e jashtme dhe kolonizimin ose për të manaxhuar shërbime utilitare, të gjitha ekonomitë kryesore dominoheshin nga forma biznesi jo të themeluara si persona juridike të cilat zotëroheshin dhe manaxhoheshin nga individët (Dignam, Galanis, 2016). Korporatat e para të mëdha ishin pothuajse kudo biznese familiare (Morck, Steier).

Në fakt, deri në shekullin XIX, edhe në SHBA dhe në shumë vende perëndimore, e drejta për të bërë biznes në formën e kompanisë (shoqërisë) ishte çështje e pushtetit mbretëror /

³³ E themeluar në 1602, dhe me një jetëgjatësi prej 2 shekujsh, Dutch East India Company ishte kompania e parë publike që lëshoi aksione të negociueshme. Ajo kishte një strukturë të brendshme të krahasueshme me atë që sot e njohim si modeli me një nivel. Bordin me 17 drejtorë kishte pushtet manaxhues universal dhe vepronte pothuajse i lirë nga cdo ndërhyrje nga ana e aksionarëve të pakicës. Problemi kryesor i qeverisjes lindi nga mungesa e përcaktimit të detyrave të drejtuesve në linjë me vendimmarrjen dhe interesat e shoqërisë. Në 1623, u themelua një komitet me 9 anëtarë i cili mund të shihet si një formë e hershme e këshillit mbikqyrës modern (Hopt, Leyens, 2004: 2). Më tej Rystemaj (2012) thekson se: “kjo shoqëri, përdori gjerësisht, marrëdhëniet ngushta me shtetin për t’iu ofruar garanci investitorëve të mundshëm në lidhje me rreziqet që mund të hasnin ndërmarrjet gjatë shekullit të 17. Pra, themeluesit e kësaj shoqërie përdoren forcën e pushtetit shtetëror për të tejkaluar dyshimet e investitorëve dhe për t’i tërhequr ata në financimin nevojave të tyre për kapital. Kjo mbështetje shtetërore u shfaq në formën e të drejtave ekskluzive apo monopol të dhëna nga shteti për ushtrimin e aktiviteteve të caktuara. Megjithatë, edhe pse mbështetja shtetërore shërbente si garanci, u vu re që në afat të gjatë, më shumë rëndësi kishte administrimi i brendshëm i shoqërisë” (Rystemaj 2012: 18). Për më tepër, në këtë kuadër vlen të theksohet dhe fakti se Holanda ka bursën më të vjetër në botë dhe sipërmarrësit e saj krijuan shoqëritë aksionare (Morck, Steier).

shtetëror ose kishtar dhe jo e interesave private ekonomike. Mbretërit ose Papa i akordonin statute kompanive publike të cilat premtonin përfitime publike si eksplorimi dhe kolonizimi i Botës së Re. Themelimi i shoqërive të tilla ishte një privilegj i cili ekzistonte për qëllime publike ndaj dhe grantet e hershme ishin për qëllime bamirëse ose për zgjerimin e pushtetit dhe interesave të Kurorës (Farrar, 199:206). Individët mund të zotëronin aksione në shoqëri, dhe t'i shisnin ato, (kuptohet me disa kufizime), por qëllimi nuk ishte thjesht t'u shërbente interesave të aksionarëve³⁴.

Në kolonitë amerikane, kompanitë e para të biznesit të themeluara gjatë shekullit të 18-të, u krijuan për të kryer shërbime të tilla si ndërtimi i infrastrukturës së transportit, furnizimit me ujë, mbrojtja nga zjarri etj (Hood, 1998). Në këtë mënyrë shteti realizonte funksionet e veta në lidhje me përgjegjësinë sociale, funksione të cilat më vonë, në kuadrin e shtetit të mirëqenies sociale, shteti i realizoi duke shtetëzuar pjesën më të madhe të ofrimit të shërbimeve.

Ndërkohë që gjatë shekullit XIX, në ShBA kërkesa për organizimin e biznesit në formë korporative ishte në rritje. Kjo sepse, forma korporative u pa si një mekanizëm i cili i lejonte sipërmarrësit dhe drejtuesit të “mbanin” kapitalin e investuar në sipërmarrje, duke bërë të mundur që të investonin në asete të caktuara afatgjata (Blair, 2004: 3)³⁵. Në të njëjtën kohë,

³⁴ Termi “drejtor” është përdorur së pari përgjithësisht në fund të shekullit të shtatëmbëdhjetë. Ai u përdor nga Banka e Anglisë dhe Banka e Skocisë (Farrar, 1999: 261).

³⁵ Shih Blair M, “Reforming Corporate Governance: What history can teach us”, 2004, Vol.1, Issue 1, (cit. Robert Wright, *The wealth of the nations rediscovered: Integration and expansion in American financial markets*, 159 – 61, 2002): Për të krijuar një korporatë duhej që legjislatura e shtetit përkatës të miratonte një akt të vecantë i cili i jepte themeluesve të drejtën për të krijuar një entitet ligjor të mëvetësishëm, për të poseduar asetet që do të përdoreshin nga sipërmarrja. Në vitin 1800 kishte vetëm 335 korporata biznesi në Shtetet e Bashkuara, dhe pjesa më e madhe e tyre ishin krijuar pas 1790. Në 1890, numri i tyre ishte rreth 500 000, më shumë se në cdo vend. Për të krijuar një korporatë duhej që legjislatura e shtetit përkatës të miratonte një akt të vecantë i cili i jepte themeluesve të drejtën për të krijuar një entitet ligjor të mëvetësishëm, për të poseduar asetet që do të përdoreshin nga sipërmarrja.

Shtetet e Bashkuara ishin transformuar nga një ekonomi e dobët dhe e varur, në një lider botëror të prodhimit industrial (Blair, 2004: 5). Zgjerimi i tregjeve dhe teknologjitë e reja në linjat e prodhimit ishin një faktor shumë i rëndësishëm i cili ndihmoi në përhapjen e korporatave. Fakti që korporata shihej si një entitet ligjor më vete me potencialisht afat të pacaktuar, e cila zotëronte asetet e përdorura në biznes, e bënë këtë formë si mënyrën e preferuar të organizimit të bizneseve, sidomos në rastin e bizneseve të mëdha dhe komplekse. Tipike për shoqëritë tregtare të shekullit IX është fakti që pronësia dhe kontrolli i tyre janë të integruara në një dorë të vetme: atë të pronarit – sipërmarrës / investitor, të cilët arrijnë që të manaxhojnë ngarkesën që dikton puna. Ndërkohë fundi i shekullit të IX- të do të shënojë një kthesë të rëndësishme me revolucionin e dytë industrial. Hovi i zhvillimit të telekomunikacionit, hekurudhave, minierave po përhapej gjerësisht në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara. Këto sipërmarrje mund të ndërmerreshin vetëm nga shoqëri të mëdha të cilat nuk drejtoheshin nga pronarët – sipërmarrës por nga një hierarki e zgjeruar manaxhuese kundrejt pagesës (Dignam, Galanis, 2016) në kuadër të operacioneve komplekse që zhvilloheshin dhe sistemit po aq kompleks që këto shoqëri po ndërtonin, si dhe zhvillimit të tregjeve të kapitalit si burim i ri i financimit të shoqërive.

Deri atëherë, kishin qenë vetë individët të cilët kishin siguruar financimin e bizneseve të tyre duke qenë në të njëjtën kohë investitorë dhe drejtues të shoqërive. Ndryshimet ekonomike të cilat diktuan nevojën për zgjerim të bizneseve, tregjeve dhe larmisë së produkteve të ofruara nxitën kërkesën për financime të reja qofshin këto dhe nga burime të reja. Tregjet e kapitalit ku aksionet e shoqërive ishin tituj të tregtueshëm ofronin pikërisht mundësinë jo vetëm për

injektim të burimeve të reja të financimit, po në dallim nga huatë e bankave³⁶, dhe mjetet e tyre financiare, investorëve të rinj, në këmbim iu ofrohej mundësia të bëheshin tashmë pjesë e shoqërisë në cilësinë e aksionarit, duke bërë kështu që struktura e shoqërive që deri atëherë kishte funksionuar në unitetin “drejtimi dhe pronësia në një dorë”, tashmë të diversifikohej në simbiozën e pronësisë së ndarë nga drejtimi³⁷.

Në këtë mënyrë shoqëritë tregtare që filluan të përhapen kudo filluan të drejtoheshin dhe administroheshin nga persona jashtë “petkut” të pronarit – sipërmarrës. Kur individët shërbejnë si drejtues të bizneseve, ata përfaqësojnë interesat e pronarëve të tjerë (Colley, Doyle, Logan & Stettinius, 2003). Këta drejtues në pjesën më të madhe të tyre ose zotëronin pjesë të vogla në kapital themeltar të shoqërive ose nuk ishin aspak pjesëmarrës në kapital. Për drejtimin e shoqërisë ata paguheshin duke shënuar kështu ndarjen e pronësisë nga kontrolli i shoqërisë, një fenomen që do të shënonte dhe një nga karakteristikat kryesore të shoqërive të kësaj periudhe: shoqëritë e drejtuara nga jo pronarët, të cilat erdhën gjithnjë e më në rritje duke u etiketuar madje (sipas Burnham) për lindjen e “klasës sunduese të manaxherëve”. Tashmë “*dora e padukshme*” e Adam Smith ishte zëvendësuar me “*dorën e dukshme*” të hierarkisë manaxhuese (Chandler, 1990).

Kështu lindën shoqëritë e mëdha të manaxhuara, fillimisht në SHBA dhe Gjermani e më pas në Britani dhe Japoni si aktorët dominues ekonomik të shekullit XX (Dignam, Galanis, 2016). Dhe në këtë situatë mundësia për konflikte interesi ekzistonte vërtet (Colley, Doyle,

³⁶ Kjo rezultoi në fazën e ardhshme të kapitalizmit bankar që e karakterizoi historinë e SHBA-së, Australisë dhe Zelandës së Re në shekullin XIX dhe në shekullin XX, të paktën deri në 1930 (Farrar. 1999:262).

³⁷ Përtej ndryshimeve strukturore në jetën e shoqërisë, ndarja e pronësisë nga drejtimi, thithja e investimeve nëpërmjet titujve të tregtueshëm në bursë, do të shënonte dhe një element thelbësor në jetën e shoqërisë: raportin mes drejtuesve jo pronarë dhe vetë pronarëve, duke ngritur dhe atë që më pas u njoh si “marrëdhënia përfaqësues – i përfaqësuar” apo “vlëra e aksionarëve”.

Logan & Stettinius, 2003). Vlen të theksohet se ndarja e pronësisë nga kontrolli nuk ndodhi në mënyrë të njëtrajtshme dhe të njësuar në këto vende. Ajo u kushtëzua nga karakteristikat e zhvillimit historik, ekonomik dhe social i këtyre vendeve, karakteristika të cilat përcaktuan dhe momentin e ndarjes së pronësisë nga kontrolli, çështja e cila do të trajtohet në vijim.

KAPITULLI III HISTORIKU I SHOQËRIVE TREGTARE DHE TË DREJTËS TREGËTARE NË SHQIPËRI

3.1 E drejta tregëtare në periudhën 1912 – 1944

Në dallim nga rendet juridike të cilat kishin një traditë të fortë juridike në fushën e së drejtës tregtare moderne, Shqipëria nuk ka një histori domethënëse në këtë degë të veçantë të së drejtës private (Tahiraj, Llozana, 2012). Deri në shpalljen e pavarësisë së vendit, në Shqipëri zbatoheshin “*Sheriati*” - e drejta osmane, përfshirë edhe marrëdhëniet tregtare³⁸.

Viti 1912 shënoi një kthesë historikë për Shqipërinë e cila i hapi rrugën zhvillimeve dhe një kursi të ri politik, ekonomik dhe social. Fitorja politike e 28 Nëntorit 1912, krijimi i shtetit të parë shqiptar pas gati pesë shekujsh nga pushtimi otoman, bëri që krerët më të spikatur të politikës dhe kulturës shqiptare, të mbështetur edhe në përvojën e vendeve të civilizuar, të krijojnë strukturat qeverisëse të këtij shteti (Angjeli, 2012). Një prej masave më të rëndësishme ishte ngritja e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, për ngritjen e së cilës qeveria e Ismail Qemalit bashkëpunoi me shtetet e mëdha perëndimore. Në marrëveshjen për ngritjen e bankës, “AKT KONQESIE” - një koncension 60 vjeçar - e cila u lidh në 4 tetor 1913 me përfaqësues të Wiener Bank Verein dhe të Banca Commerciale Italiana, parashikohej:

³⁸ Këto marrëdhënie rregulloheshin nga dispozitat e së drejtës osmane, dispozita të cilat ishin përmirësuar me hyrjen në fuqi të Kodit Tregtar Osman në 1850. Në vitet në vijim, Perandoria Osmane miratoi ligje të tjera që u frymëzuan nga modelin i së drejtës Franceze. Në vitin 1856 u miratua Kodi Tregtar Detar, në 1858 hyri në fuqi Kodi Penal Tregtar; në 1869 u miratua Megalla e cila kodifikoi të drejtën e detyrimeve dhe të drejtës procedural. Kodi ndiqte modelin e kodit francez të 1807 dhe përmbante dispozita të cilat rregullonin fusha të tilla si tregtia, falimenti dhe likuidimi. Pra, nga pikëpamja e rregullimit në një nivel kodi tregtar, Kodi Tregtar Osman i 1850 ishte kodi i parë tregtar që u zbatua në Shqipëri (Tahiraj, Llozana, 2012).

“[]... Për të krijuar një institut Banke të privilegjuar, shoqërie anonyme Shqiptare, e cila do të emënohet: BANKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË, dhe do të ketë të drejtën të mbajë armurat e Shtetit shqiptar”.

Fillimi i viteve ‘900, periudhë e cila përkoi dhe me ashpërsimin e kontradiktave të interesave italo-austriake në Ballkan, u shoqërua me disa shkrime në lidhje me mundësitë e investimit të kapitalit të huaj (kryesisht atij italian) në vend dhe ngritjen e bankave italiane në Shqipëri³⁹. Gjatë periudhës së Luftës I Botërore, Shqipëria u pushtua nga ushtritë e fuqive ndërluftuese. Kjo periudhë nga ana e pikëpamjes tregtare u përfaqësua nga veprimtaria e filialeve të bankave të huaja, kryesisht të bankave austriake⁴⁰, veprimtaria e të cilave ishte në fushën e kreditimit.

Pas revolucionit të 1924, një nga pikat e programit të qeverisë demokratike të kryesuar nga Fan S. Noli, ishte dhe lehtësimi i hyrjes së kapitalit të huaj dhe mbrojtja e organizimi i kapitaleve të vendit (Pika 25 e Programit)⁴¹. Në fakt, programi nuk u arrit të zbatohet. Qeveria ishte jetëshkurtër dhe me përmbysjen e saj, në pushtet erdhi Ahmet Zogu. Fillimi i mesit të

³⁹ Për më shumë shih Zarshati O. (2011) i cili përmend: []...Antonio Baldaçi, (Antonio Baldacci), specialisti italian i ekonomisë politike, botoi artikullin “Italia dhe tregtia jonë me Malin e Zi dhe Shqipërinë Veriore” (L’Italia e il nostro commercio con il Montenegro e con l’Albania Settentrionale). Në këtë artikull ai parashtronte që kapitali italian të ngrinte një bankë në Malin e Zi, e cila do të shërbente jo vetëm për investimin e kapitaleve në degë të ndryshme të ekonomisë të Malit të Zi, por do të bënte të mundur edhe ndikimin e kapitalit italian në ekonominë e Shqipërisë. Gjithashtu, në vitin 1903, në gazetën italiane “Il giornale d’Italia” (Gazeta e Italisë), që dilte në Romë, deputeti Antonio di San Giuliano, botoi artikullin me titull: “Letra për Shqipërinë” (Lettere sull’Albania). Në këtë artikull ai propozonte ngritjen e një banke italiane në Shkodër. Në vitin 1906, Battista Pelegrini (Battista Pellegrini), botoi në Romë librin me titull: “Drejt luftës? Mosmarrëveshjet mes Italisë dhe Austrisë” (Verso la Guerra? Il dissidio fra l’Italia e l’Austria). Në këtë libër Battista Pelegrini i propozonte qeverisë italiane të asaj kohe dhe përfaqësuesve të kapitalit Italian që të investonin veçanërisht për ngritjen e bankave italiane në Shqipëri”.

⁴⁰ Në këtë periudhë, austriakët hapën në Shkodër degë të bankave të mëposhtme: Wiener Bank-Verein, Pester Bank, Ungarische Bank (shih Zarshati, 2011).

⁴¹ Programi përmbyllet me fjalët: “Nuk mohojmë vështirësitë e plotësimit të premtimeve tona, as themi se ky program do të mbushet i tëri përnjëherësh, po ne jemi të bindur, o popull se me ndihmën e Zotit dhe me përkrahjen tënde do të mundim ta vëmë në zbatim gradualisht”.

viteve '20, shënoi një sërë zhvillimesh për ekonominë shqiptare. Filluan iniciativat për të organizuar shoqëri aksionere në fushën e industrisë, ndërtimit, transportit (Monitor, 2014). Në këtë kohë u krijuan 14 shoqëri të reja. Kapitali fillestar i tyre ishte 7.6 milionë franga ari, rreth 28% më shumë se kapitali i shoqërive të periudhës '21-'24. Në vitin 1928, numri i ndërmarrjeve arriti në 127. Kapitali vendas ishte 6 herë më i madh se në vitin 1927 (Monitor, 2014). Shumë kompani italiane, angleze, franceze e amerikane filluan të jenë pranishme në tregun shqiptar dhe nëpërmjet sigurimit të marrëveshjeve koncesionare apo nëpërmjet investimeve direkte që nisën aktivitetin e tyre⁴².

Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare (1 dhjetor 1928) i miratuar nga Asambleja Kushtetuese, në Titullin VI, “Të drejtat e Qytetasve”, në nenin 200 parashikonte shprehimisht: *“Art.200. Shtetasit shqiptarë, mbrenda kufinit të ligjëve kanë të drejtë të formojnë shoqnina (societies); përdorimi i kësaj të drejte nuk i nënshtrohet as ndonjë mase preventive”*. Gjithashtu në Titullin VII “Dispozita të ndryshme”, art. 219 parashikohej: *“Shteti njej personat morale të krijueme mbas ligjës”*.

Në qershor 1930 u mbledh Kongresi i Tregtarëve Shqiptarë, i cili shqyrtoi zëvendësimin e koronave prej argjendi që qarkullonin në Shqipëri, pasi mungesa e monedhave metalike bëhej shkak për vështirësi të shumta në transaksionet brenda vendit, duke sjellë dhe rritjen e çmimit të tyre. Në fakt gjatë kësaj periudhe (sidomos vitet 1924 – 1938), në Shqipëri janë shfaqur element të kapitalizmit, një legjislacioni bashkëkohor, në një sërë fushash, si dhe fenomene

⁴² I tillë ishte rasti i shoqërisë SISMA (Societa Italiana Sfrutamento Miniere Albania); shoqëria SEIA (Sociata Electrica Italo-Albanese); shoqëria ALBA (Azienda Lavori Boschi Albania); shoqëria EIAA (Ente Italiano Attivita Agraria); shoqëria SESA, që mori koncesionin e elektrikut në 7 qytete të Shqipërisë; shoqëria anglo-persiane “Oil Company”; shoqëria amerikane “Standart Oil Company”; sindikata franko-shqiptare e vajgurit; shoqëria gjermane INAG për shfrytëzimin e pyjeve etj.

tipike të ekonomisë së orientuar nga tregu që i gjejmë dhe në botën perëndimore (Llaci, Leskaj, 2000:5). Pavarësisht gjendjes së përgjithshme të prapambetjes social – ekonomike të vendit, hidhen hapat e parë në zgjerimin e veprimtarive prodhuese ekzistuese dhe krijimin apo hapjen e aktiviteteve të reja. Karakteristikë e kësaj periudhe është se, industria kombëtare u rrit vetëm me investimet e kapitaleve private dhe pa asnjë kontribut nga ana e shtetit (Llaci, Leskaj, 2000:6).

Pas vitit 1934 nisi rimëkëmbja e ekonomisë shqiptare. Kjo u shpreh në investimet e atëhershme në ekonominë e vendit, e cila vazhdoi të mbetej një ekonomi agrare. Investimet tashmë u konkretizuan nga forma të vogla manifature, në formën juridike të shoqërive tregtare dhe pikërisht të shoqërive aksionare. Duhet pohuar se, shoqëritë aksionare lindën si produkt objektiv i kohës, i proceseve të brendshme të ekonomisë shqiptare, i ndikimit të jashtëm dhe i kushteve të krijuara nga organet shtetërore zogiste për mbrojtjen e pronës private (Llaci, Leskaj, 2000:7). Nga shpallja e pavarësisë së Shqipërisë, në vitin 1912 e deri në fund të vitit 1924 (kohë që u karakterizua nga lufta dhe trazira), në degën e industrisë u krijua vetëm një shoqëri aksionare (STAMLES), ndërsa në vitet 1925 – 1939 u krijuan 20 shoqëri të tilla të rëndësishme (Llaci, Leskaj, 2000:7) të cilët operonin në fushën e duhanit (STAMLES në Durrës, SAIDE në Elbasan), kripës (SITA në Tiranë), çimentos, alkoolit etj. Njëkohësisht në këtë periudhë Shqipëria nis të presë dhe investitorë të huaj, (kryesisht italianë, francezë, amerikanë etj) të cilët u shtrinë në të gjitha degët e ekonomisë, falë dhe

koncensioneve si në ndërtimin e rrugëve, urave, transportit, minierë, naftë etj. Në vitin 1939 – 1944, është karakteristikë veprimi i shoqërive aksionere⁴³ (Llaci, Leskaj, 2000:8).

Rregullimi ligjor i sipërmarrjes në Shqipëri dhe sidomos në formën e tregtarëve dhe shoqërive tregtare, sipas së drejtës shqiptare daton që në fillimet e shtetit shqiptar në 1912. Në mbështetje të zhvillimeve ekonomike, kapitalit dhe investimeve të huaja, erdhën dhe ndryshimet në legjislacion, përfshirë dhe miratimin e ligjeve të reja bashkëkohore, mbështetur në përvojat e vendeve perëndimore. Megjithatë, në planin historik rregullimi i parë i mirëfilltë ligjor shqiptar në Shqipëri, në fushën e së drejtës tregtare, ishte Kodi Tregtar i Zogut (1932), hartuar nën drejtimin e statistit Mehdi Frashëri, i cili përbënte një reformë të rëndësishme që shpalli monarkia zogiste në fushën e legjislacionit. Deri në fund të muajit mars 1932 marrëdhëniet dhe konfliktet tregtare në Shqipëri vazhduan të rregulloheshin e të zgjidheshin sipas dispozitave të legjislacionit përkatës të Perandorisë Osmane, të cilat ishin ndërtuar kryesisht, mbi bazën e Kodit Tregtar francez të vitit 1807 (Llaci, Leskaj, 2000:13). Kodi Tregtar i vitit 1932, Ligji “Mbi aplikimin e Kodit Tregtar” si dhe dekretregullorja “Mbi aplikimin e dispozitave të Kodit Tregtar që iu përkasin shoqërive me aksione” e vitit 1934 përbëjnë të drejtën tregtare të mbretërisë së mbretit Zog.

Nxjerrja e këtyre tre ligjeve u përcaktua sidomos nga nevoja për të siguruar qetësinë dhe qëndrueshmërinë në gjendjen juridike dhe në veprimtarinë ekonomike të shoqërive tregtare të ndryshme (Llaci, Leskaj, 2000:14). Kodi Tregtar kishte ndarjen strukturore më të përsosur në krahasim me kodet tregtare që vepronin në atë kohë në Europë (Llaci, Leskaj, 2000:14).

⁴³ Vetën në Tiranë, gjatë vitit 1939, u krijuan 8 shoqëri të rëndësishme aksionere; në vitin 1940 u krijuan 9 shoqëri të tilla, ndërsa gjatë vitit 1941 – 1942 u krijuan dhe 11 shoqëri, pra gjithsej 28 shoqëri aksionere (Llaci, Leskaj, 2000:9).

Ky Kod përbënte një kornizë të plotë ligjore për ushtrimin nga tregtarët dhe shoqëritë tregtare të veprimtarisë tregtare (Leskaj 2008). Kodi Tregtar i 1932 ishte mjaft i plotë dhe modern për kohën, pasi për hartimin e tij u morën si model legjislacionet e vendeve të zhvilluara perëndimore të kohës sidomos Italia, të cilat iu përshtatën kushteve dhe interesave të veçanta të Shqipërisë⁴⁴. Kodet shënuan shkëputjen drastike nga legjislacioni i periudhës osmane.

Kodi Tregtar, hyri në fuqi më 1 prill 1932⁴⁵. Ai u ndoq nga Ligji “Mbi aplikimin e Kodit Tregtar⁴⁶” (1932), dhe dekret rregullorja “Mbi aplikimin e dispozitave të Kodit Tregtar që u përkasin shoqërive me aksione” (1934). Të tre së bashku këto ligje përbëjnë burimet themelore të së drejtës tregtare në Shqipëri dhe njëkohësisht janë akte burimore të rëndësishme të një drejte e cila më pas për gati 50 vjet do të qëndronte e izoluar dhe e pazbatuar.

Korniza ligjore e së drejtës tregtare në të këtë periudhë ishte një nevojë e cila diktohej jo vetëm nga prania e shoqërive vendase po sidomos dhe nga veprimtaria e shtuar dhe në rritje e shumë shoqërive italiane në vend, pozitat e të cilave kishin ardhur duke u forcuar e madje duke eklipsuar dhe ato shqiptare. Për hartimin e Kodit Tregtar u krijua një komision i posaçëm juristësh shqiptarë. Kodi u hartua mbi bazën e një projektkodi tregtar Italian i quajtur “Projekti Vivante”, sepse ishte redaktuar nga një komision juristësh që kryhesoj nga ky specialist i shquar i së drejtës tregtare (Krisafi et al. 2007). Nga ana e tij Projekti Vivante synonte ndërmarrjen e reformës në të drejtën tregtare italiane sidomos në lidhje me shoqëritë

⁴⁴ Shih <http://www.shqiptarja.com/dossier/2711/eqerem-vlora-nje-nga-kritiket-me-te-medhenj-te-ahmet-zogut-170113.html#sthash.Rl5itNFt.dpuf>.

⁴⁵ Kodi Tregtar u botua ne Gazetën Zyrtare numër 1, të vitit 1932.

⁴⁶ Ligji “Mbi aplikimin e Kodit Tregtar u botua ne Gazetën Zyrtare numër 4, të vitit 1932.

anonime me kuota, shoqëritë anonime me aksione, shoqëritë anonime me një person, shoqëritë financiare dhe audituesit e llogarive.

Kodi Tregtar (1932) kishte 1138 nene, i ndarë në 7 libra. Si subjekt të marrëdhënieve juridike ky kod përcaktonte: a) Tregtarët, d.m.th personat privatë, që ushtronin në emër te vet, një industri ose tregti jo të vogël. Tregtari përcaktohej si personi fizik i cili ushtronte aktivitetet tregtar (neni 6) (Papajorgji, Alikaj, 2016). b) Shoqëritë tregtare, këtu rregulloheshin hollësisht llojet kryesore të shoqërive tregtare kapitaliste, format dhe përmbajtja e kontratës për krijimin e shoqërive, statutin, si dhe mënyrat e mbarimit dhe likuidimit të tyre (Krisafi et al. 2007), të cilat mund të ushtronin një ose më shumë aktivitete tregtare (neni 95).

Shoqëria (Shoqnia) anonime rregullohej në kaptinën IV. Kodi parashikonte mes të tjerave, përzgjedhjen dhe përgjegjësitë e administratorit. Pjesë e Kodit Tregtar (1932) ishin dhe Titujt e kredisë dhe Paditë Tregtare. Titujt e kredisë përmbanin parashikime dhe rregullime në lidhje me titujt si ceku, kambiali etj si dhe paditë e lidhura me to. Gjithashtu në një libër me vete trajtoheshin paditë tregtare, falimentimi si dhe tregtia detare dhe lundrimi.

Më 7 prill 1939, Shqipëria u pushtua nga Italia. Vendi ynë u shndërrua përfundimisht në një koloni të Italisë (Angjeli, 2012). Pas 8 shtator 1943, shoqëritë italiane në Shqipëri e zbehën veprimtarinë e tyre ekonomike për shkak të kapitullimit pa kushte të Italisë Fashiste dhe të prerjes së lidhjeve me qendrat e tyre në Itali. Megjithatë zhvillimi ekonomik dhe veçanërisht ai industrial në Shqipëri ishte thuajse i papaërfillshëm, duke bërë që vendi të anonte kryesisht nga ekonomia agrare.

3.2 E drejta tregëtare në periudhën 1944 – 1990

Më 29 nëntor 1944, Shqipëria u çlirua dhe në zgjedhjet e para pas çlirimit, Fronti Demokratik, krijuar nga Partia Komuniste e Shqipërisë fitoi shumicën e votave. Më 11 janar 1946 u shpall Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë. Periudha që pasoi pas çlirimit të vendit, 1944 – 1990, është historia e një diktature gati 50 vjeçare, e cila formëzoi dhe ekonominë sipas modelit socialist, të mbështetur te prona shtetërore, shtetëzimi dhe kolektivizmi, duke i mbyllur çdo dritë jeshile zhvillimit të sipërmarrjes së lirë dhe biznesit. Vetëm në vitin 1944, pasuria e 111 shoqërive aksionere të huaja kaloi pa shpërblim në pronësi të Shtetit Shqiptar (Zarshati, 2011).

Hapi themelor, i ndërmarrë nga regjimi i Hoxhës, ishte shtetëzimi dhe kontrolli absolut i industrisë, bujqësisë, burimeve natyrore, tregtisë dhe profesionave të ndryshme (Jacques, 2003). Sistemi ligjor gjatë komunizimit është i kuptueshëm në Shqipëri vetëm nëse studiojmë institucionet ligjore dhe zhvillimin e tyre (Papajorgji, Alikaj, 2016). Në 1946, rreth 83% e pronës private u shndërrua në pronë shtetërore (Fishta, Ziu, 2004).

Kodi Tregtar Shqiptar dhe gjithë normat ligjore tregtare të periudhës së pas luftës u shfuqizuan (Papajorgji, Alikaj, 2016). Monopolet privatë u hoqën dhe u ndaluan. Sistemi ekonomik, një sistem tërësisht i centralizuar, u ngrit mbi modelin e planit 5 vjeçar, të kooperativave dhe ndërmarrjeve shtetërore të cilat ishin persona juridikë e funksionuan sipas tipit/ marrëveshjeve *Hozrashot*⁴⁷, qëllimi i të cilave nuk ishte fitimi ekonomik po përmbushja

⁴⁷ Hozrashoti u fut thellë në ekonominë popullore dhe u bë metodë e drejtimit të ndërmarrjeve dhe organizatave ekonomike, të cilat, në shumicën e tyre janë rentabël dhe i sigurojnë nga viti në vit buxhetit të shtetit akumulimin e nevojshëm për të financuar zhvillimin e ekonomisë dhe kulturës. Sipas Leninit, në V. I. Lenin. Veprat, vëll. 54, f. 150, bot. V rus: “Trustet dhe ndërmarrjet në hozrashot bazohen pikërisht në faktin se ato vetë duhet të përgjigjen nga çdo pikëpamje për punën me humbje”. Gjendet në https://www.marxists.org/shqip/subjekt/dokumente-shqiptare/ppsh/dokumentet_kryesore/04/vellimi4.1.pdf

e nevojave të masës. Sidomos pas prishjes së marrëdhënieve diplomatike me Kinën, ekonomia shqiptare e thelloi dhe më shumë centralizimin dhe izolimin. Ky centralizim i mjeteve financiare në duart e shtetit çoi në asfiksimin e ndërmarrjeve shtetërore, çka përbënte edhe një nga shkaqet e futjes në krizë të ekonomisë shqiptare (Angjeli, 2012).

3.3 E drejta tregëtare në periudhën 1990 – 2007 (“Reforma e parë”)

Vitet '90 ishin *annus mirabilis* për vendet ish komuniste të Bllokut të Lindjes, mes tyre, dhe për Shqipërinë, si vite që shënuan fillimin e një ere të re. Zgjedhjet e para pluraliste në Shqipëri u mbajtën në mars të vitit 1991, ndërkohë që vendi po i nënshtrohej procesit të liberalizimit dhe hapjes së tij me vendet e tjera. Reforma ligjore dhe legjislativë ishte një kusht i qenësishëm dhe i domosdoshëm, jo vetëm për marrëdhëniet ekzistuese po sidomos për ato marrëdhënie të reja të cilat kishin qenë të ndaluara deri atëherë. Sipërmarrjes private iu hap drita jeshile për të zhvilluar vetveten në formën e tregtarit, shoqërive të thjeshta dhe shoqërive tregtare (të personit dhe të kapitalit).

Kalimi në fillim të viteve '90, nga planifikimi i centralizuar në ekonominë e tregut të lirë, solli ndryshime strukturore rrënjësore në Shqipëri, përfshirë këtu politika të reja makroekonomike dhe reforma strukturore, të tilla si liberalizimi i çmimeve dhe tregtisë, privatizime në shkallë të gjerë, reforma fiskale, hapje të vendit ndaj kapitalit të huaj etj (Pajaj, Ferzaj, 2013). Si hap i parë në këtë drejtim, më 18 prill 1992 u miratuan disa reforma, në bazë të të cilave do të privatizohej shumica e pronës në Shqipëri, shumica e ndërmarrjeve shtetërore, apartamentet e banimit dhe do t'i jepej fund financimit nga shteti të çmimit të sendeve ushqimore (Jacques, 2003). Privatizimi ishte kështu një nga shtyllat e reformës ekonomike të Europës Qendrore dhe Lindore. Hapja me botën pati specifikën se vinte pas

një mbylljeje të plotë; ishte kalimi nga izolimi në liri të plotë, me pasoja të jashtëzakonshme në shkëmbimin e mallrave, në çmimet, në teknologji, në marrëdhëniet njerëzore, politike dhe ekonomike (Meksi, 2001).

Në vitet '90, Shqipëria, u përball dhe me një *vacuum* ligjor të krijuar nga përmbysja e sistemeve. Jo vetëm që ligjet ekzistuese ishin tashmë të pazbatueshme por në të njëjtën kohë kushtet e reja ekonomike, politike dhe sociale kërkonin mbështetjen e nevojshme ligjore dhe nënligjore në mënyrë që të funksiononin. Për këtë arsye, shpesh u kthye vëmendja nga vendet europiane, kryesisht ato fqinjë, për të marrë përvojat më të mira në hartimin dhe krijimin e kornizës së re ligjore. Referimet në praktikat ekzistuese në legjislacione të së drejtës romake dhe huazimet prej tyre ishin të shpeshta, ndonëse në disa raste krijimi i kuadrit ligjor shqiptar mbeti ende me vakuume apo bëri huazime të cilat, ose ishin jo relevante ose u huazuan pjesërisht duke krijuar më vonë probleme në zbatimin dhe interpretimin e ligjeve të caktuara. Transformimi i ekonomisë së Shqipërisë nga një ekonomi e izoluar dhe e centralizuar në një ekonomi të tregut dhe të hapur kërkonte hartimin dhe zbatimin e një kuadri të ri ligjor (Pajaj, Ferzaj, 2013). Gjatë vitit të ndërmjetëm prill 91' – mars 92' u arrit të hidhen themelet e një shteti të ri me elementet e para të ekonomisë së tregut, falë konsensusit real opozitë – pozitë dhe sidomos për hartimin e Dispozitave Kushtetuese, që mundësuan reformën ekonomike, legjislative dhe institucionale në vitet që pasuan (Meksi, 2001), të cilat do të shfuqizoheshin në vitin 1998 me miratimin e Kushtetutës. Sistemi i ri demokratik dhe pluralist u karakterizua kështu nga miratimi i shumë ligjeve dhe kodeve, sidomos vitet 92-96', gjatë të cilëve u punua në mënyrë të vazhdueshme për krijimin e një baze të re ligjore në mbështetje të ndryshimeve të thella në ekonominë shqiptare, dhe për krijimin e strukturave dhe të marrëdhënieve të reja ekonomike në funksion të këtyre ndryshimeve. Reforma legjislative në vend gjeti

mbështetjen e partnerëve ndërkombëtare e sidomos të Bashkimit European, i cili dha asistencën e tij për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë european.

Në korrik 1990, në Parlamentin Shqiptar u miratuan Dekretet nr. 7406 dhe 7407 përkatësisht për “Mbi mbrojtjen e investimeve të huaja në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë” dhe “Mbi aktivitetin ekonomik të ndërmarrjeve me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë (një tentativë e parë kjo për hapjen ekonomike të Shqipërisë (Angjeli, 2012). Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë u miratua me Ligjin 7850, datë 29.07.1994, Kodi i Procedurës Civile u miratua me ligjin numër 8116, datë 29.03.1996, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë u miratua me Ligjin 7895, datë 27.01.1995 etj.

Që nga vendosja e demokracisë dhe pluralizmit në vend, e drejta tregëtare ka qenë subjekt i reformave të rëndësishme ligjore.

Nga vitet '90 deri në vitin 2008, e drejta tregëtare në Shqipëri u rregullua fillimisht nga Ligji nr. 7512, datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” (Ligji 7512/1991), dhe kryesisht nga i ashtuquajti Kodi Tregëtar, ose Tri Ligjet për shoqëritë tregëtare: Ligji nr. 7632, datë 04.11.1992, “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregëtar (Ligji 7632/1992), Ligji nr. 7638, datë 19.01.1992 “Për shoqëritë tregtare” (Ligji 7638/1992), dhe Ligji nr. 7667, datë 28.01.1992, “Për regjistrin tregëtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare (Ligji 7667/1992). U deshën rreth 15 vjet që kjo kornizë ligjore të ndryshohej.

Tri Ligjet për shoqëritë tregëtare: Ligji 7632/1992, Ligji 7638/1992, dhe Ligji 7667/1992 i paraprinë miratimit të këtyre Kodeve, e sidomos Kodit Civil. Nevoja për rregullimet ligjore

të cilat do të shërbenin për të krijuar një klimë biznesi të shëndetshme, për të tërhequr investime të reja dhe për të zhvilluar tregun e kapitalit, ishte mëse imediate.

Ligji 7512/1991 sanksiononte ne preambulën e tij qëllimin që: *“të vendoset një rend i ri ekonomik dhe të zbatohet kalimi nga një sistem me ekonomi të centralizuar e të kontrolluar nga shteti, në një sistem ekonomik të bazuar në parimet e tregut të lirë”*. Për këtë arsye ky Ligj parashikonte në nenin 1 të tij: *“Sanksionohen dhe mbrohen prona private, nisma e lirë, veprimtaritë private të pavarura, afarizmi, investimet e huaja, e drejta për të marrë e për të dhënë kredi, e drejta për të punësuar e për t’u punësuar, privatizimi i pronës shtetërore dhe i gjithë procesi i kalimit të ekonomisë së Republikës të Shqipërisë nga një ekonomi e planifikuar dhe e kontrolluar nga shteti, në një ekonomi të tregut të lirë”*.

Ky ligj pati si qëllim vendosjen e një rendi të ri ekonomik në Shqipëri në mënyrë që të zbatohet kalimi nga një sistem me ekonomi të centralizuar e të kontrolluar nga shteti, në një system ekonomik të bazuar në parimet e tregut të lirë (Leskaj, 2008: 1). Ligji ynë për shoqëritë tregtare (7638) është huazuar nga ligji francez nr. 66 – 537 “Sur les societe commerciales”, por pa rimarrë shumë nene nga ky i fundit (Berberi, 2004). Në fakt, Ligji 7638/1992, gërshetoi dhe elementë të Kodit Civil Francez (si neni 3, 4, 6, 7, 8 dhe 11 të Ligjit 7638/1992, në lidhje me statutin, selinë, personalitetin juridik, padinë për parregullshmërinë e themelimit ose të ndryshimit të statutit, përgjegjësisë për themelimin e parregullt dhe vlerësimin e të drejtave të ortakëve në shoqëri), ndërkohë që hartimi i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë u mbështet te Kodi Civil Italian.

3.3.1 Ligji nr. 7632, date 4.11.1992, “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregëtar”

Ligji 7632/1992 përcaktonte “hierarkinë” e legjislacionit tregtar për fushën e tregtisë, në nenin 1 të tij, duke renditur: legjislacionin tregtar, dhe në mungesë të trajtimit të tij, praktikat tregtare. Praktikë lokale ose të veçanta marrim përparësi ndaj atyre të përgjithshme dhe në

mungesë të tyre zbatohet Kodi Civil. Në kuptim të këtij Ligji, Tregtar është personi fizik dhe shoqëritë tregtare që gjatë ushtrimit të profesionit kryejnë veprime tregtare në emër të tyre. Ky përkufizim përfshin dhe veprimet që kanë të bëjnë me aktivitetin bujqësor kur kryhen si sipërmarrje, përpunim ose shitjes prodhimi (nenin 6). Në të nuk përfshihen veprimet e aktivitetit bujqësor që nuk janë tregtare, personat që ushtrojnë të vetëm veprimtari të përmasave të vogla dhe që nuk kalon kufijtë e zanatit (si për shembull shitësit ambulantë, karrocierët etj). Gjithashtu nga përkufizimi i tregtari ishin të përjashtuar dhe shteti, organet e pushtetit lokal dhe entet e tjera publike, pavarësisht se veprimet e tyre me natyrë tregtare rregulloheshin nga legjislacioni dhe praktikat tregtare. Përjashtimi nga detyrimi për regjistrim parashikohej në varësi të shkallës së veprimtarisë me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në kuptim të ligjit veprimet tregtare ishin:

1. Blerja me qëllim rishitjeje, shitja që rrjedh nga një blerje e mëparshme e bërë me qëllim rishitjeje, si dhe përgjithësisht çdo veprim shkëmbimi i lidhur me një veprim tjetër shkëmbimi.
2. Çdo akt i sipërmarrjeve industriale të ndërtimit, të shfrytëzimit të minierave, të transportit, të sigurimeve, të magazinimit, të shfaqjeve publike, të reklamës, të botimit të shtypshkrimit joartizanal;
3. Çdo operacion bankar dhe këmbimi;
4. Të gjitha operacionet ndërmjetese tregtare, si operacionet e ndërmjetësisë ose të speditimit dhe ato të përfaqësuesve tregtarë.

Kapitulli III i Ligjit 7632/1992 rregullonte Regjistrin Tregtar dhe modalitetet për mbajtjen e funksionimin e tij. Ligji përcaktonte se regjistri mbahej nga gjykatat dhe modalitetet

caktoheshin me vendim të Këshillit të Ministrave. Më pas, me Ligjin 7667, datë 28/1/1993, kjo tagër u ngrit në nivel ligji. Ligji kërkonte që kërkesat për regjistrim në regjistër dhe për depozitimin e tyre, të autentifikoheshin nga noteri ose një institucion tjetër shtetëror. Ky lloj autentifikimi nga njëra anë synonte të garantonte vërtetësinë duke pasur një “vërtetim” nga ana e noterit apo një institucioni shtetëror me tagra të ngjashme por nga ana tjetër krijonte dy lloj kostosh për tregtarin: kosto financiare duke pasur parasysh tarifat e aplikueshme nga ana e noterëve si dhe eficiensa dhe koha e shpenzuar për të kryer këto veprime.

Ligji paraqitej kërkuar edhe përse i përket akteve që kërkohehin të njoftoheshin nga ana e tregtarit të cilat përfshinin: aktet e dhurimit, të shitjeve, të qirave, të pengjeve, të pushimit ose të likuidimit të tregtisë (neni 20).

Nga pikëpamja e formaliteteve dhe kërkesave, Ligji 7632/1992 ishte mëse i tillë. Në kuadrin në të cilin ky ligj u miratua dhe rrethanat në të cilat ai funksiononte, mund të justifikonin deri diku formalizmin, i cili sot mund të gjykohej si i tepruar. Por nga ana tjetër, duke pasur parasysh ndryshimet demokratike në vend dhe tranzicionin institucional, ligjor, vakuumet ligjore dhe papërshtatshmërinë e disa institucioneve, justifikohet masa e kërimit të këtyre formalizmave.

3.3.2 Ligji nr. 7638, datë 19.1.1992 “Për shoqëritë tregtare” (Ligji 7638/1992)

Së bashku me Ligjin 7632/1992, Ligji 7638/1992, drejtoi dhe rregulloi jetën dhe veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri në një hark kohor më shumë se 15 vjeçar. Ligji 7632/1992, iu nënshtrua ndryshimeve me Ligjin nr. 7935, datë 21.6.1995, dhe me Ligjin nr. 8108, datë 28.03.1996.

Ligji 7638/1992 parashikonte 4 lloje shoqërisht tregtare: shoqërinë kolektive, komandite, me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërinë anonime me ofertë publike dhe pa ofertë publike, të cilat i përkufizonte si tregtare për shkak të formës, pavarësisht objektit të tyre (neni 2), kjo pasi karakteri tregtar i një shoqërie përcaktohej nga forma ose nga objekti i saj. Shoqëritë kolektive dhe komandite⁴⁸ nuk zunë vend në praktikën e vendit tonë dhe në vende të tjera ekzistojnë në shifra fare të vogla dhe shihen shumë si mbetje e historisë. Përgjegjësia e pakufizuar, madje shpesh edhe solidare në shoqëritë kolektive për detyrimet ndaj të tretëve është një kërcënim jo i vogël (Berberi, 2004).

Shoqëria në kuptim të Ligjit 7638/1992 (neni 1), themelohej si rregull nga dy ose më shumë persona të cilët:

- Merren vesh nëpërmjet një kontrate,
- Për të destinuar në një sipërmarrje të përbashkët pasuritë ose shërbimet e tyre,
- Me qëllim që të ndajnë fitimin OSE të përfitojnë nga të ardhurat që mund të rrjedhin prej saj.

Shoqëritë të cilat mund të themeloheshin nga një ortak i vetëm ishin vetëm shoqëria me përgjegjësi të kufizuar (neni 37) dhe shoqëria anonime (neni 74). Shoqëria tregtare fitonte personalitetin juridik që nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar. Pra, kemi dy akte

⁴⁸ Në shoqërinë kolektive të gjithë ortakët kanë cilësinë e tregtarit dhe përgjigjen pa kufizim e solidarisht për borxhet e shoqërisë (neni 13); si rregull shoqëria priset me vdekjen e një ortaku (neni 24), përveç kur vazhdueshmëria vendoset unanimitet nga ortakët e mbetur dhe trashëgimtarët e ortakut të vdekur, ose kur ortakët e mbetur riblen të drejtat e trashëgimtarëve që nuk duan të jenë pjesë e shoqërisë. Ortakët janë dhe administratorë përveç kur parashikohet ndryshe në statut (neni 15). Ortakët që nuk janë administratorë kanë të drejtë në çdo kohë të informohen personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihen me llogaritë dhe dokumentat e saj (neni 21).

Shoqëria komandite përbëhet nga ortakë të pakufizuar dhe ortakët e kufizuar (neni 26), kontributi i të cilëve nuk mund të jetë në shërbime. Ortakët e kufizuar gëzojnë minimalisht një të drejtë të “kufizuar” informimi: të njihen dy herë në vit me librat dhe dokumentat e shoqërisë dhe të bëjnë pyetje me shkrim për administrimin e saj për të cilat përgjigja duhet të jepet po me shkrim (neni 32). Shoqëria vazhdon edhe kur vdes një nga ortakët e “kufizuar”.

të cilat në vetvete rregullonin situatë të ndryshme, në aktin e themelimit shprehej vullneti i aksionarëve për të hyrë në një marrëdhënie juridike duke themeluar një organizëm të ri, shoqërinë dhe nga ana tjetër kishim statutin që rregullonte funksionimin e këtij organizmi (Xhoxhaj, 2012: 14).

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar rregullohet nga nenet 37 – 73 të Ligjit 7632/1992. Ky tip i shoqërisë është i veçantë dhe gjendet vetëm në disa shtete të Europës kontinentale (GMBh në Gjermani, s.r.l në Francë dhe Itali, s.p.r.l. në Belgjikë etj.) (Berberi, 2004). Disa veprimtari nuk mund të ushtrohen nga Sh.p.k. sic është rasti i veprimtarive të bankave, të sigurimeve dhe të risigurimeve, të fondeve të investimeve etj (Berberi, 2004), veprimtari të cilat ligji ua kishte besuar organizimin kryesisht formës së shoqërisë anonime.

ShPK themelohet nga një ose disa ortakë të cilët përballojnë humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar (neni 37), vlera minimale e të cilit është 100 000 lekë (neni 38). Pjesët e kapitalit themeltar mund të përfaqësojnë kontribute në natyrë, në para por nuk mund të përfaqësojnë kontribute në shërbime dhe as letra me vlerë të tregtueshme (neni 40 dhe neni 45). Kjo shoqëri administrohet nga një ose disa persona fizikë, të zgjedhur dhe jashtë bashkësisë së ortakëve, me vendimin e ortakëve që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar. Emërimi i tyre në detyrë bëhet për tërë periudhën e ekzistencës së shoqërisë përveç kur statuti parashikon ndryshe. Si rregull kompetencat e administratorit përcaktohen në statut. Në qoftë se statuti nuk përmban dispozita që përcaktojnë kompetencat e administratorit, ky mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë (Berberi, 2004). Mbledhja e asamblesë së ortakëve si organi më i lartë vendimmarrës, mund të kërkohej dhe nga ortaku/ortakët të cilët përfaqësojnë 10% të pjesëve të kapitalit themeltar.

Shoqëritë anonime janë shoqëri, kapitali i të cilave përbëhet nga aksionet (letra të tregtueshme) dhe me përgjegjësi të kufizuar të ortakëve deri në vlerën e kontributeve të vëna si kapital. Në ligjin nga është huazuar ligji ynë 7638, është përdorur termi “anonime” dhe jo me “aksione”, ndoshta për shkak se ekzistojnë edhe shoqëritë komandite me aksione (Berberi, 2004), pavarësisht se këto të fundit nuk u përfshinë në legjislacionin në atë kohë. Ligji dallonte shoqërinë anonime me ofertë publike, kapitali themeltar minimal i të cilave është 10 milion lekë dhe atë pa ofertë publike, kapitali themeltar minimal i të cilës është 2 milion lekë.

Në bazë të nenit 97, aksionet ishin nominative (emërore) dhe “për prurësin”. Aksionet e shoqërisë me ofertë publike janë të regjistruara zyrtarisht në bursën e letrave me vlerë, pra janë të shpërndara në publik dhe janë të formës “për prurësin” sepse tregtohen lirisht. Themelimi dhe funksionimi i tyre i nënshtrohej një rregullimi më të veçantë, përfshirë formalitetet në themelimin e tyre dhe në emetimin e aksioneve. Publikimet, ofertat etj i nënshtroheshin dhe rregullimeve të tjera që buronin nga autoritete të tjera të caktuara me ligj si Komisioni i Letrave me Vlerë etj. Kurse në shoqëritë pa ofertë publike, aksionet mbahen nga një numër i kufizuar aksionarësh (Berberi, 2004)⁴⁹.

Gjithashtu ligji njohte dhe shoqërinë shtetërore e cila është një shoqëri anonime në të cilën të gjitha aksionet zotërohen nga shteti ose një ent publik (neni 95). Kjo shoqëri i nënshtrohej legjislacionit të përgjithshëm mbi shoqëritë, nëse nuk përcaktohej apo të rregullohej ndryshe me një ligj të veçantë.

⁴⁹ Berberi (2004) qartëson terminologjinë dhe tipologjinë korresponduese të emërtimeve të përdorura të shoqërisë anonime sipas Ligjit 7638 dhe atyre të huaja. Kështu shoqërisë anonime me ofertë publike i korrespondon “the public company limited by shares” në Angli, ose business corporation ose corporation në ShBA; kurse shoqërisë anonime pa ofertë publike i korrespondon “The private company limited by shares”.

Përsa i përket drejtimit të shoqërive anonime, ligji parashikonte vetëm sistemin e drejtimit me dy nivele, pra me këshill mbikqyrës dhe drejtori, e cila përbëhej nga një ose disa anëtarë⁵⁰ dhe ushtronte funksionet e saj nën kontrollin e këshillit mbikqyrës. Këshilli Mbikqyrës emëronte anëtarët e drejtorisë (që mund të ishin vetëm persona fizikë, aksionarë ose jo), për një mandat nga dy deri në gjashtë vjet. Drejtoria kishte kompetenca të plota për vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë, brenda objektit të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ua jepte shprehimisht Asamblesë së Aksionarëve dhe Këshillit Mbikqyrës.

Këshilli Mbikqyrës përbëhej nga jo më pak se 3 dhe jo më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët e Këshillit nuk mund të ishin dhe anëtarë të drejtorisë, duke bërë që mandati në Këshill të përfundonte me emërimin në funksionin e ri. 2/3 e anëtarëve të këshillit emëroheshin nga mbledhja e zakonshme e asamblesë dhe 1/3 nga të punësuarit në shoqëri⁵¹, për një mandat maksimal deri në 6 vjet. Këshilli ushtron kontroll të vazhdueshëm ndaj Drejtorisë për administrimin e saj, duke pasur të drejtë të kryente në çdo kohë verifikime dhe kontrolle që i çmonte të arsyeshme dhe të njihej me dokumentat që i gjykonte të nevojshme për plotësimin e detyrave të tij. Personi juridik mund të emërohej në Këshillin Mbikqyrës.

Mbledhja e Asamblesë mund të ishte e Zakonshme ose e Jashtëzakonshme e përcaktuar kjo nga kompetencat përkatëse dhe vendimmarrja. Ligji i njihte të drejtën çdo aksionari për të

⁵⁰ Në bazë të nenit 96 të Ligjit 7638/1992, në shoqëritë anonime kapitali i të cilave është mbi 5 milion lekë në ditën e emërimit të drejtorisë, drejtoria përbëhet të paktën nga 2 persona në rast se statute nuk parashikon që ajo të përbëhet nga një person i vetëm.

⁵¹ Qënia anëtar i këshillit mbikqyrës nuk cënonte përfitimet e punonjësit nga kontrata e punës por nuk lejonte mbajtjen e mandateve të tjera përfaqësuese të të punësuarve si për shembull sindikatat. I punësuarit për t'u zgjedhur duhet të plotësonte kriterin e vjetërsisë në punë (të paktën dy vjet) dhe të kishte një kontratë pune për një vend real / efektiv. Gjithashtu ligji parashikonte se të punësuarit si inxhinierët, kuadrot ose personat e ngjashëm me to duhet të kishin të paktën një vend në këshill në rast se numri i të zgjedhurve nga punëdhënësi ishte i barabartë ose më shumë se dy (neni 109).

marrë pjesë në mbledhjet e jashtëzakonshme dhe nga ana tjetër, lejonte rezervën statutore që në mbledhjet e Asamblesë së Zakonshme të vendoste një prag jo më të madh se 10 për të siguruar të drejtën e pjesëmarrjes në to, përfshirë edhe numrin akumulativ prej 10% kur disa aksionarë bashkoheshin me njëri – tjetrin për të arritur këtë prag.

Duhet theksuar se Ligji 7638/1992 përdor termin ortak dhe aksioner në të njëjtën kohë kur i referohet shoqërisë anonime.

Të drejtat e aksionereve në shoqëri mund të dallohen në dy kategori kryesore:

(a) të drejtat për të marrë pjesë apo ndërhyrë në jetën e shoqërisë;

(b) të drejtat monetare (apo financiare) (Berberi, 2004).

Të drejtat e pjesëmarrjes në jetën e shoqërisë përfshinin:

- Të drejtën për të marrë pjesë në mbledhjet e asamblesë, e drejtë e cila nuk mund të kufizohet përveç në rastin e vendosjes së pragut në mbledhjen e Asamblesë së Zakonshme prej jo më shumë se 10%.
- E drejta e votës që rrjedh nga aksioni dhe që është proporcionale me pjesën e kapitalit. Statuti mund të parashikonte kufizimin e numrit të votave që disponon çdo aksionar me kusht që ky kufizim të vihej mbi të gjithë llojet e aksioneve pa dallim kategorie.
- E drejta për informim, përfshirë këtu dhe shumën e shpërblimeve të dhëna për personat që paguhet mirë;
- E drejta e zgjedhjes në organet drejtuese në kuadrin e funksioneve të këshillit mbikqyrës apo drejtorisë;
- E drejta për të vënë në lëvizje gjykatën.

Nga pikëpamja e të drejtave financiare, aksionari kishte të drejtën për të marrë përfituar dividend, të drejtën për kthimin e kapitalit kur shoqëria prishej dhe likuidohej.

3.3.3 Ligji 7667, datë 28/1/1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”

Ligji 7667/1993 përcaktonte centralizimin e mbajtjes së regjistrimit për të gjithë territorin e Shqipërisë në gjykatën e rrethit të Tiranës (neni 1). Regjistri duhej të paraqitej për t’u konsultuar nga publiku gjatë orarit zyrtar në zyrat e gjykatës. Gazetat të cilat autorizoheshin për publikimin e njoftimeve ligjore përcaktoheshin me vendim të Këshillit të Ministrave brenda datës 6 dhjetor të çdo viti.

3.4 E drejta tregëtare në periudhën 2007 e në vijim (“Reforma e dytë”)⁵²

Shqipëria është vend në zhvillim, i cili vazhdon të ndërmarrë reforma strukturore, ekonomike, sociale dhe ligjore, kryesisht në kuadrin e procesit të integritetit të vendit në BE (Pajaj, Ferzaj, 2013). Reforma e së drejtës tregëtare në Shqipëri shënoi arritje me miratimin e ligjit numër 9723, datë 3 maj 2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i cili vendosi parimin e “*One stop shop*”. Ligji i ri për shoqëritë tregëtare i miratuar në 14 prill 2008, hyri në fuqi më 22 maj 2008 dhe është ndryshuar përkatësisht me ligjin Nr.10475, datë 27.10.2011 dhe ligjin 129/2014 (këtu e në vijim referuar si “Ligji” ose LSHT). Ligji parashikon kuadrin e ri ligjor në lidhje me themelimin, organizimin dhe ushtrimin e aktivitetit tregëtar të

⁵² Trajtimi më i detajaur i Ligjit të ri për Shoqëritë Tregtare (LSHT) do të bëhet në vijim, pasi Ligji do të analizohet dhe në dritën e teorive subjekt i këtij punimi.

tregëtarit dhe të shoqërive tregëtare. Gjithashtu Ligji synon të krijojë një sistem të thjeshtë, të qartë dhe të përditësuar (Pajaj, Ferzaj, 2013).

Ligji numër 10475, datë 27.10.2011, “Për një ndryshim në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” është përafruar plotësisht me Direktivën e Dytë të Këshillit 77/91/KEE, datë 13 dhjetor 1976 “Mbi koordinimin e masave mbrojtëse nga shtetet anëtare, të cilat nevojiten për ruajtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, për kompanitë, sipas kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 58 të Traktatit, lidhur me krijimin e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar, mbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit të tyre, me qëllim për t’i bërë këto masa mbrojtëse ekuivalente”⁵³.

Ligji numër 129/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, është përafruar pjesërisht me: Direktivën 2009/109/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, 16 shtator 2009, që ndryshon direktivat e Këshillit 77/91/KEE, 78/885/KEE, 82/891/KEE dhe direktivën 2005/56/KE, lidhur me kërkesat për raportim dhe dokumentim në rastet e bashkimeve dhe ndarjeve, e ndryshuar⁵⁴; Direktivën 2009/101/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, 16 shtator 2009, mbi koordinimin e masave, të cilat për qëllime të mbrojtjes së interesave të anëtarëve dhe të palëve të treta, duhet të zbatohen nga shoqëritë e shteteve anëtare, në kuptimin e paragrafit të dytë, të nenit 48, të traktatit, dhe me qëllim për t’i bërë këto masa ekuivalente, e ndryshuar⁵⁵.

⁵³ Numri CELEX: 31977L0091, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 26, datë 31.1.1997, faqe 1-13.

⁵⁴ Nr. Celex: 32009L0109, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.259, datë 2.10.2009, faqe 14–21.

⁵⁵ Nr. Celex 32009L0101, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.258, datë 1.10.2009, faqe 11–19.

Miratimi i ndryshimeve ligjore në vitin 2007 pati rëndësi pasi lehtësoi formalizmat duke u hequr detyrimi i përgatitjes së akteve të themelimit të shoqërisë si akte noteriale dhe duke e lenë këtë detyrim opsional në diskrecion të palëve të përfshira⁵⁶.

Për çështjet që nuk rregullohen nga e drejta evropiane, Ligji i ri shqiptar për Shoqëritë Tregtare mbështetet në masë të madhe në inspirime nga ligjet për shoqëritë tregtare të Gjermanisë dhe Anglisë. Për rrjedhojë, orientimi për interpretimin e këtij ligji mund të vijë edhe nga vendimet e gjykatave të një Shteti Anëtar, nëse dispozita në fjalë është marrë nga legjislacioni përkatës i atij Shteti Anëtar (Bachner, Schuster & Winner, 2009).

Ligji 9901 është akti kryesor i cili rregullon qeverisjen e korporatës në Shqipëri. Krahas parashikimeve të Ligjit 9901/2014, me 2 dhjetor 2011, me vendimin numër 1 të tij, Këshilli Konsultativ i Biznesit, vendosi miratimin e Kodit të Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Tregtare në Shqipëri, jo të regjistruara në bursë. Kodi përbëhet nga 14 parime, ku katër prej të cilave i adresohen shoqërive të mëdha të palistuara në bursë, (si për shembull bankat, shoqëritë e sigurimit) (EBRD 2013). Kodi nuk është i detyrueshëm për t'u zbatuar dhe mund të zbatohet në mënyrë vullnetare nga të gjitha bizneset, duke iu lene vullnetit dhe angazhimit të mirë të shoqërive që veprojnë në vend.

⁵⁶ Kjo solli një kursim prej 8% të kostove në fazën e fillimit të biznesit (Doing Business Report 2016).

KAPITULLI IV TEORIA INSTRUMENTALE – TEORIA E AKSIONARËVE

4.1 Hyrje

Në fillim të shekullit XX supozohej se kompania ekziston për të bërë para për themeluesit e saj⁵⁷, një qëndrim i cili u lëkund dhe u vu në dyshim me veprën e A. Berle dhe G. Means⁵⁸ dhe me vendimet e gjykatave të cilat njohën se tashmë interesi i shoqërisë tregtare ka ndryshuar dhe në këtë këndvështrim, duhen marrë në konsideratë dhe qëllime të tjera krahas maksimizimit të fitimit.

Korporata është përcaktuar si një qenie artificiale, e padukshme dhe e paprekshme, e cila ekziston vetëm në përputhje me ligjin. Duke qenë një krijesë e thjeshtë e ligjit, ajo gëzon vetëm tre cilësi të cilat ja jep akti i saj i themelimit, ose shprehimisht ose si kusht për ekzistencën e saj... [më] të rëndësishmet janë pavdekësia dhe nëse mund të lejohet të themi,

⁵⁷ Një rol të rëndësishëm në këtë aspekt luajti çështja Dodge k. Ford, (1919) ku vëllezërit Dodge aksionarë që zotëronin 10% të Ford, kundërshtuan vendimin për mosndarjen e dividendit të aksionarit Ford që zotëronte 58%, i cili pretendonte se do të përdorte atë për: “të punësuar më shumë njerëz, që të përhapen të mirat e këtij sistemi industrial te sa më shumë njerëz, t’i ndihmojmë ata të ndërtojnë jetën dhe shtëpitë e tyre”. Vëllezërit Dodge e akuzuan Ford se po përdorte pjesën që zotëronte në kapitalin e shoqërisë për të përmbushur qëllimet e tij filantropike. Gjykata e Lartë e Michigan-it, pavarësisht respektit për gjykimin e Ford, pranoi pretendimin e vëllezërve Dodge duke përcaktuar se një kompani ekziston në interes të aksionarëve dhe nuk mund t’i përdorë fitimet për qëllime të tjera”. Si çështje praktike, Dodge v. Ford dhe çështje të gjashme në fillimet e shekullit të njëzet i dhanë një diskrecion të madh manaxherëve të korporateve. Çështja hodhi themelin e konceptit se korporatat kanë përgjegjësi direkte vetëm ndaj aksionarëve (shih Hood John, Do Corporations Have Social Responsibilities?, 1998, marrë nga http://www.fee.org/the_freeman/detail/do-corporations-have-social-responsibilities, date 21 maj, 2014, ora 11:07;

Krahas ishin dhe çështje të tjera madje dhe më parë si Hutton v West Cork Railway Co. (1883). Në këtë çështje Gjykata e Apelit e Mbretërisë së Bashkuar vlerësoi se pagesa prej 2,550 paund për zyrtarët dhe drejtorët e hekurudhave të West Cork ishte e pavlefshme. Në atë kohë, biznesi ishte shitur dhe kompania po shpërbëhej. Gjykata tha se pagesa nuk ishte "në mënyrë të arsyeshme rastësore" - me fjalë të tjera në thelb të lidhura - me kryerjen e biznesit të kompanisë për "përfitim të kompanisë".

⁵⁸ Adolf Berle dhe Gardiner Means, në librin e tyre, *The Modern Corporation and Private Property*, argumentuan se aksionarët janë pronarë pasivë në rastin më të mirë; ata ushtrojnë në mënyrë efektive vetëm të drejtën për të shitur aksione nëse janë të pakënaqur me politikat apo performancën e korporatës. “Duke dhënë kontrollin dhe përgjegjësinë” – shkruante Berle dhe Means, aksionarët kanë “dhënë të drejtë që korporata duhet të operohet vetëm në interesin e tyre”. (Hood 1996: 3).

individualitet; cilësi sipas të cilave suksedimi i përtjetshëm i disa personave konsiderohet si i njëjti, dhe fakti që mund të veprojë si një individ i vetëm⁵⁹.

Tre cilësi e bëjnë korporatën tërheqëse: jeta e pakufizuar, përgjegjësia e kufizuar e pronarëve dhe ndashmëria e pronësisë që lejon transferimin e interesave të pronësisë pa ndërprerë strukturën e organizatës (Colley, Doyle, Logan & Stettinius, 2003). Si krijim i ligjit, jeta e korporatës, themelimi, organizimi dhe funksionimi i saj është subjekt i rregullimit ligjor, një rregullim i cili nuk mund të kufizohet vetëm te e drejta tregtare apo kodi tregtar në kuptimin e ngushtë të fjalës po dhe një sërë ligjesh e aktesh të tjera ligjore për shkak të dinamikës së zhvillimit të sferës së aktivitetit tregtar⁶⁰, dhe për më tepër si një krijim i ligjit, kjo shoqëri e ka të ndarë ekzistencën e saj nga ajo e pronarëve të saj.

Në fakt doktrina e pranuar gjerësisht në ShBA dhe në shoqëri të tjera perëndimore ishte që e drejta për të bërë biznes në formën e korporatës qe prerogativë mbretërore ose shtetërore, dhe jo e interesave privatë ekonomike (Hood, 1996: 2). Statutet e korporateve me ofertë publike ofronin përfitime publike të tilla si zbulimi dhe kolonizimi i Botës së Re, ndërtimi i infrastrukturës rrugore, ujësjellësi etj. Vetëm pas shekullit të XVIII, dhe kryesisht si pasojë e zhvillimeve ekonomike, filloi themelimi i shoqërive në mënyrë të pavarur pa pasur nevojën e shprehjes së vullnetit nëpërmjet një akti shtetëror ose mbretëror dhe për më tepër me qëllimin e qartë për kryerjen e biznesit për qëllime private vetjake⁶¹.

⁵⁹ Një përcaktim i tillë për korporatën është bërë nga Gjykatësi i Gjykatës së Lartë së SHBA, John Marshall në çështjen Dartmouth College v. Woodward. Në këtë mënyrë korporatat u bënë ligjërisht të mundshme që në shekullin e XIX.

⁶⁰ Përmendin për shembull që në Shqipëri ky kuadër përfshin edhe legjislacionin mbi konkurrencën e lirë, mbi kontratat e ndryshme tregtare, Ligjin 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të regjistrimit”, Ligjin 9879/2009 “Për Titujt”, Ligjin 10236/2010 “Për kontrollin e shoqërive publike”, Ligji 8901/2002 “Për falimentimin” etj.

⁶¹ Për më shumë në lidhje me këtë shih Kapitullin I të këtij punimi.

Nisur nga natyra artificiale e personit juridik, shoqërisë tregtare i mungon karakteri i vullnetit të qenies njerëzore. Shoqëria tregtare është vegël në duart e njerëzve që e kontrollojnë, qoftë duke vepruar në formën e organeve të shoqërisë, qoftë duke ushtruar ndikim mbi ata që veprojnë si organe në emër të shoqërisë (Islamaj, 2011). Ky mekanizëm mund të përdoret për qëllime të ligjshme po edhe të keqpërdoret për qëllime të paligjshme (Islamaj, 2011).

Në të njëjtën kohë në themel të së drejtës tregtare qëndronte parimi që korporata ekziston për të bërë para për aksionarët e saj, parim i cili në vijim gjeti një mbështetje të gjerë në vitet '70, fillimisht me Milton Friedman dhe më pas dhe me Michael Jensen e William Meckling, me maksimizimin e vlerës së aksionarëve dhe me një përçmim të dukshëm për “kapitalizmin e grupeve të interesit” që kishte nisur të përhapej në Europën Perëndimore.

Prova e parë e rëndësishme ligjore e përgjegjësisë së drejtuesve të korporatës erdhi me çështjen e vitit 1919 Dodge vs. Ford (Hood 1996: 2)⁶². Sot, koncepti i përgjegjësisë sociale të korporatës ka tërhequr shumë vëmendjen e literaturës në manaxhim dhe organizim (Tuzzolino, Armadi 1981). Sipas Garriga & Melè (2004), teoritë në lidhje me Përgjegjësinë sociale të biznesit kategorizohen si më poshtë:

- Teoritë instrumentale (ose Teoria e aksionarëve e Friedman ku korporata shihet si krijuese e mirëqenies);
- Teoritë integrative (ose Teoria e Grupeve të Interesit e Freeman me biznesin si pjesë e shoqërisë);
- Teoritë politike (me theksin te pushtetit i kompanisë);

⁶² Shih supra shënimin (57);

- Teoritë e etikës së biznesit (Përgjegjësia Sociale si mjet për përfshirjen e etikës në vlerat e korporatës).

Dy teoritë që përballen më shumë janë e para dhe e dyta, pra teoria instrumentale dhe ajo integrative të cilat do të trajtohen dhe gjerësisht në këtë punim.

Teoritë gjejnë zbatim në aktivitetin e administrimit të zakonshëm dhe të përditshëm të shoqërive tregëtare dhe nëse përfaqësuesve ligjorë, në nivel administratori apo përfaqësuesi ligjor është një zgjedhje, parashikimet ligjore ne dallim, janë detyruese dhe sesi funksionon mekanizmi ligjor është një çështje që vlen të vleresohet.

A është e mjaftueshme të marrim për të mirëqenë se nëse administratori vepron në përputhje me statutin e shoqërise dhe ligjet në fuqi, (njohuritë për të cilat, ligjet sidomos, nuk mund të jenë asesi shterruese), atehere roli i tij është përmbushur pavarësisht nëse kjo nuk është reflektuar një rritje e fitimit të ardhurave, apo vlerës së shoqërisë, apo në rritjen e konkurrencës, tregut, përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve etj, - më vete dhe së bashku? Natyrshëm që jo. Sa më lart është parimi themelor ku bazohet roli i administratorit në shoqëri.

Në rastin e shoqërive me pronar të vetëm që është njëkohësisht dhe administrator, një konflikt i interesit mes “pronarit – drejtuesit” nuk ekziston, por në momentin që aksionaret vendosin të zgjedhin apo të delegojnë zgjedhjen e administratorëve jashtë rrethit të tyre, atëherë janë të gjitha rrethanat e mundshme për një konflikt të tillë.

Pra, në të drejtën tregtare dhe në praktikë në një shoqëri është administratori një “i zgjedhur” (po aq dhe “i besuar”) i aksionarëve i veshur me kompetenca përfaqesimi, ndaj të cilëve ai është *drejtpërdrejt* dhe *vetëm* përgjegjës për të maksimizuar fitimin dhe mirëqenien e tyre sipas teorisë se aksionarëve të Fridman, apo administratori, i zgjedhur/i emëruar për të

drejtuar shoqërinë, ka përgjegjesi dhe është përgjegjës për grupet e interesit të brendshëm punonjësit dhe organet drejtuese dhe *Grupet e jashtëm të interesit* (Konsumatorët, Furnitorët, Kreditorët, Konkurenca, Komuniteti) me të cilët po aq mbart dhe një marrëdhënie besimi (Freeman).

4.2 Teoritë instrumentale (ose Teoria e aksionarëve e Milton Friedman)

Në mesin e viteve '60, zëri kritik që kundërshtonte reformat në të drejtën tregtare që lejonin bamirësinë ose promovimin e gjerë të interesave të palëve jo aksionare, u bë më i fortë. Ishte një periudhë e mbushur me frikën nga komunizmi. Askush nuk ishte aq i egër në kritikën e tij sa Milton Friedman (Gorezi, 2011: 236). Teoria bazohet në një përjasje ekonomike që e percepton firmën si një *nexus* kontratash mes entitetit ligjor e quajtur firmë dhe elementëve përbërës të ndryshëm që përfshin punëmarrësit, klientët, furnitorët, investitorët, dhe grupe të tjera (Boatright, 2006: 110⁶³).

Në artikullin e tij të famshëm të 13 shtatorit 1970 në NY Times, Friedman, themeluesi i Shkollës Ekonomike të Çikagos përvijon haptazi dhe qartë teorinë që në titullin e artikullit: “Përgjegjësia sociale e biznesit është që të rrisë fitimet e tij”. Bazat e kësaj teorie ishin hedhur që më parë me veprën e tij “Kapitalizmi dhe liria”, më 1962⁶⁴.

Friedman pozicionohet menjëherë dhe ashpër kundër përgjegjësinë sociale të biznesit të konceptuar si “*ndërgjegjësia sociale*” e biznesit dhe përgjegjësitë e tij për të ofruar punësim,

⁶³ Cit. Coase, 1937; Alchian dhe Demsetz, 1972; Williamson, 1975, 1984; Jensen dhe Meckling, 1976)

⁶⁴ Shënim: Libri u botua fillimisht në 1962 nga University of Chicago Press. Ai diskuton rolin e kapitalizmit ekonomik në shoqërinë liberale. Libri është përkthyer në tetëmbëdhjetë gjuhë. Në gjuhën shqipe libri u botua për herë të parë në vitin 2005 nga IPLS dhe Dita 2000. Më pas ribotua në vitin 2017 nga Shtëpia e Librit & Komunikimit në 2017.

eliminimin e diskriminimit, shmangien e ndotjes etj. të cilat i etiketon si “predikim i pastër i socializmit të kulluar” (Friedman 1970:1). Madje, Friedman shkon dhe më tej duke i përcaktuar biznesmenët që flasin në këtë mënyrë si “marioneta të atyre forcave intelektuale të cilat kanë minuar bazat e shoqërisë së lirë në dekadat e fundit” (Friedman 1970:1).

Sipas tij, pikëpamja sipas së cilës zyrtarët e korporatave dhe drejtuesit sindikalistë kanë “përgjegjësi sociale” që shkon përtej interesave të aksionarëve ose anëtarëve të tyre ... tregon për një keqkuptim thelbësor të karakterit dhe natyrës së një ekonomie të lirë (Friedman 2000: 150). Në një ekonomi të tillë ekziston një dhe vetëm një përgjegjësi shoqërore e biznesit: të përdorë burimet e veta dhe të angazhohet në veprimtari me qëllim rritjen e fitimeve të tij për sa kohë që është brenda rregullave të lojës, që do të thotë të angazhohet në konkurrencën e lirë dhe të hapur, pa zhgënjim ose mashtrim (Friedman 2000: 150).

Së pari, në konceptin e Friedman, duhet të përcaktohet një kornizë ligjore brenda së cilës individit do të ndjekë interesin e tij privat. Sepse, duke ndjekur interesat e tij, ai promovon shpesh interesin e shoqërisë shumë më mirë sesa në rastin kur realisht synon ta promovojë. Unë nuk kam parë ndonjëherë që të bëhet më shumë për të mirat publike se ajo që bëhet nga ata që u përfshinë në tregti (Friedman 2000: 150).

Adoptimi i përgjegjësisë sociale nga ana e drejtuesve të korporatave dhe drejtuesit sindikalistë është një prirje shkatërrimtare e themeleve bazë të shoqërisë së lirë. Përgjegjësia e tyre është maksimizimi i fitimit për aksionarët, pasi në të kundërt si do të dinë ata të zgjedhin se cili është interesi shoqërorë që duhet të ndjekin? Ndaj Friedman ngre pyetjen a mund të vendosin ata sa e rëndë është barra që iu lejohet të vendosin mbi veten e tyre ose aksionarët e tyre, me qëllim që t'i shërbejnë atij interesi shoqëror?

Në mënyrë të përmbledhur Friedman vë në pikëpyetje se cili do të ishte në fakt interesi shoqëror (pra, mund të ketë një, disa, shumë), dhe deri në cilën pikë apo masë do të ishte përgjegjësia e palëve për të ndjekur dhe realizuar këtë interes, aq më tepër kur drejtuesit do të ishin duke vepruar në emër të aksionarëve të tyre. Pra, nëse do të “devijonin” në interesin që ndjekin, jo vetëm që do të ndiqnin një interes të ndryshëm nga pala që i ka përzgjedhur po nga ana tjetër do të tejkalonin tagrat e tyre duke i ngarkuar këta të fundit me barra apo përgjegjësi të cilët ata vetë me vullnetin e tyre nuk i kanë zgjedhur apo nuk do t’i zgjidhnin. Në trajtimin e tij, Friedman ka një *momentum* personal, kur ndihet i detyruar të trajtojë një çështje në fushën e përgjegjësisë sociale e cila prek dhe interesat e tij vetjake: thirrja që biznesi duhet të kontribuojë me mbështetjen e veprimtarive bamirëse dhe në mënyrë të veçantë të universiteteve. Sipas tij: “një dhuratë e tillë nga korporatat është një përdorim i papërshtatshëm i fondeve të korporatës në një shoqëri të sipërmarrjes së lirë” (Friedman 2000:152).

Në interpretim të fjalëve të tij, përsa kohë që ai ndihet i detyruar të prekë një çështje të përgjegjësisë sociale, do të thotë që përgjegjësia sociale vjen si multi çështje, pra interesi shoqëror nuk është një dhe i fiksuar dhe kjo i jep të drejtë Friedman kur pyet se cili do të ishte interesi shoqëror në fund të fundit. Sepse atëherë do të kemi interesa dhe/ose grupe interesi të cilët do të konkurojnë brenda kornizës së përgjegjësisë ligjore, jo vetëm për të zëvendësuar maksimizimin e fitimit për aksionarët po dhe me vetë njëri - tjetrin. Aq më tepër kur në vetë listën e grupeve të interesit zakonisht përfshihen: punonjësit, klientët, furnizuesit, dhe komuniteti si dhe aksionarët dhe investitorët e tjerë (Boatright, 2006:106).

Sipas pikëpamjes tradicionale, aksionarët e zotërojnë korporatën⁶⁵ (Velasco, 2010: 897), pikëpamje e cila sipas Levitt (2008) është thelbi i kapitalizmit modern. Korporata është një instrument i aksionarëve që e zotërojnë atë (Friedman 2000:152). Nëse korporata jep një kontribut, kjo e ndalon aksionarin individual të vendosë vetë se si duhet të përdorë fondet e tij (Friedman 2000:152). Biznesi nuk ka përgjegjësi, njerëzit kanë. Kjo sepse korporata është një krijesë artificiale dhe si e tillë mund të ketë përgjegjësi artificiale por asesi përgjegjësi të mirëfillta dhe aq më tepër në formën apo përmbajtjen që pretendohet.

Përgjegjësia sipas Friedman mund dhe duhet t'i ngarkohet biznesmenëve që janë pronarët individualë ose drejtuesit ekzekutivë. Këta të fundit Friedman i cilëson si punonjës të pronarëve të biznesit dhe në trajtimin e tij ndalet pikërisht te kjo kategori, kjo sepse në cilësinë tyre si drejtues ekzekutivë, manaxheri është agjenti i individëve të cilët zotërojnë korporatën dhe ndaj të cilëve ka përgjegjësi (Friedman 1970:1).

Por a është e saktë kjo? Nga pikëpamja ligjore, përfaqësuesi ligjor i një korporate, ose drejtuesit e saj lidhin një kontratë pune me shoqërinë së cilës ligji i njej personalitet juridik për të kontraktuar. Kjo shoqëri që si rregull përfaqësohet nga një /disa përfaqësues individ,

⁶⁵ Qëndrimet në këtë pikë ndryshojnë: Sipas Velasco (2010: 897) nga ana teorike çështja e pronësisë është e nevojshme për një kuptim të saktë të natyrës së shoqërisë tregtare dhe të drejtës tregtare. Në fakt, ndonëse aksionarët zakonisht quhen pronarë të korporatës, kuptimi i pronësisë këtu është i ndryshëm nga përdorimi i tij i zakonshëm (Boatright, 2006: 113). Më tepër, aksionarët kanë disa të drejta që përfshijnë të drejtën e kontrollit dhe të drejtën ndaj fitimeve të firmës (Hansmann, 1996). Nga ana tjetër, po sipas Velasco, teoricienët e së drejtës tregtare ngrenë pretendimin se shoqëria tregtare nuk është një gjë që mund të zotërohet, por nëse kjo do të ishte e vërtetë atëherë aksionarët jo vetëm që nuk do ta zotëronin shoqërinë po as nuk do të mundeshin. Ndaj në tërësi, aksionarët janë pronarë të shoqërisë tregtare në kuptimin që kjo pronësi iu jep atyre të drejta dhe detyrime, që lindin nga aksionet që ata mbajnë në shoqëri. Kjo lidhet dhe me faktin se shoqëria tregtare nga ana e saj zotëron prona, asete të cilat nuk janë prona apo asete të aksionarëve, si dhe me faktin se aksionarët në rastin e shoqërisë aksionare të cilët nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë që mbulojnë humbjet e saj vetëm me vlerën e pashlyer të aksioneve të nënshkruara (neni 105 i LShT) dhe ortakët në rastin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë përsionalisht humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara (neni 68 i LShT)

është në fakt para ligjit punëdhënësi. Në asnjë rast, drejtuesi nuk lidh një kontratë me një apo me disa nga aksionarët, përkundrazi në shoqëritë me pronësi të fragmentarizuar, shoqëritë me ofertë publike aksionet e të cilës tregtohen lehtësisht në bursë, aksionarët janë të shumtë në numër dhe nuk ka mundësi fizike që një drejtues t'i njohë ata e aq më pak të kontraktojë me ta. Personaliteti juridik që i atribuohet shoqërisë (korporatës) e fuqizon atë para ligjit si një entitet i aftë për të kontraktuar.

Për sa më sipër, pretendimi i Friedman se drejtuesi është agjenti dhe punonjësi i aksionarëve lë shumë hapësira për interpretim, sidomos në kushtet e një realiteti të një pronësie gjithnjë e më të shpërndarë të shoqërive tregtare. Megjithatë, shoqëritë me ofertë publike janë shënjestra e pjesës më të madhe të diskutimeve në lidhje me përgjegjësinë sociale përse i përket mënyrës sesi janë krijuar dhe sesi manaxhohen (Hood, 1996:1).

Friedman sheh te manaxheri/ drejtuesi, një përfaqësues (Agjent) të individëve të cilët zotërojnë korporatën. Dhe për sa kohë ai është përfaqësues i tyre, ai duhet të sillet dhe të veprojë në mënyrë të tillë që të kurojë dhe mirëkujdeset për këto interesa.

Nëse përfaqësuesi vendos për mënyrën sesi duhet të shpenzojnë paratë të cilat i janë besuar të administrojë dhe begatojë, atëhere ai nuk duhet të shpërdorojë këtë besim, e aq më pak të abuzojë me të në favor të të ashtuquajturës përgjegjësi sociale. Pasi në të kundërtën, ai kthehet në fakt në një punonjës publik, një nëpunës civil ndonëse ai quhet ende punonjës i një sipërmarrjeje private (Friedman 1970:3).

Në fakt, çështja e të drejtave të aksionarëve ka marrë një përmasë të re që në momentin e shfaqjes së kapitalizmit manaxherial, pra ndarjes së pronësisë nga administrimi që përkon me fundin e shekullit të XIX dhe fillimin e shekullit të XX. Si rezultat i kësaj ndarjeje të pronësisë nga kontrolli, ka ekzistuar gjithmonë një pyetje në lidhje me rolin që i takon

aksionarëve (Berle, Means 1968).⁶⁶ Në vetvete pozicionimi i rolit të aksionarëve duhet të shihet në thelbin e debatit në lidhje me rolin e përfaqësuesit (agjentit) që kanë personat e ngarkuar me administrimin. Tashmë për aksionarët në cilësinë e pronarëve investitorë / kontribues bëhet e domosdoshme kontrolli dhe mbikqyrja e personave të ngarkuar me administrimin e shoqërisë të cilët nuk janë më (dhe jo gjithmonë) aksionarë/pronarë por përfaqësues (agent) të tyre.

Vështirësia në ushtrimin e “përgjegjësisë sociale” ilustron sigurisht virtytin e madh të sipërmarrjes private konkurruese – që i detyron njerëzit të jenë të përgjegjshëm për veprimet tyre dhe e bën të vështirë të “shfytëzosh” njerëz të tjerë për qëllime egoiste ose jo egoiste (Friedman 1970: 4). E thënë ndryshe në fjalët e Friedman, të bësh mirë, por vetëm nga vetja jote dhe jo në kurriz apo me shpenzimet e të tjerëve.

Friedman u përpoq që të sqaronte çështjet ligjore dhe etike të përfshira në debat duke theksuar se bizneset janë vetëm një grup njerëzish dhe vetëm njerëzit kanë përgjegjësi. Nëse një korporatë dhuron për bamirësi, pa autorizimin e aksionarëve, shkruante Friedman, manaxherët po vendosin sesi të shpenzojnë paratë e të tjerëve. Do të ishte më mirë që paratë t’i jepeshin aksionarëve si dividend apo të ardhura nga kapitali dhe ata të vendosnin se çfarë bamirësie do të bënin (Hood, 1996: 5).

Më shumë sesa të lidhura me objektiva të mirëmenduar sociale ose biznesi, kontribute të tilla shpesh reflektojnë besimet dhe vlerat personale të drejtuesve ose punonjësve (Porter, 2008: 453).

⁶⁶ Shih Gorezi A., (2011) Shareholder rights, Executive compensation and stakeholder protection: A comparative overview of United States of America and chosen European Union Jurisdiction, CEU, Electronic thesis and dissertations collection;

Në kuptimin e Friedman, manaxherët që përfshihen në aktivitete të përgjegjësive sociale janë duke shkelur të drejtën e pronës private; nëse manaxherët veprojnë në këtë mënyrë, ata do të ishin duke vepruar si autoritet fiskal duke vendosur taksa, pra duke marrë prerogativa që i përkasin institucioneve shtetërore të zgjedhura në mënyrë demokratike dhe nga ana tjetër, veprimet të tilla do të kishin pasoja, sepse manaxherët nuk janë ekspertë të problemeve sociale, ndaj dhe do të dështonin në përpjekjen e tyre për t'u sjellë si të tillë.

Aq më pak, nuk është e tillë as një shoqëri tregtare, e cila nuk mund të adresojë çështje sociale përtej përgjegjësive dhe mundësive të saj. Në këtë rast do të ishte shoqëria e cila do të përpiqej të zëvendësonte shtetin dhe detyrat e tij (Ferrero et al. 2012:7). Friedman arrinte në përfundimin se nëse duhet të bëhen kontribute bamirësie, ato duhet të bëhen nga aksionarët individualisht dhe jo nga shoqëria.

4.3 Teoria e Përfaqësuesit (Agjentit)

Bazat e teorisë së Friedman u përpunuan më tej nga Michael Jensen dhe Dean William Meckling (Universiteti Rochester)⁶⁷ të cilët ndërtuan atë që u njoh si “Teoria e Agjentit”. Sipas kësaj teorie qeverisja e shoqërisë bazohet te konfliktet e interesave mes pronarëve të shoqërisë, drejtuesve të saj dhe ofruesve kryesorë të borxhit financiar, dhe të tre këto grupe kanë interesa të ndryshme.

Ashtu si dhe Friedman, Jensen dhe Meckling u shprehën se marrëdhënia e agjentit është një formë kontrate mes pronarëve të shoqërisë dhe drejtuesve të saj ku pronarët (të përfaqësuarit)

⁶⁷ Artikulli i tyre “Theory of the firm: Managerial Behavior, Agency Costs and Ownership Structure” u botua në Journal of Financial Economics, më 1976. Shënim: Në dallim nga termi “corporate”, i përdorur nga Friedman, autorët përdorën termin “firm”.

caktojnë një përfaqësues/ agjent (drejtuesit në këtë rast) që emrin dhe llogarinë e tyre të administrojnë shoqërinë. Për shkak të kësaj marrëdhënie, pronarët duhet t'i delegojnë autoritet vendimmarrës drejtuesve (Wolf, 2013: 50).

Pronarët presin që përfaqësuesit e tyre të veprojnë në interesin më të mirë të pronarëve, dhe në rastin ideal “kontrata” e lidhur mes tyre duhet të sigurojë pikërisht këtë: që drejtuesit veprojnë gjithmonë në interesin më të mirë të pronarëve. Por në realitet një “kontratë” e tillë ideale është e vështirë që të jetë, ndaj si mund të nxiten drejtuesit të veprojnë në interesin më të mirë të pronarëve? Jensen dhe Meckling shkuan më tej duke u shprehur se në mënyrë që shoqëritë të fokusoheshin vetëm në bërjen e parave për aksionarët, shoqëritë duhet që t'i bënin vetë drejtuesit ekzekutivë aksionarë duke iu ofruar këtyre të fundit kompensime në formën e aksioneve. Në këtë mënyrë, ata do të kishin më shumë nxitje për t'u mirëkujdesur për interesat e aksionarëve të tjerë që tashmë do të ishin edhe tyre.

Përfaqësimi i aksionarëve me anë të përfaqësuesve (agjentëve) shoqërohet dhe me kosto në momentin që pronarët zgjedhin që shoqëria të administrohet nga palë të treta.

Përsa kohë pronësia dhe kontrolli nuk janë absolutisht të ndara, dhe si të tilla pronari dhe drejtuesi është i njëjti person, përfaqësimi është pa kosto. Kostot lindin në momentin kur palë të treta jashtë pronarëve ngarkohen me detyrën e përfaqësimit. Kostot e përfaqësimit janë potencialisht shumë të larta në shoqëritë shumë të mëdha, ku ka shumë aksionarëv dhe drejtues të lartë profesionistë (Wolf, 2013: 45).

Kostot e përfaqësimit mund të përcaktohen si “*vlerë e humbur*” të aksionarët, e cila lind nga dallimet mes interesave të aksionarëve dhe drejtuesve të shoqërisë (Wolf, 2013: 46), kosto të cilat mund të minimizohen duke përmirësuar monitorimin e drejtuesve të shoqërisë

nëpërmjet bordeve dhe/ose duke iu dhënë drejtuesve incentiva të shëndetshme për të përqasur sa më afër interesat e tyre me ato të aksionarëve.

4.4 Përgjegjësia sociale dhe filantropia në dritën e Teorisë së Aksionarëve

Ngjashmërisht me çështjen e filantropisë të parashtuar nga Friedman, teoria e përfaqësimit /agjentit ngre po aq çështjen e donacioneve nga ana e shoqërisë. Një aspekt i rëndësishëm i qeverisjes së korporatës është nëse donacionet janë përdorur për qëllimin e synuar dhe nuk janë keqpërdorur apo përvetësuar⁶⁸. Gjithmonë e më shumë drejtuesit ekzekutivë e gjejnë vetën të zënë ngushtë mes kritikave për më nivele më të larta të “përgjegjësisë sociale” nga njëra anë dhe investitorët që bëjnë vazhdimisht presion për të maksimizuar fitimet afat shkurtra (Porter, 2008: 451).

Argumentat e Friedman kanë në bazë dy supozime: i pari është që objektivat sociale dhe ekonomike janë të ndarë dhe të dallueshëm nga njëri – tjetri, kështu që shpenzimet me natyrë sociale të një shoqërie tregtare bëhen në kurriz të rezultateve ekonomike. Së dyti, shoqëritë tregtare kur adresojnë objektiva sociale nuk ofrojnë përfitime më të mëdha sesa kur ato jepen nga dhurues individualë (Porter, 2008: 454).

Shoqëritë tregtare nuk funksionojnë të izoluara nga shoqëria ku ndodhen. Duke ofruar punë, duke investuar kapital, duke blerë mallra, dhe duke bërë biznes çdo ditë, shoqëritë tregtare kanë një ndikim të thellë dhe pozitiv në shoqëri (Porter, 2008: 498). Gjëja më e rëndësishme që mund të bëjë një shoqëri tregtare për shoqërinë, dhe çdo komunitet është që të kontribuojë

⁶⁸ Wolf (2013: 50) sugjeron se mënyrat për të zvogëluar problemin e agjencisë në rastin e donacioneve, përfshijnë:

Transparencën e plote financiare në lidhje me veprimet e kryera; Auditim transparent i veprimtarisë; Donacionet të manaxhohet nga bordi i drejtorëve të mbikqyrur nga një komitet i pavarur.

për një ekonomi të begatë (Porter, 2008: 498). Shoqëritë tregtare nuk janë përgjegjëse për të gjitha problemet në botë, dhe as nuk kanë burimet për t'i zgjidhur ato. Në vend që kompanitë të vendosin se cilat çështje sociale duan të mbështesin, duhet që qeveria të ndërhyjë për të promovuar projekte të zgjedhura (Buffet⁶⁹, 2020).

Çdo shoqëri mund të indentifikojë disa probleme sociale për të cilat është më e përgatitur për t'i zgjidhur dhe prej të cilave mund të marrë përfitimet më të mëdha konkurrenciale (Porter, 2008: 499). Pasi në të kundërt, duke lënë gjithcka në duar të individëve, do të ulet në fakt "përmasa" e impenjimit të tyre në kuadrin e përgjegjësisë sociale, duke ia lënë përzgjedhjes dhe preferencave individuale, ulet efikasiteti i tyre si dhe mund të humbë efekti i tyre në kohë, pra një veprim i pritur të bëhet në një moment të dhënë, shtyhet në një kohë të dytë.

Në planin afatgjatë qëllimet sociale dhe ekonomike nuk janë në thelb konfliktuese, por të lidhura në mënyrë integrale. Konkureshmëria lidhet me produktivitetin me të cilin shoqëria tregtare përdor punën, kapitalin dhe burimet natyrore për të prodhuar mallra dhe shërbime cilësore dhe gjithashtu dhe suksesi i tyre është lidhur tashmë dhe me institucionet lokale dhe kushte të tjera kontekstuale.

Kohët e fundit gjithnjë e më shumë kanë dalë në pah, tre treguesit jo financiarë (environmental, social, governance - ESG) të cilat zakonisht nuk janë pjesë e raportimit financiar të detyrueshëm, megjithëse kompanitë gjithnjë e më shumë po i bëjnë pjesë në

⁶⁹ Shënim: Kohët e fundit kompania Berkshire e Buffet shpenzoi afërsisht 30 miliardë dollarë në turbinat e erës dhe infrastrukturën përkatëse në Iowa, por Buffett tha se investimi u bë për shkak të "kreditimit të taksës së prodhimit që marrim". (marrë nga https://markets.businessinsider.com/news/stocks/warren-buffett-companies-should-prioritize-profitability-over-social-causes-esg-2020-1-1028791675?fbclid=iwar0eajqrzh6urbgko5go5uqbmqyr5m_yhxeqwhpach6uhalqgxoknjhg6po8)

raportin e tyre vjetor ose në raport e qëndrueshmërisë⁷⁰, të cilat ashtu si sugjeron vetë emri kanë të bëjnë me mjedisin, anën sociale dhe qeverisjen.

Çështjet ESG shpesh janë të ndërlydhura, dhe mund të jetë e vështirë për të klasifikuar një çështje të ESG si vetëm çështje mjedisore, sociale ose e qeverisjes. Çështjet ESG shpesh mund të maten por mund të jetë e vështirë t'u caktohet atyre një vlerë monetare (p.sh. cila është kostoja e qarkullimit të punonjësve për një kompani?)⁷¹.

Në kuadër të sa më sipër, ndonëse këto faktorë mund të merren parasysh në vlerësimin e një shoqërie tregtare, mbetet fakt që fokusi i saj duhet të mbeten aksionarët dhe përfitimet e tyre, dhe jo tek e ashtuquajtura veprimtaria ESG; kjo e fundit duhet të mbetet në vëmendje dhe në dorë të qeverisë dhe të vetë shoqërisë për të përcaktuar prioritetet dhe mënyra veprimi nga ana e aktorëve në treg, për t'i zgjidhur dhe për të zbutur kostot. E thënë ndryshe, aktorët në treg, shoqëritë tregtare do të mund të përfshihen në çështje apo kauza sociale, mjedisore, sensitive etj sipas një listë prioritetesh për të cilat ato përfitojnë lehtësira, favorizime financiare, fiskale etj duke bërë që barra të shpërndahet në mënyrë të drejtë dhe të mos rëndojë në mënyrë abuzive apo të njëanshme vetëm të shoqëria dhe rrjedhimisht dhe tek të ardhurat e pronarëve të saj apo te qytetari – konsumator.

⁷⁰ Shih <https://www.cfainstitute.org/en/research/esg-investing>

⁷¹ Po aty

KAPITULLI V: TEORIA E GRUPEVE TË INTERESIT (TEORIA E FREEMAN)

5.1 Hyrje

Mendimi se korporatat kanë grupe interesi është bërë i zakonshëm në literaturën e manaxhimit, si akademike dhe profesionale (Donaldson, 1995). Koncepti i grupeve të interesit është një koncept me peshë (Phillips, Freeman & Wicks, 2003). Kjo vjen deri në një shkallë të arsyeshme nga gjerësia e konceptit (Phillips, Freeman & Wicks, 2003). Ndërkohë që autorë të tjerë ngrenë pyetjen nëse kemi të bëjmë me një koncept të gjerë apo një koncept po aq të paqartë, një paqartësi që mund ta diktojë gjerësia e konceptit *per se*, ose paqartësi e vetë konceptit si i tillë.

Në thelb të argumentave dhe teorisë së tij, Freeman vendosi pyetjen: “*Në interes të kujt dhe në kurriz të kujt duhet të drejtohet një firmë?*”. Për të adresuar pyetjen e tij, ai përdori argumentin ligjor dhe atë ekonomik.

Korporatat nuk janë më thjesht mjete ligjore me anën e të cilave kryhen transaksionet e biznesit privat të individëve (Berle, Means 1932). Freeman sfidoi pikëpamjen se: “Manaxherët kanë një marrëdhënie speciale me aksionarët e nje firme”.

Deri atëherë e drejta tregtare kishte pasur në fokus të saj parimin e interesit të aksionarëve⁷².

Veprimet dhe mosveprimet e korporatës duhet të udhëhiqen nga vëmendja ndaj nevojave të

⁷² Në ShBA një rol të rëndësishëm luajtën dhe vendimet e gjykatave e sidomos në çështjen AP Smith Mfg. Co. v. Barlow e 1953. Gjykata ripërcaktoi qëllimin e korporatave. Në vitin 1951, Bordi i Drejtorëve të A.P. Smith, prodhues valvulash dhe fikëse zjarri, mori vendimin që t'i dhuronte një kontribut prej \$1,500, Universitetit të Princeton. Aksionarët ngritën padi duke e quajtur kontributin jashtë qëllimit të shpenzimeve të korporatës. Gjykata hodhi poshtë pretendimet e tyre duke lënë vendimin për dhënien e kontributit në fuqi dhe theksoi se: “...aksionarët interesat privatë të të cilëve janë vetëm për mirëqenien e korporatës, nuk duhet të lejohen të mbyllin sytë ndaj realitetit të përditshëm dhe të pengojnë veprimin e korporatave në njohjen e detyrimeve të saj dhe përmbushjen e tyre, si një element përbërës i strukturës sonë moderne shoqërore ". I njëjti qëndrim ishte

aksionarëve, që zakonisht matet me cmimin e aksioneve, fitimet për aksion, ose me masa të tjera financiare (Freeman, Reed, 1983: 88). Kapitalizmi manaxherial shihte te aksionarët zotëruesit e aksioneve të cilët gëzonin të drejta dhe privilegje të cilat në fjalët e Freeman (1983), iu jepen nga manaxherët dhe të tjerët. Freeman (1983:39) nga ana tjetër synonte të: “përtërijë konceptin e kapitalizmit manxherial duke zëvendësuar konceptin se manaxherët i detyrohen aksionarëve me konceptin se manaxherët kanë një marrëdhënie besimi me grupet e interesit”, duke bërë kështu një zhvendosje nga termin qëndrimi klasik “aksionar” te ai i “grupeve të interesit”. Në këtë grup ai përfshinte furnizuesit, klientët, punonjësit, aksionarët, komunitetin si dhe manaxhmentin në rolin e tij si agjent i këtyre grupeve⁷³. Për më tepër, secili nga këto grupe ka të drejtën të mos konsiderohet si mjet për arritjen e një qëllimi dhe të marrë pjesë në përcaktimin e drejtimit të ardhshëm të firmës në të cilën ata kanë një interes (Freeman, 1983: 39).

Fjala “*grup interesit*” u përdor për herë të parë në një memorandum të brendshëm të Institutit Stanford të Kërkimit në 1963 duke iu referuar “atyre grupeve pa mbështetjen e të cilëve organizata do të pushontë së ekzistuari” (Freeman, Reed, 1983: 89). Për pjesën më të madhe zhvillimi i konceptit të grupeve të interesit në fund të viteve gjashtëdhjetë dhe fillimit të shtatëdhjetës ishte i ngadaltë (Freeman, Reed, 1983: 89). Por nisur nga zhvillimet në legjislacion, në lidhje me përgjegjësinë e prodhuesit të produktit për dëm të shkaktuar

mbajtur nga gjykata dhe në çështjen *Armstrong Cork Co. v. H.A. Meldrum Co.* ku mbështeti kontributet e bëra për Universitetin e Buffalo-s dhe Kolegjin Canisus, çështjen *Evans v. Brunner, Mond & Company, Ltd.* [1921] për grantin prej £100 000 për universitetet dhe institucionet shkencore (shih vendimin çështjen *AP Smith Mfg. Co. v. Barlow* 13 NJ. 145 (1953) 98 A. 2d 581 e aksesueshmë në <https://h2o.law.harvard.edu/cases/3875>).

⁷³ Shënim: krejt në dallim nga Friedman që e sheh drejtuesin e shoqërisë si punëmarrës të pronarëve të biznesit, pra të aksionarëve dhe i njeh atij rolin e përfaqësuesit të këtyre të fundit, Freeman, i vesh drejtuesit të shoqërisë “petkun” e përfaqësimit të të gjithë grupeve të interesit që ai (Freeman) identifikon. Për më shumë shih, Freeman E. “Stakeholder theory of the modern corporation”, (1983).

konsumatorit, tërheqja e produkteve nga tregu, informimi në lidhje me përmbajtjen ushqimore të produkteve, e drejta e organizimeve kolektive të punonjësve, mbrojtja nga diskriminimi, mbrojtja e interesave të konsumatorëve, Freeman argumentonte se ky parim ishte kufizuar.

Një rol po aq të rëndësishëm luajti dhe rritja e interesit në përfshirjen sociale të biznesit. Mjafton të thuhet se lëvizjet sociale të viteve '60 dhe '70, - të drejtat civile, lëvizjet kundër luftës, konsumatorizmi, ambientalizmi, dhe të drejtat e grave – shërbyen si një katalizator për të rimenduar rolin e biznesit në shoqëri (Freeman, Reed, 1983: 90).

Teoria e grupeve të interesit gjendet gjerësisht në vendet e Europës Perëndimore, kryesisht në Francë dhe Gjermani, ku punonjësit luajnë një rol të rëndësishëm në drejtimin e shoqërisë (Pajaj, Ferzaj, 2013: 18), dhe veçanërisht në ato shoqëri të cilat për shkak të përmasave të tyre ushtrojnë ndikim në disa grupe në shoqëri. Në këto vende përfaqësuesit e punonjësve ose janë pjesë e Bordit (Këshillit) drejtues ose zotërojnë aksione në shoqëri. Si rrjedhojë, ata ndikojnë te politikat, strategjitë dhe administrimin e përditshëm të shoqërisë nëpërmjet ushtrimit të të drejtës së votës (Pajaj, Ferzaj, 2013: 18). Në thelb të Teorisë së Grupeve të Interesit qëndron parimi se drejtuesit e shoqërisë janë përgjegjës ndaj grupeve të interesit dhe jo vetëm ndaj aksionarëve⁷⁴.

⁷⁴ Në fakt Key (1998) (e cila referon Donaldson dhe Preston, 1995; Jones, 1995; Mitchell et al. 1997; Mitnick, 1993; Rowley 1997, 1998; Wood, 1991) është e mendimit se në mënyrën sesi është konceptuar nga Freeman (1984) në punimin e tij origjinal, modeli i grupeve të interesit nuk përmbush kriteret e të qenit teori. Në artikullin e saj "Toward a new theory of the firm: a critique of the stakeholder "theory", Management Decision, 37/4, [1999] – 317 – 328, analizon doktrinën ekzistuese dhe sugjeron hedhjen e hapave drejt një teorie të re të firmës nisur nga koncepti i grupeve të interesit. Key merr parasysh ndarjen në grupe individuale interesi, organizacionale dhe intuticionale sipas Wood (1991) sesa konceptin artificial dhe jo konkret të grupit të interesit. Pra, shoqëria si e tërë mund të shihet si grup interesi në një nivel dhe në një nivel tjetër, mund të shihen individët. Interesat që i lidhin mund të përkojnë ose të konfliktojnë në varësi të nivelit të analizës.

5.2 Analiza e Grupeve të Interesit

Analiza do të nisë pikësëpari nga vetë koncepti i grupeve të interesit, çfarë janë dhe çfarë nuk janë ato, çfarë përfshijnë dhe çfarë nuk përfshihet në këtë koncept.

Së pari, shoqëritë tregtare kanë grupe interesi, të cilët kanë pritshmëri të ndryshme dhe të caktuara nga shoqëria tregtare. Nëse shoqëria tregtare nuk i jep diçka gjithë grupeve të interesit, pra grupeve që kanë një interes të ajo, atëherë grupet mund të mos mbajnë më të njëjtin interes në shoqërinë tregtare. Në të kundërt, nëse shoqëria dëshiron të mbajë këto interesa me grupet që i përfaqësojnë, atëherë ajo duhet të bëjë diçka për t'iu përgjigjur dhe, në rastin ideal, për të përmbushur pritshmëritë e tyre. Shpesh interesat dhe pritshmëritë nuk janë në përputhje me njëri – tjetrin, ose mund të jenen dhe diametralisht të kundërta. Në fakt, jo gjithmonë është e mundur të indentifikohen kërkesat ose pritshmëritë e një grupi interesi. Sipas Freeman dhe Reed (1983) një nga arsyet kryesore të përmasave që mori koncepti i grupeve të interesit i atribuohet pikërisht rritjes së vëmendjes në lidhje me përfshirjen sociale të biznesit. Këtu vlen të ndalemi një moment të paraqitur dhe kontekstin historik të rrethanave të krijuara: vitet '60 dhe '70 shënuan vendin e tyre në histori. U karakterizuan nga lëvizje të shumta shoqërore në lidhje me të drejtat civile dhe shoqërore, lëvizjet paqësore kundër ndërhyrjeve dhe luftës në Kore, në Vietnam etj., lëvizja për të drejtat e grave përfshirë të drejtën e abortit, si dhe lëvizjet me karakter ambientalistë shërbyen sipas Freeman e Reed (1983): *“si një katalizator për të rimenduar rolin e ndërmarrjes së biznesit në shoqëri”*. Është në këtë rrethana që morën një përmasë të re dhe vetë koncepti i grupeve të interesit.

5.3 Analiza e “grupit të interesit” si koncept

Për të analizuar “grupin e interesit” si koncept, do të “huazojmë” fillimisht përcaktimin e bërë nga Freeman. Sipas Freeman, grupet e interesit janë ato grupe të cilat kanë një interes apo pretendim ndaj firmës⁷⁵. Në këtë grup Freeman përfshinte veçanërisht furnitorët, konsumatorët, punonjësit, aksionarët dhe komunitetin lokal si dhe drejtuesit në cilësinë e tyre të agjentit (përfaqësuesit) për këto grupe. Korporatat kanë grupe interesi, që do të thotë grupe ose individë të cilët përfitojnë ose dëmtohen nga veprimet e korporatës dhe të drejtat e të cilëve shkelen apo respektohen prej tyre (Freeman, 1984). Në kuptim të Freeman, aksionarët kanë disa kërkesa të veçanta ndaj firmës, dhe si të tillë ata kanë të drejtë t’i parashtrojnë kërkesa drejtuesve, edhe grupet e interesit kanë të drejtë për të bërë kërkesë. Pra, grupi i interesit është një përgjithësim edhe i konceptit të aksionarëve.

Përsa kohë të dy palët: aksionarët nga njëra anë dhe grupet e interesit nga ana tjetër kanë të drejtë të bëjnë kërkesa, atëherë mbetet për t’u vlerësuar natyra e tyre dhe mënyra sesi këto kërkesa parashtrohen, adreson dhe zgjidhen, gjithmonë nëse zgjidhen.

Pra, në funksion të konceptit të grupit të interesit, mbajmë parasysh tre elementë të tij:

- Grupi i interesit mund të preket/të ndikohet nga ajo çfarë bën entiteti;
- Grupi i interesit mund të prekë/ndikojë entitetin;
- Grupi i interesit mund të ndikohet nga dhe të ndikojë entitetin.

⁷⁵ Në artikullin e tij, Freeman përdor termin firmë kryesisht, as shoqëri, organizatë apo korporatë. Ai i referohet dhe përdor termin “korporatë” kur ndërton Doktrinën e Kontratës së Drejtë, e cila sqarohet në vijim.

5.4 Klasifikimi i kërkesave të grupeve të interesit

Kriteri mbizotërues në klasifikimin e grupeve të interesit është interesi i ligjshëm i këtyre subjekteve në shoqëri (Pajaj, Ferzaj, 2013: 18). Nisur nga fakti që jo gjithmonë është e mundur të indentifikohen kërkesat e një grupi të caktuar interesi, klasifikimi i parë është ai i kërkesave që kanë grupet e interesit: Kërkesat direkte të grupeve të interesit dhe kërkesat indirekte. Ky klasifikim merr për bazë supozimin se një/disa grupe mund të mos e dinë që kanë një kërkesë ose mund të dinë që e kanë po nuk dinë se ku apo si ta parashtrojnë atë⁷⁶.

- **Kërkesat direkte** bëhen direkt nga vetë grupet e interesit, si për shembull punonjësit mund të kërkojnë një pagë më të lartë;
- **Kërkesat indirekte** bëhen në mënyrë indirekte në emër të dikujt tjetër: për shembull një klient që ankohet mund të përdorë një entitet apo zyrë e cila merrem me mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit. Një nga pikat e dobëta të kësaj lloj kërkesë është fakti i saktësisë në parashtrimin e kërkesës dhe saktësia e grupit që përfaqësohet.

5.5 Klasifikimi i grupeve të interesit

Klasifikimi i grupeve të interesit, sipas tipologjive të tyre është i larmishëm dhe është bërë nga autorë të ndryshëm dhe sugjeruar nga literatura në vite.

(i) Grupet e interesit në kuptimin e ngushtë dhe grupet e interesit në kuptimin e gjerë

Në një analizë të mëparshme Freeman dhe Reed (1983) dalluan në grupin e interesit, grupet e interesit të kuptimin e ngushtë dhe grupet e interesit në kuptimin e gjerë.

⁷⁶ Për më shumë shih Emile Woolf Publishing Limited, faqe 32.

Grupet e interesit në kuptimin e ngushtë janë ato grupe të cilët janë të qenësishëm për mbijetesën dhe suksesin e korporatës, në të cilin bëjnë pjesë: aksionarët (pronarët), punonjësit, furnizuesit, klientët dhe komuniteti vendas (të gjithë pjesëtarët e grupit të interesit në kuptimin e ngushtë do të analizohen në detaje në pjesën në vijim).

Grupet e interesit në kuptimin e gjerë janë grupe të cilët ndikojnë apo mund të ndikohen nga korporata. Në këtë kontekst Freeman përfshin konkurentët dhe organet shtetërore.

Grupi i interesit në kuptimin e gjerë - Çdo grup apo individ i identifikueshëm i cili mund të ndikojë arritjen e qëllimeve të organizatës ose i cili mund të ndikohet nga arritja e qëllimeve të organizatës (grupet publike të interesit, grupet e protestës, agjensitë shtetërore, organizmat e tregtisë, konkurentët, sindikatat, ashtu si dhe punonjësit, segmentët e klientëve, zotëruesit e aksioneve, dhe grupe të tjerë interesi në këtë kuptim) (Freeman, Reed, 1983)

Grupi i interesit në kuptimin e ngushtë: çdo grup apo individ i identifikueshëm nga i cili organizata varet për mbijetesën e saj të vazhdueshme (Punonjësit, segmentimet e klientëve, disa furnitorë, agjensitë kryesore shtetërore, zotëruesit e aksioneve, disa institucione financiare, ashtu si dhe grupe të tjera interesi në kuptimin e ngushtë të konceptit (Freeman, Reed, 1983).

Nga sa më sipër shohim se në vetvete të dy ndarjet përfshijnë pothuajse të njëjtët pjesëmarrës por:

1. Dalloni rolin e tyre ndaj organizatës;
2. Dalloni lidhjen e tyre nga dhe me organizatën;

Gjithashtu duhet pasur parasysh nëse në jetën e saj, organizata duhet të ketë parasysh dhe në konsideratë vetëm ato grupe nga e cila varet ekzistenca e saj apo edhe ato grupe të cilat në

një mënyrë apo në një tjetër ndikojnë në arritjen e qëllimeve të saj dhe si e tillë, indirekt dhe në ekzistencën e saj.

(ii) Grupet e interesit sipas Donaldson dhe Preston

Donaldson dhe Preston nga ana e tyre ngritën hipotezën se:

- (a) grupet e interesit janë persona ose grupe me interesa të ligjshme në aspektin procedural dhe/ose substantive në aktivitetin e korporatës; si të tillë ata indentifikohen nga interesat e tyre në korporatë nëse korporata ka ndonjë interes funksional përkatës ndaj tyre;
- (b) interesat e grupeve të interesit janë të një vlere themelore. Që do të thotë se çdo grup interesi i takon vlerësim për hir të vetëvetes dhe jo thjesht për shkak të aftësisë për të cuar më tej interesat e grupeve të tjera si ato të zotëruesve të aksioneve.

(iii) Grupet normativë të interesit dhe grupet derivativë të interesit

Phillips (2003) sugjeron se grupet e interesit mund të ndahen në (i) grupe interesit normativë dhe (ii) derivativë. Sipas Phillips grupet e interesit normativë janë ato grupe ndaj të cilëve organizata ka një detyrim moral të drejtëpërdrejtë për mirëqenien e tyre. Ky kategorizim përfshin: punëmarrësit, konsumatorët, financierët, furnizuesit dhe komunitetet lokale. Përkundrazi, grupet e interesit derivativë janë ato grupe apo individë të cilët ose mund ta dëmtojmë ose ta ndihmojnë organizatën por kjo e fundit nuk ka asnjë detyrim moral të drejtëpërdrejtë si grup interesi (Phillips, Freeman & Wicks, 2003) të cilët mund të jenë: konkurentët, terroristët apo media.

Pra, edhe brenda grupeve të interesit duhet të dallojmë dy kahe apo grupime të cilët, të vënë përballë, ndikojnë të organizata (për mirë apo për keq) por dallohen pikërisht nga detyrimi

moral që ka organizata ndaj tyre. E thënë ndryshe, mund t'i ndajmë në grupin i drejtpërdrejtë i interesit dhe jo i drejtpërdrejtë.

Nisur nga teoria e grupeve të interesit, grupi i drejtpërdrejtë i interesit është grupi interesat e të cilit pritet që të kurohen nga ana e drejtuesve të shoqërisë ndërkohë që interesat e grupit të drejtpërdrejtë nuk “konkurojnë” për të përfutur po ama merren parasysh që procesin e drejtimit të një shoqërie. Është e kuptueshme që Ligji nuk bën një ndarje të tillë kaq të prerë, të shprehur dhe funksionale. Një ndarje e tillë ka lindur nga debati akademik në kuadrin e teorive dhe diskuri që ka ndjekur ato. Pavarësisht se nuk kërkohet që drejtuesit e shoqërisë të marrim parasysh interesat e grupeve jo të drejtpërdrejta në masën, formën apo përmbajtjen që (duhet të) marrin grupin e drejtpërdrejtë, analizimi dhe konsiderimi i tyre konsiderohet i rëndësishëm në procesin e drejtimit dhe mund të themi se është një mjet që në fund i shërben interesit të fundmë të grupeve të interesit.

Teoria e grupeve të interesit është teori e manaxhimit organizativ dhe etik (Philips, Freeman & Wicks, 2003). Në thelb të kësaj teorie, është përmbajtja morale sepse pjesë integrale e saj janë çështjet e moralit. Sipas themeluesve të kësaj teorie, teoria e grupeve të interesit shquhet sepse adreson shprehimisht moralin dhe vlerat si një tipar thelbësor i manaxhimit të organizatave (Philips, Freeman & Wicks, 2003).

Përveç këtyre grupeve të interesit, Capron (2003) paraqet dhe një element tjetër që krijon një pengesë në teorinë e grupeve të interesit. Këtu ai dallon grupet e interesit “memecë” si për shembull mjedisi natyror dhe grupi i interesit të munguar si brezat e ardhshëm ose viktimat e mundshme. Të dy këto grupe interesi përtej të qenit grup, janë njëkohësisht në një pozitë më të dobët dhe të pafavorshme mbrojtje për të ngritur zërin e tyre krahasuar me grupet e tjera të interesit si punonjësit, klientët, furnitorët etj. Ose në një këndështrim tjetër, duhet që

një grup tjetër interesi të bëhet po aq përfaqësues apo t'i japë “zë” këtyre grupeve që të mos jenë të nën përfaqësuar⁷⁷.

(iv) Grupe interesi primare (parësore) dhe sekondare (dytësore)

Tipologjia e grupeve të interesit të Clarkson është më gjerësisht e njohur dhe e pranuar (Branco, Rodrigues, 2007). Clarkson (1995) bën ndarjen në grupe interesi primare (parësore) dhe sekondare (dytësore):

Grupet e interesit primarë janë ato pa të cilët shoqëria nuk mund të mbijetojë si një çështje në vijim (aksionarët dhe investitorët, punonjësit, klientët dhe furnitorët dhe gjithashtu qeveritë dhe komunitetet) që japin infrastrukturë dhe tregje, ligjet dhe rregullat e të cilëve duhet të respektohen dhe ndaj të cilëve mund të lindin detyrime për taksa apo detyrime të tjera”.

Grupet dytësore “influencojë ose ndikojnë, ose influecohen ose ndikohen nga shoqëria por nuk janë të angazhuar në veprime me shoqërinë dhe nuk janë thelbësore për mbijetesën e saj, të paktën në terma afatshkurtër (Clarkson, 1995). Sipas Clarkson, grupet parësorë kanë një ndikim të madh në vendimet dhe veprimet e shoqërisë.

(v) Grupet aktivë dhe pasivë të interesit

I pari që e bëri këtë klasifikim qe Mahoney (1994).

⁷⁷ Në fakt, ky klasifikimi lidhet dhe me klasifikimin e kërkesave të grupeve të interesit të bërë në seksionin 5.4 më lart, i cili dallon kërkesat direkte dhe indirekte të grupve të interesit. Për shembull, për ilustrim, brezat e ardhshëm përfaqësojnë “Kërkesat indirekte” – ato mund të kenë pretendim për mënyrën sesi vepron sot një shoqëri tregtare dhe nëse veprimet e saj mund të ruajnë apo dëmtojnë mjedinë në të ardhmen e cila iu përket pikërisht këtyre brezave. Si breza të ardhshëm në momentin që ndodh ky veprim, ata mund të jenë ende minorenë për të parashtruar një kërkesë të tillë.

Grupet aktive të interesit janë ata të cilët përpiqen që të përfshihen në vendimet dhe veprimet e shoqërisë tregtare. Ata mund të jenë pjesë e proceseve normale të vendimmarrjes dhe operimit si drejtuesit dhe punonjësit (Woolfe : 34). Gjithashtu këtu mund të përfshihen dhe autoritetet shtetërore rregullatore ose grupet e mbrojtjes së mjedisit.

Grupet pasive zakonisht nuk përpiqen që të përfshihen në politikëbërjen e shoqërisë tregtare pavarësisht interesit të madh që mund të kenë te kjo e fundit. Si të tilla mund të përmendim shtetin ose komunitetet lokale.

(vi) Grupet vullnetare dhe jo vullnetare të interesit

Ky klasifikim dallon:

Grupin vullnetar të interesit i cili mbart/ fiton cilësinë e grupit të interesit në mënyrë vullnetare si për shembull punonjësi i një shoqërie, një konsumator që zgjedh të blejë një mall apo shërbim nga ofrues të ndryshëm, si dhe kryesisht në rastin e shoqërive aksionare me ofertë publike, aksionarët të cilët blejnë apo shesin aksionet e tyre.

Grupet jo vullnetare nuk zgjedhin të jenë apo të bëhen të tillë por nuk kanë mundësi zgjedhjeje. Këtu mund të përmendimin: një ofrues shërbimi bëhet i tillë në momentin kur në treg hyn një konkurent i ri, krahas atyre ekzistues. Një shembull tjetër është rasti i hapjes së një aktiviteti të ri tregtar për shembull një fason, apo hotel, në një komunitet ose qytet të caktuar, i cili nuk e zgjedh këtë aktivitet por është aktiviteti që e zgjedh atë.

(vii) Grupet legjitime dhe jo legjitime të interesit

Me tepër sesa një klasifikim objektiv, ky klasifikim lidhet me tepër me gjykimin se çfarë do të konsiderohet e drejtë apo jo dhe në fund është vetë shoqëria ajo që përcakton nëse kërkesa është legjitime ose jo.

Grupet legjitime janë ato që kanë “të drejtë” të parashtrojnë një kërkesë te shoqëria, duke pasur kështu një kërkesë “legjitime”. Grupet ilegjitime nuk e kanë një të drejtë të tillë dhe kështu dhe vetë kërkesa e tyre do të jetë jo legjitime. Zakonisht kjo kategori përfshin më tepër grupet e presionit apo aktivistët në fusha të caktuara si për shembull grupet e mbrojtjes së të drejtave të kafshëve, etj.

(viii) Grupet e njohura dhe të panjohura të interesit

Që nga vetë përkufizimi, shoqëria njeh grupet e njohura dhe nuk ka dijeni për grupet e panjohura. Kryesisht ky lloj klasifikimi prek më tepër ato lloj aktiviteteve tregtare të një natyre të gjerë dhe me ndikim në mjedis, veprimtaria e të cilave janë dhe subjekt më i detajuar rregullimi në tregun përkatës ku veprojnë. Këtu mund të përfshihen dhe raste studimi të biznesit në fjalë.

(ix) Grupet e jashtme dhe grupet e brendshme të interesit

Është një klasifikim i përdorur gjerësisht dhe për shkak të lehtësisë së identifikimit të palëve të përfshira:

Grupet e brendshme janë brenda shoqërisë dhe janë pjesë e saj si aksionarët, punonjësit, drejtuesit, dhe në shoqëri të caktuara ose në fusha të caktuara të veprimtarisë, edhe sindikatat kur ato janë mjaftueshëm të forta, apo në vëndet të cilat kanë një traditë në organizimet

sindikale. Për legjislacione të caktuara, kryesisht ato Europiane, këtu mund të bëjnë pjesë dhe Këshillat e Punëmarrësve.

Grupet e jashtme janë jashtë shoqërisë, nuk punojnë për të dhe nuk janë pjesë e saj megjithëse kanë ndikim te ajo apo kanë një interes te ajo. Ata mund të jenë në gjendjen të ndikojnë në mënyrën sesi drejtohet shoqëria (Woolfe: 37). Në këtë grup bëjnë pjesë:

- Konkurentët e tjerë në treg, të cilët kryesisht ndikojnë në strategjitë operacionale të shoqërisë;
- Furnizuesit të cilët e kanë shoqërinë tregtare një klient;
- Huadhënësit e shoqërisë tregtare të cilët presin të paguhet për paratë e dhëna. Zakonisht ata monitorojnë performancën e shoqërisë sidomos në periudha të vështirësive financiare.
- Autoritetet rregullatore me fuqi monitoruese dhe detyruese për shoqërinë. Fusha të aktivitetit të cilat janë subjekt rregullimi mund të ndikojnë në mënyrën sesi drejtohet një shoqëri.
- Bursat përsa kohë që shoqëritë tregtare janë me ofertë publike dhe të kuotuar në bursë, rregullat e së cilës janë detyruese për shoqëritë pjesëmarrëse në të. Sidomos këto lloj shoqërish janë dhe më shumë subjekt rregullimi i akteve ligjore dhe nënligjore.

Gjithashtu në rastin e shoqërive me ofertë publike, në grupi e jashtëm të interesit janë dhe investitorët aksionet e të cilëve janë tituj të tregtuar në bursë.

Konsumatorët, publiku i gjerë ose grupe të veçanta interesi mund të kenë një ndikim domethënës te shoqëria tregtare sidomos nëse shoqëria mbështet suksesin e produkteve dhe shërbimeve në imazhin e mirë në treg (Woolfe: 38).

5.6 Doktrina e Kontratës së Ndershme

Freeman (1994) përqasi konceptin e Rawls-it për të ndërtuar thelbin normative të teorisë së tij duke pasur parasysh idenë e krijimit të vlerës si një process kontraktual me autonomi, solidaritet dhe ndershmëri. Qëllimi i Freeman ishte te adresonte “Tezën e ndarjes” së Goodpaster (1991), pra biznes pa etikë apo etika pa biznes ishte një paradoks që nuk mund të zgjidhej nga teoria ekzistuese e aksionarëve (Friedman, Miles, 2006: 58). Kontrata do të përcaktonte rregullat e lojës sesi korporata do te operonte (“kushtetuta e korporatës”) që do te vendosej pas një “perdeje padije” (Friedman, Mills, 2006:58).

Përfaqësuesit e grupeve të interesit supozohet se janë të vetë interesuar përsa kohë që ata janë të prekur nga shoqëria. Ata kanë njohuri të përgjithshme sesi funksionon korporata, dinë që ka ose mund të ketë kosto, eksternalitete, dhe kosto pozitive të kontraktimit; janë të paqartë për institucionet e tjera sociale por e dinë që ata ekzistojnë. Pra, ata janë “në padijeni të faktit” dhe kur faktet të zbulohet (pra perdja të ngrihet) ata nuk e dinë se çfarë interesi do të ketë secili.

Në këtë kontekst ata do të zgjedhin 6 parime bazë për t’i udhëhequr ata, çka përbën ata që sipas Freedman quhet Doktrina e Kontratës së Ndershme:

Parimi i lirisë kontraktore - kushtet e lidhjes, ekzekutimit dhe largimit nga kontrata së bashku me renegociimin e saj duhet të jenë të mirëpëcaktuara. Çdo grup interesi duhet të jetë

në gjendje që të përcaktojë se kur ka një marrëveshje dhe cilat janë shanset për ta përmbushur atë (Freeman, 1994: 46).

Parimi i qeverisjes – procedura e ndryshimit të rregullave të lojës duhet të bëhet me miratim unanim. Freeman kishte parasysh sidomos këtu rolin e aksionarëve të pakicës të cilët sipas tij nuk duhet të heqin dorë nga e drejta për të marrë pjesë në qeverisjen e korporatës ose ndoshta në organet drejtuese (në fakt ky parim bëhet më pas nxitës i pyetjes se si do të realizohet kjo). Ose aksionarët e pakicës do të vijojnë të përpiqen të jenë pjesë e qeverisjes vetëm duke marrë pjesë në mbledhjet e aksionarëve kur zëri i tyre nuk mund të jetë kurrë domethënës ose në disa rastë ligjvënësi iu ka ardhur në ndihmë duke përcaktuar mekanizma për këto zërave individualë psh. një prag minimal pakice që mundëson ushtrimin e të drejtave të tyre duke iu drejtuar organeve të tilla qoftë brenda shoqërisë (Asambleja e Aksionarëve, Administratori) ose dhe jashtë saj (gjykata)⁷⁸.

Parimi i eksternaliteteve - Përfshirja e palës së tretë C në kontratën e lidhur mes A dhe B, kur kjo kontratë ngarkon C me një kosto. Atëherë kushtet e kontratës në fjalë do të rinegociohen sepse çdo grup interesi do sigurinë që nuk do të bëhet C (Freeman, 1994: 47).

Parimi i kostove kontraktuale – Kostot që mbart në vetvete procesi i kontraktimit duhet të ndahen mes palëve.

⁷⁸ **Shënim:** Për shembull në kontekstin e Shqipërisë, shih LShT, neni 10 “Përgjegjësia e themeluesve, pika (3); Neni 19 “Këshilli i punëmarrësve”, Neni 84 “Kërkesa nga ortakët e pakicës”, Neni 91 “Hetimet e posacme”, neni 92 Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi”, neni 139 “Mbledhja e asamblesë së përgjithshme dhe rendi i ditës, i kërkuar nga aksionarët e pakicës”, Neni 146 “Mënyra e votimit”, Neni 150 “Hetimet e posacme”, Neni 151 “Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi”, Neni 155 “Numri, emërimi dhe përbërja e këshillit të administrimit”, Neni 165 “Kërkesa për mbikëqyrje të veçantë”, ku LShT parashikon kryesisht një prag minimal prej 5% të zotërimit të kapitalit në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar ose aksionare, dhe në disa raste edhe me të ulët, kur ortakët apo aksionarët sipas rastit mund të vënë në lëvizje gjykatën apo mund të nisin procedura për hetime etj. Në Gjermani, rol të rëndësishëm luajnë Këshillat e Punëmarrësve.

Parimi i agjentit /përfaqësuesit – Çdo përfaqësues duhet t'i shërbejë interesave të të gjithë grupeve të interesit duke zgjidhur konflikte brenda kufijve të të përfaqësuarve të tjerë. Ky parim qartësisht thekson se drejtuesi (përfaqësuesi) është tashmë përfaqësues i gjithë grupeve të interesit dhe jo vetëm i aksionarëve (siç pretendon Teoria e Aksionarëve). Problemi qëndron se në konceptin e përfaqësimit, i përfaqësuari me vullnetin e tij të lirë zgjedh përfaqësuesin.

Në kontekstin e shoqërisë tregtare në bazë të LShT, të paktën në rastin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, është asambleja e ortakëve ajo që zgjedh një apo disa administrator dhe cakton kompetencat e tyre. Ky është rasti i pastër që “pronarët” kanë zgjedhur “përfaqësuesin” e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Në rastin e shoqërive aksionare me një nivel, emërimi i administratorit⁷⁹ madje dhe shpërblimi i tij⁸⁰, bëhet nga Këshilli i Administrimit, anëtarët e të cilit përzgjidhet nga Asambleja e Aksionarëve; Në rastin e shoqërive aksionare me dy nivele emërimi i administratorit bëhet nga Këshilli Mbikqyrës⁸¹, anëtarët e të cilit përzgjidhen nga Asambleja e Aksionarëve.

Në asnjë nga dy rastet e mësipërme administratori nuk zgjidhet direkt nga Asambleja e Aksionarëve, përveç kur parashikohet në statut, emërimin dhe revokimin e administratorëve⁸²;

Nga ana tjetër, punonjësit nuk shprehen drejtpërdrejt për emërimin e administratorit përveç në raste përjashtimore kur Këshilli i Punëmarrësve është eficient dhe funksional. Dhe aq më

⁷⁹ LShT, Neni 154, (f)

⁸⁰ LShT, Neni 154 (g)

⁸¹ LShT, Neni 167 (2)

⁸² LShT, Neni 135 (c)

pak të shprehen furnitorët, konsumatorët etj për të. Pra, në vetvete parimi i përfaqësimit është “i vesuar” në lidhje me shprehjen direkte të vullnetit në zgjedhjen e administratorit si përfaqësues.

Parimi i pavdekësisë së kufizuar – Korporata duhet të drejtohet sikur do të vazhdojë t’i shërbejë interesave të grupeve të interesit në kohë. Ata janë të pasigurt për të ardhmen, por duke pasur parasysh lirinë kontraktore për t’u tërhequr nga kontrata, ata e kuptojnë se ekzistenca e vazhduar e korporatës është në interesin e tyre (Freeman, 1994: 47). Ndaj do të ishte e arsyeshme që të punësoheshin manaxherë që veprojnë sipas parimit të besnikërisë ndaj interesave të tyre (Freeman, 1994: 47). Zbatimi i kësaj doktrine në vijim do të kërkonte nga ana tjetër ndryshime në legjislacion, të cilat Freeman i përmbloodhi në 3 parimet e tij të famshme.

5.7 Tre parimet e Freeman

Në përfundim të analizës së tij, Freeman (1983: 47), shtron tre parimet bazë të cilët qëndrojnë në thelb të ideve liberale dhe që ai i propozon: “...të shërbejnë si elementë konstitutivë të përpjekjeve për të reformuar të drejtën e korporatave”:

- Parimi i Aftësisimit të Grupeve të Interesit
- Parimi i Përgjegjësisë së Drejtorit⁸³
- Parimi i Kërkimit i Grupit të Interesit

⁸³ Shënim: Në artikullin e tij “Stakeholder theory of the modern corporation”, E. Freeman (1983) përdor termin “Director” (drejtues, drejtor), kur iu referohet personave që drejtojnë shoqërinë dhe “management”, kur i referohet autoritetit të tyre. Për këtë të fundit, (pra, management), Freeman përcakton se: “Manaxhimi luan një rol të veçantë, sepse edhe ai ka një interes në korporatën moderne”. Dhe sipas tij, autoritetet më të larta duhet të kujdes për mirëqenien e korporatës çka nënkupton balancimin e pretendimeve (kërkesave) të shumta të grupeve kontradiktore të interesit.

Parimi i aftësisë së grupeve të interesit – korporatat duhet të drejtohen në interes të grupeve të interesit të cilët përcaktohen që janë punonjësit, financuesit, klientët, dhe komuniteti (Freeman, 1983: 47).

Parimi i Përgjegjësisë së Drejtorit – drejtuesit duhet të kenë detyrimin e kujdesit për të përdorur gjykim të arsyeshëm gjatë administrimit të shoqërisë në përputhje me parimin e aftësisë së grupit të interesit, i cili është dhe parimi i parë.

Parimi i kërkimit të grupit të interesit – grupet e interesit mund padisin drejtuesit në rast se nuk përmbushin detyrimin e kujdesit.

Këto parime janë parimet të cilat sipas Freeman (1983: 48): “duhet ende kohë që të ngrihen në nivel ligji” Megjithatë këto parime bëhen lehtësisht të zbatueshme nëse korporata nuk ndjek qëllimin e maksimizimit të fitimit për aksionarët por duke siguruar një barazi mes grupeve të interesit të tij.

5.8 Përmasat e teorisë së grupeve të interesit

A ka përmasa politike teoria e grupeve të interesit?⁸⁴ Kjo pyetje shtrihet në dy plane: plani i mirëfilltë politik, pra implikimi dhe përdorimi i kësaj teorie në makro ekonomi, në shpalosje programesh politike dhe në planin e politikëbërjes në kuptim të ndryshimeve në legjislacion.

⁸⁴Për shembull në ShBA: Sipas Jensen (2001: 21) argumentat e grupeve të interesit luajtën një rol të rëndësishëm për të bindur gjykatat dhe ligjvënësit të kufizonin marrjet e menjëhershme të kontrolleve në shoqëri nëpërmjet blerjeve duke ligjësuar taktikën e njohur si “*poison pill*”... dhe ne do të shohim më shumë veprime politike që kufizojnë pushtetin e këtyre tregjeve për të mbajtur nën kontroll manaxherët. (për më shumë shih Jensen M. (2001) “Value Maximization, Stakeholder Theory, and the Corporate Objective Function”, Journal of Applied Corporate Finance, e aksesueshme në http://papers.ssrn.com/abstract_id=220671). Nga ana tjetër, Key (1999: 318) argumenton se përgjigja juridike dhe legjislative ndaj furisë së marrjes së kontrollit nëpërmjet blerjeve të shoqërive në vitet '80 në ShBA sugjeron detyrimi ndaj grupeve të interesit janë një nga elementët e qeverisjes së korporatës. Indiana është një nga 22 shtetet që ka miratuar ligje të cilat në shkallë të ndryshme i lejojnë bordet që të marrin në konsideratë përgjegjësitë e tyre ndaj grupeve të interesit krahas aksionarëve në vendimmarrjet e korporatës. (për më shumë shih Key S. Toward a new theory of the firm: a critique of the stakeholder “theory” Management Decision 37/4 [1999] 317 -328.

Në planin e parë, a është teoria e grupeve të interesit një ekonomi politike? Sipas Philips, Freeman & Wicks, pavarësisht përpjekjeve për ta elaboruar në nivel politik, ku përpjekja më e suksesshme është ajo e Tony Blair në fjalimin e tij në 1996, ndërsa përpjekja për të marrë seriozisht organizatat e biznesit në teorinë politike meriton një duartrokitje, ky përkthim i veçantë nga teoria organizative në teori politike përfaqëson një precipitim të paautorizuar të teorisë së grupeve të interesit.

Në qendër të debateve në Europë dhe veçanërisht në Mbretërinë e Bashkuar, ka qenë një “huazim” i teorisë në ekonominë politike. E thënë ndryshe: grupi i interesit është çdo qytetar dhe korporata apo organizata e biznesit nuk është gjë tjetër veçse vetë shteti dhe makineria e tërë e aparatit shtetëror me agjensitë, entet, pushtetin qendror dhe lokal. Për sa kohë qytetari ka një interes në organizatë dhe për sa kohë kjo e fundit varet dhe ndikohet nga qytetari, atëherë vendimmarrja në organizatë duhet të ketë parasysh interesat e grupeve të interesit. Ose, me fjalët e Philips, Freeman & Wicks (2003) ekonomia e grupeve të interesit është diçka më shumë se “socializmi i ri”. (Në dallim, Friedman (1970), në kritikën e tij e kishte etikuar “ndërgjegjen sociale” të biznesit dhe përgjegjësitë e tij për të ofruar punësim, eliminimin e diskriminimit, shmangien e ndotjes etj., si “predikim i pastër i socializmit të kulluar”).

Në planin e dytë, teoria e grupeve të interesit do të kthehej në një “injektor” ndryshimesh në legjislacion, në lidhje me vete shoqëritë tregtare dhe me një interes të veçantë të qeverisja e korporatave. Mënyra sesi debati mbi konceptin e grupit të interesit është zhvilluar, tregon sesi mund të riformojmë rolin e etikës së biznesit në linja më pragmatiste (Freeman, 1994). Në fakt, Goodpaster vjen me një sugjerim tjetër për atë të cilën ai e quan si “analiza e grupit të interesit”. Është për t’u theksuar në fakt që Goodpaster nuk e quan apo ta njohë si teori sesa si analizë, e cila në këndështrimin e tij ka dy interpretime që konkurojnë njëra – tjetrën.

Sipas tij, Interpretimi Strategjik e sheh manaxhimin e grupeve të interesit si një mjet, mbase një mjet i thjeshtë, për arritjen e qëllimit si të aksionarëve ose qëllimeve manaxherialë. Pra, manaxhimi i grupeve të tilla në vetvete është as më shumë dhe as më pak sesa një mjet për arritjen e objektivave të firmës, pra në kuptimin e ngushtë ekonomik (në maksimizimin e fitimit).

Interpretimi tjetër, është ai i Besimit të Shumëfishtë, sipas të cilit manaxherët dhe drejtorët mbartin detyrimin e besnikërisë ndaj grupeve të interesit, tek të cilët padyshim bëjnë pjesë dhe vetë aksionarët. Manaxhimi i grupeve të interesit në këtë këndvështrim nuk është më alternativë apo dëshirë por kërkesë morale. Duke pasur parasysh analizën e Boatright dhe përmbledhjen e argumentave të Donaldson dhe Preston kundër teorisë së aksionarëve, besoj se mund të themi me siguri se teoria e aksionarëve është ose të paktën duhet të jetë intelektualisht e vdekur (Freeman, 1994). Ashtu si e quan dhe vetë Freeman, u sugjerua një parim i një lloji neo Kantian për të trajtuar grupet e interesit si qëllim sesa si thjesht mjete.

Por nga ana tjetër, kritikët e kësaj teorie kanë parë te ajo një përmasë të rrezikshme dhe një mjet për fuqizimin e drejtuesve të shoqërisë. Sipas Jensen (2001: 9) teoria e grupeve të interesit i ka rrënjët në sociologji, sjellje organizative, politikat e interesave të vecantë dhe vetë interesi manaxherial. Teoria e grupeve të interesit është bërë një mjet i interesave të veçantë të cilët dëshirojnë të përdorin burimet e korporatës për qëllimet e tyre (Jensen, 2001: 21). Me dështimin masiv të ekonomive komuniste dhe socialite të planifikuara, ata të cilët dëshirojnë që të përdorin forca jo të tregut për të rishpërndarë mirëqenien tashmë shohin mundësi të mëdha në fushën e re të lojës që hap teoria e grupeve të interesit (Jensen, 2001: 21). Jensen shkon më tej duke parë te kjo teori një vegël në duart e grupeve të caktuara të

interesit për të legjitimuar pozitat e tyre. Sipas tij ajo bën që drejtuesit e korporatës të kthehen në shërbëtorë të shumë zotërinjve në të njëjtën kohë dhe logjikisht është e pamundur të maksimizosh në më shumë se një dimension. Kjo teori i liron nga përgjegjësia drejtuesit për veprimet e tyre. Është e qartë se një teori e tillë, mund të jetë tërheqëse në vetë interesin e manaxherëve dhe drejtuesve (Jensen, 2001: 1), sepse ajo politizon korporatën dhe fuqizon manaxherët që të veprojnë sipas pëlqimeve të tyre duke shpenzuar burimet e firmës. Nëse përdoret gjerësisht, teoria e aksionarëve do të pakësojë mirëqenien sociale ndonëse mbështet pretendimin e rritjes së saj – ashtu si ka ndodhur në eksperimentet e dështuara komuniste dhe socialiste të shekullit të kaluar (Jensen, 2001: 21). Në kundërpërgjigje të saj, Jensen (2001) propozonte atë që u njoh si *Teoria e moderuar e grupeve të interesit* e cila merr për bazë strukturën e teorisë së grupeve të interesit por pranon maksimizimin e vlerës afatgjatë të firmës si kriter për kompromiset e nevojshme mes grupeve të interesit. Teoria përcakton maksimizimin e vlerës afatgjatë ose kërkimin e vlerës si objektiv të firmës⁸⁵ dhe si e tillë, zgjidh problemet që lindin nga objektivat e shumtë që shoqërojnë teorinë tradicionale të grupeve të interesit (Jensen 2001: 2).

⁸⁵ Jensen (2001) shkon më tej dhe përcakton si mjet matës të performancës - Vlerën Ekonomike të Shtuar (Economic Value Added). EVA është fitimi net pas taksave minus kapitali * kosto e kapitalit në të gjitha format, përfshirë borxhin). EVA si mjet për matjen e performancës ka gjetur mbështetje dhe nga autorë të tjerë si Houle (2008), Issham (2010, 2011).

KAPITULLI VII LIGJI 9901, DATË 14.04.2008 “PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE” (LSHT)

6.1 HYRJE

Nisur prej muajit maj 2008⁸⁶, themelimi, organizimi dhe drejtimi i organizatave të biznesit në Shqipëri rregullohet me ligjin 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (Dine, Blecher 2016:1), të ndryshuar. Miratimi i këtij ligji i dha fund debatit pesëvjeçar mbi reformimin e të drejtës tregtare në Shqipëri (Dine, Bletcher, 2007:1), e cila synonte krijimin e një sistemi të koordinuar të veprimtarisë civile dhe tregtare (Dine, Bletcher, 2007: 1). Këto ndryshime nuk kufizohen thjesht në çështje teknike, por përbëjnë një revolucion të çështjeve kryesore të kuadrit ligjor shqiptar për shoqëritë tregtare (Bachner, Schuster & Winner 2009:11).

Sipas Bachner, Schuster & Winner (2009:16), rregullat ligjore të LSHT-së nuk përbëjnë një vazhdimësi të traditave sipas regjimit ligjor të mëparshëm të Ligjit nr. 7638, por revolucionalizojnë ligjin shqiptar për shoqëritë tregtare. Ekziston shumë pak apo aspak vazhdimësi ndërmjet ligjit të vjetër dhe ligjit të ri. Nga ana tjetër, sipas Dine dhe Bletcher (2016:7), në vitin 2008, ligji për shoqëritë tregtare merrte në konsideratë elemente të vlefshme të ligjeve të mëparshme si: ligji nr. 7638 “Për shoqëritë tregtare”, dhe ligji nr. 7632 “Për pjesën e përgjithshme të Kodit Tregtar”, në mënyrë që të ruhej sa më shumë të ishte e mundur praktika ligjore shqiptare e krijuar në periudhën 1994 – 2008.

⁸⁶ LShT u miratua në 14 prill 2008, dhe hyri në fuqi më 22 maj 2008. U botua në Fletoren Zyrtare nr. 60, faqe 2631.

Në fakt, “huazimet” nga ligjet e mëparshme ishin në një shkallë mjaft të paktë për të qenë thelbësore dhe LShT mund të thuhet se ndryshoi dukshëm praktikën 16 vjeçare që kishte krijuar deri atëherë e drejta tregtare në vend në nivel të drejte. Nga ana e funksionimit të pandërprerë të aktivitetit të biznesit, rol të rëndësishëm luajti momenti i rregullimit të fazës tranzitore të LShT⁸⁷.

LSHT-ja u përgatit me qëllimin për të implementuar (me përjashtime të vogla) standartet evropiane të së drejtës për shoqëritë tregtare (të ashtu quajturën “*acquis*”) dhe për të përmbushur kështu edhe Nenin 70 të Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian⁸⁸, i cili parashikon përafrim të plotë me *acquis communautaire* brënda 10 vjetëve (Bachner, Schuster & Winner 2009:16).

LShT është ndryshuar përkatësisht me ligjin Nr.10475, datë 27.10.2011⁸⁹ dhe ligjin 129/2014. Ndryshimet ligjore të vitit 2011 kishin si qëllim përshtatjen e nivelit të kapitalit minimal të shoqërive aksionare⁹⁰ me kërkesat e Direktivës së Dytë të BE-së mbi Ligjin e Shoqërive. Në vitin 2014, me qëllim hamonizimin e mëtejshëm me direktivat e reja të BE-së, Kuvendi i Shqipërisë miratoi disa shtesa dhe ndryshime të mëtejshme me karakter më

⁸⁷ Pjesa X e LShT në nenet 230 – 232 rregullonte fazën tranzitore të hyrjes në fuqi të LShT. Për të adresuar çështjet praktike dhe po aq thelbësore që lindën nga këto dispozita, ndryshimet e bëra me Ligjin 129/2014 ri adresuan dhe prekën dhe këto nene. Trajtimi më i zgjeruar bëhet në vijim të këtij kapitulli.

⁸⁸ Shih Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit ndërmjet Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.87, datë 14.8.2006, faqe 2955; Gjendet në https://www.parlament.al/Files/Integrimi/marreveshja_e_stabilizim_asociimit_be_shqiperi_23381_1.pdf

⁸⁹ Ligji Nr.10475, datë 27.10.2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.152, faqe 6979.

⁹⁰ Para ndryshimeve ligjore të vitit 2011, LShT parashikonte se kapitali minimal nuk mund të ishte më i vogël se 2 000 000 lekë për shoqëritë aksionare me ofertë private dhe jo më të vogël se 10 000 000 për shoqëritë aksionare me ofertë publike (Shih Neni 107 i vjetër i LShT). Pas ndryshimeve me Ligjin 10475/2011, kapitali minimal i kërkuar u bë përkatësisht 3 500 000 lekë për shoqëritë me ofertë private dhe 10 000 000 lekë me ofertë publike.

thelbësor në Ligjin për Shoqëritë Tregtare (Dine, Blecher 2016:2). Këto shtesa dhe ndryshime jo vetëm iu përqasën legjislacionit evropian por adresuan dhe çështje të ngritura nga praktika.

Në mënyrë të përmbledhur, tiparet më dalluese të reformës tregtare dhe LShT⁹¹ ishin:

1. Sanksionimi i një sistemi të thjeshtë, të qartë dhe të përditësuar i aftë për të thithur investime të huaja;
2. Ligji për shoqëritë tregtare është vendosur në mënyrë të kënaqshme në një kontekst kombëtar⁹²;
3. Përputhshmëria e tij me sistemet e reja rajonale të së drejtës tregtare, për të pasqyruar kërkesën për integrim rajonal dhe marrëdhënie ekonomike rajonale;
4. Mundësimi i anëtarësimit të Shqipërisë në BE;
5. Synon harmonizimin me legjislacionin evropian të shoqërive tregtare përfshirë direktivat përkatëse, pavarësisht se në raste të caktuara ka dhe devijime nga to. Për çështjet që nuk rregullohen nga e drejta evropiane, Ligji i ri shqiptar për Shoqëritë Tregtare mbështetet në masë të madhe në inspirime nga ligjet për shoqëritë tregtare të Gjermanisë dhe Anglisë (Bachner, Schuster & Winner 2009:17).
6. Rrjedhimisht, ligji për shoqëritë tregtare pasqyron standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare lidhur me të drejtën tregtare, drejtimin e brendshëm të shoqërive tregtare dhe përgjegjësinë sociale të shoqërisë tregtare (Dine, Blecher, 2016: 6).

⁹¹ Për më shumë shih Dine J., Blecher M., “Ligji për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare, Teksti me shpjegime, version i rishikuar”, botim GIZ, prill 2016

⁹² Në çdo rast, Neni 230 (2) parashikon që brenda tre vjetëve pas hyrjes në fuqi të LSHT-së, domethënë, deri më 21 maj 2011, shoqëritë tregtare janë të detyruara të përshtasin organizimin dhe funksionimin e tyre sipas dispozitave të LSHT-së. Përndryshe këto shoqëri tregtare prishen dhe likujdohen;

7. Reforma nuk kishte për synim edhe reformimin e mosmarrëveshjeve tregtare duke mbetur brenda kuadrit të rregullimit të ligjit formal dhe jo atij material;
8. Përqasja ndaj legjislacioni europian për shoqëritë tregtare duke njohur përfshirjen e negociuar te punëmarrësve në procesin vendimmarrës⁹³ me anë të Rregullores (KE) 2157/2001 për statutin e shoqërisë tregtare evropiane.
9. Reforma e të drejtës tregtare e cila strukturoi veprimtarinë tregtare të organizatave tregtare, u pasua dhe me ligje e rregullime të tjera, qoftë edhe jo detyruese (rekomandime me natyrë vullnetare)⁹⁴;

Në një analizë të sa më sipër, shohim se kryesisht qëndrimi i studiuesve të së drejtës tregtare në Shqipëri, e lidh atë ngushtësisht me të drejtën e Bashkimit Europian duke pasur parasysh detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit e 12 qershor 2006⁹⁵ dhe në të njëjtën kohë i vesh LShT edhe pasqyrimin e standardeve europiane në lidhje me përgjegjësinë sociale⁹⁶ po në kuadër të MSA-së.

Thënë këtë, përsa kohë që autorët⁹⁷ pranojnë se LShT mbart parimet e përgjegjësisë sociale, në këtë punim, në analizën e LShT do të trajtohet pikërisht dhe përfshirja e mbartja e këtyre

⁹³ Neni 19 – 21, 156 dhe 167 i LShT, si dhe neni 16, 17, 18 i Ligjit 110/2012 “Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare”, botuar në Fletoren Zyrtare numër 157, faqe 8484.

⁹⁴ Këtu përmendim: Kodi i drejtimit të brendshëm të shoqërive tregtare i miratuar nga me 2 dhjetor 2011, me vendimin numër 1 të Këshillit Konsultativ i Biznesit, i cili gjendet në http://www.ekonomia.gov.al/files/userfiles/Kodi_i_Qeverisjes_se_Korporatave_ne_Shqiperi_-_shqip.pdf (si rekomandim jo detyrues); Ligji 110/2012 “Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare”, botuar në Fletoren Zyrtare numër 157, faqe 8484 etj.

⁹⁵ MSA hyri në fuqi me 1 prill 2009, pas ratifikimit të saj nga 25 vendet anëtare të BE-së, të cilat ishin pjesë e BE-së në momentin e nënshkrimit të MSA-se, si dhe miratimin e saj nga Parlamenti shqiptar, duke i hapur kështu rrugën Shqipërisë drejt aplikimit në BE për marrjen e statusit të vendit kandidat. Në lidhje me përafrimin e legjislacionit shih sidomos Titulli VI, neni 70 i MSA-së, ku specifikisht referohet dhe ligji për shoqëritë tregtare si fushë e rëndësishme e përafrimit të legjislacionit (po aty, pika 3).

⁹⁶ Po në Titullin VI, neni 70, pika 3, MSA parashikon se përafrimi do të përqëndrohej në elementë thelbësorë të *acquis*.... duke i kushtuar rëndësi të vecantë sigurisë dhe standarteve mjedisore si dhe aspekteve sociale ...”

⁹⁷ Shih Dine, Bletcher, 2008; 2016;

standarteve në të si dhe në të njëjtën kohë ky punim synon të paraqesë edhe sa realisht dhe efektivisht janë përmbushur në praktikë këto standarde nga shoqëritë tregtare në vend.

6.2 Lloje të organizimit të aktivitetit tregtar

Ligji i ri nr. 9901, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, përcakton katër lloje të organizimit të aktivitetit tregtar⁹⁸ të cilave u referohet me termin e përgjithshëm “shoqëri tregtare” të cilat janë:

- shoqëritë kolektive
- shoqëritë komandite⁹⁹
- shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK-të)
- shoqëritë aksionare (SHA-të) (Bachner, Schuster & Winner 2009:15).

Ligji shqiptar – në linjë me ligjin francez dhe me ligjin e mëparshëm shqiptar për shoqëritë nr. 76383 – u jep statusin e personit juridik të gjitha llojeve të subjekteve të aktivitetit tregtar të rregulluara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare (Bachner, Schuster & Winner 2009:16), duke i konsideruar ato si shoqëri tregtare¹⁰⁰. Aplikimi i konceptit të personalitetit juridik për të gjitha shoqëritë tregtare shmang krijimin e problemeve ligjore të ndërlikuara (Dine, Bletcher,

⁹⁸ Nga kjo bazë strukturore kanë gjeneruar forma të tjera organizimi të aktiviteteve tregtare, të cilat shënohen në forma të vecanta në regjistrin tregtar që janë:

1. Shoqëritë e kursim – kreditit
2. Shoqëritë e bashkëpunimit reciprok (Malltezi, 2011: 14).

⁹⁹ Shoqëritë kolektive dhe komandite ndryshe kategorizohen si “shoqëri personi” ku kreditorët e shoqërisë kanë të drejtë të kërkojnë shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë ndaj tyre si me anë të pasurisë së shoqërisë, ashtu dhe me anë të pasurisë së ortakëve. Pra ortakët përgjigjen personalisht dhe solidarisht për detyrimet e pashlyera të shoqërisë (Malltezi, 2011: 14). Në dallim, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe ato aksionare njihen si “shoqëri kapitali”. Në këto shoqëri, ortakët apo aksionarët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë ndaj të tretëve deri në vlerën e kontributeve që ata detyrohen të derdhin në kapitalin e regjistruar (Malltezi, 2011: 14).

¹⁰⁰ Neni 1 (1) dhe neni 3 (1) e LShT

2016: 28)¹⁰¹. Megjithatë në fokus të këtij punimi janë kryesisht shoqëritë aksionare të cilat do të trajtohen më gjerë në vijim.

Një shoqëri tregtare krijohet apo *themelohet* nga investitorët. Në fazën e themelimit, investitorët negociojnë termat e kontratës së bashkëinvestimit të tyre, kushtet që përcaktojnë raportet e pjesëmarrjes së tyre në shoqëri, në fitimet dhe humbjet e saj, si dhe kushtet e tjera ligjore të ekzistencës së shoqërisë (Malltezi, 2011: 10). Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj¹⁰².

Shoqëritë mund të themelohen dhe regjistrohen sipas ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", formës përkatëse të shoqërisë tregtare, edhe vetëm në bazë të statutit. Legjislatori ka hequr detyrimin që shoqëritë tregtare të kenë domosdoshmërisht akt themelimi (Malltezi, 2011: 10). Pavarësisht se klauzolat e aktit të themelimit dhe të statutit të shoqërisë mund të bashkohen në një dokument të vetëm, kjo mundësi është një çështje procedurale e lidhur me dokumentat e regjistrimit, dhe këto dy akte (pra statuti dhe akti i themelimit) mbeten gjithësesi të ndryshme në kuptimin juridik (Dine, Bletcher, 2016: 34).

Kjo sepse akti i themelimit përfaqëson marrëveshjen e themeluesve për të krijuar shoqërinë, duke qenë kështu një kontratë subjekt rregullimi nga Kodi Civil kurse nga ana tjetër organizimi dhe funksionimi i vetë shoqërisë tregtare bëhet nga statuti i saj, që është subjekt

¹⁰¹ Në disa shtete të Bashkimit Europian, shoqëritë kolektive dhe komandite nuk mund të kenë personalitet juridik (Dine, Bletcher, 2016: 28).

¹⁰² Po aty;

rregullimi nga LShT dhe është “kushtetuta” e shoqërisë tregtare. Në fakt, reforma e së drejtës tregtare ndikoi dukshëm në lehtësimin e procedurave të themelimit të biznesit duke i lehtësuar ato. Kështu në dallim nga Ligji i 7632, “Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit tregtar”, në të cilin parashikohej bërja e akteve përkatëse, akti i themelimit dhe statutit në prani të noterit, tashmë regjistrimi mund të bëhet edhe vetëm nëpërmjet formularit të kërkesës dhe deklarimit të përmbushjes së dispozitave ligjore në fuqi për organizimin dhe funksionimin të shoqërisë që themelohet për shoqëritë kolektive, komandite dhe ato me përgjegjësi të kufizuar¹⁰³.

Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit¹⁰⁴, i cili është i veçantë nga ai i themeluesve /investitorëve të saj. Këta të fundit bëhen pronarë të shoqërisë së re dhe në bazë të llojit të shoqërisë quhen *ortakë* ose *aksionarë* (Malltezi 2011: 11). Ndërsa për një shoqëri të thjeshtë sipas Kodit Civil, regjistrimi nuk nënkupton fitim të personalitetit juridik të ndryshëm nga ai i ortakëve (Dine, Bletcher 2016: 28).

LShT ecën në të njëjtën linjë me parashikimet e Kodit Civil i cili për personat juridikë privatë përcakton se e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji, (i cili në rastin konkret për shoqëritë tregtare është LShT) dhe mbaron sipas mënyrës së caktuar në aktin e krijimit, në statut ose në ligj¹⁰⁵.

¹⁰³ Neni 28 i Ligjit 9723, datë 3/5/2008 “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar.

¹⁰⁴ Shih neni 3 (3) i LShT

¹⁰⁵ Neni 34 i Kodit Civil “Mbarimi i personit juridik”.

Kodi Civil rregullon dhe tiparet e dallueshme që ka personi juridike: emri¹⁰⁶, qendra¹⁰⁷, zotësia¹⁰⁸, përgjegjësia¹⁰⁹, veprimet e tij dhe likuidimin¹¹⁰. Gjithashtu Kodi Civil në nenin 31 parashikon se “... *personi juridik vepron me anë të organeve të veta të parashikuara në ligj, në aktin e themelimit ose në statut*” dhe se “*veprimet juridike të kryera nga organet e personit juridik, brënda kompetencave të tyre, quhen si të kryera nga vetë personi juridik*”.

Ky parim i vendosur nga Kodi Civil përcakton dhe njëherë se shoqëria tregtare si person juridik është një krijim vullneti i së cilës shprehet nëpërmjet organeve që veprojnë në emër të saj dhe që e drejtojnë/administrojnë atë.

Ndaj, një veçori e rëndësishme e së drejtës për shoqëritë tregtare është njohja e shoqërisë tregtare si person juridik i veçantë, e dallueshme nga ortakët ose aksionarët e saj (Bachner, Schuster & Winner 2009:25). Kjo bën që shoqëria tregtare të ketë personalitet juridik, dhe si e tillë të ketë të drejta dhe detyrime ndaj anëtarëve të saj (psh aksionarëve) si dhe palëve të treta (psh kreditorëve), të jetë palë në proces gjyqësor, si dhe të zotërojë prona /asete, tituj etj.

Duke qëndruar në këtë pikë sidomos përsa i përket shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe ato aksionare, dy qëndrimet më të para janë nëse aksionarët janë pronarë /zotërues të shoqërisë ose jo.

Disa dekada më parë, lëvizjet e së drejtës dhe ekonomiksit, e panë shoqërinë si një tërësi kontratash mes palëve. Si e tillë, shoqërinë nuk ishte një gjë e aftë që të zotërohej

¹⁰⁶ Neni 27 i Kodit Civil

¹⁰⁷ Neni 28 i Kodit Civil

¹⁰⁸ Neni 29, 30, 31 i Kodit Civil

¹⁰⁹ Neni 32 i Kodit Civil

¹¹⁰ Neni 37 dhe 38 i Kodit Civil

(Bainbridge, Lipton 2007)¹¹¹. Çdo pjesëmarrës në sipërmarrjen e shoqërisë bën një investim në këmbim të një të drejte kontraktuale në kthim të investimit të tij¹¹² (Velasco, 2010:899), të fitimeve financiare të krijuara nga veprimet tregtare të korporatës (Lipton, 2007:754). Kurse sipas pikëpamjes tradicionale, aksionarët zotërojnë shoqërinë (Velasco, 2010:897) dhe për më tepër ky parim është parë si thelbi i kapitalizmit modern¹¹³. Pra, pjesëmarrja në pronësinë e SHA-së përfaqësohet nga aksionet (pjesë të kapitalit të shoqërisë) (Dine, Blecher, 2008). Zotërimi i aksioneve në një shoqëri prodhon të drejta dhe detyrime për aksionarët.

¹¹¹ Shih Michael C. Jensen, A Theory of The Firm: Governance, Residual Claims, And Organizational Forms 1-3 (2000).

¹¹² Një nga mbështetësit më të mëdhenj të kësaj pikëpamje është S. Bainbridge sipas të cilit aksionarët virtualisht nuk kanë asnjë pushtet për të kontrolluar veprimet e përditshme të shoqërisë ose politikat e saj afatgjata. Kontrata e aksionarëve me firmën ka disa tipare të ngjashme me pronësinë përfshirë të drejtën për të votuar dhe detyrimin e besimit të drejtorëve dhe zyrtarëve. Megjithatë, aksionarëve iu mungojnë të drejtat kryesore të pronësisë të cilat mund të përcaktohet si e drejta e posedimit, përdorimit dhe manaxhimit të aseteve të korporatës, dhe të drejtat ndaj aseteve dhe të ardhurave të korporatës. Për shembull, aksionarët nuk kanë të drejtë të përdorin ose posedojnë pronën e korporatës. Të drejtat e manaxhimit i përkasin bordit të drejtorëve. Është e lehtë të harrosh faktin kryesor - se firmat nuk janë asgjë më shumë se grupe njerëzish. Thjesht, nuk ka asgjë që mund të zotërohet. (Shih The Board of Directors as Nexus of Contracts: A Critique of Gulati, Klein & Zolt's 'Connected Contracts' Model, UCLA, School of Law Research Paper No. 02-05, gjendet te https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=299743, <http://www.professorbainbridge.com/professorbainbridge.com/2006/02/who-owns-the-corporation-nobody.html>)

Megjithatë duhet pasur parasysh se Bainbridge i referohet kryesisht modelit të korporatës në ShBA, një vend me histori të shquar korporative, e cila dallon për dy elementë: një pronësi e shpërndarë duke pasur parasysh numrin e madh të shoqërive me ofertë publike në kërkim të investitorëve të rinj, cka e bën shumë të vështirë përfshirjen e aksionarit në qeverisjen e shoqërisë sesa në një shoqëri me ofertë private, dhe rolin e rëndësishëm që luan Bordi i Drejtorëve me kompetencat e tij të zgjeruara.

Krahas kësaj pikëpamje, një tjetër qëndrim ka marrë në konsideratë dhe vetë të drejtën tregtare. Shumë shtete kanë miratuar Model Business Corporation Act në të cilin aksionet përcaktohen si “njësi në të cilat janë ndarë interesat pronësore”. Kjo nxjerr në pah elementin e pronësisë ndaj shoqërisë të shprehur në aksione. Nga ana tjetër, legjislacioni i shtetit Delaware si një nga legjislacionet më të rëndësishme të së drejtës tregtare, ndonëse nuk parashikon shprehimisht në lidhje me çështjen e pronësisë, burimet e tjera të së drejtës, sidomos vendimet e gjykatës kanë mbështetur pikëpamjen tradicionale (për më shumë shih Velasco J. “Shareholder Ownership and Primacy”, University of Illinois Law Review, Vol 2010, 4/6/2010, faqe 929, 930).

Në analizë të këtij punimi, krahasimisht vendi ynë nuk mbart asnjë nga këto dy elementë (forma dominante është shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëria aksionare, kurse modeli i qeverisjes ka ndjekur modelin europian kur kompetencat e bordit nuk vijnë në këtë përmasë. Si e tillë, qasja e Bainbridge, Lipton etj. dhe përkrahësve të tij, nuk gjen mbështetje në modelin e vendit tonë.

¹¹³ Shih Arthur Levitt Jr. “How to boost Shareholder Democracy”, Wall Street Journal, Korrik 2008.

Këtë qëndrim ndan dhe praktika gjyqësore në vend. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij Nr.00-2012-469 i Vendimit (59)¹¹⁴ është shprehur se: “Referuar Ligjit “Për Shoqëritë Tregtare”, shoqëria anonime nuk është gjë tjetër veçse pronë e aksionarëve të saj, të cilët kanë kontribuar në kapitalin e kësaj shoqërie në të holla ose në natyrë, ose kanë blerë aksione nga aksionarët fillestarë të saj. Vetëm zotëruesit e këtyre aksioneve kanë të drejtë të marrin vendime të rëndësishme në lidhje me shoqërinë. Për këtë arsye, asambleja e aksionarëve konsiderohet dhe si një nga organet më të rëndësishme të shoqërisë anonime, që funksionon konform parashikimeve të neneve 128 e vijuese të Ligjit “Për Shoqëritë Tregtare”¹¹⁵”.

Nga ana tjetër, kjo pikëpamje e zotërimit të shoqërise ka ngritur pyetjen nëse ortakët /aksionarët zotërojnë edhe aktivet e pronat e shoqërisë? Bachner, Schuster & Winner shprehen se sipas ligjit, aktivet e shoqërisë tregtare, janë me ligj vetëm pronë e saj dhe jo e ortakëve /aksionerëve të saj. Kjo vlen edhe në rastet kur shoqëria tregtare është shoqëri me një ortak/ aksionar të vetëm¹¹⁶. Për rrjedhojë, zotërimi i një kuote /aksioni në *shoqërinë tregtare* nuk do të thotë zotërim i një pjese në *aktivet e shoqërisë*. (Bachner, Schuster & Winner 2009:25). Por ama ata shkojnë më tej duke thënë se shoqëria tregtare është një vegël në duart e njerëzve që e kontrollojnë atë, qoftë duke vepruar në formën e organeve të shoqërisë, qoftë duke ushtruar ndikim vendimtar mbi ata që veprojnë si organe (dhe, për rrjedhojë në emër të shoqërisë). Ky mekanizëm mund të shfrytëzohet për qëllime të ligjshme, por edhe të keqpërdoret për qëllime të paligjshme.

¹¹⁴ Shih vendimin Nr.11241-01597-00-2009 i Regj. Themeltar

¹¹⁵ Shënim: GjL në gjykimin e kësaj çështje i referohet Ligjit të vjetër për Shoqëritë Tregtare.

¹¹⁶ Neni 3 (1) i LSHT

Këtu kemi disa elementë që duhet të përmendim:

Shoqëria zotëron aktive të cilat nuk janë zotërim /pronë e ortakëve /aksionarëve të saj;

Zotërimi i një kuote /aksioni në shoqërinë tregtare nuk do të thotë zotërim i një pjese në aktivet e shoqërisë;

Shoqëria kthehet në një mjet të organeve drejtuese të saj ose të atyre që ndikojnë në këto organe që në rastin e një shoqërie me një ortak/aksionar do të ishte ortaku apo aksionari i vetëm, ose ortaku/aksionari i shumicës. Kjo nuk përjashton faktin, që në mënyrë indirekte edhe duke mos i zotëruar aktivet e shoqërisë, ortaku apo aksionari mundën që nëpërmjet organeve drejtuese, përsa kohë që mund t'i kontrollojnë ato, të “ndërhyjnë” në aktivet e shoqërisë.

Ndërkohë që Malltezi (2001: 105) mban një qëndrim të ndryshëm në lidhje me pronësinë sidomos në rastin e shoqërisë aksionare. Sipas Malltezit (2011: 105), aksionarët janë pronarët e shoqërisë aksionare. Pronësia e tyre mbi shoqërinë, **asetet e saj**¹¹⁷, të drejtat dhe detyrimet reflektohen në mënyrë proporcionale në pronësinë e tyre mbi pjesët e kapitalit të regjistruar të shoqërisë. Malltezi vë në dukje se pronësia e aksionarëve shtrihet dhe mbi asetet e shoqërisë. Nëpërmjet aksioneve, aksionarët influencojnë në vendimmarrjen e shoqërisë; numri i aksioneve ka një raport të drejtë me numrin e votave që gëzon një aksionar dhe pjesën e dividendit nga i cili përfiton. Këto raporte pronësie shërbejnë si simbolikë e ndarjes së pasurisë së shoqërisë (Malltezi, 2001: 105, 106). Të njëjtin qëndrim mban dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij Nr.00-2012-469 i Vendimit (59)¹¹⁸ ku është shprehur se humbja e të drejtës së pronësisë mbi aksionet që zotërojnë në shoqëri ka sjellë për rrjedhojë

¹¹⁷ Theksimi është shtuar nga autori i këtij punimi.

¹¹⁸ Shih Vendimin Nr.11241-01597-00-2009 i Regj. Themeltar

edhe të drejtën e votës së tyre në Asamblenë e Aksionarëve, e cila është një e drejtë e lidhur pikërisht me cilësinë e të gëzuarit të statusit “aksionar” në një shoqëri.

Në të njëjtën kohë, Malltezi nxjerr në pah dhe karakterin “kolegjial” i vendimmarrjes pasi sipas saj, aksionarët nuk mund të vendosin në mënyre individuale për çështjet e aktivitetit tregtar. Duke mbajtur parasysh këtu faktin se edhe në shoqëritë tregtare, pronësia dhe administrimi i shoqërisë janë pushtete të ndara (Malltezi, 2011: 105) dhe se funksionet e pronësisë aksionarët num mund t’i ushtrojnë në mënyrë individuale por nëpërmjet forumit të përbashkët të aksionarëve, asamblesë së përgjithshme të aksionarëve (Malltezi, 2011: 106).

Në fakt, ajo që do të cënojë integritetin e këtij kolegjialitetit në këtë pikëpamje është rasti i “aksionarit të vetëm” dhe i atij /atyre që zotërojnë shumicën, të cilët mundën të imponojnë vullnetin e tyre dhe të diktojnë kështu vendimet e asamblesë në interesin e tyre.

Rrjedhimisht, kjo do të manifestohet dhe te shoqëria dhe veprimtaria e saj. Një nga qëllimet e legjislacionit tregtar është të garantojë se vendimet e APA-së do të jenë të drejta dhe të ligjshme dhe se do të trajtojnë në mënyrë të barabartë aksionarët pavarësisht nga pozita e tyre në shoqëri (Malltezi, 2011:106).

Ndonëse asetet janë të shoqërisë, dhe administrimi i tyre i përket shoqërisë, në dritën e LShT, në rastin e SHPK-ve dhe SHA-ve, LSHT-ja kërkon një vendim të asamblesë së përgjithshme kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive të saj të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të totalit të aktiveve të shoqërisë, që rezulton nga pasqyrat e fundit financiare të certifi kuara, ose kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë, nga një ortak ose aksionar, aktive që kanë vlerë më të lartë se 5% të aktiveve të shoqërisë, që

rezulton nga pasqyrat e fundit fi nanciare të çertifikuara¹¹⁹. Në këto raste, asambleja e përgjithshme përfshihet në administrimin e brendshëm të shoqërisë, që përbën një përjashtim nga rregulli sipas të cilit Asambleja nuk përfshihet në administrim. Megjithatë edhe në këto raste asambleja e përgjithshme mund të marrë “vendime këshilluese”¹²⁰, duke kritikuar apo miratuar veprimtarinë e organeve administrative (Dine, Bletcher, 2016 :171).

6.3 Shoqëria shtetërore

Ligji 9901/2008 përcakton në nenin 213 se shoqëria shtetërore është një shoqëri tregtare, e cila zhvillon veprimtari tregtare, me interes të përgjithshëm ekonomik, aksionet e së cilës zotërohen drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë nga pushteti qendror, pushteti vendor apo nga shoqëri, ku këto pushtete veprojnë si mëmë. Përkufizimi i ndërmarrjeve publike, sipas nenit 213, është në përputhje me nenin 2 të Direktivës 723/80/KEE për transparencën e marrëdhënieve financiare ndërmjet Shteteve Anëtare dhe sipërmarrjeve publike (Dine, Bletcher, 2016:237).

Themelimi, organizimi e funksionimi i shoqërisë shtetërore u nënshtrohen dispozitave të këtij ligji. Trysnia që ushtron BE-ja ndaj Shteteve Anëtare për privatizimin e pjesëve të mëdha të ndërmarrjeve publike “klasike” në sektorin e postës, telekomunikacionit, transportit dhe energjitikës është e njohur (Dine, Bletcher, 2016:238)¹²¹.

¹¹⁹ Shih Neni 136 (3 -5) i LShT

¹²⁰ Shih Neni 136 (8) i LShT

¹²¹ Supozohet që interesi publikë në këto shërbime mund të arrihet më mirë dhe me kosto më të lirë nëse ato administrohen si shoqëri private. Mirëpo është provuar se kjo është e vërtetë vetëm nëse liberalizmi, në njërën anë, shoqërohet me liberalizmin në anën tjetër, që do të thotë ngritje e agjencive funksionuese publike për monitorimin dhe mbikqyrjen me të drejtën për të ndërhyrë në rast të mosfunksionimit dhe deformimit të tregut. Në këtë aspekt, rimonopolizimi në nivel privat është rrezik që duhet përballuar me mjete ligjore (marrë nga Dine, Bletcher, 2016:238).

Nisur nga përkufizimi që bën Ligji 9901/2008 dhe terminologjia e përdorur, shohim se përdoret vetëm termi “aksion”, duke lënë pa përfshirë termin “kuotë”. Në një interpretim të ngushtë, nisur nga përdorimi i vetëm termit “aksion”, mund të deduktojmë se forma e shoqërisë mund të jetë vetëm shoqëri, kapitali i së cilës është i ndarë në aksione, pra një shoqëri aksionare, duke përjashtur kështu format e tjera të shoqërisë.

Në parantezë para se të ndalemi në këtë aspekt, duhet të marrin në konsideratë Ligjin Nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, një ligj që është më i hershëm në kohë si dhe Ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, ligji në atë kohë në fuqi përse i përket rregullimit të së drejtës tregtare. Kështu, Ligji Nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, në nenin 2 përcakton se me “Shoqëri shtetërore”, kuptohen gjithë personat juridikë publikë, të cilët do të krijohen si pasojë e transformimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe që do të funksionojnë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”. Më tej ligji parashikon se të gjitha ndërmarrjet shtetërore transformohen në **shoqëri anonime ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar** dhe do të funksionojnë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, (një nga ligjet kryesore që rregullonte të drejtën tregtare, në fuqi në atë kohë), përveç rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe¹²².

Ndonëse Ligji 7926/1995, i ndryshuar bënte referencë në ligjin e vjetër tregtar, ligji në fuqi në atë kohë, ai njihnte transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në dy forma juridike të

¹²² Në këtë pikë Ligji 7926/1995 dhe Ligji 7638/1992 ishin në të njëjtën frekuencë përse i përket legjislacionit të zbatuar në lidhje me shoqëritë tregtare që do të lindnin nga transformimi. Neni 94 “Dispozita për zbatim” i Ligjit 7638/1992 parashikonte se: “Shoqëritë shtetërore i nënshtrohen legjislacionit të përgjithshëm mbi shoqëritë, në rast se nuk caktohet ndryshe nga një ligj i veçantë”.

organizimit pra dhe shoqëri aksionare (anonime në gjuhën e Ligjit 7926/1995) dhe të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Nga ana tjetër. Vetë Ligji nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, në Nenin 95 “Përkufizim” përcaktonte: “Shoqëria shtetërore është një shoqëri anonime, në të cilën të gjitha aksionet zotërohen nga shteti ose një ent publik”.

Ligji 7926/1995 sillte dhe një përcaktim të ri që dallonte dukshëm nga Ligji në fuqi në atë kohë për Shoqëritë Tregtare 7638/1992: fakti që shoqëritë shtetërore të lindura nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore në formën e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, do të krijojnë këshill mbikëqyrës. Kështu në formatin e qeverisjes së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar shtohet një strukturë e re, ajo e Këshillit Mbikqyrës.

Kurse për shoqëritë anonime përcakton se organet drejtuese janë: - Këshilli mbikëqyrës – Drejtoria. Në lidhje me këtë parashikim Ligji 7926/1995, ishte në përputhje me dispozitat e Ligjit 7638/1992 i cili parashikonte vetëm sistemin e qeverisjes me dy nivele për shoqërinë anonime, pra me Këshill Mbikqyrës, por kishte diskrecionin që të përcaktonte vetë përbërjen dhe numrin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk janë të punësuar të shoqërisë dhe për më tepër, Neni 109 i ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare"¹²³ në lidhje me përfaqësimin e detyrueshëm të punonjësve në Këshill nuk zbatohet për atë kohë sa shteti është aksionar i vetëm".

Ligji i ri tregtar 9901/2008, në mënyrë e të shprehur duket sikur e ka përjashtuar në fakt organizimin e shoqërisë shtetërore në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, megjithatë nisur nga legjislacioni në fuqi, shohim se këto raste nuk përjashtohen.

¹²³ Neni 109 i ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" parashikon: “Një e treta e anëtarëve të këshillit mbikqyrës zgjidhet nga të punësuarit në shoqëri. Nëse numri i anëtarëve të zgjedhur nga të punësuarit është i barabartë ose më i madh se 2, inxhinierët, kuadrot ose personat e ngjashëm me ta kanë të paktën një vend në këshillin mbikqyrës”.

Përkundrazi, Autoritetet publike mund të përdorin çfarëdo forme të shoqërive për të ndjekur interesat e përgjithshëm ekonomike të tyre (neni 213, pika 1). Për më tepër, neni 213, pika 1, bën të mundur që autoritetet publike jo vetëm mund të krijojnë shoqëri tërësisht në pronësi të tyre, por mund të luajnë dhe rolin e “mëmës” [...] për ta mbajtur nën kontroll një shoqëri në pajtim me politikat e përgjithshme ekonomike të tyre (Dine, Bletcher, 2016:238).

Kështu me Vendimin nr.93, datë 28.2.1994 “Për bashkimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëritë tregtare me ortakë të tjerë”, është parashikuar rastet kur ndërmarrjet, institucionet ose njësitë e tjera shtetërore, buxhetore ose jobuxhetore, bashkohen në një shoqëri tregtare me ortakë të tjerë. Ndërmarrjet mund të bashkohen vetëm në ato shoqëri tregtare ku shteti si ortak përballon humbjet deri në kurifin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar¹²⁴. Ky bashkim kalon në procedura të veçanta miratimi dhe sanksionimi. Organi përkatës që ka vendosur për bashkimin e ndërmarrjes në shoqërinë tregtare me ortakë të tjerë, ka atributet e ortakut në këtë shoqëri në kuptimin e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, dhe në vijim të këtij vendimi do të emërtohet “ortaku shtetëror shqiptar”¹²⁵. Kërkesat në lidhje me funksionimin dhe sidomos me rregullimin e pozitës së Ortakut Shtetëror Shqiptar, ishin taksative për t’u vendosur në aktet e themelimit të shoqërive që do të krijoheshin në kuadër të këtij Vendimi.

Në lidhje me sistemin e qeverisjes, në fakt dhe me hyrjen në fuqi të Ligjit 9901/2008, i cili legjitimon qeverisjen me një dhe dy nivele për shoqëritë aksionare, një reflektim i tillë nuk u bë në modelin e qeverisjes së shoqërisë shtetërore. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave

¹²⁴ Shih Vendimin nr.93, datë 28.2.1994 “Për bashkimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëritë tregtare me ortakë të tjerë”, pika 1, paragrafi i fundit.

¹²⁵ Shih Vendimin nr.93, datë 28.2.1994 “Për bashkimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëritë tregtare me ortakë të tjerë”, pika 4.

nr.271, datë 9.5.1998 u bë miratimi i statutit tip të shoqërive anonime shtetërore të cilat krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri anonime, me organet drejtuese (1) Këshilli mbikëqyrës me mandat 4 vjeçar dhe (2) Drejtoria me mandat 4 vjeçar. Pavarësisht parashikimeve të ligjit 9901/2008, me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 570, datë 3.10.2018 “*Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore*”, u ri kompozua përbërja e këshillave sipas sektorëve ku operojnë shoqëritë shtetërore (tre, për shoqëritë jostrategjike, të vogla e të mesme; dhe gjashtë, për shoqëritë e sektorëve strategjikë me rëndësi të veçantë), shpërblimi i tyre, kriteret e përzgjedhjes apo ndalimet përkatëse për të qenë anëtar. Vlen të përmendet nga pikëpamja e teknikës legjislative se në këtë vendim i cili është ndër më të fundit përsa i përket legjislacionit, gjen përdorim sërish termi “*shoqëri anonime*”.

6.4 Aksioni

Së pari, është pranuar gjerësisht në literaturën e huaj se nuk ka një përkufizim të njësuar të aksionit (Rystemaj 2012:31). Vështirësi në gjetjen e një përkufizimi unik lindin edhe për shkak të vlerësimeve të ndryshme që historikisht i janë bërë aksionit nga dy familjet më të mëdha ligjore, d.m.th familja e të drejtës civile (civil law) dhe common law (Rystemaj 2012:31). Sipas *Common Law*, aksioni konsiderohet si një e drejtë apo tërësi të drejtash. Nga pikëpamja e së drejtës civile aksioni është konsideruar send subjekt i qarkullimit civil, i cili shitet dhe blihet lirisht në tregjet përkatëse financiare. Ligji i vjetër në terminologji dallonte “pjesët e kapitalit” për të shprehur pjesëmarrjen në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar dhe aksionet për shoqëritë anonime, por pa dhënë një kufizim për të. Aksionet klasifikoheshin në aksione për prurësin (të tregtueshme) dhe aksione nominative

(emërore)¹²⁶, klasifikim i cili i shfaqet efektet e rregullat e transferimit dhe qarkullimit të aksioneve. Në literaturën në vend, Berberi (në interpretim të ligjit të mëparshëm për shoqëritë tregtare) (2004: 83) e përcakton si “një titull (letër me vlerë të tregtueshme) që përfaqëson një pjesëmarrje në kapitalin themeltar të një shoqërie me aksione me të cilin lidhen të drejtat e ndryshme të aksionarit në shoqëri, të caktuara këto me ligj apo me statut”. E thënë ndryshe, aksioneri është personi fizik apo juridik që është pronar i një pjese të kapitalit të shoqërisë, pronësi kjo në formën e një apo disa aksioneve (Berberi, 2004: 78).

Në vijim, edhe pas Reformës së Dytë Tregtare, të njëjtin qëndrim në lidhje me termat mbajti dhe LShT duke përdorur dy fjalë të ndryshme dhe duke iu referuar “kuotë” në lidhje me SHPK-të dhe “aksion” në lidhje me SHA-të, por pa dhënë një përkufizim të vetë kuotës apo aksionit. Në ndihmë për një përcaktim vjen ligji “Për titujt”. Në kuptim të ligjit “Për titujt”, aksionet janë titull, pra instrumente financiare të cilat emetohen dhe tregtohen për sigurimin e fitimit, nëpërmjet administrimit të të drejtave, që rrjedhin nga zotërimi i tyre¹²⁷. Në kuptim të marrëdhënies juridike aksionet janë tituj të pjesëmarrjes në kapital të cilët provojnë të drejtat dhe detyrimet për një pjesë të kapitalit minimal apo atij të regjistruar të shoqërisë aksionere¹²⁸. Në vijim dhe Malltezi (2011:107) e përkufizon aksionet si njësia në të cilën shprehet pjesëmarrja e aksionarëve (apo pronarëve) në shoqëri, në kapitalin e regjistruar të saj; e thënë më thjeshtë, është njësia në të cilën ndahet apo shprehet kapitali i regjistruar i shoqërisë aksionare.

¹²⁶ Shih Neni 197 “Format” i Ligjit 7638, datë 19/11/1992 “Për Shoqëritë Tregtare”.

¹²⁷ Shih Neni 3 “Titujt sipas formës juridike”, të ligjit Nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”.

¹²⁸ Shih Neni 4 “Titujt sipas marrëdhënies juridike”, të ligjit Nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”.

Sipas Ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, shoqëritë aksionare mund të emetojnë dy lloj aksionesh, *aksione të zakonshme* dhe *aksione me përparësi*¹²⁹ (Malltezi 2011:107). Në dallim nga Ligji 7638, LShT-ja përfshiu vetëm aksionet e regjistruara, duke mos i lejuar më aksionet për prurësin. Për arsye të transparencës së pjesëmarrjes në pronësi, regjimet bashkëkohore të drejtimit të brendshëm të shoqërive janë bërë gjithnjë e më skeptike ndaj sistemeve të aksioneve të prurësit dhe preferojnë sistemin me aksione të regjistruara (Dine, Bletcher 2016:158).

Në varësi të të drejtave që i japin palëve, aksionet mund të jenë të zakonshme ose aksione me përparësi¹³⁰. Aksionet e zakonshme u japin aksionarëve tagër për të ushtruar në asamblenë e përgjithshme të drejtat financiare dhe politike të aksionarit në përpjestim me pjesën e kapitalit që ato përfaqësojnë si dhe për të përfituar pjesë të fitimeve dhe të shpërndarjes së pasurive të mbetura pas likuidimit, në raport me pjesën e kapitalit që aksionet e tyre përfaqësojnë. Aksionet e zakonshme shoqërohen gjithmonë me të drejtë vote. Aksionet me përparësi u japin tagrin që nga ndarja e dividendëve të vendosur nga asambleja e përgjithshme të përfitojnë një shumë të caktuar ose një përqindje të caktuar të vlerës nominale të aksioneve të tyre, përpara shpërndarjes së fitimeve, në favor të aksionarëve të zakonshëm. Aksionet me përparësi mund të emetohen pa të drejta vote. Në këtë rast, aksionet me përparësi nuk mund të përfaqësojnë më shumë se 49 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë¹³¹. Parimi i trajtimit të barabartë të aksionarëve ka shprehjen e tij më të

¹²⁹ Shih neni 116 (1) i LShT

¹³⁰ Shih neni 116 (1) i LShT

¹³¹ Shih neni 122 i LShT;

drejtpërdrejtë në përcaktimin taksativ ligjor se aksionet e të njëjtës kategori kanë të drejta të njëjta (Malltezi 2011:107).

Pra, në përfundim mund të themi se kuota/aksioni ka një natyrë dualiste e cila shprehet në:

- (i) një “tërësi të drejtash”, të cilat përbëjnë interesin ekonomik të ortakut/aksionarit në shoqërinë tregtare;
- (ii) aktiv që mund të blihet dhe të shitet dhe çmimi i saj/i tij përcaktohet nga pritshmëria e tregut për të adhurat financiare që ka të ngjarë të gjenerohen nga shoqëria.
- (iii) Në parim, si kuotat e SHPK-ve, si dhe aksionet e SHA-ve mund të kalohen lirisht (Bachner, Schuster, Winner, 2009:82);

6.5 Aksionarët e pakicës

Në kuptim të teorisë së grupeve të interesit, edhe vetë aksionarët janë grup interesi. Brenda këtij grupi, dallojmë aksionarët e shumicës dhe aksionarët e pakicës, të cilët kërkojnë dhe një vëmendjen më të madhe. Forcimi i aksionarëve të pakicës ndikon në përmirësimin e qeverisjes së korporatës, ndonëse angazhimi dhe përfshirja e tyre në shoqëritë me aksionarë të mëdhenj, paraitet i vështirë. Në fakt, ligji nuk bën një përcaktim se cilët janë aksionarët e pakicës. Ligji përcakton vetëm prahun minimal të zotërimit të aksioneve nga ana e aksionarit (të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë apo një vlerë më të vogël, të parashikuar në statut – Neni 151 (2) por nuk përcakton dhe një tavan të këtij zotërimi. [...] vlerësojmë se aksionarët e pakicës janë ata që pavarësisht përqindjes së aksioneve që zotërojnë, nuk mund të ushtrojnë kontroll domethënës në shoqëri (Rystemaj, 2015:279). Në përgjithësi mund të deduktojmë se statusi i aksionarit të pakicës vlerësohet rast pas rasti, në

raport me fragmentarizimin dhe shpërndarjen e pronësisë dhe të drejtat e votës që burojnë nga aksioni /aksionet e zotëruara.

Në doktrinën që ka formësuar të drejten e shoqërive tregtare është pranuar gjithmonë se vullneti i shumicës në një shoqëri, përbën vullnetin e vetë shoqërisë (Rystemaj, 2015:279).

Neni 151 i LSHT para ndryshimeve të vitit 2014 parashikonte se aksionarët, që përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë apo një vlerë më të vogël, të parashikuar në statut dhe/ose kreditorët e shoqërisë, të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 % të kapitalit të regjistruar, mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës, kur këto vlerësohen si shkelje të rënda të ligjit ose të statutit si dhe t'i drejtoheshin drejtpërdrejt gjykatës brenda 30 ditëve nga refuzimi i asamblesë.

E shprehur në këtë mënyrë, duhej që vendimet që të mund të goditeshin, të ishin shkelje të rënda të ligjit ose të statutit, duke përjashtur kështu mundësinë për të goditur apo kundërshtuar çdo lloj vendimi tjetër që nga ana formale ishin në përputhje me ligjin dhe statutin. Me ligjin 129/2014, i cili prezantoi ndryshime në Ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregare”, togfjalëshi “*në shkelje të rëndë të ligjit ose statutit*” u hoq duke lejuar kështu kundërshtim e atyre vendimeve të cilët, edhe pa qenë në shkelje të ligjit a statutit, i shkaktojnë dëm shoqërisë. Goditja e vendimeve mund të bëhet dhe për shkaqe të tjera, por gjykata nuk duhet të dalë jashtë rolit të saj duke vlerësuar gjykimin e biznesit e duke zëvendësuar kështu këshillin e shoqërisë (Rystemaj, 2015: 280). Gjithashtu pakica duhet të provojë që shkelësit e normave janë duke kontrolluar shoqërinë (Rystemaj, 2015: 280).

Pretendimet individuale të aksionarëve mbrohen me padi që i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës, pa investuar mjete interkorporative. Pretendimet që ngrihen për përfitime të klasës/grupit që ata përfaqësojnë mbrohen me padi derivative, ku fillimisht investohet asamblea. Vetëm pas refuzimit nga ana e asamblesë (brenda 30 ditëve) ose mos shprehjes nga ana e asamblesë (nëse asambleja nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa vlerësohet e refuzuar), aksionari ose kreditori, i drejtohet gjykatës.

Në këtë punim është bërë përpjekje për të bërë një “lexim” të LSHT në dritën e teorisë integrative dhe instrumentaliste të biznesit dhe për të parë sesi qëndron LSHT përballë tyre. Është e kuptueshme që gjatë analizës nuk pritej të gjendej një “pasqyrim” të plotë apo të përputhur, krejtësisht evident por do të merren në analizë ato dispozita të cilat janë gjykuar në dritën e këtij punimi se anojnë nga njëra apo tjetra teori.

Që në nenin 3 bëhet përcaktimi në lidhje me shoqëritë tregtare të cilat themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri. Kontributet mund të jenë në shoqëri, në para ose në natyrë. Pra, vetë LSHT përcakton se dakordësia për krijimin e shoqërisë tregtare janë objektivat ekonomike të përbashkët të themeluesve të saj. Mëse e qartë nisur nga fakti që kemi të bëjmë me një aktivitet tregtar dhe fitimprurës pasi në rast të kundërt do të kishim të bënim me një organizatë jofitimprurëse të cilat rregullohen nga ligji Nr.8788, datë 7.5.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar.

LSHT nuk bën vetë një përcaktim të objektivave ekonomike. Këtë e gjejmë në literaturë. Objektivi kryesor i biznesit është fitimi si diferencë ndërmjet kostos së prodhimit e shitjes së një produkti dhe asaj që klientët paguajnë për të (Llaci, 2006:18). Ky përkufizim kuptohet vlen për shoqërinë tregtare klasike pasi tashmë në treg krahas aktorëve klasikë janë dhe

bizneset sociale, një koncept i ri dhe tejet inovativ i cili mishëron në kuptimin më të ngushtë thelbin e përgjegjësisë sociale: në një biznes social, investitorët apo pronarët mund të marrin gradualisht paratë që kanë investuar, por nuk mund të marrin asnjë dividend përtej kësaj pike. Ky lloj biznesi ka si qëllim investimin dhe arritjen e objektivave sociale përmes operimit të kompanisë dhe nuk kërkohet fitim personal nga ana e investitorëve¹³².

Megjithatë duke mbetur të LSHT dhe dispozitat e tij, LSHT parashikon se gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët dhe aksionarët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve apo të aksionarëve të tjerë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës. (Neni 14).

Më së pari në këtë nen, dallojmë që LSHT referon shprehimisht konceptin “*interesat e shoqërisë*”; më pari e rendit atë të parin ndaj interesave të ortakëve dhe aksionarëve të tjerë duke e prioritzuar dhe nga ana tjetër shpalolet se tashmë shoqëria dhe pronarët nuk janë një entitet i vetëm, përkundrazi kanë interesa.

Rasti kur këto interesa përputhen dhe janë në një frekuencë është rasti ideal, sic është për shembull rasti kur pronësia nuk është e ndarë nga administrimi dhe kur portofoli i pronësisë nuk është i diversifikuar. Ajo që analizohet që në krye të herës në këtë punim është nëse interesat e shoqërisë janë për të begatuar interesat ekonomike dhe financiarëve të pronarëve të cilët kanë kontribuar në shoqëri, apo këto janë të pavarura dhe mund të përqëndrojnë fokusin e shoqërisë përtej interesave të pronarëve të saj.

¹³² Shënim: marrë nga revista Business Mag, 18/04/2019, “6 bizneset sociale më dinamike vitet e fundit në Shqipëri”, gjendet në https://businessmag.al/6-bizneset-sociale-me-dinamike-vitet-e-fundit-ne-shqiperi/?fbclid=IwAR0J4a_OVq5c1LyCMkUSIb66znnJCQNGt9RPvOD5rzZ4VBR6KXQYXPRpDfM

Neni 16 “Abuzimi me detyrën dhe formën e shoqërisë” njeh përgjegjësinë personale dhe solidarë për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre për ortakët, aksionarët e shoqërisë tregtare, administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit nëse, inter alia, trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre. Ky nen thekson edhe me tepër personalitetin juridik dhe të mëvetësishëm që ka shoqëria nga themeluesit dhe / ose drejtuesit e saj dhe në të njëjtën kohë mund të themi se “adreson” dhe drojën e Friedman që shoqëria do të trajtohej si pasuria vetjake e dikujt që nuk e ka. Neni 163 “Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia”, kërkon që krahas detyrimit të besnikërisë, administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit detyrohen: të kryejnë detyrat e tyre, të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë, në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së saj në mjedis; i njëjti formulimin gjendet dhe në nenin 98 duke iu referuar administratorëve në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar. Mund të themi se është një nga nenet më eksplicite në këtë lexim, që adreson personalitetin më vetë të shoqërisë dhe njërin nga faktorët jo financiarë ESG, mjedisin. Në fakt në tërë LSHT, termi “mjedis” përdoret vetëm 3 herë.

Transparenca dhe ndarja e informacionit padyshim që është një gur themeli në qeverisjen e mirë të korporatës. LSHT e prek këtë detyrim në disa nene të tij ku kërkon dhënie të informacionit të shoqërisë nëpërmjet faqes së internetit, që mund të mund të zbatohen nëpërmjet krijimit të një lidhjeje informatike të drejtpërdrejtë me faqen në internet, ku Qendra Kombëtare e Regjistrimit publikon informacionin për tregtarin apo shoqërinë përkatëse (Neni 1 pika 5).

Neni 15 sanksionon të drejtën e informimit, duke vendosur detyrimin për personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë që të informojnë të gjithë ortakët apo aksionarët për ecurinë e

veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë. Ky detyrim mund të përmbushet edhe duke e vendosur këtë informacion në faqen e internetit të shoqërisë tregtare dhe duke informuar për këtë personat, të cilët e bëjnë kërkesën. Në të kundërt, këto dokumente duhet të vihen në dispozicion, për shqyrtim, pranë zyrës qendrore të shoqërisë tregtare.

Në rast se informacioni i kërkuar nuk jepet, ortakët, anëtarët ose aksionarët e interesuar, brenda 30 ditëve pas refuzimit, mund t'i kërkojnë gjykatës kompetente të urdhërojnë përmbaruesit gjyqësorë të ekzekutojnë kërkesën e ortakut apo aksionarit, duke i dorëzuar këtyre të fundit informacionin dhe dokumentet që personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë nuk kanë dhënë. Ndryshimet parashikojnë rregullat për zbulimin e informacionit, mbrojtjen e palëve të treta që ndërveprojnë me shoqëritë, duke ofruar një listë të plotë të shkaqeve të pavlefshmërisë, shkrirjeve ndërkufitare dhe kërkesave për raportim dhe dokumentim për bashkimet dhe ndarjet¹³³.

¹³³ Shënim: marrë nga Vendimi Nr. 246, datë 9.5.2018, "Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2018–2020", faqe 54; gjendet në <http://efzhr.kryeministria.al/images/DokumentaStrategjik/PKIE%202018-2020.pdf>

6.6 Praktika gjyqësore në vend në lidhje me shoqëritë tregtare

Pavarësisht harkut të gjatë kohor, që nga hyrja në fuqi e Ligjit 7638, datë 19.11.1992 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, praktika gjyqësore¹³⁴ në lidhje me të drejtën tregtare ka qenë relativisht e varfër. Jo vetëm, por në shumë raste vërehet një praktikë jo konsekuente, ose një mendim jo i unifikuar. Në vitin 2008, ligji për shoqëritë tregtare merrte në konsideratë elementë të vlefshëm të ligjeve të mëparshëm si ligji 7638, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ligjin nr. 7632 “Për pjesën e përgjithshme të Kodit Tregtar”, në mënyrë që të ruhej sa më shumë që të ishte e mundur praktika ligjore shqiptare e krijuar në periudhën 1994 – 2008 (Dine, Bletcher, 2016:7).

Gjithashtu ligji për shoqëritë tregtare i vitit 2008 nuk bëntë asnjë dallim thelbësor në mënyrën e gjykimit të mosmarrëveshjeve dhe ankesave për çështje të së drejtës tregtare nga ana e gjykatave, duke qenë se reforma e ligjit për shoqëritë tregtare nuk kishte si synim edhe reformimin e mosmarrëveshjeve tregtare (Dine, Bletcher, 2016:7).

Në mënyrë të përmbledhur çështjet kryesore të trajtuara janë:

Për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar: Administrimi i shoqërisë, administratori dhe përfaqësimi i shoqërisë; Vendimmarrja në Asamblenë e Përgjithshme, mbrojtja e ortakut në minorancë, marrëdhënies ndërmjet ortakëve;

Për shoqëritë aksionare: Themelimi i shoqërisë¹³⁵, raportet mes organeve, emërimi dhe shkarkimi i administratorit, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.

¹³⁴ Shënim: për rastet praktike në këtë seksion janë marrë në konsideratë kryesisht rastet e trajtuar në librin Malltezi Argita, Rystemaj Jorida, Kromici Armela, “Gjykatat shqiptare mbi shoqëritë tregtare dhe veprimtarinë tregtare”, Shtëpia Botuese Mediaprint 2015, ISBN 978-9928-08-174-2.

¹³⁵ Ligji për shoqëritë tregtare i pajis gjykatat me mjete të mjaftueshme për të trajtuar forma të ndryshme të abuzimit (me themelimin e shoqërisë), (shih, për shembull, nenet nga 14 deri në 16 për detyrimin e besnikërisë, nenet 98 dhe 163 për përgjegjësinë e administratorëve, nenet nga 205 deri në 212 për grupimin e shoqërive) (Dine, Bletcher, 2016:41).

Deri tani nuk kemi rast të evidentuar që gjykata të jetë investuar për të marrë në shqyrtim përgjegjësinë sociale të shoqërisë apo elementë të lidhura me të, si për shembull këshilli i punëmarrësve etj. megjithatë, për të mbetur brenda qëllimit të punimit, nga rastet e përmendura më sipër, me interes në një kontekst të zgjeruar përsa i përket çështjeve të ngritura në këtë punim, ndër ato që mund të paraqesim, është emërimi dhe shkarkimi i administratorit në shoqëritë aksionare.

Administratori është një person kyç në administrimin e shoqërisë, që gëzon një status të veçantë në shoqëri. Ky status i veçantë buron nga parashikimet e LSHT, si dhe referohet dhe nga parashikimet statutores në shoqëri. Administratori është një organ i shoqërisë i cili realizon përfaqësimin organik të shoqërisë me të tretët (Rystemaj, 2015: 268). Nga pikëpamja ligjore është me interes marrëdhënia që krijohet ndërmjet administratorit dhe shoqërisë dhe nga cili legjislacion qeveriset kjo marrëdhënie.

Qëndrimet e gjykatës, disa prej të cilave do të paraqiten në vijim, kanë qenë të ndryshme. Administratori është një nga organet e rëndësishme të shoqërisë dhe marrëdhënia e tij me shoqërinë është më shumë se një marrëdhënie punë, ajo është një marrëdhënie besimi dhe përgjegjësie për ecurinë e vetë personit juridik, nëpërmjet menaxhimit të veprimtarisë së përditshme të tij, duke pasur për bazë gjithnjë interesin më të mirë të shoqërisë¹³⁶. Ai nuk mund të krahasohet me të gjithë të punësuarit e tjerë të shoqërisë, të cilët punësohen prej tij (Rystemaj, 2015: 268).

Paditësi MK i emëruar Administrator në Shoqërinë OST Security Sh.A., padit këtë të fundit për lirim nga detyra si Administrator me vendimin e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë por pa dhënë motivacion për lirim. Pala paditëse kërkon përmbushjen e detyrimit kontraktor

¹³⁶ Shih Vendimi nr. 4490, datë 8.4.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sjellim në vëmendje që në vendimin e gjykatës përmendet “**interesi më i mirë i shoqërisë**”, dhe jo “i aksionarëve”, duke bërë kështu një referencë në parashikimin e nenit Neni 98, “Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia”, pika 1 (a).

nga pala e paditur, Shoqëria OST Security Sh.A., duke e paguar paditësin derin në përfundimin e afatit të marrëdhënies së punës¹³⁷.

Në këtë rast Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë çmon se: [...] *mosmarrëveshja e paraqitur për gjykim, ndonëse në thelb është është mosmarrëveshje që rrjedh nga ofrimi i punës (shërbimit), nga administratori te shoqëria, si kontratë nuk rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës, por eventualisht nga ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), statuti i OST Security Sh.a. dhe Kodi Civil. Referimi [...] në dispozitat e Kodit të Punës është i pasaktë dhe nuk mbahet parasysht nga kjo gjykatë pasi neni 5 (a) i Kodit të Punës e përjashton shprehimisht nga fusha e veprimit të tij (ratio materiae) veprimtarinë që kufizohet vetëm në ushtrimin e detyrës së këshilltarit ose anëtarit të organit të administrimit të personit juridik që ka formën juridike të një shoqërie, kur kjo veprimtari përmban vetëm ekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë.”*

Pavarësisht se sa më sipër në arsyetimin e gjykatës nuk përjashtohet kategorisht zbatimi i Kodit të Punës, duke pasur parasysht nenin 4 të tij, që zbatohet për ato çështje që nuk gjejnë rregullim specifik në dispozitat e posacme ligjore, por në asnjë rast në lidhje me të drejtat që rrjedhin nga ndërprerja e marrëdhënies së punës, pasi këtu gjejnë zbatim ekskluzivisht ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), Statuti i OST Security Sh.a. dhe Kodi Civil¹³⁸. Gjykata njohu dhe dëmin e shkaktuar paditësit në masën e pagës që do të merrte deri në përfundim të kontratës¹³⁹; e cila edhe pse nuk kishte

¹³⁷ Vendimi nr. 4490, datë 8.4.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹³⁸ Shih Vendimi nr. 4490, datë 8.4.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹³⁹ NJë vendim i ngjashëm që vjen nga gjykatat amerikane trajtonë mënyrën sesi kompensohet anëtari i këshillit nëse kontrata e lidhur mes tij dhe shoqërisë zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga shoqëria. Për më shumë shih

afat të përcaktuar, sipas LSHT nuk mund të zgjaste më shumë se 3 vjet (Rystemaj, 2015: 269). Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të njëjtin arsyetim.

Paditësi N.E. është emëruar administrator i shoqërisë Drini Sh.A. nga Asambleja e Aksionarëve. Këshilli i Administrimit ka shkarkuar administratorin N.E. nga kjo detyrë dhe ka emëruar D.R. Paditësi pretendon se ky shkarkim është bërë në kundërshtim me parashikimet e LSHT dhe të Statutit të shoqërisë¹⁴⁰.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë çmoi se kompetenca për emërimin dhe shkarkimin e Administratorit të Shoqërisë i takonte Asamblesë së Aksionarëve dhe jo KA. Por në dallim nga rasti i mësipërm, Gjykata arsyetoi se: *“Administratori i shoqërisë për shkak të cilësisë së tij dhe kompetencave që ai kryen sipas ligjit dhe statutit të shoqërisë, konsiderohet si i punësuar i shoqërisë. Në ligjin 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, nuk është dhënë asnjë parashikim në lidhje me marrëdhënien e punës që krijohen me administratorin dhe me shoqërinë, dhe për këtë arsye gjykata konkludon se do të zbatohen dispozitat e nenit 4/2¹⁴¹ të Kodit të Punës”¹⁴², për kontratën e punës (të pashkruar, të pranuar). Gjykata çmon se paditësi duhet të përfitojë dëmshpërblim për zgjidhje të marrëdhënies së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar si dhe pa respektuar afatin e njoftimit të parashikuar në nenin 143 të Kodit të Punës dhe procedurën e zgjidhjes së marrëdhënies së punës sipas nenit 144/5 të Kodit të Punës. Pala e paditur ka patur*

Malltezi A., Rystemaj J., Kromici A., (2015) “Gjykatat Shqiptare mbi shoqëritë dhe veprimtaritë tregtare”, Mediaprint, faqe 269.

¹⁴⁰ Vendimi nr. 4848, datë 14.05.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁴¹ Neni 4/2 i Kodit të Punës parashikon se: Dispozita të veçanta të këtij Kodi zbatohen edhe ndaj personave, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për probleme të lidhura me marrëdhëniet e punës.

¹⁴² Shih Vendimi nr. 4848, datë 14.05.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

detyrimin ligjor që në momentin e shkarkimit nga detyra të paditësit, të respektonte dispozitat e Kodit të Punës që rregullojnë mënyrën e zgjidhjes së kontratës së punës¹⁴³.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1656, datë 18.07.2013 vendosi prishjen e vendimit dhe kthimin e cështjes për rigjykim. Në vendimin e saj, Gjykata argumentoi se shkarkimi nga KA është në përputhje me kompetencat e këtij organi si dhe kërkoi hetim më të zgjeruar në lidhje me shkaqet e shkarkimit.

Në një analizë të fundit, dhe në dritën e LSHT, në lidhje me administratorin e shoqërisë, si një element thelbësor në jetën dhe aktivitetin e shoqërisë, mund të konkludojmë se: Kontrata që lidhet mes administratorit dhe shoqërisë nuk është një kontratë e mirëfillte pune dhe që rregullohet vetëm nga Kodi i Punës. Kontrata që lidhet mes tyre parashikon ofrimin e shërbimit të administrimit të shoqërisë, e cila për cështje të caktuara rregullohet nga Kodi i Punës (kushtet higjieno – sanitare, ergonomike të vendit të punës etj), nga LSHT dhe nga statuti i shoqërisë. Konfuzion sa i përket kuptimit të përgjithshëm lidhur me këtë aspekt ka krijuar ligji “Për shoqëritë tregtare”, (i shfuqizuar) i cili përcaktonte se kontrata e lidhur mes këshillit dhe administratorëve është kontratë pune (Rystemaj, 2015:274).

Organi që emëron administratorin, është dhe organi që e shkarkon atë, varësisht modelit të përzgjedhur të organizimit të shoqërisë (me një nivel apo me dy nivele), të parashikuar nga normat dispozitive. Kjo qartëson llogaridhënien e administratorit dhe përgjegjësinë e tij. Administratori (në të dyja modelet e drejtimit të shoqërisë aksionare) është pozicionuar funksionalisht si organ ekzekutiv, i cili vendos në zbatim politikat e shoqërisë të përcaktuara nga asambleja e përgjithshme dhe vendimet e këshillit (Rystemaj, 2015: 274). Lidhur me

¹⁴³ Shih Vendimi nr. 4848, datë 14.05.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

shkarkimin e administratorit, ai bëhet nga organi kompetent, në cdo kohë, me apo pa një shkak të arsyeshëm. Megjithatë ekzistenca ose jo e këtij shkakut është thelbësore për pretendimet që mund të ngrejë administratori i shkarkuar ndaj shoqërisë, pasi në kushtet e mungesës së një shkakut të arsyeshëm dhe të justifikuar, shoqëria do të përballë me kërkesat për shpërblimin e dëmit që rrjedh nga marrëdhënia kontraktore e krijuar mes shoqërisë dhe administratorit të saj (Rystemaj, 2015: 269). Sa i përket shpërblimit që i takon administratorit të shkarkuar, theksojmë se doktrina vendase ka mbajtur qëndrimin që ky fakt do të varet nëse akti i shkarkimit është mbështetur në një shkak të arsyeshëm apo jo (Malltezi, 2011). Rrjedhimisht duke qenë se marrëdhënia mes shoqërisë dhe administratorit të saj nuk është marrëdhënie pune, atëherë konform ligjit “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, paditët që lidhen me shpërblimin e antëtarit, në bazë të marrëdhënies kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas normave të Kodit Civil (Rystemaj, 2015: 274).

Nga pikëpamja e praktikës gjyqësore në vend shohim se çështja e pronësisë së shoqërisë dhe roli i aksionarëve ka qenë objekt gjykimi si në periudhën kur në fuqi ishte ligji 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare, ashtu edhe pas hyrjes në fuqi të LShT-së.

Në lidhje me pronësinë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e datës 17.04.2014 vlerëson se, pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuara nga ligji (*neni 149*) dhe e drejta e pronësisë dhe të drejta të tjera mbi sendet janë të transferueshme, përveç kur ndalohet nga ligji ose nga vetë natyra e të drejtës (*neni 162*), nëpërmjet mënyrave të përcaktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë (*neni 163*)¹⁴⁴.

144 Për më shumë shih: Vendimi Nr.11115-02459-00-2008 i Regj. Themeltar, Nr.00-2014-1016 i Vendimit (163), me palë paditëse SHOQËRIA “Olimpik Petrol” Sh.P.K., palë të paditur Krenar Islami, Fadil Haxhi, me

Ndërkohë që në vendimin unifikues 25/2003¹⁴⁵, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, u shprehen se: “Për mbrojtjen e pronës ato (*lexo atyre që në momentin që kanë pranuar të bëhen aksionerë të shoqërisë tregtare*) kanë rënë dakord që të caktojnë edhe organet përkatëse të shoqërisë duke i pajisur me kompetencat e nevojshme. Pra marrëdhënia e pronësise nuk i përket çdo ortaku në veçanti, por i përket personit juridik që është shoqëria private tregtare. Në këtë kuadër drejtori apo drejtoret e shoqërisë tregtare nuk mund të ushtrojnë kompetenca që i takojnë asamblese së aksionereve. Kompetencat e drejtorise dhe marrja e vendimeve prej saj nuk mund të tejkalojnë parashikimet e nenit 101 të Ligjit nr.7638, date 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare¹⁴⁶”.

Nga përmbajtja e dispozites së mësipërme dhe, në tërësi, nga fryma dhe parimet mbi të cilat është bazuar ligji për shoqëritë tregtare, del qartë që të drejtat e drejtorisë janë të kufizuara brenda caqeve të administrimit të shoqërisë tregtare dhe të mbrojtjes së interesave të saj në raport me të tretët. Ajo nuk ka kompetenca të merret me zgjidhjen e problemeve që i takojnë fazës së krijimit të shoqërisë dhe sidomos atyre që kanë të bëjnë me raportet midis aksionereve. Në bazë të nenit 101 të ligjit për shoqëritë tregtare drejtori përfaqëson shoqërinë ndaj të tretëve (pra jo ndaj anëtareve të saj) dhe ushtron kompetencat brenda objektit të shoqërisë”.

objekt “Detyrimin e të paditurve t’i kthejnë e dorëzojnë dy depozita sipas vendimit penal nr.4/2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Sigurimin e padisë”.

¹⁴⁵ Shih Vendimi Unifikues Nr.36 i Regj. Themeltar, Nr.25 i Vendimit, date 28.03.2003 për çështjen civile nr.36 me palë paditëse DAJTI” SHA, palë të paditur K.K.K PRONAVE Tiranë, Ministria Privatizimit etj, me objekt: “Kundershtim i vendimit të KKK të Pronave si dhe pushim i të drejtave mbi aksionet e të paditurve në SHA “Dajti” dhe fshirja e tyre nga lista e aksionereve të paditesit” (e aksesueshme në http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Vendime_Unifikuese_39_1.php)

¹⁴⁶ Sipas kesaj dispozite, “Drejtorja ka kompetenca të plota për të vepruar në çdo rrethane në emër të shoqërisë. Ajo ushtron këto kompetenca brenda objektit të shoqërisë, por kufizohet nga ato kompetenca që ligji u jep shprehimisht keshillit mbikqyres dhe asamblese së aksionereve..... Drejtorja shqyrton dhe merr vendime sipas kushteve të caktuara në statut”.

Në një analizë të sa më sipër, gjykata ka njohur faktin se marrëdhënia e pronësisë i përket personit juridik që është shoqëria private tregtare. Ajo nuk i përket çdo ortaku në veçanti. Por nga ana tjetër, në po këtë vijë logjike, gjykata e asocion këtë marrëdhënie ngushtësisht me asamblenë e aksionarëve duke njohur kështu dhe një të drejtë të tyre mbi pronën e shoqërisë. Në lexim të vendimit të gjykatës shohim se roli dhe kompetencat e drejtorit (përfaqësuesit ligjor të shoqërisë), janë të kufizuara brenda caqeve të administrimit të shoqërisë tregtare dhe të mbrojtjes së interesave të saj në raport me të tretët, por që nuk përfshin dhe marrëdhënien e pronësisë së shoqërisë.

Ky qëndrim i Gjykatës është cituar dhe në raste të tjera dhe është elaboruar dhe më tej. Vendimi unifikues është cituar gjithashtu edhe në gjykimet administrative.

Kështu në vendimin nr. 4082, datë 14.07.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë¹⁴⁷, gjykata rithekson dhe përsërit qëndrimin e vendimit unifikues 25/2003 dhe në të njëjtën kohë shprehet se: “Marrëdhënia e pronësisë nuk ushtrohet nga drejtori apo drejtorët e shoqërisë tregtare të cilët nuk mund të ushtrojnë kompetenca që i takojnë asamblesë së aksionarëve... Në këtë kontekst, paditësi Posta Shqiptare, përmes drejtorit të saj ekzekutiv nuk mund të ngrejë padi kundrejt pronarit të saj që është Ministria e Ekonomisë”. Pra, në

¹⁴⁷ Çështja me palë paditëse Posta Shqiptare Sh.a., me palë të paditur Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, person i tretë Albtelecom sh.a. dhe me objekt: “Pezullim i ekzekutimit të urdhërit nr.546, datë 11/06/2013 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës “Për dorëzimin e pronave të paluajtshme Albtelecom sh.a.që përdoren nga Posta Shqiptare sh.a.” Shfuqizimin e urdhërit nr.546, datë 11/06/2013”. Çështja në fjalë përbën ndër rastet e rralla të praktikës gjyqësore kur shoqëria tregtare, në rastin konkret shoqëri aksionare e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor padit aksionarin për vendimet e marra. Posta Shqiptare iu drejtuar fillimisht Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila me vendimin nr. 2714, datë 26/02/2014 ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin për shqyrtim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Posta Shqiptare pretendon se i është dhënë e drejta e administrimit dhe posedimit të pronave dhe se i janë cënuar të drejtat dhe interesat nga urdhëri që godet. Aktualisht, në kohën që përgatitej ky punim, pas vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, Posta Shqiptare bëri rekurs në Gjykatën e Lartë dhe çështja është në pritje të zhvillimeve të mëtejshme në këtë instancë.

këto kushte palës paditës i mungon legjitimimi aktiv në ngritjen e padisë, pasi në kuadrin e funksionimit të një shoqërie aksionare me kapital shtetëror dhe aksionar të vetëm Ministrinë e Ekonomisë, e drejta e pronësisë ushtrohet nga asamblea dhe jo nga administratori (drejtori). Ky qëndrim u mbështet dhe nga vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, nr.1168, datë 12/05/2016 e cila u shpreh se: “paditësja Posta Shqiptare përmes drejtorit të saj, si përfaqësues i emëruar nga aksionari i vetëm shtetëror METE nuk mund të ngrejë padi kundrejt aksionarit të vetëm (METE) për të kundërshtuar disponimet e tij në lidhje me çështje të posedimit dhe disponimit të aseteve të paluajtshme nën përgjegjësi dhe administrim të shoqërisë pasi përfaqësuesit ligjor (administratorit) i mungon interesi i ligjshëm në ngritjen e padisë”. Gjykata në vendimin e saj thekson se vendimet e aksionarit me të cilat hiqet dorë nga administrimi dhe përdorimi i sendeve të paluajtshme dhe urdhërohet përfaqësuesi ligjor të përmbushë këtë vendim, shprehin vullnetin e pronarit dhe janë të detyrueshme që të zbatohen nga përfaqësuesi ligjor edhe në rast se ato çënojnë interesat e shoqërisë duke qenë se aksionari i vetëm ka vepruar lirisht në ushtrim të tagrave të pronësisë në kuptim të nenit 149 të Kodit Civil. Për më tepër, në kuptim të nenit 145 (3) të LShT, gjykata arsyeton se përfaqësuesi ligjor nuk mund të kundërshtojnë në gjykatë vendimin e aksionarit të vetëm me të cilat disponohet për ndryshime në të drejtat, që lidhen me posedimin e sendeve të paluajtshme në rastin konkret të shoqërisë dhe për të cilat do të kërkohej miratimi i aksionarit përkatës (që në këtë rast është dhe aksionari i vetëm).

Pra, i takon aksionarit të vetëm të vendosë në lidhje me ndryshime në të drejta, e sidomos në kufizime mbi to, duke i lënë kështu dhe diskrecion në lidhje me interesat e tij.

Në një lexim të gjerë, të vendimit po dhe të nenit 145 (3), disponimi dhe posedimi i aseteve të paluajtshme pra i përkasin aksionarëve të cilët shprehen nëpërmjet asamblesë të thirrur

dhe të mbledhur rregullisht në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore. Në rast se nuk do të kishim një aksionar të vetëm, atëherë kushti i qenësishëm do të qe dhe miratimi i aksionarit përkatës. Vendime të kësaj natyre nuk legjitimojnë përfaqësuesin ligjor për të vepruar përveç kur e cënojnë atë personalisht. Në analizë përsa kohë që ortakët /aksionarët janë pronarët e shoqërisë, ata ndikojnë në asetet e shoqërisë dhe vendimmarrjet që lidhen me to. Por ky ndikimi mund të jetë më i madh në shoqëritë me një ortak /aksionar, apo vlen më shumë për shumicat vendimmarrëse duke lënë kështu në hije aksionarët e pakicës, të cilët nuk mund të ndikojnë fare në këtë drejtim. Këtu vlen të theksohet rëndësia e rolit të legjislacionit tregtar që të garantojë se vendimet e APA-së do të jenë të drejta dhe të ligjshme dhe se do të trajtojnë në mënyrë të barabartë aksionarët. Nga ana tjetër, duhet pranuar që pronësia e shprehur në kuota/aksione, i bën përkatësisht ortakët/aksionarët, mbajtës të drejtash dhe detyrimesh të cilat i shquajnë ata dukshëm nga anëtarët e tjerë të grupeve të interesit.

KAPITULLI VII QEVERISJA E KORPORATËS

7.1 Klasifikimi i bizneseve

Bizneset klasifikohen sipas shkallës së aktivitetit, sektorëve të ekonomisë, formave të pronësisë dhe statusit ligjor¹⁴⁸.

- Klasifikimi sipas shkallës së aktivitetit lidhet me aktivitetin që zhvillon biznesi:

Biznesi i Aktivitetit primar (bizneset që operojnë në industrinë nxjerrëse, pra në stadin e parë të prodhimit, si industria minerare, naftënxjerrëse etj);

Biznesi i Aktivitetit sekondar (bizneset që operojnë në industrinë prodhuese dhe përpunuese, në stadin e dytë të prodhimit, si për shembull industria e prodhimit të automobilave, pasijeve elektro shtëpiake etj);

Biznesi i Aktivitetit terciar (bizneset që ofrojnë shërbime si bankat, shoqëritë e sigurimit, agjensitë turistike, arsimi, shëndetësia etj).

- Bizneset klasifikohen sipas sektorëve të ekonomisë, në sektorin privat dhe në atë publik.

Biznesi i sektorit privat janë ato biznese që janë pronësi të individëve, grupeve të individëve apo organizatave të tjera të biznesit private.

Biznesi i sektorit publik janë të gjitha firmat që janë në pronësi, kontrollohen, financohen prej shtetit nëpërmjet autoriteteve të tij qendrore ose lokale. Madhësia e sektorit publik përcaktohet nga qeveria, politikat dhe strategjitë e saj dhe ndryshon dukshëm nga njëri shtet në tjetrin, ashtu dhe në periudha të ndryshme. Literatura mbi përcaktimin e madhësisë së

¹⁴⁸ Është marrë për bazë klasifikimi i bërë nga Llaci, 20006.

sektorit publik është shumë e madhe dhe daton që në shekullin XIX me ligjin e Wagner¹⁴⁹ (1877-1890) (Katsimi 1998:117). Ndodh që sektorë të caktuar të ekonomisë mund të kalojnë nga sektori publik në atë privat dhe anasjelltas ose të rezultojnë edhe në pronësi të përbashkët, ku shteti mund të mbajë paketën kontrolluese të aksioneve ose jo.

Objektivat e aktivitetit në sektorin publik janë:

Aksesi për të gjithë qytetarët;

Cilësia në ofrim;

Mundësia për t'i siguruar shërbimet dhe

Barazia në ofrim pa diskriminim;

- Klasifikimi sipas formave të pronësisë:

Biznes individual (me një pronar), si formë më e vjetër dhe më e thjeshtë;

Ortakëri (dy ose më shumë persona individë dhe / ose juridikë)

- Klasifikimi sipas statusit ligjor:

Person fizik ose Person juridik

Biznesi ndikohet, vepron dhe ndërvepron në kushtet e mega mjedisit dhe të mikromjedisit.

Mega mjedisi, apo mjedisi i përgjithshëm inkludon atë grup makrofaktorësh ose atë segment të mjedisit të jashtëm që pasyqron kushtet dhe tendencat e shoqërisë brenda së cilës vepron organizata e biznesit. Në këtë grup inkludohen një sërë faktorësh, ku më të rëndësishmit janë

¹⁴⁹ Sipas <https://www.oxfordreference.com/view/10.1093/oi/authority.20110803120324615>: Një vëzhgim i bërë në shekullin e 19-të nga Adolph Wagner (1835–1917) nxorri në pah se pjesa e sektorit publik në prodhimin e brendshëm bruto ishte rritur me kalimin e kohës. Ligji i Wagner ishte parashikimi që kjo tendencë do të vazhdonte. Ligji bazohet në tre pretendime: rritja ekonomike rezulton në një rritje të kompleksitetit që kërkon futjen e vazhdueshme të ligjeve të reja dhe zhvillimin e strukturës ligjore; urbanizimi rrit eksternalitetet negative, siç janë mbipopullimi dhe krimi, të cilat kërkojnë ndërhyrje; dhe mallrat e furnizuar nga sektori publik kanë një elasticitet të lartë të kërkesës për të ardhura.

pesë: faktorët politiko - ligjorë, faktorët ekonomikë, teknologjikë, socialë dhe ndërkombëtarë (Llaci, 2006:34).

Në aspektin e faktorëve të mikromjedisit, ose siç quhet ndryshe mjedisi i afërt bëjnë pjesë të gjithë ata elementë, me të cilët organizata e biznesit bashkëvepron gjatë realizimit të aktivitetit të saj. Elementët kryesorë të mikromjedisit janë: klientët, konkurentët, furnitorët, fuqia punonjëse, sindikatat, partnerët, rregullatorët etj (Llaci, 2006:39). Duke marrë parasysh pikëpamjet dhe interesat e palëve të interesuara të saj, kompania duhet të jetë në gjendje të arrijë objektivat e tij me integritet dhe të ndihmojë për të arritur qëndrueshmërinë veprimtarisë së saj të terma afatgjatë (Mallin 2011:79).

Qeverisja e korporatës si koncept dhe si fushë problemore është diskutuar fillimisht në Shtetet e Bashkuara¹⁵⁰; më vonë debati European filloi në Mbretërinë e Bashkuar¹⁵¹. Që këtu, çështja e qeverisjes së korporatës nisi rrugëtimin në të gjitha shtetet moderne të industrializuara përfshirë, Australinë, Kinën dhe Japoninë (ECGI 170/2011:2). Thelbi i problemit të qeverisjes së korporatës qëndron në vetë natyrën e shoqërisë aksionare (Xhepa, 2010:59). Qeverisja e korporatës është një temë e vështirë që t'i qasesh (Nordberg, 2011:14). Në kuptimin më të gjerë termi mund të mbulojë të gjitha rregullat dhe kufizimet në vendimmarrjen e korporatave. Sipas Baker dhe Griffith (2007:516)¹⁵² qeverisja e korporatave është një koncept i gjerë së cilës literatura ligjore i ka dhënë një përkufizim të ngushtë.

¹⁵⁰ Në përmbajtjen që i japim sot, termi “qeverisje e korporatave” ka një histori prej jo më shumë se tre dekadash. Analistët e shtypit anglo – amerikan kanë treguar se realisht dhe në kuptimin modern, termi qeverisje e korporatës, doli në kohën e skandalit të Watergate-it. Pas mesit të viteve '70 opinionin publik zbuloi befas se korporatat më të mëdha amerikane ishin përfshirë në afera korruptive brenda dhe jashtë vendit (Llaci, 2012:57)

¹⁵¹ Qeverisja bashkëkohore e korporatës në Mbretërinë e Bashkuar filloi në 1992 me Raportin Cadbury, i cili erdhi si pasojë e falimentimit të disa kompanive të mëdha. Raporti u mor kryesisht me mbrojtjen e aksionarëve të pakicës ndaj drejtorëve dhe administratorëve të cilët kishin interesa në shoqëri.

¹⁵² Tom Baker & Sean J. Griffith, *Predicting Corporate Governance Risk: Evidence from the Directors' and Officers' Liability Insurance Market*, 74 U. CHI. L. REV. 487, 516 (2007).

Studiuesit e diskutojnë atë më së shpeshti në kontekstin e reformave specifike rregullatore ose në kuptimin e dispozitave të statutit dhe karakteristikave të tjera strukturore lehtësisht të vëzhgueshme. Sot qeverisja e korporatës ka marrë një kuptim më specifik.

Sipas Bainbridge (2014), çdo model i qeverisjes së korporatës duhet t'i japë përgjigje dy pyetjeve bazike: *Kush vendos?* dhe *Interesat e kujt mbizotërojnë?* Çështjet organizative dhe struktura vendimmarrëse e korporatës në një shkallë domethënëse janë produkt i të drejtës tregtare (Nesteruk, J. J Bus Ethics (1991) 10: 723. <https://doi.org/10.1007/BF00705878>).

Në mënyrë të përmbledhur, problemi i qeverisjes së korporatës përmbahet në paragrafin e Adam Smith në veprën “Pasuria e kombeve”, 1776: *“Nga drejtuesit e shoqërive të tilla, duke qenë manaxherë më tepër të parave të tjerëve sesa të tyre, nuk mund të pritet që ata do të kujdesen për to me të njëjtën vigjilencë me të cilën zakonisht kujdesen partnerët në një partneritet privat...”*. Smith vazhdonte më tej duke theksuar se investitorët nuk mund t'ia besojnë kursimet e paratë e tyre palëve të treta, që ishin manaxherët. Kjo mund të vlente vetëm në fusha të caktuara si furnizimet me shërbime utilitare për të cilat nuk kërkoheshin aftësi të spikatura manaxheriale. Të lësh jashtë kontrollit drejtuesit e lartë të kompanisë është fundi i përgjegjësisë së sipërmarrjes (Xhepa, 2010:58).

Ky problem, i njohur sot si konflikti i përfaqësuar – përfaqësuesi /agjenti mes aksionarëve dhe drejtuesve, ka qenë një sfidë për të drejtën tregtare dhe ligjbërësit që në fillimet e korporatës moderne në shekullin XIX. Përpjekjet për ta minimizuar këtë konflikt kanë arritur një sukses të kufizuar, ashtu si dëshmojnë gjerësisht herë kodifikimet shtrëuese¹⁵³, herë aktet ligjore të njëpasnjëshme¹⁵⁴ (ECGI 170/2011: 2).

¹⁵³ Si për shembull, Australia, 2001, Mbretëria e Bashkuar, 2006 etj.

¹⁵⁴ Si për shembull Gjermani me 68 reforma të Ligjit për shoqëritë aksionare, 1965

Qeverisja e korporatave mund të referohet më gjerësisht në çdo aspekt të sistemit të stimuljeve dhe kufizimet që operojnë brenda një firme. Përdorimi i saj lidhet me nevojën për të kufizuar menaxherët për të vepruar në interesin më të mirë të aksionerëve, të paktën në korporatën publike. Me fjalë të tjera, qeverisja e korporatave është një përgjigje ndaj problemet e agjencisë të krijuara nga ndarja e pronësisë dhe kontrollit, domethënë aksionarët e pafuqishëm dhe menaxhimi autonomy (Wells, 2010:1252).

Sipas Sale (2004:460): “Termi "qeverisja e korporatave" është përdorur gjerësisht për t'iu referuar balancës së pushtetit mes drejtuesve, drejtorëve dhe aksionarëve. Akademikët shpesh e diskutojnë atë në kontekstin e rregullimit të komunikimit. dhe luftimin e kostove të agjencive kur drejtuesit e korporatave dhe drejtorët kanë fuqinë për të kontrolluar kompaninë, por pronarët janë aksionerë të ndryshëm dhe kryesisht joaktive. Mirëqeverisja e korporatave, atëherë, lejon një ekuilibër mes asaj që bëjnë drejtuesit dhe drejtorët dhe asaj që dëshirojnë aksionarët. Termi nënkupton që menaxherët kanë stimujt e duhur për të punuar në emër e aksionarëve dhe që aksionarët janë të informuar siç duhet për aktivitetet e menaxherëve”.

Sipas Fox dhe Heller (2000:1722) firmat tregojnë qeverisje të mirë korporative kur të dyja maksimizojnë – pasurinë e krijuar nga operacionet reale të firmës - dhe, në rastin e firmave investuese, shpërndajnë pasurinë e prodhuar në mënyrë proporcionale për aksionarët.

Ndërsa përkufizimet variojnë në forma të ndryshme sipas studiuesve të ndryshëm, shumë e vënë theksin te nevoja për mekanizma për të minimizuar problemet e krijuara nga ndarja e pronësisë dhe kontrollit.

Pra, në një botë aksionesh të shpërndara dhe "kryesisht joaktive", qeverisja e korporatës pyet se cilat mekanizma ligjorë, ekonomikë dhe social, mundën më së miri të detyrojnë agjentët

e tyre, menaxherët e korporatës, jo vetëm për të drejtuar korporatën mirë, por edhe për ta drejtuar atë në dobi të aksionarëve dhe jo të vetes së tyre (Wells, 2010:1252)¹⁵⁵.

Sternberg (1998) jep një përkufizim të qartë në favor të këtij orientimi: "Qeverisja e korporatës përshkruan mënyrat për të siguruar që veprimet, asetet dhe agjentët e saj të drejtohen në arritjen e objektivave të korporatës të vendosur nga aksionerët e korporatës". Por përkufizimet si më sipër kanë në fokus vetëm një shqetësim: përfitimin e aksionarëve, ndërkohë që lënë pa përfshirë, përmendur dhe adresuar realitetin social të shoqërisë dhe grupeve të interesit të përfshirë në të.

Mitchell (1992, 1995) në veprat e tij kritikon ashpër maksimizimi e figurës së aksionarëit në të drejtën tregtare. Madje ai (2001) shkon më tej dhe shprehet: "E drejta tregtare amerikane i injoron punëtorët. Ata nuk figurojnë në strukturën e korporatës ose në detyrat e saj ligjore. Por nuk ka asnjë grup njerëzish të identifikuar më shumë me një korporatë dhe me më shumë përgjegjësi për sjelljen e saj të përditshme sesa punonjësit e korporatave.

Të njëjtin qëndrim mbajnë dhe den Berghe dhe de Ridder të cilët argumentojnë për evoluimin e modelit demokratik të qeverisjes së korporatës¹⁵⁶, i cili do të karakterizohet nga:

- (a) punonjësi i fuqizuar si rezultat i revolucionit të komunikimit;
- (b) një zhvendosje e pushtetit nga aksionarët te punonjësit e pajisur me njohuritë e duhura;
- (c) vlera të përbashkëta (Farrar, 1999: 274).

Përcaktimet e ngushta dhe të gjera të qëllimit të qeverisjes së korporatës mund të shihen që i përkasin dy ekstremeve (Gorezi, 2011: 13). Nga njëra anë qëndrojnë advokuesit e teorisë së

¹⁵⁵ Diskutimi trajtohet nga Jonathan Macey, *Corporate Governance: Promises Kept, Promises Broken* vii (2008)

¹⁵⁶ Ky model, i cili dallon nga modeli Anglo – Amerikan që është i orientuar drejt aksionarëve, mbart deri diku vlerat e modelit European dhe atij Japonez, duke kthyer sytë tashmë nga punonjësi deri tani i lënë mënjanë.

aksionarëve sipas të cilëve korporata duhet të administrohet në përfitim të aksionarëve. Nga ana tjetër janë ata të cilët besojnë se korporata duhet të administrohet sipas interesave të grupeve të interesit, përfshirë dhe komunitetin (Gorezi, 2011: 13).

Modeli anglo – amerikan apo modeli liberal, sikurse thuhet shpesh, tenton t'i japë prioritet aksionerëve. Ndërsa *modeli i koordinuar*, (modeli i Rinelandit) i cili gjendet në vëndet e Europës kontinentale dhe Japoni, ka në qendër të vëmendjes edhe interesat e punëtorëve, manaxherëve, furnitorëve, klientëve dhe komunitetit, apo e thënë ndryshe modeli i orientuar nga pretendentët (*stakeholders-it*) (Llaci, 2012:449). Secili prej modeleve adreson në mënyra të ndryshme pyetjen që është në themel të qeverisjes: *Kush vendos? dhe Interesat e kujt mbizotërojnë?*

Modeli që ka në fokus aksionarët dallon për:

- Prirjen e kontrollit nga aksionarët;
- Aksionarët në cilësinë e pronarëve priren të kenë pozicione drejtuese në borde/këshilla apo në pozicione të larta drejtuese;
- Marrëdhënia mes aksionarëve dhe manaxhimit janë më të ngushta;

Modeli që ka në fokus grupet e interesit dallon për:

- Varësia dhe lidhja me rregullimet e tregut;
- Mungesa e një marrëdhënieje të ngushtë aksionar – manaxhim;
- Prioritizimi i grupeve të interesit;

E thënë shkurt, modeli tradicional anglo – amerikan i qeverisjes së korporatës orientohet në kahun e siguruesit të kapitalit (investitori), ndërsa modeli europian kontinental orientohet në kahun e palëve të interesuara, pasi pranohet se dhe aktorë të tjerë, përveç siguruesit të

kapitalit (kryesisht, punëmarrësit dhe kreditorët), luajnë njëfarë roli kyç në drejtimi e shoqërisë tregtare (Dine, Bletcher, 2016: 10). Të dy sistemet janë objekt i një debati shumë të madh, por të dy modelet ndodhen nën “trysni”, pasi asnjëri prej tyre nuk ka arritur të krijojë imunitet ndaj kolapseve apo skemave mashtruese (Dine, Bletcher, 2016:11)¹⁵⁷.

Përcaktimi i termit korporatë dhe përkufizimi i qeverisjes së korporatave nuk është unik. Këto përkufizime që përfaqësojnë këndëvështrimet dhe perspektivat e traditave ligjore të vendeve përkatëse, të autorëve dhe juridiksioneve të ndryshme ku ato aplikohen, përafrohen në disa parime të përbashkëta. Një përcaktim mjaft i ngushtë i qeverisjes së korporatave është dhënë nga Shleifer dhe Vishny (1997): “Qeverisja e korporatës merret me mënyrat me të cilat furnizuesit e financave për korporatat sigurohen që të marrin një kthim të investimit të tyre” (Mallin, 2013:7)

Sipas OECD (1999), qeverisja e korporatave është mjeti i brendshëm me atë të së cilit korporatat veprojnë dhe kontrollohen [...] në të cilin përfshihen një sërë marrëdhëniesh të manaxhimit të një shoqërie, të bordit të saj, të aksionarëve të saj dhe aktorëve të tjerë (grupeve të interesit). Ajo gjithashtu siguron strukturën përmes së cilës vendosen objektivat e kompanisë, dhe përcaktohen mjetet për arritjen e këtyre objektiveve, dhe monitorimin e performancës. Të njëjtin qëndrim kishte mbajtur edhe Raporti Cadbury në vitin 1992¹⁵⁸ duke

¹⁵⁷ Për më shumë shih Dine J, Bletcher M. “Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, teksti me shpjegime, version i rishikuar, prill 2016, botim GIZ: “... të dy sistemet janë tronditur nga skandalet. Në SHBA kodet ekzistuese të etikës nuk arritën ta shmangnin keqadministrimin dhe mashtrimin brenda shoqërisë ENRON; në Gjermani bashkëvendosja midis drejtuesve dhe punëmarrësve nuk arriti të pengojë bashkimet, ligjërisht të dyshimta mes shoqërive (p.sh. rasti MANNESMAN) dhe as pasurimin e paligjshëm të administratorëve (p.sh. rasti SIEMENS), ndërsa në Itali qëndrimi pozitiv i disa bankave të rëndësishme europiane bëri që publiku të kishte besim te administrimi i shoqërisë PARMALAT, pavarësisht faktit se kjo shoqëri po shkonte drejt falimentimit dhe brenda saj po kryeshin “veprime tregtare të paligjshme” (faqe 11). Rasti Enron në mënyrë domethënëse tregoi se qeverisja e mirë e korporatës varet nga një bashkëveprim i balancuar mes mjeteve të dallueshme të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm (Hopt, Leyens, 2004:3).

¹⁵⁸ Komiteti Cadbury u krijua në vitin 1991 në Mbretërinë e Bashkuar nisur nga shqetësimet rreth standardeve të raportimit financiar dhe llogaridhënies dhe me qëllim të marrjes së një qëndrimi mbi rolin e drejtuesve

e përcaktuar si: "Tërësia e rregullave që përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet aksionarëve, manaxherëve, kreditorëve, qeverisë, punonjësve dhe pretendentëve të tjerë të brendshëm dhe të jashtëm në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, ose si *sistemi me anën e të cilit drejtohen dhe kontrollohen kompanitë*" (Llaci, 2012:63). Qeverisja e korporatave merret me mbajtjen e ekuilibrit mes qëllimeve ekonomike dhe sociale dhe midis qëllimeve individuale dhe të përbashkëta. . . qëllimi është që të përafrohet sa më shumë që të jetë e mundur interesat e individëve, korporatave dhe shoqërisë" (Cadbury 1999).

Nisur nga përcaktimet e mësipërme për qeverisjen e korporatave shihet se ajo synon të trajtojë jo vetëm marrëdhënien me aksionarët dhe aspektet e rregullimit të brendshëm të një shoqërie tregtare po dhe marrëdhënien me grupet e interesit, përfshirë aksionarët.

Në thelb qeverisja e korporatave është struktura që synon të sigurohet se bëhen pyetjet e duhura dhe që funksionojnë kontrollet dhe balancat për të garantuar se përgjigjet reflektojnë çfarë është më e mira në krijimin e vlerave afatgjata të qëndrueshme për shoqërinë (Monks & Minoë 2003:1). Proceset që përbëjnë qeverisjen shtrihen përtej nocionit të administrimit të shoqërisë (Malltezi, 2010:133).

Qeverisja e korporatës ka si shtylla mbështetëse respektimin e ligjit nga ana e kompanive; përgjegjësinë dhe llogaridhënien e strukturave të kompanisë para aksionarëve, grupeve të interesit dhe organeve të kontrollit jashtë kompanisë; trajtimin e barabartë të aksionarëve dhe garantimin e ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga pronësia mbi aksionet; transparencën e

ekzekutivë dhe jo-ekzekutivë në korporata. Komiteti miratoi një "Kodin e praktikave më të mira mbi Aspektet Financiare të Qeverisjes së Korporatave" në vitin 1992. Megjithatë vullnetar, Kodi është pjesë e kërkesave të listimit në Bursën e Londrës, dhe shoqëritë në Britaninë e Madhe, duhet të bëjnë deklaratën e përputhshmërisë në lidhje me Kodin dhe të japin arsytet për ndonjë mospërputhje.

aktivitetit të kompanisë para aksionerëve, grupeve të interesit dhe publikut të gjerë sipas masës që përcakton ligji (Malltezi, 2010:133).

Pra, në thelb parimet e një qeverisjeje të mirë janë përgjegjësia, ndershmëria, konfidencialiteti, transparenca dhe hapja e informacionit.

Rëndësia e qeverisjes së korporatës u bë mëse e qartë në vitin 2002 kur një sërë shkrirjesh, mashtrimesh dhe katastrofa të tjera çuan në shkatërrimin e pasurisë prej miliarda dollarësh të aksionarëve, humbjen e mijërave vendeve të punës, ndjekjen penale të një sërë ekzekutivësh dhe një numër rekord në shpalljen e falimentimit (Monks & Minow 2003, f.1).

Një nga arsyet pse këto skandale u bënë ngjarjet më të famshme të vitit ishte fakti që çdo mekanizëm i krijuar për të kontrolluar dhe balancuar kishte dështuar në të njëjtën kohë.

Pikërisht në këtë kohë të gjithë i kthyen sytë nga qeverisja e korporatave. Qeverisja e korporatave prej mëse dy dekadash është bërë pjesë e realitetit ekonomik edhe e vendeve të Europës Lindore (Llaci, 2012: 2).

7.2 Sistemet e qeverisjes

Zhvillime të ndryshme ekonomike në vitet 1980-90 të rritën vetëdijen mbi rëndësinë e dallimeve midis ekonomive politike kombëtare (Gilpin, 2001:133). Sistemi i qeverisjes së korporatave dhe i praktikave të biznesit privat përbë një komponent tjetër të rëndësishëm të një ekonomike politike kombëtare (Gilpin, 2001:134). Debati për qeverisjen e korporatës, përtej modeleve për t'u marrë, mund të shihet dhe në nivelin e çdo shoqërie tregtare ashtu si dhe në nivel vendi, duke marrë kështu përmasat e një sistemi.

Franks dhe Mayer (1992) propozuar ndarjen në dy sisteme: sistemi *outsider* dhe *insider*.

Sistemi outsider ishte dominues në Mbretërinë e Bashkuar dhe në ShBA, ku karakteristike janë numër i madh kompanish të listuara në bursë, përqendrim i ulët i pronësisë, treg kapitali me likuiditet të madh.

Sistemi Insider i atribuohet kryesisht Europës dhe Japonisë, të cilat karakterizoheshin nga një numër i vogël kompanish të listuara në bursë, një nivel i lartë i përqendrimit të pronësisë (aksioneve) në duart e korporatave, institucioneve, familjeve ose dhe vetë shtetit, dhe treg kapitalesh me likuiditet të ulët. Megjithatë edhe vetë brenda dy sistemeve dhe sidomos sistemit *insider*, ekzistonin dallime. Secili nga sistemet e Europës kontinentale kanë në një masë të ndryshme disa elementë të sistemit *outsider*. Nga këndvështrimi ligjor, disa janë shumë afër sistemit anglez, por janë në të njëjtën kohë shumë të ndryshme në zhvillimin e tregjeve financiare. Dy nga sistemet më të mbyllura, Zvicra dhe Japonia, kanë një numër të madh të Kompanive të listuara në bursë dhe një kapitalizim të lartë të tregut të aksioneve (CEPS Ëorking Report No. 12, 1995:7). Korporatat amerikane, gjermane, japoneze kanë sisteme qeverisjeje mjaft të ndryshëm nga njëri – tjetri, dhe në kuadrin e tyre, veprimtaritë ekonomike (prodhimi, marketingu etj.), organizohen në mnëyra të ndryshme (Gilpin, 2001:134).

Weimer dhe Pape (1999) ishin ndër të parët të cilët propozuan klasifikimin e sistemeve të qeverisjes së korporatës të vendeve të industrializuara në katër grupe: modeli anglosakson, gjerman, latin dhe japonez. Klasifikimi u bazua në tetë karakteristika të cilët përfshinin: konceptin e firmës në nivel kombëtar¹⁵⁹, modelin e bordit (një nivel dhe /ose me dy nivele),

¹⁵⁹ Koncepti i firmës përfshin një numër elementesh thelbësorë: firma si një lojtar i moralshëm, si pronar i përgjegjësive ekonomike, sociale dhe mjedisore, që lidhet me aktorët e tjerë në nivele të ndryshme dhe si një operator në një horizont pasigurie dhe ndryshimi. Supozohet se të gjitha këto aspekte që përbëjnë firmën janë të ndërlidhura dhe mund të artikulohen në nivele të ndryshme.

rëndësinë e tregjeve të bursës në ekonominë kombëtare, aktorët e spikatur që mund të ushtronin ndikim në vendimmarrjen menaxheriale, prania ose mungesa e një tregu të jashtëm për kontrollin e korporatave (procesi me të cilin pronësia dhe kontrolli i kompanive të listuara në bursë transferohej nga një grup investitorësh dhe drejtuesit tek një tjetër), struktura e pronësisë përsa i përket përqëndrimit të pronësisë (prania dhe / mungesa e aksionarëve të mëdhenj) dhe identiteti i aksionarëve (individë, banka, institucione të tjera financiare, institucione jofinanciare, shteti, vendas, të huaj), shkalla në të cilën kompensimi i drejtuesve varej nga performanca e korporatave.

7.3 Mekanizmat në kontekstin e qeverisjes së korporatës

Në parim, dy mekanizma të dallueshëm për kontrollin e korporatave mund të shquhen: kontrolli i jashtëm nëpërmjet tregut dhe kontrolli i brendshëm nëpërmjet bordeve të shoqërisë (Walsh, Seward, 1990). Kërkimet mbi qeverisjen moderne të korporatës synojnë që të reflektojnë ndryshimin e kushteve duke shquar sistemet e kontrollit të brendshëm – i cili kryesisht mbështetet në mekanizma kontrolli të brendshëm të institucionalizuara¹⁶⁰ dhe – sisteme kontrolli të jashtëm – të cilat janë kryesisht të bazuara te fuqia e jashtme kontrolluese e tregut¹⁶¹ (Hopt, Leyens, 2004:3).

Në një kontekst më të zgjeruar sipas disa studiuesve mekanizmat e kontrollit të brendshëm shihen në kontekst të pronarëve ose bordeve dhe aftësisë së tyre për të kontrolluar drejtuesit dhe drejtorët e shoqërisë, pra manaxhimin e saj, përfshirë këtu komitet e ndryshme të

¹⁶⁰ Modeli evropian

¹⁶¹ Sistemi anglo – sakson ose si njihet ndryshe sistemi anglo – amerikan i qeverisjes së korporatës dallohet si një sistem i bazuar te tregu.

krijuara, programet e shpërmbimit me synimin për të harmonizuar interesat e aksionarëve dhe drejtuesve. Disa autorë të tjerë i përcaktojnë si “tërësia e stimuljeve të destinuara për përmirësimin e vendimmarrjes dhe kontrollit” (Llaci, 2012:59).

Në mekanizmat e kontrollit të jashtëm, krahas fuqisë kontrolluese të tregut ku operon shoqëria dhe tregut të punës për vetë drejtuesit (një performancë e mirë e shoqërisë, është një vlerë e shtuar për drejtuesin dhe kuotimin e tij në tregun e punës si drejtues i mirë), përfshihen edhe legjislacioni i zbatueshëm ndaj shoqërisë në fjalë, standardet e kontabilitetit, raportimit dhe auditimit financiar, auditimi i jashtëm etj.

Qeverisja e Korporatës – Ndarja e pronësisë nga kontrolli

Qeverisja e korporatës dhe manaxhimi i saj janë dy anët e të njëjtës medalje. E thënë ndryshe, qeverisja e korporatës është sistemi operativ i korporatës (Gilson 2016:5). Prej më shumë se 400 vjetësh, e drejta tregtare është përpjekur të zgjidhë problemin e qeverisjes së korporatës, ndarjen e pronësisë nga kontrolli (Hopt, Leyens, 2004:2). Me fjalë të tjera, qeverisja e korporatave është një përgjigje ndaj problemit të agjencisë të krijuar nga ndarja e pronësisë dhe kontrollit, domethënë aksionarët e pafuqishëm dhe menaxhimi autonom (Wells, 2010: 1252).

Në SHBA, ndonëse zakonisht debati modern dhe bashkëkohor për qeverisjen e korporatës lidhet me botimin e veprës së Adolf A. Berle dhe Gardiner Means “The Modern Corporation and Private Property”, në vitin 1932, vepër e cila e vinte theksin në ndarjen e pronësisë nga kontrolli dhe problemet që sillte kjo ndarje, fillesat janë edhe më të hershme. Problemet e mundshme të ndarjes së pronësisë dhe kontrollit u identifikuan në shekulli i tetëmbëdhjetë nga Smith (1838) (Mallin, 2013: 17). Sipas Ferrer (1999) ndarja e pronësisë nga kontrolli

ishite parashikuar edhe nga Marksi në veprën e tij “Kapitali” dhe Lenini në veprën e tij “Ese mbi kapitalizmin”.

Në vitet '20 në Shtete e Bashkuara, qeverisja e korporatës kishte marrë një përmasë të re. Qeverisja e korporatës ishte kthyer në shqetësim publik, i cili kishte ngjallur dhe tërhequr interesin jo vetëm të profesorëve të ekonomisë dhe të drejtësisë po dhe të amerikanëve në përgjithësi, të cilët u njohën dhe më pas u zemëruan me konceptin e ndarjes së pronësisë nga kontrolli (Wells, 2010:1250).

Ndarja e pronësisë nga kontrolli në shoqëri ishte kthyer tashmë në çështje të ditës. Ka diskutime se kur u përdor për herë të parë ky term në Shtetet e Bashkuara dhe nëse mund t'i atribuohet një autori të vetëm. Herbert Hovenkamp e has këtë koncept të paktën te ekonomisti Alfred Marshall dhe juristi William W. Cook në vitet 1980 (Wells, 2010: 1251). Megjithatë përsa kohë që mënyra e organizimit dhe drejtimit të shoqërisë, ka krijuar apo ka dhënë shkas për lindjen e një konflikti mes investuesve dhe manaxherëve, atëherë qeverisja e korporatës ka ekzistuar si çështje. Historia ka treguar se këto konflikte nuk kanë munguar as në shoqëritë e para të mëdha, si për shembull konfliktet mes drejtorëve dhe aksionarëve në Shoqërinë Dutch East India, që në shekullin e XVII.

Shekulli XIX u bë dëshmitar i rritjes së sipërmarrjeve komplekse, gjigande në fusha të ndryshme të industrisë, duke nisur me hekurudhat. Pikërisht në vitet 1900 merr gjithmonë e më shumë formë dhe del në pah ndarja e pronësisë nga kontrolli në korporatën moderne. Fillimi i shekullit XX shënoi dhe njëherë këto ndryshime në organizimin dhe jetën e shoqërive të mëdha tregtare sidomos me zgjerimin e tregut të titujve dhe numrin në rritje të aksionarëve, të mëdhenj dhe të vegjël. Aksionarët e vegjël nga njëra anë shfaqeshin pak ose aspak të fuqishëm në aftësinë dhe mundësinë e tyre për të ndikuar të shoqëria tregtare. Nga

ana tjetër, pronësia e diversifikuar në shumë portofole të larmishëm bënte që drejtimi i shoqërisë të ishte tashmë në duart e drejtuesve dhe drejtorëve.

Në këto kushte, lindin dy pyetje:

A përputheshin interesat e aksionarëve të vegjël me interesat e aksionarëve të mëdhenj?

Dhe

A përputheshin interesat e synimet e aksionarëve me interesat dhe synimet e drejtuesve dhe drejtorëve të shoqërisë?

Ndërkohë këto vëzhgime dhe përfundime pasqyrohen dhe në shkrimet e kohës. Gjykatësi Brandeis (1914) nisur nga shpërndarja e madhe e pronësisë, thekson se: "... obligacionet dhe aksionet e korporatave më të rëndësishme janë në pjesën më të madhe. . . në pronësi, të investitorëve të vegjël, të cilët nuk marrin pjesë në menaxhimin e kompanisë". Kështu, ajo çka e shqetësonte më shumë Brandeis nga ndarja e kontrollit dhe pronësisë, ishte rreziku i korporatave gjigande për të dëmtuar publikun dhe pronarët e vegjël ndaj të cilëve konkuronin në treg dhe jo aksionarët (Wells, 2010:1257).

Lippmann (1913) foli gjithashtu për ndarjen e pronësisë nga kontrolli, ku theksoi se pasoja e kësaj ndarjeje do të ishte ndryshimi në vetë nocionin e pronësisë dhe pronës (Wells, 2010: 1257). Lippman nuk e shihte këtë ndarje si problem dhe aq më pak, ashtu si dhe Brandeis, të shqetësohej për aksionarët, të cilët nuk konsultohen për sa i përket menaxhimit të shoqërisë dhe në rast se do të pyeteshin, ata do të ishtin krejtësisht të paaftë për këshilla.

Sipas tij: "*kur dikush blen aksione në një korporatë të madhe, teorikisht ai bëhet një nga pronarët e saj. Por në fakt ai nuk mund ta shohë kurrë pronën e tij, nuk mund të dijë se ku është prona e tij. Proceset që e bëjnë atë të pasur në mëngjes dhe të varfër në mbrëmje, që rrisin të ardhurat e tij ose i zvogëlojnë ato, janë misteret e padepërtueshme. Askush nuk ka pasur ndonjëherë një lidhje më abstrakte me atë që kishte në pronësi*".

Prona private do të shkrihet, parashikoi ai. Funksionet e saj do të ndërmerren nga ana e njerëzve që paguhen, nga komisionet e qeverisë, [dhe] duke themeluar sindikatat. Aksionarët, të privuar nga të drejtat e tyre të pronësisë, po shndërrohen në huadhënës të parave (Wells, 2010: 1259).

Për Lippmann, ndarja e pronësisë nga kontrolli ishte një monent i mirëpritur në evolucionin shoqëror (Wells, 2010: 1259).

Pamja për të ishte e qartë: pushteti po përqëndrohej në duart e njerëzve të përzgjedhur nga pronarët e shoqërisë, njerëz të cilët do të paguheshin për punën që do të kryenin. Por ajo që ai shihte si më thelbësore ishte fakti se vetë drejtimi po ndryshonte duke kapërcyer sjelljen fitimprurëse të pronarëve – operacionalë dhe duke marrë përsipër një rol të ri shoqëror. Kjo sepse ku motivi i fitimit nuk është më motivi personal i drejtuesve. Ai besonte se menaxherët, të liruar nga aksionarët, do të liroheshin gjithashtu nga kërkesat e "sistemit të fitimit", dhe do të përdorin ekspertizën e tyre për t'u bërë "burra shteti industrialë", duke udhëhequr korporatat në interesin e shoqërisë (Wells, 2010: 1259).

Qëndrimi i Brandis dhe Lippman, që i vendoste aksionarët në plan sekondar, tregonte për dimensionin e ri që po formëzonte sjelljen e shoqërive tregtare, të organizimit dhe të manaxhimit të tyre. Kështu, madje para Luftës së Parë Botërore, ideja e dominimit menaxherial të korporatës dhe mungesa e pushtetit të aksionarëve ishte e pranishme në debatet publike, por në forma të ndryshme shpesh konfliktuale (Wells, 2010: 1261).

Para viteve '20, në ShBA, debati publik mbi korporatat u përqendrua në marrëdhëniet e korporatës në grupe jashtë korporatës - konsumatorët, konkurrentët, publiku në përgjithësi, që u përmbledh në konceptin e "problemi i besimit". Në vitet '20, vëmendja kishte filluar të zhvendosej tashmë në marrëdhëniet e korporatës me aksionarët e saj. Që në vitet 1890 e deri

në fillimet e Luftës I Botërore, autorë si Louis Brandeis, Walter Lippmann, dhe Thorsten Veblen u morën gjerësisht me konceptin e ndarjes së pronësisë nga kontrolli dhe të qeverisjes së korporatës.

Trendi i blerjes së letrave me vlerë kishte filluar të përshpejtohej gjatë Luftës së Parë Botërore, kur amerikanët blenë Obligationet Liberty për të financuar përpjekjet e luftës (Wells, 2010: 1265), tendencë kjo që u përka nga studiues të asaj kohe dhe u pa si një mjet lehtësues për problemet sociale pasi u jepte amerikanëve të zakonshëm pjesë në ekonominë në rritje të vendit. Kjo tendencë nxiti blerjen e bonove e aksioneve, sidomos në kompanitë e mëdha për punonjësit dhe klientët. Padyshim që efekti kryesor i rritjes së numrit të zotëruesve të aksioneve, ishte dhe shpërndarja e pronësisë. Në të njëjtën kohë kjo periudhë përkoj dhe me maksimizimin e rolit të aksionarëve në qeverisjen e korporatës dhe politikën ekonomike. Në vitin 1927, koncepti i ndarjes së pronësisë nga kontrolli dhe problemet që lindin prej saj u trajtuan gjerësisht në librin e William Z. Ripley “Main Street and Wall Street”. Zgjidhja për problemin që sillte ndarja e pronësisë nga kontrolli, për Ripley qëndronte te transparenca e informacionit. Dhënia e informacionit do t’i vinte në ndihmë aksionarit, i cili edhe sikur të zotëronte aftësitë personale për të vlerësuar të dhënat, do të mund të merrte “gjykimin e zgjuar të ekspertëve kompetentë”. Dhënia e informacionit e ngritur në nivel detyrimi shtetëror do të mbulonte “vlerën bruto të biznesit, koston e bërjes së tij, dhe sidomos politikën e mirëmbajtjes dhe amortizimit” .

Ripley merrte shkas nga kushtet aktuale ku vetëm disa shoqëri publikonin bilance të audituara dhe korporatat kishin pak ose aspak detyrim për të dhënë informacion te aksionarët. Mungesa e informacionit financiar dhe sidomos mungesa e shpjegimeve për rezultatet, qofshin këto pozitive apo negative në pasqyrat financiare, si dhe mungesa e standarteve të

unifikuara të kontabilitetit, ishin të gjithë elementë të cilët cënonin negativisht cilësinë dhe sasinë e informacionit që përcillej te aksionarët.

Rëndësinë e këtij informacioni për aksionarët, Ripley e shihte nga këndvështrimi i tyre si investues në shoqëri. Për Ripley-n, aksionarët nuk kanë dëshirë ose aftësi për t'u përfshirë në manaxhimin e korporatës. Aksionari mesatar është tërësisht i pakualifikuar për t'u angazhuar në mënyrë aktive në manaxhim. Dhe as informacioni dhe fuqia e tij nuk do të ishin në ndihmë në këtë rast për të përmirësuar aftësitë e tyre si drejtues. Përkundrazi, përfitimi i aksionarëve nga informacioni i mirë, i saktë dhe i plotës, do të ishte mbrojtja e interesve ekonomike në mënyrë indirekte.

Për shkak të Ripley dhe të tjerëve, nga vitet 1920 orientimi i të drejtës tregtare u zhvendos nga shqetësimi për fuqinë e korporatave ndaj të huajve siç janë konsumatorët dhe konkurrentët, te shpërndarja e pushtetit brenda korporatës, pasi mbrojtja e aksionarëve u bë një shqetësim kryesor për të drejtën dhe teorinë e korporatave (Wells, 2010: 1292).

Me botimin e veprës "The Modern Corporation" të Berle dhe Means në 1932, ndarja e pronësisë nga kontrolli u kthye në kryefjalë të qeverisjes moderne të korporatës. Për Berle and Means, mbrojtja e aksionarëve gjendej më vetëm brenda shoqërisë por ajo mund të bëhej dhe në gjykatë. "The Modern Corporation" u mbyll me një vizion më profetik - një nga qëllimet e sipërmarrjes private, braktisja e motivit të fitimit dhe transformim i kontrollit të korporatës nga një klikë egoiste në një "teknokraci të thjeshtë neutrale, duke balancuar një shumëllojshmëri të kërkesave nga grupe të ndryshme në komunitet dhe caktimit të secilit të një pjesë të të ardhurave në bazë të politikës publike dhe jo të lakmisë private (Wells, 2010: 1291).

Duke iu referuar historisë, periudha nga vitet 1960 deri në vitet 1980 përfaqëson epërsinë që merr manaxhimi i shoqërisë. Nga njëra anë vihej theksi te nevoja për të mbajtur nën kontroll manaxhimin e shoqërisë, duke vendosur detyrimin e besimit dhe përgjegjësisë në nivel ligji e statuti të shoqërisë. Nga ana tjetër vlerësohej roli i forcave ekonomike dhe tregut si fuqi rregullatore. Ekzistonte besimi se ndarja e pronësisë nga kontrolli dhe rritja e numrit të aksionarëve duke e shpërndarë pronësinë, do të rriste në raport të drejtë dhe përgjegjësinë e drejtuesve të shoqërisë ndaj aksionarëve.

Në treg nuk konkuronin vetëm produktet dhe shërbimet që ofronte një shoqëri po dhe vetë manaxhimi i saj. Përsa kohë që shoqëria do të kishte nevojë të thithte kapital investues, (kjo në rastin e shoqërive publike), investitorët nuk do të mbështesin shoqëritë e manaxhuara keq. Në këtë mënyrë do të ishte tregu, gjithmonë i padukshëm, që do të bënte rolin e “vlerësuesit”. Rënia e tregut të aksioneve që pasoi në tetor 1987, e njohur në histori si “E Hëna e Zezë”, ishte një goditje për stabilitetin e sistemit financiar, jo vetëm për shkak të vlerës së rënies së çmimit, por më e rëndësishmja për shkak se funksionimi i tregut ishte dëmtuar ndjeshëm.

Në vitin 1999, OECD publikoi Parimet e Qeverisjes së Korporatave, kodi i parë ndërkombëtar i mirëqeverisjes së korporatës të miratuar nga qeveritë. Këto parime fokusoheshin te shoqëritë me ofertë publike dhe kanë për qëllim t'i ndihmojnë qeveritë në përmirësimin e kuadrit ligjor, institucional dhe rregullator që mbështetet në qeverisjen e korporatave. Ndoshta në mënyrë më agresive, në 1997 gjatë krizës financiare të Azisë Lindore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore përfshinë reformën e qeverisjes së korporatave si kusht për ndihmë krahas kufizimeve tradicionale makroekonomike siç është ulja e deficitit (Gilson, 2016:3).

7.5 Qeverisja e korporatës në Europë - Modelet e qeverisjes në Europë

Në Europë, qeverisja e korporatës nuk qe ende një disiplinë kërkimi para fundit të mijëvjeçarit të fundit (Hopt, Leyens, 2004: 2). Megjithatë debati mbi qeverisjen e korporatës dhe sistemeve të saj, është gjithashtu i ndikuar nga rrethanat historike dhe nuk mund të vlerësohet i shkëputur nga ky kontekst. Po ashtu edhe sistemet e qeverisjes së korporatës duhet të shihen në kontekstin e shoqërisë në të cilën krijohen dhe funksionojnë.

Qasja e ShBA ndaj qeverisjes së korporatës u ndikua nga disa zhvillime kryesore gjatë shekullit të kaluar si çështja anti trust në fund të shekullit XIX, kriza ekonomike e viteve '30 etj. Në mënyrë të përmbledhur për ShBA mund të themi se nevoja për kapital, përtej kapacitetit të themeluesve dhe kufizimeve të vëna ndaj institucioneve financiare si investitorë, solli shpërndarjen e pronësisë dhe gradualisht ndarjen e pronësisë nga kontrolli. Kjo bëri që kontrolli tashmë t'i besohej personave të kualifikuar me aftësitë përkatëse, si profesionistë të punësuar, në disa raste dhe zotërues paketash modeste aksionesh. Pra, historia e korporatës në ShBA u dallua për pronësi të shpërndarë dhe manaxhim të përqëndruar.

Europa, nga ana tjetër u karakterizua me një pronësi të përqëndruar të shoqërive tregtare, ndonëse edhe brenda këtij modeli shtete të ndryshme kanë patur karakteristika të ndryshme. Modeli i qeverisjes së shoqërisë, mënyra e organizimit të bordeve (këshillave) janë elementë shumë të rëndësishëm për qeverisjen e korporatës. Mënyra e organizimit të bordit ndikon te natyra dhe detyrimet e drejtorëve, te përgjegjësitë e tyre dhe mund të ndikojnë dhe kërkesën e llogarisë së bordit ndaj drejtuesve. Europa është unike në larinë e madhe të strukturave

të bordeve (IFC 2015: 37). Klasifikimet tipike janë: modeli me një nivel, modeli me dy nivele dhe modeli Nordik¹⁶² të cilët trajtohen në vijim.

7.5.1 Modeli i sistemit me një nivel

Modeli i sistemit me një nivel zakonisht ka drejtues ekzekutivë dhe jo ekzekutivë. Bordi është përgjegjës për të gjitha aspektet e aktivitetit të shoqërisë dhe të gjithë drejtuesit kanë detyrimin që të sigurojnë prosperitetin dhe suksesin e shoqërisë. Drejtuesit zgjidhen nga mbledhja e përvitshme e asamblesë së aksionarëve. Në Bashkimin Europian 8 shtete kanë këtë model¹⁶³.

7.5.2 Modeli me një nivel në Mbretërinë e Bashkuar

Qasja rregullatore në Mbretërinë e Bashkuar në lidhje me bordet është më fleksibël, duke u prirur më shumë drejt një qasje vetë rregullatore nisur nga diskrecioni që jep Ligji për Kompanitë 1985 (Companies Act 1985). Sipas tij (seksioni 8 (1), shoqëritë janë të lira që të miratojnë rregullat në lidhje me emërimin dhe shpërblimin e drejtuesve kurse dispozitat detyruese lidhen me shkarkimin dhe përgjegjësitë e tyre, dy elementë shumë të rëndësishmë në krijimin e kushteve për të siguruar eficiencë dhe qëndrueshmëri të drejtuesve. Modeli i qeverisjes me një nivel në Mbretërinë e Bashkuar përqëndron drejtimin dhe kontrollin në duart e bordit të drejtorëve të cilat janë të veshur me pushtet universal (Hopt, Leyens, 2004:11).

¹⁶² IFC 2015 :37(A Guide to Corporate Governance Practices in the European Union http://www.ifc.org/wps/wcm/connect/c44d6d0047b7597bb7d9f7299ede9589/CG_Practices_in_EU_Guide.pdf?MOD=AJPERES)

¹⁶³ Shih Shtojcën 1.

Tipare të dallueshme të këtij modeli në Mbretërinë e Bashkuar janë¹⁶⁴:

Dallimi mes drejtorëve ekzekutivë të cilët punësohen si drejtues dhe drejtorëve jo ekzekutivë të cilët nuk përfshihen në administrimin e përditshëm të shoqërisë;

Ndarja dhe dallimi i pozicionit të kryetarit të bordit nga ai i drejtorit ekzekutiv (CEO) që lidhet ngushtësisht me ndarjen mes drejtimit (drejtorët ekzekutivë) dhe kontrollit (drejtorët jo ekzekutivë të kryesuar nga kryetari i bordit); Të gjithë drejtorët – ekzekutivë ose jo – kanë të njëjtat detyrime ndaj shoqërisë (Hopt, Leyens, 2004:11). Qeverisja e korporatës mbështetet kryesisht të rreziku i largimit me vendim të asamblesë së zakonshme të aksionarëve sidomos në rastin e ndryshimit të kontrollit të shoqërisë, kurse përsa i përket detyrimit të besnikërisë, rëndësi i kushtohet parandalimit të konfliktit nëpërmjet standardeve të pavarësisë (Hopt, Leyens, 2004:11). Bashkëvendosja është pothuajse e panjohur për të drejtën tregtare në Mbretërinë e Bashkuar¹⁶⁵.

Nisur nga kjo, Raporti Cadbury (1992) do të theksonte në hyrjen e tij: *“Ekonomia e vendit varet nga nxitja dhe efikasiteti i kompanive të saj. Kështu, efektiviteti me të cilin bordet kryejnë përgjegjësitë e tyre përcakton pozicionin konkurrues të Britanisë. Ata duhet të jenë të lirë t'i drejtojnë kompanitë e tyre përpara, por ta ushtrojnë këtë liri brenda një kuadri përgjegjësie efektive. Ky është thelbi i çdo sistemi të qeverisjes së mirë së korporatës”*.

¹⁶⁴ Një rol të rëndësishëm luajti Raporti Cadbury (1992) i komitetit me të njëjtin emër, i cili rekomadoi:

- a. Preferencë e fortë për ndarjen e rolit të drejtuesit ekzekutiv nga kryetari;
- b. Rëndësia e një elementi të pavarur në bord: drejtorët joekzekutivë duhet të jetë vërtet i pavarur dhe të kalibrit të lartë; ata duhet të jenë në gjendje të marrin këshilla të pavarura, paga e tyre duhet të reflektojë kohën e kaluar në bord dhe ata duhet të jenë të emëruar nëpërmjet një procesi formal;
- c. Paga e drejtorëve ekzekutivë duhet të bëhet e ditur dhe t'i nënshtrohet rekomandimeve të një komisioni shpërblimesh. Drejtorët duhet të raportojnë mbi efektivitetin e procedurave të kontrollit të brendshëm.

¹⁶⁵ Punësimi i plotë i pasluftës i vendosi interesat e punës në qendër të debatit vetëm për një kohë të shkurtër. Pas dështimit të Komitetit Bullock dhe propozimeve të tij në lidhje me përfaqësimin e punëmarrësve në nivel bordi në mesin e viteve '70, e drejta tregtare angleze vijoi të ishte refraktare ndaj shqetësimeve të punëmarrësve. Që nga koha e Thatcher-it, fokusi ka qenë në ligjin për grevat. Sot, Company Act 1980 parashikon se manaxhimi duhet të marrë në konsideratë interesat e punëmarrësve, një parashikim i vakët dhe “jo i mirënjohur dhe i kuptuar” (për më shumë shih Hopt K., Leyens P. “Board Models in Europe. Recent developments of Internal Corporate Governance Structures in Germany the United Kingdom, France and Italy. Law working paper, no. 18/2004, gjendet në www.ssrn.com/abstract=487944

7.5.3 Modeli me dy nivele

Në sistemin me dy nivele drejtimi dhe mbikqyrja janë përgjegjësi e kompetenca të ndara mes dy bordeve, duke mos lejuar mbajtjen e njëkohshme të funksioneve në të dy bordet. Kjo bën që dallimi mes manaxhimit dhe kontrollit të jetë i qartë. Bordi mbikqyrës i cili mbikqyr zhvillimin e aktivitetit drejtues të shoqërisë, përbëhet tërësisht nga drejtues nga jashtë dhe bordi drejtues nga drejtorë ekzekutivë, të cilët drejtojnë shoqërinë dhe aktivitetin e saj. Asambleja e aksionarëve emëron anëtarët e bordit mbikqyrës të cilët në vijim zgjedhin anëtarët e bordit drejtues. 7 shtete anëtare të Bashkimit European kanë këtë model¹⁶⁶.

7.5.4 Modeli i sistemit me dy nivele në Gjermani

Integrimi i financave dhe i industrisë ka qenë një tipar i rëndësishëm i qeverisjes gjermane të korporatave (Gilpin, 2001:155). Krahasuar me modelin anglo-amerikan, shoqëria aksionare në Gjermani dallon për tre veçori strukturore.

Së pari, është sistemi i qeverisjes me dy nivele që ndan në mënyrë të qartë manaxhimin (drejtimin) dhe mbikëqyrjen, pavarësisht madhësisë së shoqërisë dhe listimit të saj në bursë. Në Gjermani ka dy lloj bordesh, borde mbikqyrëse, të ngjashëm me bordin amerikan të drejtorëve dhe borde manaxhimi, të përbërë nga shefat ekzekutivë dhe drejtuesit më të lartë të manaxhimit (Gilpin, 2001:153). Bordi drejtues është përgjegjës për drejtimin e shoqërisë kurse bordi mbikëqyrës emëron, shkarkon, mbikëqyr dhe këshillon anëtarët e bordit drejtues (dhe jo vetë shoqërinë). Ndarja e rreptë e drejtimit nga mbikqyrja nuk lejon që i njëjti person të jetë anëtar i bordit drejtues dhe mbikëqyrës të shoqërisë. Forcimi i rolit strategjik të bordit

¹⁶⁶ Shih Shtojcën 1.

mbikqyrës (Aufsichtsrat) nëpërmjet Kodit Gjerman të Qeverisjes së Korporatave të 2002, nënkupton një përpjekje për t'i dhënë një avantazh kryesor modelit të qeverisjes me një nivel. Ndërsa në teori, bordi mbikqyrës është organi më i lartë, në praktikën e përditshme shtë shpesh bordi i menaxhimit, një organ i përhershëm që funksionon në bazë të konsensusit, bordi që sundon (Gilpin, 2001:153).

Së dyti, anëtarët e bordit drejtues janë përgjegjës bashkarisht për drejtimin e shoqërisë dhe duhet të marrin pjesë në drejtimin e saj në kushte të barabarta. Komitetet janë më pak të zakonshme krahasuar me Mbretërinë e Bashkuar apo ShBA (Hopt, Leyens, 2004: 5), ndonëse ka një prirje në rritje përse i përket komiteteve me natyrë audituese sidomos në shoqëritë e mëdha me ofertë publike.

Së fundi, bordi mbikëqyrës është subjekt i bashkëvendosjes. Në varësi të madhësisë së shoqërisë, jo të gjithë anëtarët e bordit mbikëqyrës zgjidhen nga mbledhja e asamblesë së aksionarëve. Pjesa tjetër, zakonisht gjysma¹⁶⁷, zgjidhet nga përfaqësuesit e punonjësve të shoqërisë. Vota vendimtare e kryetarit të Bordit i jep disi më shumë pushtet aksionarëve, pavarësisht se me anë të pjesëmarrjes së tyre, punëmarrësit sigurojnë të drejtën që të shprehen për emërimin e anëtarëve të bordit drejtues. Bashkëvendosja përforcohet nga detyrimi i manaxhmentit për të pasur parasysh koalicionin e interesave mes aksionarëve dhe grupeve të interesit, përfshirë ato të punonjësve dhe madje dhe interesin publik (Hopt, Leyens, 2004: 7, cit. Mulbert 1997: 129:171).

¹⁶⁷ Në shoqëritë që kanë më shumë se 2000 punonjës vendas, gjysma e anëtarëve të bordit zgjidhen nga fuqia punëtore. Shoqëritë aksionare që kanë më pak se 500 punonjës nuk janë të detyruar të emërojnë përfaqësues të punonjësve në bordet e tyre mbikëqyrëse nëse dhe vetëm nëse janë në pronësi familiare ose të themeluar pas 10 gushtit 1994. Në shoqëritë e mëdha numri i anëtarëve të zgjedhur nga punëmarrësit shkon nga dhjetë deri në njëzet anëtarë.

Qasja e gjykatës – e cila në parim është e mirëpritur – ndaj standardit të përgjegjësisë objektive në lidhje me shkeljen e parimit të kujdesit, është ai i rregullit të gjykimit të biznesit, që do të thotë se drejtuesit nuk janë përgjegjës nëse kanë vepruar në interesin e shoqërisë dhe informacion të mjaftueshëm (Hopt, Leyens, 2004: 5). Në dallim nga filozofia anglo – saksone e aksionarëve, përqasja e grupeve të interesit të përgjegjësitë e drejtuesve nuk lejon një matje të saktë të vlerës së vendimeve të manaxhmentit (Hopt, Leyens, 2004: 8).

7.5.5 Modeli Nordik

Bordi në këtë model është trup i pavarur i cili është përgjegjës dhe jep llogari para mbledhjes së asamblesë së aksionarëve. Bordi përbëhet kryesisht nga drejtues jo ekzekutivë të cilët zgjidhen dhe ri zgjidhen cdo vit dhe që mund të shkarkohen në cdo kohë edhe pa dhënë arsye. Ka një ndarje shumë të qartë të detyrave dhe përgjegjësiave mes drejtorit ekzekutiv dhe bordit. Roli i bordit është që të kujdeset dhe mbrojtë asetet e aksionarëve. Brenda këtij kuadri, bordi ka autoritet të gjerë për të menaxhuar punët e shoqërisë siç e sheh të arsyeshme për të përmbushur përgjegjësitë e tij ndaj aksionarëve. Punonjësit kanë të drejtë që të përfaqësohen në bord¹⁶⁸ ndonëse kjo e drejtë nuk zbatohet gjithmonë.

Madhësia e bordeve dhe përbërja e tyre në Europë është e larmishme, përfshirë këtu dhe pjesëmarrjen e punonjësve, përqindja mes drejtuesve ekzekutivë dhe jo ekzekutivë etj. Studimet (Heidrick, Strggld, 2014) tregojnë se forma dhe struktura e bordeve ka mbetur e pothuajse e pandryshuar gjatë dekadës së fundit (IFC 2015: 38). Gjithashtu nga studimet e kryera (Ferreira, Kirchmaier, 2013) është arritur në përfundimin se larmia në madhësinë e

¹⁶⁸ Përjashtim bën Finlanda në lidhje me këtë të drejtë.

bordeve në Europë shpjegohet me dallimet mes karakteristikave të shoqërive (si madhësia e tyre), dhe karakteristikat e industrisë. (IFC, 2015: 38).

7.6 Qeverisja e korporatës në shoqëritë e palistuara

Ndërsa debati për qeverisjen e korporatës është përqendruar kryesisht te kompanitë e listuara në vendet me tregjet të zhvilluara të kapitalit dhe te kompanitë me pronësi të shpërndarë, sfidat e qeverisjes së korporatës në kompanitë jo të listuara meritojnë vëmendje të veçantë, veçanërisht në vendet ku tregjet e kapitalit janë më pak të zhvilluara (OECD 2006: 5). Në shumë vende, shpesh shoqëritë e palistuara apo të themeluara/ në zotërim nga familje, luajnë një rol të rëndësishëm ekonomik dhe social, ndaj dhe përmirësimi i qeverisjes së korporatës është thelbësor në stimulimin e mirëqenies sociale dhe ekonomike.

Sipas Haasmaan / Krakman (2004) kompanitë e palistuara, janë ato kompani, aksionet e të cilave nuk tregtohen lirisht në tregjet impersonale, ose sepse aksionet e tyre janë në duart e një numri të vogël personash ose për shkak se janë subjekt i kufizimeve që pengojnë transferueshmërinë e tyre (OECD 2006:9). Një karakteristikë tjetër është dhe faktori i jashtëm që zakonisht haset në ekonomitë në tranzicion, i mungesës së një tregu kapitalesh ose i një tregu jo aktiv dhe eficient edhe kur ai ekziston.

Pronësia në shoqëritë e palistuara shfaqet e larmishme: shoqëria mund të jetë në pronësi të shtetit, në pronësi të familjeve, të një shoqërie tjetër (e listuar ose jo), të një grupi (kryesisht i huaj), të dala nga privatizimet masive (kryesisht tipike për vendet e ish Bllokut Lindor) etj. Ajo që është dalluese është fakti që aksionarët / ortakët e shumicës marrin pjesë aktivisht në menaxhimin, drejtimin e operimin e shoqërisë. Në shumicën e rasteve, aksionarët/ ortakët kontrollues emërojnë dhe shkarkojnë organet dhe autoritetet drejtuese të të shoqërisë.

Padyshim që detyrimi për të dhënë dhe zbuluar informacion në shoqëritë e palistuara është shumë herë më i vogël sesa në rastin e shoqërive të listuara. Por nga ana tjetër, vihet re se aksionari / ortak i shumicës në përgjithësi ka shumë informacion dhe akses në informacion sesa aksionari/ ortakët e pakicës. Forma juridike e shoqërisë mund të jetë e ndryshme pasi nuk kërkohet një formë e paracaktuar nga ligji (për shembull vetëm shoqëri aksioanre) në rastin e shoqërive të palistuara.

Aksionerët në shoqëritë publike - ndryshe nga ato në shoqëritë jo të listuara – janë të mbrojtur kryesisht nga mekanizma që synojnë të kufizojnë aksionarët e mëdhenj për shkak të pranisë së një tregu ku aksionet janë të transferueshme, dhe nga agjentë si kontabilistët, agjencitë e vlerësimit dhe bursat, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në uljen e asimetrive në marrjen e informacionit dhe zbulimin e mashtrimit. Nga ana tjetër, tregu ku operon shoqëria dhe tregu i punës për vetë drejtuesin janë faktorë përcaktues për performancën e shoqërisë së listuar. Në rastin e shoqërive të palistuara këto mekanizma të jashtëm mungojnë. Ndaj në këto kushte, një kuadër i mirë për qeverisjen e korporatës për kompanitë e pa listuara mund të ndihmonte jo vetëm për të përcaktuar *ex ante* pritshmëritë e grupeve të brendshëm dhe të jashtëm të interesit, por gjithashtu, dhe më e rëndësishmja, do t'i vijë në ndihmë gjyqtarëve, audituesve, avokatëve në zgjidhjen e problemeve *ex post* (OECD, 2006: 8).

Kompensimet shtesë për drejtuesit e shoqërisë duke iu ofruar pjesëmarrje në kuotat/ aksionet e shoqërisë, shihen si një nxitës për ta, për të rritur performancën profesionale dhe të shoqërisë, si dhe për të shmangur dhe minimizuar riskun. (Ky qëndrim në këtë rast do të ecte në linjën se drejtuesi në këtë rast do të “administronte” dhe paratë e tij, krahas atyre të aksionarëve/ ortakëve të tjerë, pra do të maksimizonte edhe më mirë interesat e kësaj kategorie në përgjithësi).

Nisur nga asimetria në cilësinë dhe aksesin në informacion ndërmjet shumicës dhe pakicës, transparenca e informacionit, zbulimi i tij i saktë në formën e kohën e duhur, janë elementë për t'u pasur parasysh në rastin e shoqërive të palistuara. Rritja e simetrisë në zbulimin e informacionit, ndihmon në krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe të qëndrueshëm për strategjitë afatgjata të investimit në shoqëri. Niveli i transparencës paraqitet i ndryshëm në vende të ndryshme.

Nisur nga përkufizimi i drejtimit të brendshëm dhe të qeverisjes së korporatës sipas OECD, të cilat përkufizohet si tërësia e marrëdhënieve ndërmjet administratorëve, këshillit të administrimit, aksionarëve dhe grupeve të tjera të interes, aksesin në informacioni është i nevojshëm edhe për grupet e interes, të cilët në asnjë rast nuk mund të kenë mundësitë për akses që ka një aksionar/ ortak i shumicës. Transparenca e informacionit dhe saktësia e dhënies së tij, shërben për të analizuar dhe kuptuar biznesin si dhe në të njëjtën kohë të jetë një mekanizëm për të minimizuar riskun dhe manaxhimin e tij. Ndaj për këtë arsye transparenca dhe aksesin në informacion duhet të jetë i ngritur në nivel ligjor, dhe jo të lihet në dëshirën e mirë apo vullnetin e palëve.

7.7 Detyrimet e raportimit për shoqëritë e palistuara në Bashkimin Europian¹⁶⁹

Raportimi financiar

Shoqëritë e listuara duhet të përgatisin pasqyrat financiare të konsoliduara në përputhje me standardet ndërkombëtare IFRS (Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar).

¹⁶⁹ Për më shumë shih https://ec.europa.eu/info/business-economy-euro/company-reporting-and-auditing/company-reporting_en

Për shoqëritë jo të listuara dhe bizneset e vogla, zbatohen kërkesa të tjera. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar që operojnë në BE, pavarësisht nga madhësia e tyre, duhet të përgatisin pasqyrat vjetore financiare dhe t'i depozitojnë në regjistrin përkatës të biznesit kombëtar. Grupet duhet të përgatisin pasqyra financiare të konsoliduara. Ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme gjithashtu duhet të publikojnë raporte menaxhimi.

Raportimi jofinanciar

Shoqëritë e mëdha duhet të japin / të zbulojnë informata të caktuara mbi mënyrën e veprimit dhe menaxhimin e sfidave sociale dhe mjedisore. Kjo ndihmon investitorët, konsumatorët, politkëbërësit dhe palët e tjera për të vlerësuar performancën jofinanciare të shoqërive të mëdha dhe i inkurajon këto shoqëri që të zhvillojnë një qasje të përgjegjshme për biznesin. Këto rregulla zbatohen vetëm për shoqëritë e mëdha publike me më shumë se 500 punonjës, duke përfshirë: shoqëritë e listuara, bankat, kompanitë e sigurimeve, kompani të tjera të përcaktuara nga autoritetet kombëtare si entitete me interes publik. Për shoqëritë e listuara zbatohen parashikimet e Direktivës 2004/109/EC¹⁷⁰.

Së fundmi, shoqëritë e listuara dhe shoqëritë e mëdha të pa listuara që janë aktive në sektorët e naftës, gazit, minierave apo lëndës drusore, kanë detyrime specifike për raportim. Ata duhet të raportojnë të gjitha pagesat për qeveritë të ndara sipas vendit. Kompanitë duhet të raportojnë llojet e mëposhtme të pagesave si: taksat mbi të ardhurat, prodhimin ose fitimet, honorare, dividendët, tarifat e licencës, tarifat e qirasë, dhe / ose koncesionet, pagesat për përmirësimin e infrastrukturës etj.

¹⁷⁰ Gjendet në <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2004:390:0038:0057:EN:PDF> aksesuar në 29 nëntor 2018.

7.8 Raportimi në ShBA

Detyrimi për raportim dhe zbulim të informacioni në ShBA për shoqëritë e palistuara është dukshëm më i vogël në krahasim me BE.

Dokumentat e themelimit të një shoqëri në ShBA, që zakonisht njihen si *Certificate of Formation* ose *Certificate of Incorporation* të cilat vendosen në regjistrin shtetëror përkatës mjaftohen me informacione të tilla si emri i shoqërisë, objekti i aktivitetit, pjesët e kapitalit. Shoqëria është e detyruar të regjistrojë ndryshime të tilla si selia, kapitali, bashkimet apo ndryshimin e formës së shoqërisë. Fillimi i procedurave të falimentimit nuk vendoset në këtë regjistër por informacioni mund të merret vetëm pranë gjykatave. Në disa shtete kërkohet depozitimi në regjistër i emrit të drejtuesve të shoqërisë por nuk kërkohet depozitimi i përditësimit në rast se ka ndryshime dhe as depozitimi i përfaqësimit të shoqërisë në lidhje me palët e treta.

Në shumicën e rasteve shoqëritë private (të palistuara) nuk janë të detyruara me ligj që të zbulojnë informacione të hollësishme financiare dhe operacionale. Bizneset e vogla dhe ndërmarrjet e tjera në pronësi private mund të mbrojnë informacionin e tyre dhe të përcaktojnë lloje të veçanta të informacionit që duan të zbulojnë. Në dallim publike, nga ana tjetër, janë subjekt i rregullimeve ligjore të detajuara në lidhje me gjendjen financiare, kompensimi i drejtuesve, etj. Në rastin kur shoqëritë më të vogla zgjedhin të rrisin kapitalin duke ofruar askione në tregun e kapitalit, atëherë pavarësisht përmasës së biznesit, ato i nënshtrohen të njëjta rregullave si shoqëritë e mëdha të listuara.

Me miratimin e ligjit Dod Frank¹⁷¹, u prezantua një ndryshim shumë i rëndësishëm: miratimi i kompensimit të drejtorit ekzekutiv nga ana e aksionarëve së paku një herë në tre vjet për shoqëritë (korporatat) publike. Gjithashtu periodiciteti i miratimit vendoset po nga asambleja e aksionarëve, një herë në 6 vjet. Aksionarët duhet të informohen për kompensimin faktik të drejtuesit ekzekutiv dhe performancën financiare, duke marrë parasysh çdo ndryshim në vlerën e aksioneve dhe të dividendëve si dhe për raportin mes mesatares së totalit vjetor të shpërblimit të punonjësve me kompensimin total të drejtorit ekzekutiv.

7.9 Qeverisja e korporatës - Rasti i Shqipërisë

Kuadri ligjor i qeverisjes së korporatës në vend aktualisht mbështetet te Ligji 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligji Nr.10 091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, Ligji 9662/2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Kodi i drejtimit të brendshëm të shoqërive aksionare jo të regjistruara në bursë” është gjithashtu një dokument i rëndësishëm por zbatimi i tij është vullnetar¹⁷².

¹⁷¹ Ligji për Reformën dhe Mbrojtjen e Konsumatorëve të Dodd-Frank është një pjesë e rëndësishme e legjislacionit për reformën financiare të miratuar nga administrata Obama në vitin 2010 si një përgjigje ndaj krizës financiare të vitit 2008. Dispozitat e shumta të aktit, të përshkruara në rreth 2,300 faqe, po zbatohen gjatë një periudhe prej disa vitesh dhe kanë për qëllim uljen e rreziqeve të ndryshme në sistemin financiar të SHBA. Akti krijoi një numër të agjencive të reja qeveritare të ngarkuara me mbikëqyrjen e komponentëve të ndryshëm. Ligji gjendet në <https://www.cftc.gov/LawRegulation/DoddFrankAct/index.htm>

¹⁷² Vetë Kodi parashikon: “Ky kod, tregon vetëm praktikën e mirë për shoqëritë në Shqipëri të cilat nuk janë të regjistruara në bursë me synim ndërtimin e një kuadri të praktikave më të mira të cilat të jenë shumë më lart se kërkesat ligjore minimale. Pra, nuk është një rregullore të cilën janë të detyruara ta zbatojnë shoqëritë tregtare. Po kështu, nuk është as një legjislacion fakultativ në lidhje me të cilin shoqëritë do të duhet të raportojnë në se e zbatojnë apo jo, apo të shpjegojnë përse nuk e zbatojnë (sipas parimit “zbato ose shpjego”). Përkundrazi, kjo është një pamje e përgjithshme e praktikave më të mira në lidhje me drejtimin e brendshëm të shoqërive jo të regjistruara në bursë, siç janë në momentin e hartimit të këtij kodi, dhe synon të shërbejë si material mbështetës dhe frymëzues për shoqëritë tregtare shqiptare, që këto të fundit të zhvillojnë një kuadër të shëndoshë të drejtimit të brendshëm” (faqe 3).

Ndonëse në Shqipëri termi “qeverisje e korporatave” përbën një nocion relativisht të ri për kompanitë tregtare dhe shumicën e aktorëve të tjerë të tregut, tradita e qeverisjes së kompanive Shqiptare duhet analizuar në raport me legjislacionin që ka rregulluar veprimtarinë e shoqërive tregtare dhe mënyrën e zbatimit të këtij legjislacioni (Malltezi, 2010: 134). Legjislacioni tregtar në fuqi për periudhën 1992 – 2007, me gjithë mangësitë në zbatim dhe mungesën e përmirësimeve, krijoi një traditë të caktuar në qeverisjen e shoqërive aksionere (Malltezi, 2010: 136). Duhet patur parasysh gjithashtu që në një hark kohor njëzet vjeçar, Shqipëria kaloi nga një regjim totalitar, me ekonomi të planifikuar dhe të centralizuar, në një regjim të ri demokratik, me ekonomi tregu dhe të decentralizuar, një ndryshim rrënjësor ky i cili preku të gjitha sferat e shoqërisë, përfshirë të drejtën tregtare. Është konstatuar shpesh varfëria e praktikës gjyqësore në këtë degë të së drejtës e rrjedhimisht edhe mungesë të opinionit të shtjelluar e konsoliduar gjyqësor mbi interpretimin dhe zbatimin e normave të saj (Malltezi, Rystemaj, 2015).

Për Shqipërinë janë edhe disa faktorë të cilët duhet të përmenden në këtë kontekst:

1. Kalimi në një ekonomi tregu të lirë u shoqërua natyrshëm dhe me procesin e privatizimit të ndërmarrjeve deri atëherë në pronësi vetëm të shtetit dhe që operonin në fusha të rëndësishme si telekomunikacion, energji, lëndë djegëse etj; Në Shqipëri forma e zgjedhur e privatizimit ishte përmes ankandëve, tendenave, apo bonove të privatizimit, duke shmangur kështu shitjen e ndërmarrjeve shtetërore nëpërmjet bursës sic ishte bërë në vende të tjera.

Nga pikëpamja e pronësisë, shoqëritë aksionare në Shqipëri ndahen në:

- i. Shoqëria aksionare me pronar të vetëm shtetin shqiptare, - shoqëri shtetërore¹⁷³. Këto shoqëri kryesisht operojnë në fusha të tilla si shërbimi postar (Posta Shqiptare Sh.A.), energjia elektrike, hidrokarburet (Albpetrol Sh.A.) etj.
- ii. Shoqëri aksionare të dala nga nga privatizimet; këto shoqëri dallohen për një aksionar të madh i cili kryesisht zotëron paketën kontrolluese të aksioneve; shteti mund të ruajë një pjesë të vogël, si dhe në disa raste një paketë e aksioneve i është ofruar në momentin e privatizimit edhe punonjësve të shoqërisë dhe /ose pronarëve të truallit ku gjenden pasuritë e paluajtshme të shoqërisë. Gjithsesi paketa mbetet e vogël dhe nuk bën diferencë në vendimmarrje.
- iii. Shoqëri aksionare të krijuara nga sipërmarrës vendas dhe/ose të huaj, individë dhe/ose personave juridikë;

Pra, pronësia e aksionave në shoqëritë aksionare në vend nuk paraqitet e shpërndarë. Ajo është e shpërndarë vetëm kur paketat e aksioneve i janë ofruar punonjësve dhe ish punonjësve të shoqërisë kryesisht kundrejt konvertimit të bonove të privatizimit të zotëruar dhe sipas formulave përkatëse të zbatuara për këtë konvertim. Megjithatë, edhe kur paraqiten të shumë në numër, ata të gjithë së bashku janë në minorancë dhe nuk mund të ndikojnë apo drejtojnë vendimmarrjen.

¹⁷³ Sipas Nenit 213 “Dispozitat e zbatueshme” të Ligjit 9901/2008: “1. Shoqëria shtetërore është një shoqëri tregtare, e cila zhvillon veprimtari tregtare, me interes të përgjithshëm ekonomik, aksionet e së cilës zotërohen drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë nga pushteti qendror, pushteti vendor apo nga shoqëri, ku këto pushtete veprojnë si mëmë, sipas përkufizimit të nenit 207 të këtij ligji”. 2. Themelimi, organizimi e funksionimi i shoqërisë shtetërore u nënshtrohen dispozitave të këtij ligji.”

2. Gjithashtu karakteristikë po bëhet dhe mbizotërimi i shoqërive në pronësi familiare, kryesisht në fushën e medias së shkruar dhe vizive.
3. Së fundi mungesa e bursës dhe e tregut të kapitalit, ka qenë një element karakteristik për vendin¹⁷⁴. Në shtetet e rajonit, zhvillimi i tregut të kapitale u mbështet nga shteti, me shumë vende që realizuar shitjen e ndërmarrjeve shtetërore përmes bursës, në Shqipëri forma e zgjedhur e privatizimit ishte përmes ankandëve, tendenave, apo bonove të privatizimit¹⁷⁵. Gjithashtu, ishte ende shpejt për biznesin vendas që të siguronte financim përmes ofertave publike në bursë, ndërkohë që dhe informaliti ishte i lartë duke i shtuar kështu pengesat që shoqëritë t'i drejtoheshin bursës. Kjo bën që shoqëritë në Shqipëri nuk janë të listuara. Procesi i krijimit të shoqërive aksionere publike nëpërmjet ofertës në publik të letrave me vlerë është një fenomen i ri për kushtet shqiptare, proces i cili kërkon njohuri dhe njohje të procedurave (AMF faqe 3).

¹⁷⁴ Bursa Tiranës u themelua në 1 korrik 2002 në formën e shoqërisë aksionare, duke u shkëputur nga Banka e Shqipërisë, me aksionar të vetëm Shtetin Shqiptar. Ajo funksionoi sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr.9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”. Më parë ajo ishte themeluar si departament i Bankës së Shqipërisë me synimin e shkëputjes pas një periudhe tranzitore disa vjecare. Asnjë ndërmarrje shtetërore nuk u kuotua në bursë, (sic kishte ndodhur në vendet e tjera të Europës Lindore, dhe nuk u ofrua asnjë incentivë për shoqëritë të cilat mund të synonin kuotimin në të. Pas 12 vjetësh, gjatë të cilëve, Bursa e Tiranës nuk pa të listuar asnjë kompani dhe pa tregtuar asnjë aksion, Bursa u mbyll përfundimisht, duke dështuar në objektin e saj të krijimit të një tregu kapitalesh në Shqipëri. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare licençoi më datë 3 korrik 2017 shoqërinë “Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE” sh.a. , (Albanian Stock Exchange) si bursa e parë shqiptare me kapital privat e licencuar në vend. Në vitin e parë të aktivitetit, transaksionet e Bursës do të përqendrohen vetëm në tregtimin e titujve të qeverisë. Në tregun shqiptar, krijimi i një burse është aktivitet progresiv për ekonominë e vendit, një pikë takimi midis njësive ekonomike për të gjetur kapital dhe rritur biznesin e tyre, si edhe qeverisë për të gjetur financime për projekte zhvilluese dhe për pushtetin vendor (marrë nga AMF periodiku 2017:2).

¹⁷⁵ Shih <http://www.monitor.al/mbyllet-pa-lavdi-bursa-e-tiranes/> botuar në 9.12.2014

Modeli i qeverisjes në Shqipëri

Deri në vitin 2008, e drejta tregtare, Ligji 7638, kishte ndjekur sistemin e qeverisjes me dy nivele. I mbështetur në zanafillë kryesisht në legjislacionin francez, Ligji 7638 në këtë rast ndoqi zgjidhjen gjermane me dy nivele (Dine, Bletcher, 2016:168). Në mënyrë të përmbledhur: shoqëria drejtohej nga një drejtori e përbërë nga një ose disa anëtarë, e cila i ushtronte funksionet e saj nën kontrollin e një këshilli mbikqyrës¹⁷⁶. Sipas parashikimeve ligjore, anëtarët e drejtorisë emëroheshin nga këshilli mbikqyrës dhe shkarkoheshin prej tij për shkaqe të përligjura¹⁷⁷. Nga ana tjetër, Këshillit Mbikqyrës i atribuoheshin funksionet e kontrollit dhe mbikqyrjes duke ushtruar kontroll mbi drejtorinë për administrimin e shoqërisë nga ana e saj. Emërimi i 2/3 të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës bëhej nga mbledhja e asamblesë së aksionarëve¹⁷⁸ dhe 1/3 nga të punësuarit në shoqëri¹⁷⁹.

Por pavarësisht parashikimeve ligjore, zbatimi në praktikë i tyre ishte krejt i ndryshëm për shkak të ndikimit të pronësisë në kontrollin e shoqërive.

Kështu në këtë aspekt, dallojmë:

1. Pozicioni dominues i siguruar dhe rezervuar aksionarit mazhoritar në organet e administrimi të shoqërisë; ky pozicion krijonte një situatë të pafavorshme përsa i përket aksionarëve të pakicës, marrjen e informacionit dhe transparencës. Në mënyrë të theksuar, ky i fundit ka qenë një problem praktik në të gjitha shoqëritë tregtare (Malltezi, 2010: 140);

¹⁷⁶ Neni 96 “Përbërja e drejtorisë dhe kontrolli mbi të”, Seksioni IV, nënseksioni I – Drejtoria, e Ligjit 7638, datë 19/11/1992.

¹⁷⁷ Neni 97, Neni 98, Seksioni IV, nënseksioni I – Drejtoria, e Ligjit 7638, datë 19/11/1992. Shkaqe të përligjura që rendiste Ligji ishin: faji i rëndë i anëtarit, paaftësia në kryerjen korrekt të funksioneve, humbja e besimit nga ana e asamblesë.

¹⁷⁸ Neni 105, nënseksioni II – Këshilli Mbikqyrës, i Ligjit 7638, datë 19/11/1992.

¹⁷⁹ Neni 109, nënseksioni II – Këshilli Mbikqyrës, i Ligjit 7638, datë 19/11/1992.

2. Përbërja e këshillit mbikqyrës kishte problematika të theksuara (Malltezi, 2010: 140).

Prirja e krijimit të shoqërive me një aksionar apo shoqërive me karakter familiar bënte të padukshme ndarjen mes pasurisë personale nga ajo e shoqërisë. Kjo shprehej në emërimin e anëtarëve të këshillit nga rrethi i personave të afërt apo familjarë të aksionarëve të mëdhenj. Vendimmarrja e tyre diktohej nga interesi i aksionarit që përfaqësonin dhe jo nga interesi i shoqërisë (Malltezi, 2010: 140). Këtë situatë nuk e lëhtësonte as parashikimi taksativ për përzgjedhjen e 1/3 së anëtarëve nga të punësuarit në shoqëri. Ligji 7638 njihte të drejtën e të punësuarve për të zgjedhur dhe për të qenë të pranishëm në kontrollin e mbikqyrjen e shoqërisë, duke ndjekur kështu shembullin e modelit gjerman. Kanë qenë shumë të rralla rastet kur shoqëritë aksionere u kanë rezervuar vende në këshill përfaqësuesve të të punësuarve, ndonëse ky ishte një detyrim taksativ ligjor (Malltezi, 2010: 141). Në këtë mënyrë vetë shoqëria dhe aksionarët e pakicës përballeshin me riskun që mbartte përbërja dhe vendimmarrja e këshillit.

3. Kompetencat që ligji 7638 “Për shoqëritë tregtare” i atribuonte këshillit ishin të përgjithshme dhe të paqarta (Malltezi, 2010: 141). Kjo zbehte dhe dobësonte dukshëm rolin e këshillit mbikqyrës në shoqëri, duke forcuar asamblenë e aksionarëve nga ana tjetër¹⁸⁰.

¹⁸⁰ Për ilustrim përmendim se një nga detyrat më të rëndësishme të këshillit mbikqyrës ishte emërimi dhe shkarkimi i drejtorit të përgjithshëm. Për një çudi juridike, ishte dukuri shumë e përhapur emërimi dhe shkarkimi i drejtorëve nga ana e asamblesë së aksionerëve, pavarësisht se asnjë dispozitë ligjore nuk ja njihte këtë kompetencë asamblesë (Malltezi, 2010: 141). (Për më shumë shih Malltezi Dr. A., Tradita e qeverisjes së Shoqërive Aksionere në Shqipëri për periudhën 1992 – 2007”, Jus & Justicia, Pranverë 2010, Universiteti Europian i Tiranës).

Ligji për Shoqëritë Tregtare i vitit 1992 përçonte parimet bazë të mirë – qeverisjes, *barazinë mes aksionerëve, përgjegjësinë e strukturave para aksionerëve dhe para ligjit, transparencën e aktivitetit, dhe llogaridhënien e strukturës* (Malltezi, 2010: 136). Pavarësisht kësaj, mënyra e kuptimit dhe zbatimit të ligjit nga ana e subjekteve të tij dhe organeve ligjzbatuese, përfshirë këtu dhe mungesa e përditësimit të kujdesshëm dhe aktual të tij, la për të dëshiruar. Ndaj dhe pse parimet e qeverisjes së korporatës reflektoheshin mjaftueshëm në legjislacionin Shqiptar, moskuptimi i tyre, zbatimi i gabuar i ligjit, etika e varfër e biznesit dhe qëndrimi i këtij të fundit ndaj zbatimit të ligjit dhe konkurrencës së ndershme kanë lënë pas një traditë të varfër të qeverisjes së korporatave (Malltezi, 2010: 138).

Në dallim, Ligji i ri, 9901/2008 ruajti tempin dhe eci në një frekuencë me legjislacionin europian të qeverisjes së korporatës. Ai përmban parimet e trajtimit të barabartë të aksionarëve, përgjegjësinë e llogaridhënies, transparencën dhe kontrollin e shoqërisë.

Ligji i ri, 9901/2008, përkundrazi, ndoqi një qasje tjetër, përse i përket piramidës së administrimit duke iu ofruar shoqërive aksionare që të zgjedhin ndërmjet tre sistemeve: dy modelet klasike me një ose dy nivele dhe modelin italian. LShT-ja parashikon:

- (i) Sistemin me një nivel të administrimit nëpërmjet Këshillit të Administrimit që përfshin Administratorët të cilët emërohen nga Asambleja e Aksionarëve¹⁸¹;
- (ii) Sistemin me dy nivele të administrimit i cili realizohet duke ndarë funksionet e administrimit dhe kontrollit. Funksionet e administrimit i besohen administratorëve të cilët emërohen nga Këshilli Mbikqyrës. Ky i fundit zgjidhet nga Asambleja e Aksionarëve dhe ka funksione kontrolli¹⁸².

¹⁸¹ Nenet 134 (1) 1, 154 – 165 i LShT-së.

¹⁸² Nenet 134 (1) 2, 166 dhe 167

- (iii) Sistemi me dy nivele të administrimit ku këshilli mbikqyrës dhe administratorët të emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Ky variant “italian” i administrimit e fuqizon rolin e asamblesë së përgjithshme. Ai rrjedh nga modeli standard italian i drejtimit të brendshëm të shoqërisë aksionare (nenet 2380 deri në 2409 të Kodit Civil Italian) (Dine, Bletcher, 2016:168¹⁸³).

Sa i takon SHA-ve, ligji për shoqëritë tregtare ka eliminuar tërësisht përbërjen “hierarkike” të shoqërisë dhe ka përcaktuar “drejtpeshimin fleksibël të pushteteve” ndërmjet organeve të shoqërisë, domethënë, ndërmjet Asamblesë së Përgjithshme, këshillit të administrimit ose këshillit mbikqyrës dhe administratorëve. Asambleja e Përgjithshme mund të ruajë forcë nëse zgjidhet “varianti Italian” i sistemit të administrimit me dy nivele (Dine, Bletcher 2016: 170). Raporti i EBRD (2017:5) për qeverisjen e korporatës në Shqipëri, vëren se: “Këshillat përbëhen nga pak anëtarë”¹⁸⁴.

Të drejtat e aksionarëve

Objekti i LShT rregullon *inter alia*: të drejtat dhe detyrimet e themeluesve, [...] dhe aksionarëve¹⁸⁵. Të drejtat themelore të aksionarëve janë të parashikuara në ligj dhe

¹⁸³ Shënim: në lidhje me këtë element, Dine e Bletcher sqarojnë se: Ligjvënësit shqiptarë nuk e zbatuan modelin Italian në mënyrë tërësore. Anëtarët e atij që në Itali e quajnë “collegio sindacale” (“kolegji sindakal”), (neni 2397), vijnë vetëm nga sektori i kontabilitetit. Megjithatë, kompetencat e tyre (neni 2403), përputhen shumë me ato të këshillave mbikqyrës të modelit “klasik” me dy nivele. Për rrjedhojë, i vetmi dallim që bën këtu modeli shqiptar me dy nivele është se Asambleja e Përgjithshme mund të zgjedhë edhe administratorët, jo vetëm anëtarët e Këshillit Mbikqyrës (Dine, Bletcher, 2016: 169).

¹⁸⁴ Raporti i EBRD (2017) për qeverisjen e korporatës në Shqipëri, gjithashtu vëren se provat e tregojnë se këshillat e vegjël në numër anëtarësh priren të performojnë më mirë, me kusht që të kenë kombinimin e nevojshëm të aftësive dhe mbështetjes. Megjithatë ky nuk duket se është rasti i Shqipërisë” (faqe 5).

¹⁸⁵ Neni 1 “Objekti i Ligjit, perkufizime, regjistrime te detyrueshme”, pika 1 përcakton: “Ky ligj rregullon statusin e tregtarit, themelimin dhe administrimin e shoqërive tregtare, të drejtat dhe detyrimet e themeluesve, të ortakëve dhe aksionarëve, riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive tregtare. Shoqëritë tregtare janë shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare”.

ndryshimet e mëdha në nivel shoqërie miratimin e supershemicës në mbledhjen e asamblesë (EBRD, Albania Country Report, 2017: 6).

Pjesët e kapitalit të shoqërive tregtare konsiderohen si sende të luajtshme, të patrupëzuara. Pronësia mbi aksionet i bën aksionarët titullarë të të drejtave, të cilat mund të klasifikohen në të drejta politika dhe të drejta financiare.

Të drejtat e aksionarëve për çështjet e lidhura me veprimtarinë dhe funksionimin e shoqërisë ushtrohen nëpërmjet asamblesë së përgjithshme (neni 135 i Ligjit). Sa më e madhe të jetë shoqëria në terma pronësie, pra sa më e shpërndarë të jetë pronësia, aq më e vështirë është për aksionarët që të ushtrojnë të drejtat e tyre. Ky qëndrim nuk ka të bëjë thjesht me parashikimet në nivel ligji dhe statuti, por me mundësinë reale që aksionet që zotëron një aksioner i japin atij “pushtet” që të vendosë në lidhje me shoqërinë. Parimi i përgjithshëm mbi bazën e të cilit funksionon asambleja e përgjithshme e aksionarëve është që vullneti i shumicës në një shoqëri përbën vullnetin e shoqërisë (Rystemaj, 2015:287).

E drejta e aksionarëve për të përcaktuar politikat tregtare të shoqërisë i vesh aksionarëve një rol primar në përcaktimin e kuadrit strategjik brenda të cilit të do të veprojnë personat e ngarkuar me administrimin e shoqërisë. E thënë ndryshe, vendosin në nivel makro për t’ia lënë ndjekjen dhe zbatimin në nivel mikro dhe operacional administratës së shoqërisë.

Meqënëse aksionarët janë pronarë të shoqërisë dhe marrin përsipër riskun ekonomik të aktivitetit të saj, ligji për shoqëritë tregtare natyrisht e ngarkon asamblenë e përgjithshme me marrjen e vendimeve që kanë të ngjarë të kenë ndikim domethënës në interesat (financiare) të aksionarëve (Bachner, Schuster & Winner, 2009).

Sipas Rystemaj (2012:15), qëllimi i krijimit të shoqërive tregtare është maksimizimi i fitimeve dhe pasurisë së aksionerëve të saj. Aksionerët i maksimizojnë fitimet e tyre

nëpërmjet rritjes së fitimit të shoqërisë që më pas do t'u shpërndahet proporcionalisht me pjesën që zotëron secili, si dhe nëpërmjet rritjes së vlerës së aksioneve në treg. Grupet e tjera të interesit, si punëmarrësit, klientët, kreditorët dhe komuniteti lokal ku shoqëria ushtron aktivitetin, mund të kenë pritshmëri të ndryshme dhe vizione të ndryshme për shoqërinë që mund të vijjnë në kundërshtim me parashikimet e aksionerëve. Në këtë kontekst, shoqëria është e detyruar që, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, të marrë në konsideratë edhe interesat e aktorëve të tjerë të cilat në çdo rast, do i shërbejnë objektivit primar të shoqërisë. *Trajtimi i drejtë dhe i barabartë i aksionerëve* është ngritur në standarde të reja, të cilat nëpërmjet instrumentave shtesë të regjistrimit dhe publikimit të titujve financiare, garantojnë njohjen e pronësisë mbi aksionet, transparencën e transaksioneve me to si dhe të drejtat që rrjedhin nga pronësia (Malltezi, 2010:146).

Qeverisja e korporatave nuk është një formulë që gjendet në një ligj të caktuar, por një frymë, një qëndrim ndaj legjislacionit, kuptimit dhe zbatimit të tij si dhe përmirësimeve të vazhdueshme që ai pëson (Malltezi, 2010: 135). Të kuptuarit e qeverisjes së korporatës është një mënyrë për të përmirësuar mekanizmat e saj, duke bërë dhe ndryshimet apo ndërhyrjet e nevojshme institucionale për t'i shërbyer këtij qëllimi. Nga ana tjetër një qeverisje e mirë e korporatës është një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e tregut, një promotor në nxitjen e konkurrencës dhe investimeve, dhe të ekonomisë në tërësinë e saj. Sigurisht që problemet që hasin vendet në tranzicion janë të një natyre relativisht të ndryshme nga ato të modeleve të vendeve perëndimore dhe të zhvilluara. Sipas Oman (2001) “konflikti potencial i interesave nuk është ndërmjet manaxherëve dhe aksionarëve *per se*, por ndërmjet manaxherëve –

pronarëv dominues nga njëra anë, me aksionarët në minorancë dhe investitorët e tjerë nga ana tjetër¹⁸⁶.

Harmonizimi i interesave të manaxherit (agjentit) me ato të aksionerit (primari) nuk është një gjë e lehtë dhe as nuk mund të realizohet vetiu me anën e forcave të tregut. Shumë aksionarë nuk janë në gjendje që të gjykojnë dhe të vendosin mbi alokimin e aseteve të kompanisë për shkak se ata nuk e njohin në detaje kompaninë, operacionet e saj dhe mjedisin specifik të industrisë ku ajo vepron (Llaci, 2012:33). Nga ana tjetër, manaxherët mund të mos gjykojnë në mënyrë të drejtë riskun që shoqëron një investim të caktuar, për shkak se ata nuk kanë pjesëmarrje direkte në pronësinë e kompanisë (Llaci, 2012:33). Për të siguruar harmonizimin e interesave ndërmjet pronarëve dhe manaxherëve janë të nevojshme mekanizmat e brendshme të raportimit dhe të llogaridhënies, të cilat duhet të jenë të parashikuara në nivel ligji, dhe të ecin në një frekuencë me sistemin e qeverisjes së brendshme. Shoqëritë e mirëdrejtuara dhe transparente bëhen kështu promotore të zhvillimit të ekonomisë në vend. Ne kemi parë se çfarë ndodh nëse shoqëritë nuk janë të tilla: investimet dhe vendet e punës humbasin; dhe në rastet më të këqija, të cilat janë shumë, aksionarët, punonjësit, kreditorët dhe publiku grabiten (Bolkestein, 2003)

Tashmë është fakt që sfida kryesore strategjike për shoqëritë është që jo vetëm të mbijetojnë por të dallojnë në një mjedis gjithnjë e më konkurrues duke qenë të ndërgjegjshme se tregu do t'i penalizojë në rast se nuk gjenerojnë fitime dhe të rriten. Sistemi i Qeverisjes së Korporatave është i një rëndësie vendimtare sepse mund të ndikojë në vendimet e marra nga firmat dhe në fund të fundit ka një ndikim në pasurinë e krijuar në një vend (Braendle, 2006).

¹⁸⁶ Shih C.H. Oman, "Corporate governance and national development", Technical Papers 180, OECD Development Center, Paris, 2001.

Rasti i Shqipërisë – Shoqëritë e listuara

Në Shqipëri, listimi i shoqërive tregtare në vend është subjekt rregullimi nga disa ligje. Ligji 9901/2008, përcakton në Nenin 105, dy forma të shoqërisë aksionare: me ofertë publike dhe me ofertë private, në përputhje me dispozitat e ligjit për titujt¹⁸⁷. Kapitali minimali regjistruar i shoqërisë aksionare me ofertë private nuk mund të jetë një kapital më të vogël se 3 500 000 lekë, kurse i shoqërisë aksionare me ofertë publike kanë pragun minimal prej 10 milion lekë¹⁸⁸. Gjithashtu, Ligji 9901/2008 shpreh qartë në nenin 68 (3) se Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara nuk mund të ofrojnë kuotat e tyre si mjete investimi për publikun e gjerë.

Dallimi kryesor midis tyre qëndron në faktin se shoqëritë me ofertë publike janë të vetmet që mund të tërheqin kapital nëpërmjet tregtimit të titujve nëpërmjet ofertës publike, pra ofrimit të tyre tek një grup i papërcaktuar investitorësh, nëpërmjet shitjes në bursë ose të struktura të tjera të përcaktuara nga ligji për këtë qëllim (Malltezi, 2011: 87).

Një shoqëri me ofertë publike mund të emetojë tituj me anë të ofertës publike dhe ofertës private. Një shoqëri me ofertë private mund të emetojë tituj vetëm me anë të ofertës private, pasi në të kundërt, ajo duhet të shndërrohet në shoqëri me ofertë publike.

Një nga mënyrat për rritjen e kapitalit, është emetimi dhe shitja letrave të reja me vlerë¹⁸⁹ nga ana e shoqërise, të cilat mund të jenë emetime aksionesh, obligacionesh apo letrash te

¹⁸⁷ Ligji 9901/2008, në nenin 105 (1) referon Ligjin nr. 9878, datë 21.1.2008 “Për titujt”.

¹⁸⁸ Neni 105 (2) i Ligjit 9901/2008, I ndryshuar me Ligjin Nr.10 475, datë 27.10.2011.

¹⁸⁹ Ligji nr. 9878, datë 21.1.2008 “Për titujt” përcakton se titujt quhen ndryshe në ligje të tjera si “*letra me vlerë*”. Në nenin 3, Ligji bën ndarjen e titujve formës juridike ku përfshihen pa kufizim aksionet, obligacionet e shoqërive tregtare dhe të pushtetit vendor, bonot e thesarit dhe obligacionet e emetuara nga shteti shqiptar, titujt e emetuar nga Banka e Shqipërisë, dëftesat tregtare, aksionet ose kuotat e fondeve të investimit, si dhe instrumente të tjera financiare, të krahasueshme me aksionet dhe obligacionet dhe që vlerësohen dhe miratohen si të tilla nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Gjithashtu sipas marrëdhënies juridike titujt mund të jenë tituj të pjesëmarrjes në kapital, tituj borxhi, aksione ose kuota të fondit të investimeve apo fondit të pensioneve. Tituj të pjesëmarrjes në kapital janë tituj, të cilët provojnë të drejtat dhe detyrimet për një pjesë të kapitalit minimal apo atij të regjistruar të shoqërisë aksionere. (neni 4).

tjera me vlere. Procesi i krijimit të shoqërive aksionere publike nëpërmjet ofertës në publik të letrave me vlere është një fenomen i ri për kushtet shqiptare, proces i cili kërkon njohuri dhe njohje të procedurave (AMF 2012:3). Ligji “Për titujt” përcakton qartë ofertën publike dhe private dhe dallimin mes tyre:

- Ofertë publike e titujve është ftesa për të nënshkruar titujt, e cila, duke përdorur mjetet masive të komunikimit, i drejtohet një numri të papërcaktuar personash.
- Ofertë private e titujve është emetimi, në të cilin oferta për të nënshkruar titujt u drejtohet vetëm investitorëve institucionalë¹⁹⁰, aksionerëve ose punonjësve, por jo më shumë se 100 investitorëve të jashtëm¹⁹¹, të cilët janë adresuar drejtpërdrejt tek emetuesi.

Zgjerimi i aktivitetit, i biznesit, i tregjeve ku operohet, rritja e gamës dhe /ose cilësisë së shërbimeve e produkteve, përmirësimi i teknologjisë në dispozicion, i aftësive konkurrenciale etj janë disa nga kërkesat e shoqërisë të cilat diktojnë nevojën për shtimin e kapitalit, për të financuar aktivitetin tregtar duke u mbështetur publiku i gjerë. Për shoqëritë të cilat zgjedhin të mbështeten te publiku për kapital të ri, ato duhet të jenë të ndërgjegjshme se mbi këtë formë shoqërie zbatohet një regjim i ngjeshur rregullash shtesë që kanë të bëjnë me publikimin, transparencën, kontrollin dhe aspekte të tjera të qeverisjes së shoqërive publike

Ligji “Për titujt”, e njeh aksionin si titull, instrument financiar por përkufizimin, llojet e aksioneve, mënyrën e marrjes në zotërim të tyre, si dhe përmbajtjen e vendimit të emetimit të aksioneve ia atribuon ligjit për shoqëritë tregtare (neni 12).

¹⁹⁰ Sipas nenit 27 të ligjit “Për titujt”: “Investitorë institucionalë janë fondet e investimeve, fondet e pensioneve, shoqëritë e sigurimeve, si dhe personat juridikë, të cilët investojnë në titujt vetëm për llogari të portofoleve të tyre të investimit”.

¹⁹¹ Sipas nenit 27 të ligjit “Për titujt”: “Investitor i jashtëm është çdo individ ose person juridik, vendas apo i huaj, që nuk është aksioner apo punonjës i emetuesit dhe investitor institucional”.

(Malltezi, 2011:87). Themelimi dhe regjistrimi i shoqërisë aksionare me ofertë private është i njëjte me format e tjera të shoqërive tregtare kurse themelimi dhe regjistrimi i shoqërive publike kalon në dy faza.

Raporti me publikun dhe transparenca e informacionit është një nga tiparet kryesore dalluese të shoqërisë me ofertë publike ose private. Informacioni prezantohet dhe përcillet te investitorët nëpërmjet prospektit, përmbajtja e të cilit rregullohet nga ligji “Për titujt” në nenet 28 – 34. Qëllimi i përgatitjes dhe publikimi i prospektit është mbrojtja e palëve të treta, investitorëve, nga rreziku që mund t’u vijë si pasojë e blerjes së titujve (Malltezi, 2011:87).

Vlen të theksohet prospekti i ofertës private është disi më i thjeshtuar në informacionin që përmban në dallim nga prospekti i ofertës publike. Oferta për blerje aksionesh zakonisht u bëhet investitorëve të cilët aksionarët ekzistues i vlerësojnë për shkak të karakteristikave personale, profesionale apo financiare. Për këtë arsye, ligji prezumon se investitorët që pranojnë këtë lloj oferte kanë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar rrezikun dhe përfitimet e këtij investimi (Malltezi, 2011:89, 70).

Prospekti i ofertës publike i drejtohet një publiku të gjerë, të pakufizuar në numër. Homogjeniteti i këtij grupi përsa i përket dijeve dhe përvojës në fushën e investimit, bën që ligji t’iu sigurojë informacionin e nevojshëm për të bërë vlerësimet përkatëse. Ky prospekt konsiderohet si informacion minimal që cdo investitor të bëjë vlerësimin e rrezikut dhe përfitimit potencial që sjell blerja e titujve (Malltezi, 2011: 90). Në mënyrë të përbledhur, prospekti përmban informacion në lidhje me:

- Titujt e ofruar, kushtet e emetimit, qëllimi i përdorimit;
- Të dhëna për emetuesin; të dhëna për anëtarët e organeve vendimmarrëse;

- Të dhëna për veprimtarinë e emetuesit;
- Të dhëna për mjetet e emetuesit, gjendjen financiare, borxhin, rezultatin financiar të tre viteve të fundit dhe vitin në vazhdim;
- Deklarata e vërtetësisë së të dhënave.

Prospekti i ofertës publike botohet në mjetet masive të komunikimit, gazeta me tirazh të madh etj, kurse prospekti i ofertës private dërgohet në ftesa individuale. Në të dy rastet, prospekti është subjekt i miratimit nga ana e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare.

Sipas Ligjit “Për titujt”, brenda 30 ditëve nga data e emetimit të aksioneve në ofertë publike, shoqëritë aksionere regjistrojnë aksionet në kuotim burse. Nga ky çast shoqëria aksionere konsiderohet si shoqëri me ofertë publike - shoqëri publike¹⁹² dhe padyshim që detyrimet dhe përgjegjësitë e saj në lidhje me publikimin e informacionit dhe transparencën janë më të mëdha. Shoqëritë publike kanë si aksionarë, përveç themeluesve, një numër të madh individësh nga publiku i gjerë, të cilët mbështeten jo vetëm në administrimin e mirë të shoqërisë nga organet e kësaj të fundit, por edhe në kontrollin e organizmave publike si AMF apo bursat, të cilat janë krijuar me qëllim disiplinimin e aktivitetit të shoqërive publike dhe mbrojtjen e interesave të investitorëve që blejnë titujt e kësaj shoqërie në tregje të hapura (Malltezi, 2011: 95).

Kështu, shoqëritë publike në Shqipëri i nënshtrohen publikimit periodik dhe raportimit financiar cdo tremuaj pranë AMF-së, (neni 105 i Ligjit “Për titujt”) si dhe të dhëna të tjera të kërkueshme nga AMF në bazë të rregulloreve të saj, që lidhen me mirëqeverisjen e qeverisë;

¹⁹² Ligji Nr. 10 236, datë 18.2.2010 “Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike”, në nenin 2, përcakton: “Shoqëri publike” është shoqëria aksionare me ofertë publike, e cila regjistron aksionet e saj në kuotim burse, në përputhje me nenin 105 të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”.
Pra, si në rastin e Ligjit 9901/2008 dhe në këtë rast, të dy ligjet referojnë në Ligjin “Për titujt”.

publikimi i raportit të transparencës që garanton standardet e kontrollit nga ana e ekspertit kontabël të regjistruar në faqen e internetit të këtij të fundit (neni 45 dhe 46 i Ligjit “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”).

Kërkesa të veçanta për shoqëritë aksionare në lidhje me raportimin dhe pasqyrat financiare vendos dhe Ligji 10 236, datë 18.2.2010 “Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike”, në nenin 4¹⁹³. Nga pikëpamja e terminologjisë së përdorur, në këtë Ligj, bie në sy, përdorimi i termit “kompani” (3 herë) dhe “bord” (12 herë). Termi “bord” përdoret si “bordi i shoqërisë” (neni 3, 4), “bordi drejtues i shoqërisë” apo “bordi i drejtorëve” (neni 3). Ligji është i vitit 2010, dhe është miratuar dy vjet pas Ligjit 9901/2008, i cili në asnjë rast nuk përdor termin “kompani”. Termi “bord” përdoret vetëm një herë në nenin 156 dhe lexon si më poshtë: *“Anëtarësimi në këshillin mbikëqyrës apo këshillin e administrimit të shoqërive të tjera të një grupi vlerësohet si anëtarësim vetëm në një bord”*.

¹⁹³ Keto kërkesa përfshijnë:

- a) strukturën e kapitalit, kategoritë e ndryshme të aksioneve dhe për secilën kategori, të drejtat dhe detyrimet, që rrjedhin prej tyre dhe përqindjen e kapitalit aksionar, që përfaqësojnë;
- b) kufizimet, nëse ka, për kalimin e titujve;
- c) zotërimet e drejtpërdrejta ose të tërthorta;
- ç) zotëruesit e titujve me të drejta të posaçme kontrolli dhe një përshkrim të këtyre të drejtave;
- d) sistemin e kontrollit të skemës së aksioneve të punëmarrësve, nëse ka, kur të drejtat e kontrollit nuk ushtrohen drejtpërdrejt nga punëmarrësit;
- dh) normat, që rregullojnë emërimin dhe largimin e administratës së shoqërisë dhe ndryshimin e statutit;
- e) kompetencat e anëtarëve të bordit të shoqërisë, në veçanti kompetencat për të emetuar dhe riblerë aksione;
- ë) aktmarrëveshjet, ku shoqëria është palë, të cilat hyjnë në fuqi, ndryshojnë ose zgjidhen me ndryshimin e kontrollit të shoqërisë pas një oferte për marrje në kontroll, me përjashtim të rasteve, kur, për shkak të natyrës së tyre, të dhënat për to do të cenojnë rëndë shoqërinë tregtare.
- f) aktmarrëveshjet ndërmjet shoqërisë tregtare dhe anëtarëve të këshillit apo punëmarrësve të saj, ku parashikohet kompensim, nëse ata, përkatësisht, japin dorëheqjen ose kur shkurtrohet vendi i tyre i punës pa shkak të arsyeshëm, apo kur zgjidhen marrëdhëniet e punës me ta, për shkak të një oferte për marrje në kontroll.
- g) çdo kufizim në të drejtat e votimit;
- gj) çdo marrëveshje ndërmjet zotëruesve të aksioneve, të njohura nga kompania dhe që mund të rezultojnë në kufizime të transferimit të aksioneve dhe/ose të drejtave të votimit.

Ligji “Për titujt” e përdor vetëm 4 herë termin “bord” dhe i referohet vetëm bordit të drejtimit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare si institucion.

Mund të thuhet se Ligji 10236/ 2010 ka dashur të referojë në këtë rast organin drejtues të shoqërisë por nuk ka marrë parasysh gjuhën dhe strukturën e përdorur nga Ligji 9901/2008. E lexuar në kontekst vetëm të Ligjit 10236/ 2010, duket sikur merren në konsideratë vetëm shoqëritë aksionare me një nivel duke lënë kështu ma përfshirë ato me dy nivele. Një konsideratë tjetër është që për me tëpër duke referuar bordin e drejtorëve, duket sikur ligji ka më shumë parasysh modelin e organizimit të shoqërive (korporatave) amerikane sesa ato të vendit tonë. Megjithatë deri tani përse kohë që shoqëritë shqiptare nuk janë të kuotuar në bursë, pra nuk janë me ofertë publike, ligji nuk ka gjetur zbatim konkret dhe ndonjë problematikë e mundshme që mund të vinte për shkak të terminologjisë së përdorur, nuk është hasur. Pavarësisht, është qasja e duhur është ajo e një gjuhe të njësuar në legjislacion për të shmangur interpretime, hapësira apo keqkuptime.

Zbulimi i informacionit sipas Ligjit 9901/2008

Në bazë të parashikimeve të ligjit 9901/2008, neni 1, tregtarët dhe shoqëritë tregtare mbajnë libra kontabël, hartojnë e publikojnë të dhënat financiare dhe raportet për gjendjen e ecuresë së veprimtarisë, përfshirë dhe raportet e kontrollit të ekspertëve kontabël të autorizuar në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Publikimi i të dhënave bëhet në regjistrin tregtar i cili mbahet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe /ose në faqen internet të shoqërisë.

Nisur nga roli i rëndësishëm i internetit në publikimin e ndarjen e informacionit, dhe nga përmbajtja e informacionit që shoqëritë njoftojnë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit,

parimi i publikimit lidhet me standartin e publikuar në QKB: të dhënat që i njoftohen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, publikohen në faqen internet të shoqërisë nëse shoqëria tregtare ka krijuar një faqe të saj, dhe u vihen në dispozicion personave të interesuar.

Gjithashtu ligji parashikon që kur dispozitat, kërkojnë dhënie informacioni në faqen e shoqërisë në internet, ato mund të zbatohen nëpërmjet krijimit të një lidhjeje informatike të drejtpërdrejtë me faqen në internet, ku Qendra Kombëtare e Regjistrimit publikon informacionin për tregtarin apo shoqërinë përkatëse. Kjo nga ana operationale dhe teknike, lehtëson procesin e vendosjes së informacionit në një seksion të faqes, duke bërë lidhjen direkte me faqen përkatëse të QKB-së.

Ligji kërkon që shoqëria të ketë një “indentikit” të saj, në të gjitha komunikimet me palët e treta pavarësisht formës së realizimit: me letër apo mjete elektronike. Kështu, neni 11 “Të dhënat në korrespondencat dhe dokumentet e tjera të veprimtarisë”, parashikon se korrespondenca që u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:

a) numrin unik të identifikimit; b) formën ligjore të shoqërisë; c) vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj; ç) të dhëna nëse shoqëria është në likuidim.

Këto të dhëna duhet të shfaqen dhe në faqen e internetit të shoqërisë ose duke e marrë informacionin e kërkuar nëpërmjet lidhjes (ridrejtim) me faqen përkatëse të QKB-së.

Përgjegjësia e vërtetësisë së të dhënave i takon shoqërisë dhe mosrespektimi kësaj kërkesë të ligjit, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë deri në 15 000 lekë (neni 11(2). Ligji nuk e përcakton shprehimisht administratën që bën mbikqyrjen e plotësimit të detyrimit apo mbledhjen (ekzekutimin) e gjobës, por ja njeh këtë të drejtë edhe administratës tatimore kur kundërvajtja administrative konstatohet gjatë një kontrolli të organizuar nga kjo administratë.

QKB është themeluar me Ligjin Nr.9723, datë 3.5.2007¹⁹⁴, i cili rregullon organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, administrimin e regjistrit tregtar, përcakton subjektet që regjistrohen dhe procedurat e regjistrimit¹⁹⁵. QKB është institucion publik qendror, me personalitet juridik. Funksionet përcaktohen në nenin 4 të Ligjit¹⁹⁶.

Regjistri është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin subjekt që ka detyrimin e regjistrimit. Në bazë të nenit 19 të Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007, të ndryshuar, Regjistri duhet të përmbajë të dhëna, që i përkasin themelimit, veprimtarisë dhe rregjistrimit të subjekteve, çdo ndryshim në status dhe organizimin e subjektit, të dhëna, që i përkasin atij në lidhje me përfaqësimin, si dhe të dhëna të tjera, të parashikuara me ligj.

Shoqëritë tregtare regjistrohen në regjistrin tregtar, duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme¹⁹⁷, statutin dhe aktin e themelimit, në rast se janë hartuar si dy dokumente të veçanta, aktet e emërimit të organeve të shoqërisë, nëse nuk përfshihen në aktet e mësipërme, si dhe aktet e tjera të nevojshme për themelimin,

¹⁹⁴ Ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit është ndryshuar me Ligjin nr.9916, datë 12.05.2008, Ligjin Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015 dhe sot njihet si Qendra Kombëtare e Biznesit.

¹⁹⁵ Neni 1 i ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

¹⁹⁶ Shih neni 4 i Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar i cili gjendet në <http://www.qkr.gov.al/legjislacioni/legjislacioni-per-regjistrimin-e-biznesit/ligje/>; e cila ka këto funksione:

- a) mban regjistrin tregtar;
- b) kryen regjistrimet në regjistrin tregtar;
- c) kryen regjistrimin e subjekteve, të përcaktuara në ligj, për qëllim të regjistrimit fiskal, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe inspektimit të marrëdhënieve të punës;
- d) lëshon certifikata, ekstrakte të regjistrimeve dhe kopje të vërtetuara të akteve, të depozituara sipas përcaktimit të këtij ligji;
- e) publikon të dhënat e regjistrit të mbajtur, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to;
- f) informon dhe këshillon për procedurat e regjistrimit

¹⁹⁷ Të dhënat e detyrueshme për regjistrimin fillestar të shoqërive jepen në Seksionin III të Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, të ndryshuar, neni 32. Ndërkohë që të dhënat e tjera të detyrueshme për subjektet, varësisht formës së tyre jepen nga neni 33-40 i Ligjit.

sipas legjislacionit në fuqi.

Për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare janë të detyrueshme këto të dhëna:

Emri, forma, data e themelimit, të dhënat e identifikimit të themeluesve, selia, objekti, në qoftë se është i përcaktuar, kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar, të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre, specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve.

Për regjistrimin fillestar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, është i detyrueshëm edhe njoftimi i vlerës së përgjithshme të kapitalit të nënshkruar, ndarja e kapitalit në një numër kuotash të barabartë me numrin e ortakëve, vlera dhe lloji i kontributit të secilit ortak, pjesa që kuota e secilit ortak zë në kapital, si dhe informacioni nëse kontributet e nënshkruara të kapitalit janë paguar ose jo¹⁹⁸.

Për regjistrimin fillestar të shoqërisë aksionare, janë të detyrueshme edhe këto të dhëna:

- a) vlera e kapitalit themeltar të nënshkruar dhe pjesa e paguar;
- b) numri dhe forma e aksioneve të nënshkruara;
- c) vlera nominale e secilit aksion;
- d) numri i aksioneve të nënshkruara nga secili aksioner;
- e) vlera dhe lloji i kontributit të secilit aksioner, si dhe pjesa e paguar prej secilit;
- f) kushtet e veçanta, që kufizojnë transferimin e aksioneve (nëse ka);
- g) nëse ka kategori të ndryshme aksionesh (të zakonshme, me përparësi, me të drejte

¹⁹⁸ Shih nenin 35 të Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

vote, pa të drejte vote), si dhe të drejtat që lidhen me to;

- h) procedurat për konvertimin e formës së aksioneve, nëse parashikohet në statut;
- i) vlera totale ose një parashikim i kostove të veçanta në ngarkim të shoqërisë për procedurat e themelimit;
- j) përparësitë që u njihen personave, që kanë marrë pjesë në themelimin e shoqërisë apo në transaksione të veçanta, që lidhen me fillimin e veprimtarisë (nëse ka);
- k) të dhënat e identifikimit të anëtarëve të këshillit dhe ekspertit kontabël të autorizuar; afati i emërimit të tyre; numri i anëtarëve të organeve drejtuese; procedurat e emërimit të anëtarëve të organeve drejtuese, nëse ndryshojnë nga parashikimet ligjore.

Përvec regjistrimit fillestar, shoqëria tregtare mbart detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjistër si: a) pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecures së veprimtarisë dhe raportin e auditimit; b) emërimin dhe shkarkimin e ekspertit kontabël të autorizuar, likuiduesve; c) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia; etj.

Informacioni pranë QKB-së mund të aksesohet në formë elektronike dhe në formë shkresore, duke u paraqitur pranë sporteleve të saj. Të dhënat për një shoqëri tregtare mund të merren nga Regjistri Tregtar në formën e ekstraktit të thjeshtë, i cili jep “*pamjen*” e shoqërisë në momentin e dhënë në të tashmen ose në formën e ekstraktit historik, i cili përmban në rend kronologjik veprimeve e kryera. Kërkimi në formë elektronike realizohet në faqen e internetit të QKB-së në seksionin <http://www.qkr.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/> nëpërmjet kërimit për një apo disa nga kategoritë si fjalë kyçe kërkimi të cilat janë: NIPT-i, emri i subjektit, adresa, aksioneri, emri tregtar, numri i identifikimit.

Kështu, faqja zyrtare e internetit e QKB-së nëpërmjet ekstraktit të thjeshtë mundëson informacionin e përgjithshëm si më poshtë: Emri i shoqërisë, data e themelimit, data e regjistrimit, numri unik i identifikimit, selia dhe adresat dytësore, forma ligjore, kohëzgjatja, objekti i aktivitetit, kapitali, administratori dhe afati i emërimit, procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore, kufizimet e kompetencave (nëse ka), të dhëna që njoftohen vullnetarisht nga vetë shoqëria pa pasur detyrim për t'i njoftuar ato, si për shembull emri tregtar, kontakte, marrëveshje barre siguruese etj.

Për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar jepet edhe: Kapitali, numri i përgjithshëm i kuotave, ortakët, vlera e kapitalit (Para/Natyre), numri i pjesëve, pjesëmarrja në përqindje;

Për shoqëritë aksionare jepet edhe: sistemi i administrimit me një apo dy nivele, anëtarët e këshillit të administrimit apo mbikqyrës sipas rastit, kapitali, vlera e kapitalit të shlyer, kategoritë e aksioneve (të zakonshme, me përparësi, me të drejte vote, pa të drejte vote), aksionarët, numri i aksioneve (me të drejte vote /pa të drejte vote), përqindja e pjesëmarrjes.

Në fund të ekstraktit paraqitet dhe statusi i shoqërisë, nëse është aktiv apo pasiv. Në fillimet e funksionimit të QKB-së, ekstrakti mundësonte dhe informacion nëse shoqëria ishte në proces likuidimi apo falimentimi por më pas kjo kategori u hoq dhe informacioni mund të merret vetëm pranë gjykatës kompetente. Regjistrimet e tjera të detyrueshme të shoqërisë ndër vite janë të kërkueshme nëpërmjet ekstraktit historik të saj.

Pse shoqëritë (*nuk*) duan të bëhen shoqëri publike?

Të qenit një shoqëri publike ka avantazhet dhe disavantazhet e përgjegjësitë e veta. Teorikisht, mendohet se të qenit një shoqëri publike, është një fazë normale e rritjes së shoqërisë. Kthimi në një shoqëri me ofertë publike, duket të jetë një mjet i rëndësishëm për

të ndryshuar strukturën financiare dhe të pronësisë në një pikë specifike në ciklin e jetës të një firme (Fischer, 2000:3).

Ndër studimet kryesore, Pagano, Panetta dhe Zingales (1998) si faktorë të rëndësishëm që pengojnë aftësinë e kompanive të vogla për t'u shndërruar në shoqëri me ofertë publike, renditen: mungesa e zbatimit të të drejtave të pronësisë së pakicave¹⁹⁹, ekspozimi më i madh i shoqërive të listuara tek autoritetet tatimore dhe ligjore, mungesa e investitorëve institucionalë të specializuar në kapitalin sipërmarrës ose mungesa e një tregu kapitalesh.

Së pari, është kostoja që shoqëron këtë proces, jo vetëm përsa i përket procedurës po dhe kostove që lidhen me anën rregullatore dhe mbikqyrjen. Qënia e një shoqërie publike, pra me tituj të tregtueshëm në një treg burse, do të thotë dhe përmbushje e detyrimeve që parashikon legjislacioni për shoqëri të tilla: publikimi i informacionit, raportimet e detyrueshme periodike, si dhe lëvizja e cmimit të aksioneve në bursë. Padyshim që roli i masave dhe kërkesave rregullatore për këto shoqëri ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në “disiplinimin” e tyre. Qënia publike i siguron shoqërisë burime të reja financimi. Gjithashtu qenia publike ndikon në markën e shoqërisë duke i rritur besueshmërinë tek konsumatori dhe klienti.

¹⁹⁹ Sipas Fischer (2000) Aksionarët e shumicës vazhdojnë të ruajnë kontrollin qoftë duke ruajtur paketën kontrolluese ose nëpërmjet të drejtës së votës. (për më shumë shih Christoph Fischer “Why Do Companies Go Public? Empirical Evidence from Germany’s Neuer Markt”, Ludwig-Maximilians-Universität München Seminar für Kapitalmarktforschung und Finanzierung, 2000, gjendet nw https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=229529

KAPITULLI VIII PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS (PSK)

8.1 Përgjegjësia sociale e korporatës

Me përgjegjësi sociale kuptohet detyrimi i organizatave, organizmave dhe individëve për të vepruar në përfitim të shoqërisë në kuptimin e gjerë. Pavarësisht këtij përcaktimi mënyra sesi është kuptuar, perceptuar dhe realizuar përgjegjësia sociale ka qenë e ndryshme në periudha dhe vende të ndryshme, çka është reflektuar jo vetëm në teori e studime akademike po dhe në veprimtarinë e organizatave. Në këtë aspekt, termi organizate përfshin shtetin si një organizatë e sundimit politik, si dhe organizmat shtetërore të sektorit publik dhe organizmat private pavarësisht formës së tyre të organizimit (tregtare apo jo fitim prurëse).

Ndonëse grupet e aktivistëve sociale gjatë viteve '60 advokuan për një koncept më të gjerë të përgjegjësisë sociale, u desh ndërhyrja në nivel legjislativ me rëndësi sociale në fillimin e viteve '70 që shënoi krijimin e agjensive të ndryshme shtetërore si agjensitë e mbrojtjes së mjedisit, të mundësive të barabarta në punësim, të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe mbrojtjes së konsumatorit etj. Këto trupa të rinj në nivel qeverie përcaktuan se tashmë politika publike kombëtare njihte zyrtarisht mjedisin, punonjësit, dhe konsumatorët si grupe interesi të rëndësishëm dhe legjitimë të biznesit (Carroll 1991), të cilët kërkonin të drejta ligjore dhe etike, grupe të cilat u adresuan qartësisht dhe nga Freeman në teorinë e tij.

Në këtë mënyrë përgjegjësia sociale përkthehet në kuptime të ndryshme kohë dhe vende të ndryshme dhe këtij kuptimi i shtohen dhe shumë çështje të reja të realitetit sot duke pasur parasysh rolin e biznesit në një shoqëri në ndryshim. Parimet baze të përgjegjësisë sociale zhvillohen brenda kompanive dhe shpesh nxiten nga organizatat jofitimprurëse. Për më tepër, ajo që vlen të theksohet është “institucionalizimi” i përgjegjësisë sociale në nivele të

ndryshme, duke u kthyer në një çështje të organizma të shumtë, si Banka Botërore, IFC²⁰⁰, vetë BE dhe qeveritë e shteteve²⁰¹. Qeveritë mund të vendosin si referencë korniza të ndryshme, të inkurajojnë veprimtaritë dhe të nxisin dialogun jo vetëm për ndërmarrjet publike dhe shoqëritë publike po dhe për ato private (që nuk janë të listuara në tregun e bursës).

Vëmendja në rritje ndaj përgjegjësisë së korporatës nuk ka qenë tërësisht vullnetare (Porter dhe Kramer, 2006:480). E vënë në fokusin e qeverisve, mediave, grupeve të ndryshme aktivistësh, dhe të presionit publik (i cili jo rrallëherë shënjestronte shoqëritë më të suksesshme edhe kur ato mund të kishin pak ose aspak lidhje me çështjen në fjalë), ajo u kthyer në një prioritet të pashmangshëm, ndonëse përjasja ndaj saj mbetet e fragmentarizuar nga vetë biznesi dhe strategjitë e tij. Shumë shoqëri u përballën me reagimin e publikut (grupe interesi të jashtëm) për çështje të cilat nuk i kishin gjykuar apo konsideruar si pjesë të përgjegjësisë së biznesit të tyre. Padyshim që pikëpamjet e grupeve të interesit janë të rëndësishme por këto grupe nuk mund të kuptojnë plotësisht aftësitë e një shoqërie, pozicion konkurrues ose shkëmbimet dhe kompromiset që duhet të bëjë (Porter dhe Kramer, 2006: 485).

Nëse, përkundrazi shoqëritë tregtare do të analizonin perspektivat e tyre të përgjegjësisë sociale duke përdorur të njëjtat korniza të cilat drejtojnë zgjedhjet e tyre të biznesit, ato do të zbulonin se përgjegjësia sociale mund të jetë më shumë se një kosto, një ndalim ose një vepër

²⁰⁰ Vlen të përmendin këtu udhëzimet e OECD për Kompanitë Multinacionale në nivel standardesh apo UN Global Impact në nivel iniciativash.

²⁰¹ Në disa vende, si për shembull vendet e Bashkimit Europian, shoqëritë tregtare duhet të përfshijnë çështje të përgjegjësisë sociale në raportet e tyre vjetore.

bamirësie – ajo mund të jetë një mundësi, inovacion, dhe avantazh konkurrues (Porter dhe Kramer, 2006:480).

Përgjegjësia sociale bazohet në parimin se shoqëria tregtare është një qytetar i shoqërisë në të cilën ekziston dhe vepron (Woolfe, 2013: 172).

Në fakt, koncepti i shoqërisë tregtare si qytetar dhe përgjegjësia sociale janë në përputhje me teorinë e grupeve të interesit në lidhje me drejtimin e shoqërisë. Pra, shoqëria tregtare ka detyrime jo vetëm ndaj aksionarëve po dhe ndaj punonjësve, gjithë klientëve, furnizuesve dhe ndaj gjithë shoqërisë, detyrime të cilat duhet të njihet nga vetë shoqëria tregtare. Nga kjo pikëpamje qëllimi i maksimizimit të fitimit pa marrë në konsideratë përgjegjësitë sociale dhe mjedisore nuk është i pranueshëm.

Çdo biznes apo aktivitet tregtar lind dhe zhvillohet brenda kuadrin të kushteve shoqërore të dhëna, me të cilat ai ndërvepron. Ky kuadër shoqëror përmban brenda vetes si anëtarë dhe punonjës të shoqërisë tregtare e cila zhvillon aktivitetin tregtar, klientët dhe furnizuesit e saj. Përgjegjësia sociale e biznesit përfshin pritshmëritë ekonomike, ligjore, etike që shoqëria ka nga organizatat në një moment të dhënë në kohë (Carroll, 1979). Kompanitë angazhohen në përgjegjësinë sociale të korporatës (CRS) kryesisht sepse mund të përfitojnë/vjelin disa lloje benefitesh nga ky angazhim (Branco & Rodrigues, 2007). Kompanitë mbartin detyrimin për të marrë në konsideratë nevojat e dëshirat e shoqërisë në planin afatgjatë, që nënkupton se ato angazhohen në aktivitete që promovojnë përfitimet për shoqërinë dhe minimizojnë efektet negative të veprimeve të tyre për sa kohë që kompania nuk paragjykohet duke u angazhuar në aktivitete të tilla (Branco & Rodrigues, 2007).

Sipas Bankës Botërore, sot PSK është angazhimi i biznesit për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vazhdueshëm – të punosh me punonjësit, familjet e tyre, komunitetin dhe

shoqërinë më gjerë për të përmirësuar cilësinë e jetës me anë të mënyra të cilat janë të mira për biznesin dhe për zhvillimin²⁰². Në vetvete përgjegjësia sociale është procesi i manaxhimit të kostove dhe përfitimeve të biznesit ndaj grupeve të brendshme dhe të jashtme të interesit, nga punonjësit, te aksionarët, dhe investitorët te konsumatorët, furnizuesit, shoqëria civile dhe komuniteti. Duhet pranuar që biznesi është pjesë e shoqërisë dhe si i tillë zotëron potencialin e nevojshëm për të ndikuar te shoqëria, qoftë në aspektin pozitiv dhe atë negativ. Në fakt mbetet pyetja e parashtruar nga Bowen në 1953 se si interes e biznesit në planin afatgjatë bashkohen me interesat e shoqërisë’.

Studimet sugjerojnë se në vetvete përgjegjësia sociale përbëhet nga katër lloj përgjegjësish sociale dhe ato janë: ekonomike, ligjore, etike dhe filantropike (Carroll 1979).

Përgjegjësitë ekonomike – organizmat e biznesit janë krijuar si entitete ekonomike me qëllim ofrimin e mallrave dhe shërbimeve te anëtarët e shoqërisë, ku fitimi ishte incentiva fillestare për sipërmarrjen.

Përgjegjësia ligjore – Pritshmëria nga biznesi nuk është vetëm fitimi po në të njëjtën kohë prej tij pritet që të veprojë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e vendosura nga shteti, në nivel lokal, qendror, kombëtar apo federal sipas rastit.

Përgjegjësia etike – Pavarësisht se përgjegjësia ekonomike dhe ligjore përfshijnë norma etike në lidhje me drejtësinë, lojën e ndershme etj, përgjegjësia etike ka të bëjë me ato praktika dhe aktivitete që priten apo ndalohen nga vetë shoqëria pavarësisht se nuk janë të zbardhura në ligje apo të shkruara në kode. Në fakt këto përgjegjësi shpesh janë të keqpërcaktuara ose

202 Shih Ward H., Public Sector roles in Strengthening the Corporate Social Responsibility: Taking Stock, The World Bank, IFC, 2004

jo të qarta, ose shpesh në qendër të debateve publike përsa i përket ligjshmërisë së tyre dhe si të tilla bëhet të vështira për biznesin.

Përgjegjësia filantropike – Përfshin veprimtarinë e kompanive që janë në përgjigje të pritshmërive të shoqërisë nga biznesi si një “qytetar i mirë”, në promovimin e mirëqenies dhe të vullnetit të mirë. Kjo përgjegjësi dallon nga përgjegjësia etike pasi për të nuk janë të pritshme nga një pikpamje morale apo etike.

Ndonëse përgjegjësitë si më lart u sqaruan si zëra më vete, ato nuk janë përjashtuese dhe nuk mund të zëvendësojnë njëra – tjetrën, pavarësisht se përballen me njëra – tjetrën në një situatë tensionin dinamike. Ndonëse në kuptimin e konservatorëve, kjo situatë tensioni shihet si një konflikt mes “shqetësimit të kompanisë për fitim” ndaj “shqetësimit të kompanisë për shoqërinë”, në fakt kemi të bëjmë me një realitet nga pikpamja organizative dhe funksionale dhe sesi kompanitë duhet të angazhohen me veprimet, vendimet dhe programet e tyre për të përmbushur këto përgjegjësi.

Sipas Porter dhe Kramer (2006: 483), mbështetësit e përgjegjësisë sociale kanë katër argumenta pro për qëndrimin e tyre: detyrimi moral, qëndrueshmëria, licenca për të ushtruar aktivitetet dhe reputacioni. Qasja morale është se shoqëritë kanë detyrimin për të qenë qytetarë të mirë dhe “të bëjnë gjënë e duhur”, pra të arrijnë suksesin tregtar duke respektuar vlerat etike, njerëzit, komunitetin, dhe mjedisin. Qëndrueshmëria e vë theksin te çështjet e mjedisit dhe komunitetit (Porter dhe Kramer, 2006:483)²⁰³. Koncepti i licencës për të vepruar lidhet me faktin që cdo formë organizmi e shoqërive tregtare si dhe biznesi që ajo bën, i nënshtrohet

²⁰³ Një përcaktim i shkëlqyer u bë në vitet 1980, nga Kryeministri i Norvegjisë, Gro Harlem Brundtland, dhe që u përdor nga Këshilli Botëror për Zhvillim të Qëndrueshëm: “Të plotësojmë nevojat e së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre” (për më shumë shih Porter dhe Kramer, 2006: 483).

një sistemi rregullash dhe lejesh, qofshin këto të shprehura apo në heshtje, nga shteti, organet e ndryshme të pushtetit, komuniteti dhe/ose grupe të tjera interesi²⁰⁴.

Në vitet e fundit qeveritë e shteteve u janë bashkuar grupeve të tjera të interesit duke marrë një rol domethënës si nxitës të përgjegjësisë sociale të korporatës duke punuar së bashku me organizata ndërqeveritare dhe duke njohur rëndësinë e politikave publike në nxitjen e përgjegjësisë sociale të korporatës (Albareda et al. 2008).

Shoqëritë e suksesshme tregtare kanë nevojë për një shoqëri të shëndetshme (Porter dhe Kramer, 2006: 486), sepse me veprimet e tyre ato ndikojnë te njëra – tjetra, për mirë apo për keq. Nisur nga këto argumenta, atëherë për të përmbushur detyrimet e përgjegjësisë sociale, shoqëria tregtare duhet të bëjë një balancim mes vlerave që udhëheqin atë (Vlera e aksionarëve dhe vlera e grupeve të interesit), në mënyrë që të përfitojnë të dyja palët.

Pavarësisht vullnetit të mirë dhe praktikave të përgjegjësisë sociale të vetë kompanive, te cilat vlerësohen dhe mbështeten, ato nuk mund të zëvendësojnë rolin e shtetit dhe të sektorit publik, të cilët nga ana e tyre duhet të kontribuojnë me një kuadër të qartë e mirëpërcaktuar ligjor dhe rregullator dhe stimulues.

8.2 Argumentat kundër “Përgjegjësisë sociale të korporatës”

Në qendër të debatit të sotëm global për qeverisjen e korporatës²⁰⁵ është ndarja e dukshme e opinionit mbi qëllimin thelbësor të korporatës (Jensen, 2001:8). Konceptimi i sotëm i

²⁰⁴ Në formë ilustrative dhe krijimi, themelimi, regjistrimi dhe funksionimi i shoqërive tregtare në vend është subjekt i disa ligjeve që nis që me regjistrimin e saj si person juridik, si dhe me regjistrimet detyruese në lidhje me tatime, sigurime etj. Gjithashtu veprimtari të caktuara, si për shembull komunikimet elektronike kërkojnë paisjen me autorime nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike, autorizime të cilat mund të jepen nga AKEP pas përmbushjes së kërkesave ligjore (qenia operator alternative), me tender (si për shembull përdorimi i frekuencave si burim i kufizuar), apo me vetëdeklarim.

²⁰⁵ Në fakt, ky debat kryesisht përfshin shoqëritë e mëdha aksionare me ofertë publike.

përgjegjësisë sociale të korporatës nënkupton se shoqëritë në mënyrë të vullnetshme integrojnë çështje sociale dhe mjedisore në veprimet e ndërveprimet e tyre me grupet e interesit (Branco, Rodrigues, 2007).

Buchholz (1991) identifikoi pesë elementë kryesorë në lidhje me përgjegjësinë sociale të korporatës:

- Kompanitë kanë përgjegjësi përtej (veç) prodhimit të mallrave dhe shërbimeve për përfitime;
- Këto përgjegjësi përfshijnë dhënien e ndihmës për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme sociale, sidomos ato probleme të cilat janë krijuar prej tyre;
- Kompanitë kanë një përbërje më të gjerë sesa aksionarët;
- Kompanitë kanë ndikime të cilat shkojnë përtej transaksioneve të thjeshta të tregut;
- Kompanitë i shërbejnë një rreze më të gjerë vlerash njerëzore nga c'mund të përfshihen duke pasur fokus vetëm vlerat ekonomike.

Përgjegjësia sociale kuptohet si një marrëdhënie e dyanshme e cila përfshin njohjen nga ana e “shoqërisë” të domethënies dhe përpjekjeve të kompanive për të marrë miratimin e “shoqërisë” për sjelljen e tyre (Branco & Rodrigues, 2007).

Argumentat kundër PSK bazohen te pikëpamja e funksionit institucional të kompanisë ose te të drejtat e pronësisë (Branco & Rodrigues, 2007). Nga pikëpamja e të drejtave të pronësisë, i rikthehem i sërish teorisë së Friedman sipas të cilit detyrimi i vetëm i manaxherëve është të maksimizojnë fitimet e aksionarëve (pronarëve). Në fakt, në një artikull të tij, Freeman “*mirëpriti*” Friedman nën ombrellën e madhe të teoricienëve të

grupeve të interesit, sepse sipas Freeman krijimi i vlerave për grupet e interesit është një mënyrë për të maksimizuar fitimet (Freeman 2008:166; Ferrero et al. 2012: 2).

Vetë argumentimi nga pikëpamja e funksionit insitucional sipas Branco dhe Rodrigues (2007) mund të shihet nga tre këndvështrime:

- Së pari, organizatat e tjera si qeveritë, ekzistojnë në mënyrë që të merren me ato lloj funksionesh shoqërore që kërkohen nga veprime sociale të përgjegjeshme;
- Së dyti, manaxherët nuk shihet që të kenë aftësitë dhe/ose kohën për të vënë në zbatim veprime të tilla publike; dhe
- Së treti, në dallim nga politikanët të cilët zgjidhen në mënyrë demokratike, manaxherët nuk mund të jenë përgjegjës për veprimet e tyre të përgjegjësive sociale.

Përsa kohë që tregu është në gjendje që të ofrojë benefitet e dëshiruara grupeve të ndryshme të interesit, ato nuk kanë nevojë që manaxhimi të konsiderojë në mënyrë eksplicite interesat e tyre në marrjen e vendimeve (Boatright, 2006).

Literatura e qeverisjes së korporatës e vë theksin te nevoja për një kuadër të qartë rregullash se kush është vendimmarrësi kryesor, kush duhet të informohet në lidhje me këto vendime, dhe sesi mund të parandalohet abuzimi nga grupe të ndryshme interesi (Doing Business report, 2016). Sipas Bainbridge (2014), çdo model i qeverisjes së korporatës duhet t'i japë përgjigje dy pyetjeve bazike: *Kush vendos?* dhe *Interesat e kujt mbizotërojnë?* Sepse shoqëria është diçka e cila nuk mund të zotërohet (Bainbridge, 1993). Secili zotëron një input të caktuar që e këmben për një pagesë të caktuar. Megjithatë nuk duhet të harrojmë që duke zotëruar aksionet, aksionarët kanë të drejtë të kenë benefite, janë mbajtës të drejtash dhe kanë një lloj kontrolli të cilat grupet e tjera të interesit nuk i kanë (Ferrera et al. 2012: 20).

Organizatat e biznesit monitorohen gjithnjë e më shumë lidhur me funksionin dhe përgjegjësinë e tyre sociale, sidomos ngaqë shumë prej tyre janë fuqizuar në masë të tillë sa mund të ushtrojnë ndikim të ndjeshëm në kushtet ekonomike politike kombëtare dhe ndërkombëtare (Dine, Bletcher, 2016:10).

PSK shihet si një mjet që mund të përmirësojë fitimet. Në përgjithësi vlerësohet se për shoqëritë e angazhuara në PSK, disa nga benefitet që rrjedhin prej saj janë rritja e besimit dhe respektit, përmirësohet imazhi dhe kjo mund të ndikojë në rritjet e shitjeve nga njëra anë, në besnikërinë e klientëve dhe të punonjësve nga ana tjetër. Gjithashtu ndikimi mund të shihet dhe në tërheqjen e një stafi më të kualifikuar dhe profesionist. Angazhimi në aktivitete të PSK, mund të sjellë ulje kostosh për procese të caktuara si dhe të përmirësojë efikasitetin. Një avantazh i shtuar për shoqëritë me ofertë publike është se aktivitetet agresive të PSK mund t'i ndihmojnë ata të fitojnë një kuotim të mundshme në Indeksin e Qëndrueshmërisë FTSE4Good ose Dow Jones ose tregues të tjerë të ngjashëm²⁰⁶. Kjo mund të rrisë çmimin e aksioneve të shoqërisë, duke e bërë që aksionet të jenë më fitimprurëse dhe aksionerët më të lumtur²⁰⁷. Pra, në mënyrë indirekte, ndërsa PSK i shërben grupeve të ndryshme të interesit si komunitetit, konsumatorëve etj, ajo rrit vlerën e shoqërisë dhe të fitimit të saj, duke i shërbyer kështu dhe një grupi tjetër jo më pak domethënës interesi: aksionarëve të shoqërisë. PSK pmund të përkthehet në një incentivë për shoqërinë, që të marrë përgjegjësi ndaj disa grupe të ndryshme interesi dhe jo vetëm ndaj aksionarëve. Në këtë mënyrë, kthimi i investimit në PSK shihet e shpërndarë në impaktin që ka në grupet e ndryshme të interesit në shoqëri.

Por sa është ky impakt i PSK në fitimet e shoqërisë?

²⁰⁶ <http://business-ethics.com/2015/05/05/does-corporate-social-responsibility-increase-profits/>

²⁰⁷ <http://business-ethics.com/2015/05/05/does-corporate-social-responsibility-increase-profits/>

PSK shpesh shihet si mbartëse e kostove afatshkurtra që nuk japin përfitim të menjëhershëm financiar për shoqërinë. Friedman, në veçanti, dyshonte nëse PSK ishte shoqërisht e dëshirueshme. Megjithatë ai vuri në dukje se ka shumë rrethana në të cilat një menaxher i një firme mund të angazhohet në veprime që i shërbejnë interesit afatgjatë të pronarëve të firmave dhe që gjithashtu kanë një ndikim pozitiv social. Shembujt janë: investimet në komunitet që mund të përmirësojnë cilësinë e punonjësve potencialë, ose kontributet për organizatat bamirëse për të përfituar nga lehtësirat tatimore (Murillo, Martinek, 2009²⁰⁸). Pra, në këtë rast veprime të tilla justifikohen nga pikëpamja e interesit të vetë firmës, ndërkohë që krijojnë vullnet të mirë të korporatës si një nënprodukt. Për më tepër, kjo vullnet i mirë mund të shërbejë për të dalluar një kompani nga konkurrentët e saj, duke ofruar një mundësi për të gjeneruar përfitime shtesë ekonomike (Murillo, Martinek, 2009).

Nisur nga qëndrimi i Friedman, ekonomistët Bryan Husted dhe José de Jesus Salazar²⁰⁹ shqyrtuan kushtet nën të cilat PSK mund të justifikohet ekonomikisht, për shembull, një mjedis ku është e mundur që investimet në PSK të integrohen në operacionet e një shoqërie që synon maksimizimin e fitimit. Autorët vlerësuan tre tipe të motivimit që shoqëritë marrin në konsideratë para se të investojnë në aktivitetet sociale:

- Motivimi altruist: qëllimi i firmës është të prodhojë një nivel të dëshiruar të PSK pa marrë parasysh maksimizimin e përfitimeve sociale të saj, dmth. përfitimet neto private të fituara nga firma si pasojë e përfshirjes së saj në aktivitetet sociale;

²⁰⁸ Shih <https://www.stlouisfed.org/publications/regional-economist/april-2009/corporate-social-responsibility-can-be-profitable>

²⁰⁹ Husted, Bryan W.; and Salazar, José de Jesus. "Taking Friedman Seriously: Maximizing Profits and Social Performance." *Journal of Management Studies*, January 2006, Vol. 43, No. 1, pp. 75-91. (për më shumë shih <https://www.stlouisfed.org/publications/regional-economist/april-2009/corporate-social-responsibility-can-be-profitable>)

- Motivimi egoist: firma është e detyruar të përfshihet në PSK nga subjektet e jashtme që vlerësojnë ndikimin e saj shoqëror;
- Motivimi strategjik: firma identifikon aktivitetet shoqërore që konsumatorët, punonjësit ose investitorët e vlerësojnë dhe i integron ato aktivitete në objektivat e saj që synojnë maksimizojnë fitimin.

Në marrëveshje me Friedman, Husted dhe Salazar arritën në përfundimin se përfitimet potenciale për firmën dhe shoqërinë janë më të mëdha në rastin strategjik: kur "aktivitetet e përgjegjësisë shoqërore " të firmës përputhen me vetë interesin e firmës (Murillo, Martinek, 2009).

Siegel dhe Vitaliano²¹⁰ shqyrtuan teorinë se firmat angazhohen strategjikisht në PSK me maksimizimin e fitimit. Ata konkludojnë se aktivitetet e PSK të profilit të lartë (p.sh., përpjekjet vullnetare për të reduktuar ndotjen ose për të përmirësuar kushtet e punës për punonjësit) kanë më shumë gjasa të ndërmerren kur aktivitetet e tilla mund të integrohen më lehtë në strategjinë e diferencimit të firmës. Firmat zgjedhin të investojnë në lloje të ndryshme të PSK kur kujdes për grupeve të ndryshme të interesit. Një pjesë më e madhe e firmave prodhuese të mallrave treguan kapacitet në fushat e çështjeve të mjedisit. Grupet e interesit në firmat e shërbimeve nuk kanë të ngjarë të vlerësojnë përpjekjet në PSK lidhur me mjedisin, për shkak të perceptimit të ulët të ndikimit të shërbimeve në mjedis sesa firmat prodhuese.

²¹⁰ Siegel, Donald S.; and Vitaliano, Donald F. "An Empirical Analysis of the Strategic Use of Corporate Social Responsibility." *Journal of Economics and Management Strategy*, Fall 2007, Vol. 16, No. 3, pp. 773-92. (për më shumë shih <https://www.stlouisfed.org/publications/regional-economist/april-2009/corporate-social-responsibility-can-be-profitable>)

Sipas studimit të Florida Atlantic University's College of Business, Bhandari dhe Javakhadze²¹¹ të cilët shqyrtuan marrëdhëniet midis PSK dhe efikasitetit me të cilin shoqëritë ndajnë burimet e tyre kapitale, në një periudhë nga 1992 deri në 2014, është vënë në pah se theksimi i PSK nuk është i mirë për aksionarët. “Nëse jeni investitor ju duhet të mendoni dy herë para se të investoni në ato firma që theksojnë PSK” (Worstall 2017). Fokusimi në strategjitë e PSK-së imponon kostot për firmat që në afat të gjatë të çojnë në humbje për aksionarët e tyre. PSK zvogëlon performancën e përgjithshme të një firme dhe efikasitetin e investimeve. Investimet duhet të ndjekin mundësitë e rritjes, dhe PSK shtrembëron këtë marrëdhënie, sepse ai largon burimet e një firme nga praktikat e saj bazë. Ky shtrembërim është më i ulët në firmat ku kompensimi i drejtorit lidhet me çmimin e aksioneve ose në firmat që janë të pasura me burime (Javakhadze, 2017)²¹². Nëse investohet në aktivitete PSK atëherë nuk do të ketë burime të mjaftueshme për të investuar në projekte më fitimprurëse. Kjo mund të jetë e mirë për shoqërinë, mund të jetë mirë për menaxherët, por nuk është mirë për aksionarët”.

Baron, Maretno, Harjoto dhe Hoje (2009)²¹³, konkluduan se "Për industrinë e konsumit, një PSK më e madhe, lidhet me një performancë më të mirë financiare të shoqërisë, dhe e kundërta është e vërtetë për industrinë industriale. Studimet empirike kanë shqyrtuar lidhjen

²¹¹ Florida Atlantic University's College of Business, Avishek Bhandari, David Javakhadze “Corporate social responsibility and capital allocation efficiency”, Journal of Corporate Finance, Volume 43, April 2017, fq. 354-377, për më shumë shih <https://www.forbes.com/sites/timworstall/2017/06/03/no-surprise-at-all-corporate-social-responsibility-reduces-profits/#13b71a503ef2>

²¹² Për më shumë shih <https://www.prnewswire.com/news-releases/fau-study-says-corporate-social-responsibility-does-not-prove-to-be-a-profitable-investment-for-most-companies-300466555.html>

²¹³ David P. Baron, Maretno A. Harjoto, and Hoje Jo, “**The Economics and Politics of Corporate Social Performance**” (<http://www.socialinvest.org/resources/research/documents/2009WinningPrize-Moskowitz.pdf>) (April 21, 2009), (për më shumë shih <http://business-ethics.com/2015/05/05/does-corporate-social-responsibility-increase-profits/>)

ndërmjet PSK dhe performancës financiare të korporatës, dhe ndërsa rezultatet janë të përziera, në përgjithësi kërkimi ka gjetur një korrelacion pozitiv por të dobët”.

Cristiana Manescu (2010)²¹⁴ në studimin e saj, "Implikimet Ekonomike të Përgjegjësisë Sociale të Korporatës dhe Investimeve të Përgjegjshme", u shpreh se “aktivitetet e PSK-së në përgjithësi nuk kanë një efekt negativ mbi rentabilitetin, por në ato pak raste ku ato kanë një efekt pozitiv, ky efekt është mjaft i vogël ”.

Studimi nga Kellogg School of Management (Northwestern University) nxjerr në pah se kur një shoqëri investohet në PSK, ajo iu dërgon një sinjal investitorëve në lidhje me performancën e përgjithshme e financiare të saj. Kërkuesit shpjegojnë se kur investitorët shohin një firmë të mbajë ose t'i kushtojë burime për iniciativat PSK, ata konkludojnë se drejtuesit e saj janë duke vepruar sipas informacioneve private për të ardhurat e ardhshme dhe cash floë e shoqërisë. Me fjalë të tjera, PSK është ajo që bëjnë kompanitë "e pasura"²¹⁵.

Në një tjetër studim të zhvilluar nga ky Universitet, u analizuan se si aktivitetet me natyrë ekologjike ndikojnë në performancën operative të kompanive - një sërë masash që përfshijnë kostot, të ardhurat, kufijtë dhe fitimet²¹⁶. Për studimin e tyre, ata përdorën një dhëna nga njoftimet për shtyp për të identifikuar kompanitë që operojnë në industrinë e kompiuterave dhe elektronikës të cilat kishin pasur aktivitet me natyrë ekologjike në periudhën 2000 dhe 2011 dhe që i kishin të dhënat financiare publike. Të dhënat e tyre u krahasuan me shoqëri

²¹⁴ Cristiana Manescu (2010), “Economic Implications of Corporate Social Responsibility and Responsible Investments,” University of Gothenburg’s School of Business, Economics and Laë, Sweden, 6 /12/2010 (për më shumë shih <http://business-ethics.com/2015/05/05/does-corporate-social-responsibility-increase-profits/>)

²¹⁵ Shih How Companies Benefit from Corporate Social Responsibility, March 1, 2018, Thomas Lys, James Naughton, Sunil Chopra, Dylan Minor, Alexander Chernev, Shannon Schuyler, Megan Kashner, gjendet në <https://insight.kellogg.northwestern.edu/article/benefits-of-corporate-social-responsibility>, aksesuar në 27 nëntor 2018.

²¹⁶ Shih <https://insight.kellogg.northwestern.edu/article/benefits-of-corporate-social-responsibility>

që nuk kishin pasur aktivitete me natyrë ekologjike, por ishin të ngjashme në një shumëllojshmëri faktorësh të tjerë. Kur studiuesit analizuan performancën operative të kompanive dy vjet përpara njoftimit publik dhe dy vjet pas këtij njoftimi, ata arritën në përfundimin se në përgjithësi aktivitetet me natyrë ekologjike sollën impak: kompanitë që i ndoqën ato performuan më mirë se ato që nuk kishin aktivitete të tilla, dhe diferenca ishte sidomos më e thjeshtuar në vitin e dytë pas bërjes publike të një angazhimi të tillë²¹⁷.

8.3 PSK në Shqipëri

8.3.1 Trajtimi në nivel ligji

Një kuadër i përgjegjshëm nga pikëpamja sociale kërkon që aktorët pjesëmarrës në ekuacionin socio-ekonomik apo në projekte ekonomike të mëdha (d.m.th. qeveritë, investorët dhe komunitetet) të ndajnë përgjegjësi specifike dhe të përbashkëta për funksionimin e sistemit (Gyua 2013:1²¹⁸). Një studim për PSK-në, i kryer në kontekstin e Ballkanit Perëndimor, zbuloi se PSK ishte një koncept relativisht i ri në rajon, i cili promovohet kryesisht nga korporatat shumëkombëshe dhe agjencitë për zhvillimin ndërkombëtar²¹⁹. Këto vende janë më problematike duke qenë se, si pjesë e shumë viteve

²¹⁷ Përfitimi më i madh afatgjatë padyshim që ishte tek kompanitë që merreshin me aktivitete më komplekse: për shembull, Hewlett-Packard kishte adoptuar teknologji të re nga Citrix Systems të dizajnuara për të ulur konsumin e energjisë dhe burimet e ftohjes në serverat kompiuterikë.

²¹⁸ Gjendet në dokumentin “ANALIZA E SITUATËS SË PËRGJEGJËSISË SOCIALE TË KORPORATAVE në Shqipëri Praktikë dhe Sfidat Aktuale të Industrisë Nxjerrëse” që gjendet në <https://www.osce.org/sq/albania/106221?download=true>

²¹⁹ Prezenca e OSBE-së në Shqipëri së bashku me Ambasadën Kanadeze në Shqipëri e konsideruan si thelbësore kryerjen e një studimi mbi praktikën ekzistuese të CSR-së në industrinë nxjerrëse në vend, dhe u përqendrua në tetë kompanitë kryesore ndërkombëtare dhe vendase që kryejnë aktivitetin e tyre në katër sektorët kryesorë nxjerrës: nafta & gazi, minierat, prodhimi i çimentos dhe hidrocentralet. Ato kryen një studim mbi PSK në vitin 2012, gjetjet e të cili u publikuan në dokumentin “Analiza e situatës së përgjegjësisë sociale të korporatave në Shqipëri. Praktikë dhe Sfidat Aktuale të Industrisë Nxjerrëse”, që gjendet në <https://www.osce.org/sq/albania/106221?download=true>

nën regjimin komunist, sipërmarrjet shtetërore të asaj kohe, nuk kishin të inkuorpuar PSK si noción të pastër, por zbatonin programe sociale me kosto të konsiderueshme, me qëllim indoktrinimin e njerëzve”, – pohojnë ekspertët (Monitor, 05/06/2016)²²⁰. Shqipëria ka hedhur hapat e parë përta i përket PSK. Gjatë dy dekadave të fundit, ndërkohë që si globalizimi ashtu edhe integrimi evropian janë zhvilluar me ritme të shpejta, Shqipëria, njësoj si shumë vende të tjera në rajon, ka filluar një rrugëtim ambicioz duke ndërthurur pluralizmin politik, tregjet e hapura dhe konkurruese dhe një shoqëri civile mjaft aktive²²¹. MZHETTS, me mbështetjen e UNDP-së, krijoi Planin Kombëtar të Veprimit PSK për periudhën 2011-2014, i cili përmbante 22 tregues që do të shërbenin si etalon për matjen e performancës së PSK pasi të jenë përcaktuar standardet, së bashku me informacion me praktikatat më të mira PSK. Çështjet kryesore të PSK-së që mbulohen nga Plani Kombëtar i Veprimit përfshijnë: puna, mjedisi, komuniteti dhe rrjeti i dyqaneve, korrupsioni dhe transparenca, qeverisja e korporatave, konsumatorët/produktet²²².

Miratimi i LSHT si dhe Kodi i Drejtimit të Brendshëm të shoqërive pa listuara në bursë²²³ janë gjithashtu një meknizëm që do t'i vijë në ndihmë PSK. Synimi i ligjit për shoqëritë tregtare ishte sanksionimi i një sistemi të thjeshtë, të qartë dhe të përditësuar, i aftë për të thithur investimet e huaja dhe për të siguruar harmonizimin e dispozitave të tij me legjislacionin evropian të shoqërive tregtare, përfshirë direktivat përkatëse (Dine, Bletcher,

²²⁰ Gjendet në <http://www.monitor.al/per-biznese-shqiptare-te-pergjegjishme-2/> aksesuar në 30 nëntor 2018.

²²¹ Gjendet në dokumentin “Analiza e situatës së përgjegjësisë sociale të korporatave në Shqipëri. Praktikatat dhe Sfidat Aktuale të Industrive Nxjerrëse”, që gjendet në <https://www.osce.org/sq/albania/106221?download=true>

²²² Për më shumë shih dokumentin “Analiza e situatës së përgjegjësisë sociale të korporatave në Shqipëri. Praktikatat dhe Sfidat Aktuale të Industrive Nxjerrëse”, që gjendet në <https://www.osce.org/sq/albania/106221?doenload=true>

²²³ Shënim: Nga vëzhgimet e bëra për shoqëritë që operojnë në vend, shihet se Kodi është miratuar nga Banka Kombëtare Tregtare Sh.A., Alpha Bank Sh.A. dhe Telekom Albania Sh.A. Ndërkohe nga shoqëritë më kapital publik nuk rezulton ndonjë angazhim i tyre në lidhje me miratimin e Kodit.

2016:6). Rrjedhimisht ligji për shoqëritë tregtare pasqyron standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare lidhur me të drejtën tregtare, drejtimin e brendshëm të shoqërive tregtare dhe përgjegjësinë sociale²²⁴ (Dine, Bletcher, 2016:6). Për më tepër, zbatimi i standardeve të PSK-së shërben si një mjet për të krijuar përparësi konkurruese për bizneset shqiptare, si ato rajonale ashtu edhe ato që veprojnë në tregun evropian, dhe ka për qëllim krijimin e një imazhi më të mirë për kompanitë, menaxhimin e riskut dhe vlera të shtuara²²⁵.

Në një analizë të LSHT, mund të akomodohet PSK në disa parashikime të tij:

- (i) **Mbrojtja e mjedisit.** Pavarësisht se mbrojtja e mjedisit rregullohet me ligj të veçantë²²⁶, LSHT, apelon në mënyrë të veçantë në lidhje me mjedisin. Në dy raste, ndikimi i veprimtarisë së shoqërisë në mjedis është vendosur në dispozitën që përcakton *Detyrimin e besnikërisë dhe përgjegjësisë* përkatësisht për administratorët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në nenin 98²²⁷ dhe për administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit në shoqëritë aksionare në

²²⁴ Në librin e tyre, “Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, teksti me shpjegime, në versionin e rishikuar, 2016, Dine dhe Blecher sqarojnë në hyrje se: “Në disa pjesë, komentet përqëndrohen tek disa çështje kryesore dhe tek informacioni lidhur me kontekstin e nevojshëm për zbatimin, që synon të vendosë një paketë dispozitash të cilat drejtpeshojnë riskun e tregut mes ortakëve apo aksionarëve të pakicës dhe atyre të mëdhenj, apo me shoqëritë e punëmarrësve, kreditorëve, mjedisit dhe komunitetit (palët e interesit në shoqëritë tregtare) (shih faqe 7 – 8).

²²⁵ Shih dokumentin “Analiza e situatës së përgjegjësisë sociale të korporatave në Shqipëri. Praktikant dhe Sfidat Aktuale të Industrive Nxjerrëse”, që gjendet në <https://www.osce.org/sq/albania/106221?download=true>

²²⁶ Përmendin këtu: Ligji nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, gjendet në https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligj_nr_162_dt_4_12_2014_20658_11.pdf; Ligji nr.10 440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, gjendet në <http://qbz.gov.al/Ligje.pdf/mjedisi/ligji%20per%20mjedisin.pdf>; Ligji nr. 8905, date 6.6.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe demtimi”, gjendet në http://infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/ligj_8905_06_06_2002_per_mbrojtjen_e_mjedisit_detar_nga_ndotja_dhe_demtimi_2.pdf; Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” etj.

²²⁷ Neni 98 “**Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësisë**” i LSHT parashikon: 1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të këtij ligji, administratorët detyrohen: a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

nenin 163²²⁸. Përmbajtja e neneve është njësoj duke theksuar se detyrimin për të kryer detyrat taksative të përcaktuara nga ligji dhe statuti, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis; Në këtë mënyrë LSHT ngre në nivel ligjor angazhimin në një nga fushat kryesore të PSK dhe pikërisht ajo e mjedisit. Kuptohet që nuk i takon LSHT të detajojë sesi do të bëhet kjo, por LSHT i mëshon interesit më të mirë të shoqërisë (tërheqim vëmendjen që LSHT nuk thotë në interesin më të mirë të aksionarëve, duke iu shmangur dukshëm këtui teorisë së aksionarëve të Friedman) po në të njëjtën kohë dhe impaktit që kjo shoqëri e veprimtaria e saj do të kenë në mjedis.

- (ii) Mbrojtja e kreditorëve në rastin e likuidimit të shoqërisë. Likuiduesi nuk mund të shpërndajë aktivet e mbetura të shoqërisë përpara përfundimit të afatit të depozitimit të pretendimeve të kreditorëve (neni 199 (1) i LSHT).
- (iii) Në rastin e riorganizimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërive aksionare, i kushtohet vëmendje e veçantë:
 - Mbrojtjes së ortakëve ose aksionarëve të shoqërive të përfshira në riorganizim (neni 223 i LSHT)
 - Mbrojtja e zotëruesve të të drejtave të vecanta (neni 222 i LSHT)
 - Mbrojtjes së kreditorëve (neni 221 i LSHT). Ata mund të kërkojnë që pretendimet e tyre të shlyhen ose të sigurohen me garanci, dhe mund të

²²⁸ Neni 163 “**Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia**” i LSHT parashikon: 1. Përveç sa parashikohet në nenet 14, 15, 16, 17 e 18 të këtij ligji për detyrimin e besnikërisë, administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit detyrohen: të kryejnë detyrat e tyre, të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë, në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së saj në mjedis;

kërkojnë gjykatës të marrë vendimin e duhur nëse nuk është dhënë garanci e mjaftueshme (Dine, Bletcher, 2016:243).

- Mbrojtjes së punëmarrësve. Pasojat që bashkimi ka për punëmarrësit e shoqërive pjesëmarrëse duhet të përfshihen në projekt marrëveshjen e bashkimit dhe raportin sqarues në lidhje me të (neni 216 i LSHT).

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 1.10.2014 u miratua Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve dhe të planit të veprimit për periudhën 2014 – 2020²²⁹. Strategjia përbën dokumentin bazë për evidentimin dhe zbatimin e politikave kombëtare për nxitjen e biznesit dhe investimeve për periudhën 2014-2020. Si pjesë të saj në lidhje me PSK, Strategjia parashikon:

- Përfshirja e përgjegjësisë sociale në biznes përbën një sfidë për rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve, prandaj edhe se është një politikë e re për Shqipërinë, duhet të përfshihet në axhendën e zhvillimit të qëndrueshëm të biznesit²³⁰.

²²⁹ Botuar në Fletoren Zyrtare numër 157 -2014, datë 13.10.2014, që gjendet në http://aida.gov.al/images/ckeditor/fletore_zyrtare_157_2014.pdf

²³⁰ Shih http://aida.gov.al/images/ckeditor/fletore_zyrtare_157_2014.pdf faqe 8054, Fletore Zyrtare numër 157 -2014, datë 13.10.2014.

- Dokumenti politik i PSK dhe plani i veprimit²³¹ konsiderohet pjesë përbërëse e Draft Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve për periudhën 2014-2020²³².

8.3.2 Raste praktike

Një anë negative që ekspertët tregojnë se ka ekzistuar (dhe në shumë raste vijon) është sjellja e bizneseve shqiptare, të cilët, në përpjekje për të maksimizuar fitimet e tyre, shpesh tregohen të pakujdesshëm në veprimet e tyre, duke ndikuar negativisht te konsumatori, punonjësi, mjedisi etj. (Revista Monitor 05/06/2016233). Padyshim që prania e shoqërive me kapital të huaj sidomos në rastet kur aksionarët ishin shoqëri me ofertë publike, solli dhe rriti frymën e praktikave dhe angazhimeve PSK në vend ndërkohe që adaptimi i praktikave PSK nga ana e SME-ve mbetej i ulët. Pavarësisht vëmendjes në rritje për PSK, angazhimet dhe praktikat PSK në vend deri vonë kanë qenë më tepër një opsion në dëshirën dhe vullnetin individual të shoqërive sesa të ngritura në nivel strategjish apo taksative.

²³¹ Dokumenti politik i PSK dhe plani i veprimit 2016-2020, i cili është hartuar me kontributin e GIZ, konsiderohet si një masë e rëndësishme në zbatim të Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve për periudhën 2014-2020. Objektivat kryesore të këtij plani veprimi mbështeten në rritjen e ndërgjegjësimit për Përgjegjshmërinë Sociale si një element kyç për një biznes të qëndrueshëm në një ekonomi tregu; vlerësimin e performancës së PSK ndërmjet kompanive, ndërmjet sektorëve kyç të ekonomisë, në nivel kombëtar; krijimin e një mjedisi për përfshirjen e praktikave të PSK në sjelljen e biznesit; forcimin e aftësimit dhe kompetencave të PSK me një fokus të veçantë në një numër fushash kryesore, përfshirë ndërtimin; turizmin; SME-të; dhe kompani të orientuara në eksport dhe FDI; forcimin e kulturës së raportimeve transparente, në kohë të përshtatshme nga kompanitë, mbi impaktin e tyre social dhe mjedisor; dhënien e çmimeve për ekselencën dhe progresin në PSK ndërmjet kompanive në Shqipëri dhe në sektor specifikë (marrë nga <http://www.monitor.al/per-biznese-shqiptare-te-pergjegjshme-2/>)

²³² Po aty.

²³³ Gjetet në <http://www.monitor.al/per-biznese-shqiptare-te-pergjegjshme-2/>

Përsa i përket shoqërive kryesorë që operojnë në Shqipëri në fushat kryesorë të ekonomisë si sektori bankar, komunikimet elektronike, energjia²³⁴ etj, dhe bazuar në informacionin e bërë publik në faqet e tyre zyrtare të internetit, nga një shqyrtim i tyre rezultoi si më poshtë vijon: Shoqëritë tregtare janë me kapital privat, pra asnjëra prej tyre nuk është e kuotuar në bursë. Por për shoqëri të caktuara, që operojnë në sektorë të caktuar dhe janë pjesë grupesh, kanë aksionarë shoqëri me ofertë publike.

Të gjitha shoqëritë që operojnë në sektorin bankar, shfaqen se janë të angazhuara në sektorin PSK. Faqet e internetit të bankave të nivelit të dytë në vend kanë një seksion të vecantë që i dedikohet PSK, ku kryesisht paraqitet një përmbledhje e angazhimit PSK²³⁵, dhe /ose lajme të angazhimeve të ndryshme PSK (në fusha si: dhurimi i gjakut nga ana e stafit, mbështetje në rastet e fatkeqësive natyrore të zonave të prekura nga përmbytjet, zjarret, mbështetje për shtëpitë e fëmijës, foshnjës, etj.), në botime të vetë institucionit²³⁶, ose si pjesë e raportit vjetor²³⁷.

²³⁴ Prezenca e OSBE-së në Shqipëri së bashku me Ambasadën Kanadeze në Shqipëri kryen një studim mbi PSK në vitin 2012, gjetjet e të cili u publikuan në dokumentin “Analiza e situatës së përgjegjësisë sociale të korporatave në Shqipëri. Praktikë dhe Sfidat Aktuale të Industrisë Nxjerrëse”, që gjendet në <https://www.osce.org/sq/albania/106221?download=true>. Në Raport konstatohet se për subjektet e marra në analizë: “CSR-ja në industrinë nxjerrëse është me interes të veçantë në Shqipëri, duke qenë se ka shumë projekte për naftën dhe minierat, shumë prej të cilëve zotërohen dhe drejtohen nga kanadezë – ndoshta 70% e industrisë së naftës. Duke marrë parasysh se kompanitë kanadeze nuk kanë operuar për një kohë të gjatë në Shqipëri, dhe se CSR-ja është një koncept relativisht i ri në vend, kompanitë kanë deklaruar se përballen me sfida të ndryshme në zbatimin e praktikave të mira sociale dhe mjedisore” (shih faqe 7).

²³⁵ Për shembull: <https://www.intesasanpaolobank.al/retail/footer/pergjegjesia-sociale-e-korporates.html>; <https://www.fibank.al/sq/prgjegjesia-sociale/page/5375#vlerat-tona>; <https://www.societegenerale.al/al/engagements/pergjegjesi-sociale/>, <https://www.tiranabank.al/c/6/grupi/> etj.

²³⁶ Banka Credins e paraqet këtë aktivitet edhe në revistën NE, botim i bankës Credins. Për më shumë shih <https://www.bankacredins.com/index.php/category/publikime/>

²³⁷ Banka Raiffeisen e përfshin PSK në raportin vjetor. Për më shumë shih https://www.raiffeisen.al/images/uploads/default/Raporti_Vjetor_2017_sq.pdf

Bie në sy, se në përcaktimin e misionit dhe vizionit të tyre, kryesisht bankat nxjerrin në pah 3 grupet e interesi: aksionarët, punonjësit dhe klientët, të cilët janë dhe ata drejt të cilët orientohet biznesi²³⁸.

Nga vëzhgimi i faqevetë internetit dhe informacioni i publikuar rezulton se vetëm dy nga bankat (Banka Kombëtare Tregtare²³⁹ dhe Alpha Bank²⁴⁰) kanë miratuar Kodin e Qeverisjes së Korporatave (Kodi i drejtimit të brendshëm të shoqërive tregtare në Shqipëri). Banka Kombëtare Tregtare përgatit raport vjetor në lidhje me përputhshmërinë me Kodin, të cilat publikohen në faqen e internetit²⁴¹.

Tre shoqëritë kryesore në fushën e komunikimeve elektronike, Albtelecom Sh.A., Vodafone Albania Sh.A. dhe Telekom Albania Sh.A. shfaqen po aq të angazhuara në PSK dhe publikojnë informacion në lidhje me to²⁴².

²³⁸ Në lidhje me këtë, cdo bankë mbart vecoritë e saj në mënyrën e të shprehurit:

Për shembull banka Credins (<https://www.bankacredins.com/index.php/rreth-nesh/misioni/>) përcakton te Parimet e Biznesit: Shoqëri e orientuar drejt klientëve dhe Punojmë për aksionerët tanë;

Union Bank (<https://www.unionbank.al/vizioni-yne>) ka në vizioni të jetë një bankë e shëndetshme, e qëndrueshme dhe fitimprurëse, për aksionerët, klientët dhe punonjësit tanë;

Vizioni i Fibank (<https://www.fibank.al/sq/misioni-dhe-vlerat/page/4459>) është lidhshëmi i mirë, ndërveprimi i punonjësve, inovacioni dhe fleksibiliteti, të cilat na lejojnë t'ju shërbejmë sa më mirë klientëve tanë, partnerëve dhe të tërheqim kapital intelektual dhe të rrisim vlerën e aksionarëve tanë;

Tirana bank / Banka e Pireut (<https://www.tiranabank.al/1/6/18/grupi/profili-i-grupit/>) ka një vizion të përbashkët dhe një mision të vetëm: "të jetë banka më e besuar në Greqi, duke krijuar vlerë për aksionarët, klientët dhe punonjësit e saj";

Banka Intesa San Paolo (<https://www.intesasanpaolobank.al/retail/footer/pergjegjesia-sociale-e-korporates.html>) i ka më të detajuara sipas grupeve: klientët duhet të jenë gjithmonë në qendër të vëmendjes; sjellja e cila bazohet në dëgjimin dhe ndarjen e ideve me furnitorët; Banka vepron në mënyrë të tillë që vlera e të gjithë kapitalit të aksionarëve që investohet në Intesa Sanpaolo Bank Albania të mbrohet dhe të shumëfishohet në mënyrë të qëndrueshme, pa diskriminim apo preferencë.

²³⁹ <http://www.bkt.com.al/doc/Kodi-i-qeverisjessekorporatave.pdf>

²⁴⁰ <http://www.alphabank.al/al/alpha-bank-albania/kodi-i-qeverisjes-korporative/>

²⁴¹ Për më shumë shih <http://www.bkt.com.al/raport-perputhshmeri.aspx>

²⁴² Më saktësisht shih <https://www.albtelecom.al/al/rreth-albtelecom/pergjegjesia-sociale/misioni-ne-kuaderte-pergjegjesise-sociale-se-korporates/>; https://www.vodafone.al/vodafone/Pergjegjesia_Sociale_1918_1.php dhe <https://www.telekom.com.al/kompania/mjedisi/>

Telekom publikon çdo vit Raportet vjetore të Përgjegjësisë Sociale²⁴³, të cilat gjenden në faqen e internetit. Albtelecom e përfshin PSK si pjesë të raportit vjetor të veprimtarisë që përgatit në përputhje me kërkesat e nenit 134 dhe 154 të LSHT dhe që depoziton në QKB. Për momentin në faqen zyrtare të shoqërisë, raporte të tilla nuk janë të publikuara, por mund të aksesohen nërmjet gjurmimit në ekstraktin historik të shoqërisë në faqen zyrtare të QKB-së. Vodafone Albania ka të publikuara në faqen zyrtare të internetit raporte PSK për vitin 2005, 2006-2009 dhe 2010²⁴⁴. Në vijim, jep përditësime dhe lajme (të reja) nga PSK.

Në një analizë të misionit të PSK, të këtyre shoqërive bie në pah:

Vodafone Albania e konsideron PSK si pjesë integrale të kulturës së Vodafone Albania, duke pasur në objektivat e saj nismat e qëndrueshme mjedisore me klientin në fokus, bashkëpunimin me furnitorët, rritja e përdorimit të energjisë së pastër etj²⁴⁵. Në këtë kuadër Vodafone vlerëson dhe diferencimin e markës Vodafone duke pasur klientin në fokus.

Albtelecom synon “t’i shtojmë vlera shoqërisë sonë, duke promovuar aktivitetet e Përgjegjësisë Sociale të Korporatës dhe duke forcuar lidhjet me abonentët, si dhe të nxisim një impakt pozitiv të përgjithshëm në shoqëri dhe grupet e interesit²⁴⁶.

Sic evidentohet dhe nga faqja zyrtare e shoqërisë, Telekom Albania ka aderuar në Kodin e Qeverisjes së Korporatës sic shprehet dhe në raportin vjetor të korporatës 2017²⁴⁷. Nga faqet zyrtare të dy shoqërive të tjera (Albtelecom dhe Vodafone Albania) nuk rezulton apo nuk është evident nëse shoqëritë kanë aderuar në Kodin e Qeverisjes së Korporatës. Në përputhje

²⁴³ Raportet gjenden në faqen e internetit të shoqërisë: <https://www.telekom.com.al/kompania/raportet-csr/>

²⁴⁴ Shih https://www.vodafone.al/vodafone/Raporte_1406_1.php

²⁴⁵ Shih https://www.vodafone.al/vodafone/Misioni_3922_1.php

²⁴⁶ Shih <https://www.albtelecom.al/al/rreth-albtelecom/pergjegjesia-sociale/misioni-ne-kuader-te-pergjegjesise-sociale-se-korporates/>

²⁴⁷ Raporti gjendet në https://www.telekom.com.al/images/reports/english/CR_Report_2017.pdf Shih faqe 26.

me parashikimet e Nenit 134 të LShT, Albtelecom përfshin si pjesë integrale të Raportit të Ecurisë së Veprimtarisë, deklaratën e pajtueshmërinë me parimet e qeverisjes së mirë të korporatës ku paraqete detaje në lidhje me: Sistemin e administrimit, audituesit, komitetet, anëtarët e këshillit të administrimit dhe profilet profesionale të tyre.

Nga një vëzhgim i faqeve të internetit të shoqërive të sigurimit²⁴⁸, rezulton se:

INSIG nuk ka një seksion të vecantë për PSK, por jep lajme/ njoftime për te dhe i përfshin në raportet vjetore që publikohen në faqen e internetit. Është angazhuar në dhënie bursash, mbështetje për artin etj.

Sigma Inter Albanian ka seksion të vecantë për PSK (<http://www.sivig.al/kategori.php?idr=78&lang=1>) dhe e përfshin në raportet vjetore (<http://www.sivig.al/kategori.php?idr=71&lang=1>), duke u angazhuar në mbështetjen për shtresat në nevojë, dhurim gjaku, mbështetje për artin etj.

Sigal ka një seksion të veçantë dhe publikime të vecanta për PSK (<http://sigal.com.al/pergjegjesia-sociale/>) – Broshura e PSK²⁴⁹. Është e angazhuar në: kujdes shëndetësor duke ndërtuar një klinikë lëvizëse mjekësore në Shqipëri që ofron shërbime mjekësore falas, trashëgimi kulturore, art (Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA), mjedis, sport dhe edukim.

Intersig Vienna Insurance Group (VIG) ka një seksion për Përgjegjësinë Sociale (<http://intersig.al/rreth-nesh/pergjegjesia-sociale/>) dhe i përfshin në raportet vjetore

²⁴⁸ Shënim: lista e shoqërive në fushën e sigurimit është marrë nga faqja zyrtare e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare http://amf.gov.al/ts_shoqeri_sigurimi.asp

²⁴⁹ Shih http://sigal.com.al/wp-content/uploads/2018/02/pergjegjesi-sociale_sponsorizime.pdf

<http://intersig.al/rreth-nesh/raporte-vjetore/>. Është angazhuar në iniciativa bamirëse, kryesisht për fëmijët e sëmurë, mbështetje për artin dhe sportin etj.

Albsig ka një seksion të dedikuar PSK por të papërditësuar në informacion, dhe prej dy vitesh (2016 dhe 2017) gjeneron raporte të veçanta për PSK²⁵⁰. Në dallim nga shoqëritë e tjera që kryesisht në misionin dhe vizionin e tyre kanë klientit dhe sigurinë e tij, në misionin e Albsig vihet theksi te: siguria, stabiliteti financiar dhe një e ardhme e sigurtë për punonjësit, klientët, bashkëpunëtorët dhe aksionarët e kompanisë; të sigurojë zhvillim profesional dhe personal të punonjësve.

Eurosig ka një seksion PSK ku identifikon ndihmën e dhënë për arsimin, artin kulturën, institucionet publike, shtresat në nevojë²⁵¹.

Insig Jetë Sh.A. përmban informacion për PSK në seksionin “Publikime” ku jep të të reja në lidhje me disa aktivitete PSK të shoqërisë.

Sicred ka një seksion për të rejat nga PSK, i cili nuk është përditësuar në vijim, si dhe i përfshin aktivitetet PSK në raportet vjetore²⁵². Është angazhuar në mbështetje për artin (Festivali i Muzikës së Vjetër “Vox Baroque”), festivale teatrore, sport, konferenca mjekësore etj.

Shoqëria Atlantik Sh.A. dhe Ansig Insurance Company janë të vetmet shoqëri që nuk kanë informacion për PSK në faqen zyrtare dhe as në raportin vjetor.

Në një analizë mund të themi që PSK shihet e realizuar kryesisht në formën e mbështetjes për aktivitete të fusha të caktuara pra art, sport, shtresa në nevojë etj.sesa si një angazhim në

²⁵⁰ Shih <http://albsig.tokdigitalagency.com/publikime/pergjegjesia-sociale/>

²⁵¹ <http://www.eurosig.al/sq/kompania/pergjegje%C3%ABsia-sociale>

²⁵² Shih <http://www.sicred.com.al/new/118837-2/>

një politikë të caktuar që të ketë në fokus një grup të caktuar interesi psh mjedisi. Përgjithësisht janë aktivitete jo periodike, përvec disa aktiviteteve si festivale apo konferenca të një frekuence vjetore. Angazhimi në PSK shihet në formën e sponsorizimit që bëhet në përputhje me Ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, të ndryshuar²⁵³.

Në lidhje me shoqëritë në pronësi publike, vihet re angazhim në disa aktivitete PSK të cilat kryesisht jepen nëpërmjet njoftimeve në faqen e internetit, në seksione që lidhen me PSK, apo në raportet më të fundit vjetore, si për shembull:

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.A. - OSHEE sh.a. është investuar në mbështetjen e shtëpive të fëmijës, fëmijë të sëmure etj. Në fokusin e përgjegjësiave sociale, ka qenë kategoria e familjeve që janë prekur nga fenomeni i gjakmarrjes, kryesisht fëmijët dhe gratë e këtyre familjeve. Kryesisht kontributi ka qenë disa aspekte: ndihma me pako ushqimore për disa familje të cilat qëndrojnë të ngujuara në pamundësi për të siguruar të ardhurat ekonomike, ndihma për fëmijët të moshës 5-12 vjec me veshje, mjete mësimore, dhurata të ndryshme²⁵⁴.

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (**KESH - prodhuesi i energjisë elektrike në Shqipëri**) shpreh se në çdo aspekt të veprimtarisë së vet garanton komunitetin dhe brezat e ardhshëm për përkushtim në ruajtjen e integritetit mjedisor dhe mbrojtjen e mjedisit duke synuar manaxhim në mënyre rigoroze të impakteve në mjedis dhe shëndetin e punonjësve

²⁵³ Gjendet në http://appa.al/wp-content/uploads/2015/10/Ligji_7892_1994_Per_Sponsorizimet-1.pdf i aksesuar në 10 nëntor 2018.

²⁵⁴ Shih <http://oshee.al/roli-social-i-oshee-se-prezantohet-studimi-gjakmarrja/> aksesuar në 2 dhjetor 2018.

për një zhvillim të qëndrueshëm të performancës së tij social mjedisore²⁵⁵. PSK përfshihet në raportet vjetore të shoqërisë që janë të publikuara në faqen e internetit²⁵⁶.

Operatori i Sistemit të Transmetimit²⁵⁷ paraqet njoftime në lidhje me angazhimet PSK²⁵⁸ ndonëse nuk ka një seksion të dedikuar në faqen zyrtare të internetit. Në raportin e fundit vjetor (viti 2017), paraqiten të dhëna në lidhje me mjedisin, mbrojtja dhe ruajtja e të cilit shihet si një nga detyrat kryesore të OST ndaj dhe punon vazhdimisht për rritjen e performancën mjedisore të shoqërisë²⁵⁹. Mjedisi shihet nga pikëpamja e manaxhimit të çështjeve që kanë lidhje me mjedisin, përmirësimin e performancës së shoqërisë në lidhje me mjedisin dhe uljen e ndikimit negativ në mjedis.

Albcontrol Sh.A²⁶⁰ ka një seksion për PSK (https://albcontrol.al/al/?page_id=459), ku vendos lajmet me angazhimet kryesore si pssh ndihma për fëmijët talasemikë etj. të cilat pasqyrohen dhe në raportet vjetore²⁶¹.

Nga ana tjetër, vihet re se në disa raste (si Hekurudha Shqiptare Sh.a., Posta Shqiptare Sh.A., UKT sh.a. etj) nuk kanë të dhëna në lidhje me PSK të publikuar në faqen zyrtare të internetit.

²⁵⁵ Shih <http://www.kesh.al/info.aspx? NKatID=17>

²⁵⁶ Shih raportin përmbledhës vjetor 2013 -2016 që gjendet në <http://online.anyflip.com/ztfc/lffp/mobile/index.html>, aksesuar më 2 dhjetor 2018.

²⁵⁷ OST është krijuar me datën 14/07/2004, si rezultat i reformimit dhe ndarjes së Korporatës Elektroenergetike Shqiptare, nga një shoqëri e organizuar vertikalisht me funksione të gjenerimit, transmetimit dhe Shpërndarjes së energjisë elektrike, në tre shoqëri të veçanta. OST kryen funksionet e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Dispečimit dhe Operatorit të tregut. (marrë nga <https://www.ost.al/historiku-misioni/>)

²⁵⁸ Shih psh <https://www.ost.al/punonjesit-e-ost-dhurojne-gjak-per-femijet-talasemik/>

²⁵⁹ Shih https://www.ost.al/wp-content/uploads/2018/11/Annual-report_2017.pdf

²⁶⁰ ALBCONTROL është shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror, pronë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes. ALBCONTROL u krijua si ndërmarrje shtetërore në vitin 1992 dhe, në 3 shkurt 1999, u transformua në shoqëri aksionare, e quajtur Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror. (marrë nga <https://albcontrol.al/al/>)

²⁶¹ Aktualisht në faqen zyrtare ka vetëm dy raporte të publikuara, viti 2014 dhe viti 2015 që gjenden në <https://albcontrol.al/al/?p=944>

Gjatë periudhës shkurt – prill 2011, Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti, realizoi një studim për të analizuar aktivitetin filantropik të sipërmarrjeve në Shqipëri. Qëllimi kryesor ishte të mblidhte të dhëna dhe të vlerësonte nivelin dhe drejtimet e aktivitetit filantropik të biznesit në Shqipëri, si dhe hapat e nevojshëm për avancimin e tij (2011:7). Në studim u përfshinë 141 sipërmarrje, kryesisht të organizuara në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe të shoqërisë aksionare, të ndodhura në 10 prefektura të vendit, të fushave të ndryshme si transport, telekomunikacion, hoteleri, shërbime, ndërtim, etj. 62% e tyre bënin aktivitet filantropik. Arsyet që nxisnin aktivitetin filantropik ishte dhurimi si detyrim social dhe moral, dhe se dhurimi përmbushte nevojat njerëzore. Por si arsye u renditën dhe tradita dhe imazhi i shoqërisë (qëllime marketingu).

Gjetjet e studimit theksuan se aktiviteti filantropik varet nga aktiviteti kryesor ekonomik dhe qarkullimi mesatar vjetor. Aktiviteti kryesor që mbështetja financiare përmes dhurimit dhe produkte dhe shërbime në natyrë. Arsyet kryesore si pengesë për moskryerjen e aktivitetit filantropik ishtë mungesa e buxheteve, mungesa e shtysave financiare si për shembull përfitime nga lehtësirat tatimore, apo ulja e taksave, dhe mosvlerësimi i aktivitetit filantropik. Një gjetje e rëndësishme e studimit, ishte fakti se veprimtaria filantropike influencohet në shkallë të lartë nga administratorët dhe pronarët.

Në përfundim, mund të thuhet se angazhimi në PSK ka ardhur në rritje në shoqëritë në vend, si për shoqërite me kapital privat dhe për shoqërite me kapital publik. Kryesisht aktivitete të tilla i ofrohen publikut në formën e lajmeve / të rejave dhe raportohen edhe në disa raste në

raportet vjetore të veprimtarisë²⁶². Kjo angazhim shihet në formën e mbështetjes që jepet për aktivitete e fusha të caktuara (art, muzikë, sport etj) që janë sensitive apo shtresa të caktuara të shoqërisë (familje në nevojë, shtresa të popullsisë me nevoja të vecanta, raste emergjencash apo fatkeqësish natyrore etj). Në pjesën më të madhe, angazhimi PSK shihet në aktivitete që zhvillohet një herë dhe vetëm në pak raste, krijohet një lloj angazhimi i vazhduar, kur aktiviteti është periodik.

Vetëm në disa raste (si për shembull Vodafone Sh.A., KESH apo OST), angazhimi nuk është në formën e mbështetjes së një apo disa aktiviteteve të caktuara por si një angazhim konstant dhe i vazhdueshëm në disa fusha që i përkasin grupeve të ndryshme të interesit (për shembull mjedisi).

Gjithashtu, angazhimi në PSK zakonisht shoqërohet dhe me “publicitetin” përkatës të angazhimit, që mund të jetë publikim në median e shkruar dhe/ose vizive, publikime në rrjetet sociale, dhe vendosja e imazhit (logos apo çdo shenje dalluese të shoqërisë mbështetëse) në vendndodhje vizualisht të dukshme. E parë në këtë këndvështrim, angazhimi në PSK kthehet dhe përdoret dhe në një mjet marketingu dhe mediatizimi për vetë shoqërinë: nga njëra anë shoqëria angazhohet në PSK dhe e reklamon si të tillë, dhe nga ana tjetër,

²⁶² Prezenca e OSBE-së në Shqipëri së bashku me Ambasadën Kanadeze në Shqipëri kryen një studim mbi PSK në vitin 2012, gjetjet e të cili u publikuan në dokumentin “Analiza e situatës së përgjegjësisë sociale të korporatave në Shqipëri. Praktikë dhe Sfidat Aktuale të Industrive Nxjerrëse”, që gjendet në <https://www.osce.org/sq/albania/106221?download=true>. Në Raport konstatohet se për subjektet e marra në analizë: “Një ndër mangësitë që u vu re ishte fakti se zakonisht kompanitë nuk hartojnë dhe botojnë një raport vjetor që lidhet me veprimtarinë e tyre dhe politikën e CSR-së”.

asociohet veprimtaria me emrin e shoqërisë dhe kjo e fundit vendos imazhin e saj në një formë tjetër bërjeje publike.

PSK e dhënë në formën e mbështetjes (sponsorizimit) bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, të ndryshuar²⁶³. Ligji në nenin 1 të tij përcakton se sponsorizimi me qëllime të përfitimit ekonomik nga sponsorizuesi është i ndaluar. Sponsorizuesit shuma e sponsorizuar u njihet si shpenzim i zbritshëm deri në masën 3 për qind të fitimit para tatimit. Gjithashtu ligji përcakton se subjektet buxhetore ose që përfitojnë financime buxhetore, nuk mund të jenë sponsorizues²⁶⁴. Për personat juridikë publikë masat e sponsorizimit përcaktohet nga Këshilli i Ministrave²⁶⁵.

Bazuar në legjislacionin për përkatës, varësisht fushës apo industrisë ku operon një biznes, shteti ka përcaktuar dhe organe kompetente për të kontrolluar fusha të caktuara të veprimtarisë së tyre për shkak të ndikimit që kanë në mjedis apo komunitet²⁶⁶. Kështu në lidhje me mjedisin²⁶⁷, të gjitha industritë nxjerrëse janë të detyruara të kërkojnë dhe të pajisen me leje mjedisore për përmbushjen e standardeve dhe kërkesave përkatëse, leje e cila është

²⁶³ Gjendet në http://appa.al/wp-content/uploads/2015/10/Ligji_7892_1994_Per_Sponsorizimet-1.pdf i aksesuar në 10 nëntor 2018. Ligji rregullon mbështetjen me ndihma financiare e materiale, të quajtura në vijim “sponsorizime”, të veprimtarive sociale e publike ku përfshihen veprimtaritë humanitare, kulturore e artistike, sportive, edukative, arsimore, ekologjike dhe vepra letrare, shkencore dhe enciklopedike si dhe botuesve të shtypit (neni 1).

²⁶⁴ Shih nenin 3 të ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, të ndryshuar.

²⁶⁵ Shih nenin 5 të ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, të ndryshuar.

²⁶⁶ Për shembull Shoqëritë që veprojnë në fushën e komunikimeve elektronike monitorohen nga AKEP, Instituti i Rrezatimeve në lidhje me rrezatimin e antenave.

²⁶⁷ Kompanitë monitorohen shpesh në çdo aspekt të ndikimit mjedisor nga agjencitë qeveritare si Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM) ose AKBN. Ato i raportojnë çdo vit Ministrisë së Mjedisit një paketë minimale të dhënash.

e rinovueshme. Por vlerësohet se të pakta janë kompanitë që kanë bërë investime të mëtejshme për mbrojtjen e mjedisit duke investuar në filtra ajri dhe teknologji moderne²⁶⁸.

Standardi ISO 26000: 2010²⁶⁹

ISO 26000: 2010 ofron udhëzime për të gjitha llojet e organizatave, pavarësisht nga madhësia ose vendndodhja e tyre, në lidhje me konceptet, termat dhe përkufizimet që lidhen me përgjegjësinë sociale, parimet dhe praktikrat që lidhen me të etj. ISO 26000: 2010 ka për qëllim të ndihmojë organizatat për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm, duke pranuar që pajtimi me ligjin është një detyrë themelore e çdo organizate dhe një pjesë thelbësore e përgjegjësisë së tyre sociale, të promovojë mirëkuptimin e përbashkët në fushën e përgjegjësisë sociale, të plotësojë instrumente dhe nisma të tjera, jo t'i zëvendësojë ato. Ndonëse në thelb ISO 26000 u gjykua se është frymëzuar nga praktikrat më të mira nga nismat ekzistuese PSK në sektorët publik dhe privat, Standardi në vetvete nuk u mirëprit, duke u gjykuar më shumë si një standard politik sesa teknik. Disa njerëz vazhdojnë ta shohin atë si një fitore të botës së kompanive ndaj çdo dëshire për rregullim, qoftë edhe procedurale, që rrjedhin nga përgjegjësia sociale (Daugareilh, 2010):

Standardi është i aplikueshëm për të gjitha llojet e organizatave, pavarësisht aktivitetit, madhësisë apo vendndodhjes, duke zgjeruar sferën e veprimit përtej shoqërive tregtare apo shoqërive ndërkombëtare. Në këtë kuptim, kemi të bëjmë me një dobësim të konceptit të

²⁶⁸ Shih dokumentin “Analiza e situatës së përgjegjësisë sociale të korporatave në Shqipëri. Praktikrat dhe Sfidat Aktuale të Industrive Nxjerrëse”, që gjendet në <https://www.osce.org/sq/albania/106221?download=true>, faqe 46.

²⁶⁹ <https://www.iso.org/standard/42546.html> Puna për hartimin e standartit nisi në 2001, kur Këshilli i ISO i kërkoi Komitetit të ISO për Politikrat e Konsumatorit të shprehej mbi zhvillimin e standartit të PSK. Në vitin 2004 u krijua grupi i punës për hartimin e draftit nën drejtimin e agjensisë Suedeze dhe Braziliene të standartizimit. Standardi u miratua në shtator 2010 me 2/3 të votave të anëtareve të ISO.

PSK, duke zvogëluar kërkesat ndaj kompani shumëkombëshe duke i vendosur ato në të njëjtën frekuencë me të gjitha organizatat e tjera, edhe pse nuk mund të krahasohet ndikimi i aktiviteteve të tyre në mjedis ose te shoqëria në përgjithësi (Schomann, 2012: 2). Zbatimi i tij është vullnetar, duke mbetur kështu në dëshirën dhe vullnetin e organizatave. Mungesa e certifikimit e bën atë të humbasë besueshmërinë dhe interesin (Schomann, 2012: 4).

KAPITULLI XI PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

Në përfundim të këtij punimi, në bazë të analizës, modeleve me fokus Shqipërinë, janë disa përfundime dhe gjetje që jepen në vijim, në bazë të të cilave bëhen dhe disa sugjerime përkatëse krahas.

Shoqëria tregtare në formën që njohim sot nuk ka qenë e tillë në fillimet e saj. Koncepti i “*personit juridik*” është krijuar dhe përpunuar në rrjedhën e shekujve. Ndonëse gjejmë fillesa të personit juridik dhe të organizimit të shoqërive tregtare që në Perandorinë Romake, këtyre shoqërive iu mungojnë elementë thelbësorë të organizimit sidomos përsa i përket drejtimit dhe shpërndarjes së fitimit. Format e ortakërisë tregtare të shekullit XII që ngjante më shumë me shoqërinë tregtare moderne është *commenda* ndonëse me afat të shkurtër dhe qëllim të caktuar.

Shoqëritë tregtare shfaqen në formë të organizuar në shekujt XIV - XV, si një kundërpërgjigje ndaj tregje të reja, dhe nevojës për shfrytëzimin e tyre, si një prerogativë e pushtetit mbretëror dhe jo e interesave private ekonomike. Kompanitë e para të biznesit ofronin shërbime të natyrës utilitare për shërbime të ndryshme me natyrë publike. Zgjerimi i tregjeve dhe teknologjitë e reja në linjat e prodhimit ishin një faktor shumë i rëndësishëm i cili ndihmoi në përhapjen e shoqërive tregtare. Fakti që shoqëria tregtare me aksione shihej si një entitet ligjor më vete me potencialisht afat të pacaktuar, e cila zotëronte asetet e përdorura në biznes, e bënë këtë formë si mënyrën e preferuar të organizimit të bizneseve, sidomos në rastin e bizneseve të mëdha dhe komplekse.

Tipike për shoqëritë tregtare e para është fakti që pronësia dhe kontrolli i tyre janë të integruara në një dorë të vetme: atë të pronarit – sipërmarrës / investitor, të cilët arrijnë që të

manaxhojnë ngarkesën që dikton puna. Zhvillimet e tregjeve dhe të teknologjisë, shënuan ndarjen e pronësisë dhe kontrollit, një fenomen që do të shënonte dhe një nga karakteristikat kryesore të shoqërive të kësaj periudhe: shoqëritë e drejtuara nga jo pronarët, të cilat erdhën gjithnjë e më në rritje. Nga ana tjetër nevoja për kapital dhe financim, do ta afronte shoqërinë tregtare me tregun e kapitaleve: shoqëria tregtare dikur e themeluar dhe e manaxhuar brenda familjes apo një rrethi të ngushtë privat, tashmë ofron kuotat / aksionet e saj në tregun e kapitaleve. Lind nocioni i shoqërisë me ofertë publike. Ndërkohë në rrjedhën e kohës dolën në pah dhe krijimi i llojeve të rejave të formës së biznesit si biznesi social, start –up, ndërmarrjet sociale etj.

E drejta tregtare nga ana tjetër është dinamike dhe një sistem me tendencë endemike në zhvillim, ku rol të rëndësishëm luajnë vetë komuniteti tregtar dhe institucionet shtetëtorë të kohës që bënë të mundur kodifikimin dhe zyrtarizim e saj. Shoqëritë tregtare të krijuara në fillimet e tyre si një investim në të mirë publike, tashmë janë një një nxitës me një peshë specifike të veçantë në çdo ekonomi. Sipërmarrjet shqiptare, që lindën dhe u zhvilluan me rënien e sistemit komunist dhe ekonimisë së përqëndruar, mbartën tiparet e shoqërive tregtare në vendet e ish Bllokut të Lindjes.

Aktiviteti i biznesit luan një rol jetësor në çdo shtet. Biznesi, pavarësisht formës së organizimit, që nga format më të thjeshta deri të ato më komplekse, siç janë organizatat e biznesit, i nënshtrohet rregullave të lojës të vendosura nga shteti në cilësinë e tij si mbikqyrës dhe rregullator. Vlen të theksohet që një shtet, institucionet dhe agjensitë e tij, janë po aq konsumatorë ose klientë të produkte dhe / ose shërbimeve që ofron biznesi. Në të njëjtën kohë shoqëria tregtare si organizatë biznesi është një punëdhënës në ekonominë e një vendi, të një rajoni apo dhe atë ndërkombëtare. Ajo paguan detyrime ndaj shtetit në formën e taksave

dhe tatimeve, për veprimtarinë që ushtron, për aktivitetin që kryen dhe fitimet që realizon. Shoqëria tregtare zotëron dhe pasuri e prona, të luajtshme apo të paluajtshme. **Në tërësinë e saj shoqëria tregtare është një “qytetar” e cila nuk vepron në vakuum por në një mjedis të caktuar dhe sipas rregullave të caktuara.** Tërësia e legjislacionit të cilit i nënshtrohet biznesi gjatë operimit dhe funksionimit të tij, nga themelimi deri në shuarje, së bashku me statusin politik të vendit janë thelbësore në zhvillimin apo dhe pengimin e tij.

Faktorët ekonomikë që nga rritja ekonomike, inflacioni, ndikojnë po aq te biznesi, i cili nga ana tjetër nuk është “imun” ndaj zhvillimeve teknologjike. Zhvillimet teknologjike dhe dinamika e tyre kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe në aktivitetet e biznesit, qoftë kjo në sektorin publik dhe atë privat, duke e kthyer atë në një nga organizatë të domosdoshme, me kërkesa në rritje përsa i përket aftësive dhe dijeve për profesionistë me aftësi praktike. Sa më e madhe dhe komplekse të jetë ndërmarrja si në sektorin privat dhe atë publik, aq më e rëndësishme është puna në aspektin e çështjeve organizative dhe të manaxhimit. Mund të thuhet se teknologjia është bujare: atë që të heq me njëren dorë, ta jep me tjetrën, por biznesi duhet të jetë i përgatitur për këtë.

Çdo shoqëri tregtare vepron një mjedis të dhënë duke iu nënshtuar kuadrit rregullator të shtetit ku vepron. Në larminë e normave dhe sisteme ligjore dhe ekonomike, edhe shoqëritë tregtare dhe qeverisja e korporatës është e larmishme dhe dinamike. **Ndaj nuk mund të flitet për një model të njësuar organizimi apo qeverisje që do të që i duhuri në nivel global, një model unik i cili do të funksiononte për të gjithë.** Padyshim që qeverisja e korporatës është një fushë sa e re, aq dhe e larmishme. Faktin e të qenit e re lidhet padyshim me interesin e madh dhe vlerën e shtuar që mori qeverisja e korporatës në kuadrin e skandaleve të mëdha

financiare kudo në botë. Qeverisja e korporatës është një koncept dinamik dhe me përmasa ndërkombëtare. Zhvillimi i saj është ndikuar nga teori nga një numër disiplinash.

Është e pamundur të kemi në përcaktim të vetëm të konceptit të qeverisjes së korporatës ashtu si është po aq e vështirë të ketë një model të përshtatshëm për çdo shoqëri tregtare, në çdo vend. Kjo sepse si shumë institucione dhe koncepte, edhe qeverisja e korporatës ndikohet nga disa faktorë si: sistemi i së drejtës, zhvillimi ekonomik, struktura e tregjeve etj. që e bëjnë atë të dallueshme në një kohë dhe një vend të dhënë. Ashtu si nga ana tjetër, në themel të qeverisjes së korporatës vendosen disa parime të përbashkëta. Shumë prej parimeve të mira në qeverisjen e korporatave që janë përgjithësisht të zbatueshme për korporatat e mëdha publike, janë të vlefshme dhe në ndërmarrje, organizata dhe agjenci qeveritare të tjera.

Për sa më sipër, dhe në adresim të hipotezës dhe pyetjes kërkimore, ajo që mund të thuhet në përfundim të këtij punimi sipas modeleve të studiuara në këtë punim, (me fokus të veçantë në rastin e Shqipërisë), është si vijon:

1. Me kornizën e re ligjore, rregullat ligjore të LSHT-së nuk përbëjnë një vazhdimësi të traditave sipas regjimit ligjor të mëparshëm të Ligjit nr. 7638, por revolucionalizojnë ligjin shqiptar për shoqëritë tregtare. LShT mund të thuhet se ndryshoi dukshëm praktikën 16 vjeçare që kishte krijuar deri atëherë e drejta tregtare në vend në nivel të drejte. LSHT-ja u përgatit me qëllimin për të implementuar (me përjashtime të vogla) standartet evropiane të së drejtës për shoqëritë tregtare (“*acquis*”).
2. LShT pasqyron standartet e BE-së dhe ato ndërkombëtare lidhur me të drejtën tregtare, drejtimin e brendshëm të shoqërive tregtare dhe përgjegjësinë sociale të shoqërisë tregtare, e cila pasqyrohet qartë në përmbajtjen e ligjit, përsa i përket

mbrojtjes së mjedisit, aksionarëve të pakicës, kreditorëve, punëmarrësve. Kjo adreson dhe hipotezën e ngritur në këtë kërkim.

3. Përsa i përket hipotezës, LShT mbart në vetvetë teorinë e aksionarëve dhe të grupeve të interesit: pra, është ndikuar nga teoritë normative të biznesit por duke anuar kryesisht nga ana formale nga ana teorisë së grupeve të interesit duke përfshirë grupet e interesit të paktën nga ana formale.
4. Në vijim të pyetjes dhe nënçështjeve kërkimore, LShT ka në bazë faktin që Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri. Përcaktimi i objektivave ekonomike tregon qartë natyrën e shoqërisë nga ana e pikëpamjes së teorisë së aksionarëve.
5. Por nga ana tjetër, futja e parashikimeve pro përgjegjësisë sociale dhe mbrojtjes së grupeve të interesit duhet të mirëpritet dhe vlerësohet nga pikëpamja ligjore. Në të njëjtën kohë, përtej kësaj, duhet gjithashtu të theksohet se Ligji çalon të adresojë çështje të caktuara gjithashtu:

Duke lënë hapësirë për interpretimin (p.shs në rastin e emërimit të përfaqësuesve të punonjësve në sistemin e një niveli dhe në dy nivelet në rastin e Këshillit të Punëmarrësve); nuk parashikon nëse disa kërkesa (si psh themelimi i këshillit regjistrohet ose depozitohet në ndonjë regjistër ose entitet në vend që të qëndrojë brenda ndërmarrjes).
6. Ndonëse nga ana formale Korniza Ligjore është e plotë, mekanizmat e mbikqyes, matjes dhe monitorimit janë të pakta, ose të kufizuara. Sugjerohet përcaktimi i

mekanizmave të qartë të matjes dhe monitorit për këto tregues si për shembull në formën e regjistrave që mbahen nga shoqëria;

7. Nga pikëpamja ligjore, formale LShT është përpjekur (mbase jo në të mirën e tij) të "kopjojë" ligjet e homologëve në BE dhe t'i afrohet këtij lloji të organizatës. Në praktikë, këto dispozita ende nuk kanë gjetur hapësirë për t'u zbatuar plotësisht.
8. LSHT parashikon parimet që marrin parasysh gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët dhe aksionarët administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës. Neni 14 parashikon pikërisht të mbahen parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve apo të aksionarëve të tjerë, duke vënë të parën interesat e shoqërisë që shquhet nga ato të ortakëve /aksionarëve. Gjithashtu LSHT parashikon se personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët apo aksionarët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, por zbatimi real i kësaj dispozite sidomos përsa i përket zbulimit (publikimit) të informacionit në faqet e interneti të shoqërisë apo për aksionarët e pakicës lë për të dëshiruar. Sugjerohet një zbatim më i kontrolluar i detyrimit për zbulimin e informacionit të shoqërisë në faqet e internetit.
9. Në një analizë të sipërmarrjes së organizuar në formën e shoqërisë tregtare në vend, vihen re disa karakteristika dalluese:

Ndonëse legjislacioni ekziston, tregjet financiare dhe bursa në Shqipëri me shoqëri të listuara nuk është ende një realitet i prekshëm. Pavarësisht përpjekjeve shoqëritë tregtare që operojnë në Shqipëri, mbeten shoqëri private, madje dhe shpesh me organizime familiare.

Sipërmarrja shqiptare e institucionalizuar ishte me karakter “vendas” dhe më pak e ndërkombëtarizuar. Kjo sepse investimet e huaja në vend mund të përkufizohen si

modeste në vitet e para të tranzicionit, çka ndikoi dhe në organizimin e tyre, duke qenë kryesisht sipërmarrje të natyrës “familjare” e duke mbetur të tilla për shumë kohë: pronësia dhe kontrolli mbeti i përqëndruar në duart e themeluesve që kryesisht i përkisnin një rrethi të ngushtë familjar dhe /ose shoqëror. Ky centralizim ndikonte dhe në manaxhimin e shoqërive, pasi jo çdo themelues është manaxher apo drejtues profesionist.

Megjithatë për segmente të caktuara të tregut të cilat janë tregje të rregulluara apo të mbikqyrur, si bankat apo sigurimet, së fundi dhe në arsimin e lartë, legjislacioni kaloi në disa faza, për t’u maturuar në kërkesat e tij në caktimin e kriterëve për drejtuesit e shoqërive të përfshira në aktivitete të tilla. Këto rregullime në nivel ligji padyshim që janë faktorë të rëndësishëm në ndarjen e pronësisë nga kontrolli dhe atribuimit e administrimit të përditshëm, profesionistëve të fushës, për të marrë vendimet e përditshmërisë.

10. Përsa i përket shoqërive shqiptare private, ndarja e pronësisë nga kontrolli jo vetëm për tregje apo aktivitete të rregulluara, duhet të lexohet si një kërkesë për të rritur manaxhimin cilësor dhe efikas të një shoqëri tregtare nga persona me aftësi dhe kompetencat e duhura profesionale në drejtimin e tyre. Jo çdo ortak apo aksionar mund të ketë aftësitë e duhura drejtuese dhe administruese.
11. Aksionarët janë ata që injektojnë kapital për jetën dhe vazhdimësinë e shoqërisë, një jetë dhe një vazhdimësi e cila nuk do të ishte e mundur nga ana tjetër pa grupet e interesit: pra punëmarrësit, furnizuesit, komuniteti, klientët, mjedisi. Nga njëra anë, aksionarët duhet të mos mjaftohen me pozicionin e tyre thjesht si “donatorë” apo “sponsor” financiar, por të veprojnë si pronarë dhe të kërkojnë informacionet e

duhura. Ndonëse për grupet e interesit si aksionarët e pakicës parashikohen mekanizma për mbrojtjen e tyre, është e dukshme që ata nuk kanë zë në vendimmarrje.

12. Bordet drejtuese në rolin e tyre strategjik duhet të përgatiten që të japin dhe të përcjellin informacion të saktë, të qartë dhe të plotë dhe në të njëjtën kohë të vlerësojnë biznesin për atë që përfaqëson për aksionarët dhe grupet e interesit, duke ndjekur parimin e besnikërisë dhe të përgjegjshmërisë. Kontrollët e brendshme duhet të japin siguri për vërtetësinë e informacionit. Dështimi i qeverisjes së korporatës është dështim i shoqërisë tregtare dhe i pasojave të rënda që ajo sjell.
13. Për të siguruar harmonizimin e interesave ndërmjet pronarëve dhe manaxherëve janë të nevojshme mekanizmat e brendshme të raportimit dhe të llogaridhënies, të cilat duhet të jenë të parashikuara në nivel ligji, dhe të ecin në një frekuencë me sistemin e qeverisjes së brendshme. Shoqëritë e mirëdrejtura dhe transparente bëhen kështu promotore të zhvillimit të ekonomisë në vend.
14. Parimet e qeverisjes së korporatës reflektoheshin mjaftueshëm në legjislacionin Shqiptar, por kanë lënë pas një traditë të varfër të qeverisjes së korporatave.
15. Duhet të kemi parasysh që tregu dhe kultura e punës ka ndryshuar ndër vite dhe nuk është më struktura dhe forma klasike, ashtu si dhe vetë natyra e punës ka ndryshuar që nga themelimi i shoqërive të para tregtare. Forcës e punës është diversifikuar me profesionistë të lirë, persona me aftësi të kufizuara, persona nga grupe të marginalizuara, apo ndryshe si dhe inteligjenca artificiale. Koncepti i punës është bërë më fleksibël, duke dalë tej fashave orare kufizuese apo vendeve fikse të punës.

Sipas Sondazhit të Mijëvjecarit 2018 të Deloitte²⁷⁰, opinioni i të rinjve të përfshirë në këtë sondazh për etikën dhe motivimin e biznesit është në rënie në dallim me rritjen e dy viteve më parë. Ata duan që drejtuesit e shoqërive të angazhohen sa më shumë për të pasur efekte të prekshme dhe reale teksa përgatisin organizatat e punonjësit e tyre për ndryshimet që do të sjellë Revolucioni i Katërt. Prandaj, ky është momenti i duhur që drejtuesit të vihen në lëvizje dhe të ndërmarrin veprime në interes të të gjithë grupeve të interesit. Punonjësit e rinj besojnë se biznesi duhet të marrë në konsideratë interesat e grupeve të interesit si dhe fitimet, përvoja e tyre është me punëdhënës të cilët i japin përparësi bilancit sesa punonjësve, shoqërisë dhe mjedisit.

16. Sugjerohet që punëmarrësit nuk duhen parë thjesht si “prodhues” të produkteve ose shërbimeve por si një nga elementët thelbësorë të suksesit të një organizate biznesi. Veprimet dhe kultura e një organizate ndikojnë në jetëgjatësinë e besnikërinë e punonjësit në shoqëri. Studimet tregojnë se brezat e rinj (të lindurit në periudhën 1995 – 1999) janë më të prirur të largohen nga organizata e biznesit nëse nuk janë të kënaqur me të. Në kuadër të dinamikës së zhvillimeve teknologjike, biznesi duhet të përgatitet si për burime njerëzore të trajnuara dhe me mjetet e përshtatshme. Pritshmëria është që drejtuesit e biznesit të jenë aktivë për të bërë një ndikim pozitiv në shoqëri — dhe të jenë të përgjegjshëm ndaj nevojave të punonjësve.

²⁷⁰ Sondazhi 2018 u shtri në 36 shtete dhe përfshiu 10,455 të rinj të lindur në periudhën Janar 1983 dhe dhjetor 1994, me arsim të lartë, të punësuar me kohë të plotë dhe që punonin kryesisht në organizata të mëdha biznesi private. E vecanta qëndron në faktin që ky grup pjese e sondazhit, janë duke u promovuar në pozicione drejtuese nga të cilët mund të ndikojnë sesi organizmat ku punojnë adresojnë sfidat e shoqërisë. Gjithashtu në këtë raport u përfshinë dhe përgjigjet nga 1,844 të rinj, në Australi, Kanada, Kinë, Indi, Mbretëri e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara, të rinj të cilët përfaqësojnë brezin Z, të lindurit në periudhën Janar 1995 deri në Dhjetor 1999. Këta të intervistuar ishin aktualisht duke studiuar iose kishin marrë një diplomë dhe më shumë se 1/3 punonte me kohë të plotë ose të pjesshme.

17. Barra e përgatitjes së punamrësve të kualifikuar nuk i takon vetëm shkollës apo punëmarrësit në formën e të mësuarit gjatë gjithë jetës por i takon dhe vetë biznesit që të luajë rolin e tij si edukator dhe të përgatisë punëmarrësit e tij për të ardhmen. Duke qenë biznesi ai që përcakton strategjitë e zhvillimit të aktivitetit dhe mënyrën e arritjes së objektivave, duhet që në këtë projeksion të përfshihen domosdoshmërisht trajnimi i punëmarrësve si për kompetenca profesionale dhe për aftësitë e lidhura me kulturën e punës, korporatës, etikën etj, të nxisë talentet dhe të krijojë një mjedis pune të përshtatshëm.
18. Trajnimi i vazhdueshëm i drejtuesve të një shoqëri duhet parë si një mjet që jo vetëm përmirëson aftësitë e tyre por njëkohësisht ndikon në mirëmanaxhimin e shoqërisë.
19. Të mësuarit gjatë gjithë jetës nuk duhet parë si një slogan, por mund të jetë një formë e mirë e përmirësimit të vazhduar.
20. Teknologjia me zhvillimet e saj ka prekur thuajse të gjitha sferat e jetës dhe punës, ka krijuar po dhe ka zhdukur profesione, ka shpëtuar apo ka rrezikuar burime të ndryshme natyrore. Organizatat e biznesit duhet të jenë gati për t'u përballuar me sfidat që sjell teknologjia por kjo përballje duhet të marrë në konsideratë rolin e biznesit në shoqëri: të ndjekë tendencat me produkte dhe shërbime inovative që i përgjigjen nevojave të tregut por në të njëjtën kohë, të krijojnë mundësi për vende pune dhe zhvillim karriere duke ndikuar kështu në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe duke vlerësuar ndikimin në mjedis.
21. Në lidhje me krijimin e shtysave e të një ambienti të përshtatshëm që nxit përgjegjësinë sociale të korporatës, një hap i parë duhet të nis në nivel rregullator duke hedhur baza të shëndosha për krijimin e lehtësirave të nevojshme fiskale dhe

procedurat e rimbursimeve /kthimeve të cilat nga ana e tyre do të shërbejnë si stimuj për zhvillimin më tej të kësaj përgjegjësie.

22. Në këtë kuadër sugjerohet që duhet që të ketë incentiva të qarta në terma politike dhe ekonomike që të nxisin mirëqeverisjen e korporatës dhe përgjegjësinë sociale. Këto incentiva duhet të vendosin tregues që të jenë realë dhe të matshëm.

23. Për të tepër, nxitja e përqafimit të politikave “pro mjedisit”, si për shembull politikat e mospërdorimit të produkteve plastike, ulja e emetimit të karbonit etj, (përtej kërkesave dhe kushteve që vendosen për licensime apo autorizime për veprimtari të ndryshme), nisur dhe nga dëmi në rritje dhe i parikuperueshëm që shkakton, duhet të ngrihet edhe në një nivel shtrëngues dhe jo të lihet në dëshirën e lirë të shoqërive tregtare. Kjo duke pasur parasysh që shumë burime natyrore janë të kufizuara apo të fundme dhe nuk janë të përjetshme ndaj duhet mbajtur në konsideratë rinovimi i tyre. Kjo duhet të përkthehet në angazhim në nivel politikëbërje dhe ndryshime në legjislacion. Shoqëritë tregtare të cilat do të angazhohen në veprimtari të tilla, angazhim i cili të jetë i matshëm në tregues konkretë cilësorë dhe sasiorë, mund të ketë favorizime apo lehtësira nga ana fiskale.

24. Një opsion mund të jetë që PSK mund të jetë dhe një zë specifik i buxhetit apo programit ekonomik të shoqërisë tregtare, zë i cili do të alokohet për këtë veprimtari sipas vendimmarrjes së Asamblesë së Aksionarëve, sepse në një analizë të fundit, duhet të jenë edhe vetë pronarët të parët që duhet të drejtojnë fokusin e shoqërisë përtej fitimit në terma afatshkurtër. Vendimmarrja mund të jetë më e lehtë në asamblatë me një apo pak ortakë dhe më e vështirë në asamblatë me portofol të diversifikuar aksionarësh dhe / ose investitorësh, por mbetet fakti që PSK dhe grupet

- e interesit duhet të jetë më së pari një nxitje endogjene nga vetë shoqëria dhe pronarët e saj. Nëse fokusi i një shoqërie tregtare drejtohet nga vetë pronarët në mbështetje të PSK, atëherë zbërthimi i një vendimmarje të tillë në praktikë konkretizohet më lehtë.
25. E thënë ndryshe, që shoqëria të jetë shoqërisht e përgjegjshme duhet që PSK të jetë një zë në buxhetim nga ana financiare (pjesa sasiore), pjesë e strategjisë së zhvillimit të shoqërisë (pjesa cilësore), përfshirë kulturën e shoqërisë në lidhje me të. Nga ana tjetër, kjo do të zbuste dhe “divergjencat” mes pronarëve të shoqërisë dhe administratorëve të saj në lidhje me fokusin që shoqëria do të alokonte te PSK dhe grupet e interesit. Investimet afatgjata në PSK do të përkthehen në qëndrueshmëri dhe shëndet afatgjatë të shoqërisë tregtare dhe të investitorëve të saj.
26. Në një analizë të vendit tonë, mund të themi që PSK shihet e realizuar kryesisht në formën e mbështetjes për aktivitete të fusha të caktuara pra art, sport, shtresa në nevojë etj. sesa si një angazhim në një politikë të caktuar që të ketë në fokus një grup të caktuar interesi psh mjedisi. Përgjithësisht janë aktivitete jo periodike, përvec disa aktiviteteve si festivale apo konferenca të një frekuence vjetore.
27. Angazhimi në PSK shihet në formën e sponsorizimit që bëhet në përputhje me Ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar, dhe shoqërohet dhe me “publicitetin” përkatës të angazhimit, që mund të jetë publikim në median e shkruar dhe/ose vizive, publikime në rrjetet sociale, dhe vendosja e imazhit (logos apo çdo shenje dalluese të shoqërisë mbështetëse) në vendndodhje vizualisht të dukshme.
28. Angazhimi në PSK kthehet dhe përdoret dhe në një mjet marketingu dhe mediatizimi për vetë shoqërinë: nga njëra anë shoqëria angazhohet në PSK dhe e reklamon si të

tillë, dhe nga ana tjetër, asociohet veprimtaria me emrin e shoqërisë dhe kjo e fundit vendos imazhin e saj në një formë tjetër bërjeje publike.

Disa sugjerime të tjera në lidhje me nxitjen e zhvillimin e përgjegjësisë sociale.

Studimet në lidhje me PSK dhe lidhjen e ndikimin e saj në fitimet e shoqërisë janë në rritje. Ajo që duhet theksuar është që PSK duhet të jetë përtej çështjes së imazhit të një shoqërie, dhe as të lexohet si një “detyrë shtëpie”. PSK duhet të jetë pjesë integrale e strategjisë së zhvillimit të shoqërisë me synimin për të qenë në përmirësim të vazhdueshëm. Promovimi i PSK në vetvete nuk mund të marrë si të mirëqenë përgjegjësinë sociale të shoqërisë.

Duke pasur parasysh larminë e sferave të përgjegjësisë sociale, është e rëndësishme që të ketë një informacion më të madh me sferat e përgjegjësisë ku biznesi mund të kontribuojë në fusha sa më konkret për të. Kjo do t’i shërbente një përgjegjësie sociale e cila do të përkthehej në masa konkrete dhe efikase. Përgjegjësia sociale e korporatës është tashmë një faktor në që ka marrë një dimension të ri, por kjo nuk do të thotë që PSK është në nivelet më optimale. Një rekomandim tjetër lidhet me aspektin publik të perceptimit të përgjegjësisë sociale, pra rritja e njohurive të publikut të gjerë, përfshirë dhe sensibilizimin në nivel mediatik, për përgjegjësinë sociale dhe vlerësimin e këtij të fundit për të. Ndërgjegjësimi në lidhje me PSK duhet të jetë një angazhim i vazhdueshëm, i cili duhet të përkthehet në vlera dhe në tregues të matshëm përsa i përket situatës PSK të shoqërive që operojnë në vend, pavarësisht nëse janë shoqëri vendase dhe /ose me kapital të huaj, shoqëri me kapital privat apo publik.

Për rritjen e ndërgjegjësimi sugjerohen fushata të cilat mund të fillojnë, ashtu si dhe edukimi financiar që në bankat e shkollës së mesme. Për këtë kërkohet dhe sugjerohet një bashkëpunim i ngushtë me institucionet arsimore publike dhe private si dhe mbështetje nga

ana e ministrisë përgjegjëse për arsimin. Në fokus të jetë PSK dhe Qeverisja e Korporatave. Stafet akademike të kësaj fushe mund të jenë një ndihmë shumë efektive në këtë kuadër.

Përveç, fushatat mund të jenë në formën e forume të hapura ose dhe web forume me grupe interesi sipas industrive të cilat mund të moderohen nga strukturat përkatëse brenda ministrive të linjës, si dhe përhapja e informacionit nëpërmjet rrjeteve sociale, duke vënë theksin te matësit e performancës së PSK, të cilët mund të organizohen sipas industrisë, madhësisë së biznesit, në nivel rajonal apo kombëtar, për të ndërtuar kapacitete dhe për të ndarë përvojat dhe praktikat më të mira.

Është e rëndësishme që të identifikohen dhe shtysat e incentivat që nxisin PSK në shoqëritë tregtare. Përfshirja e përgjegjësisë sociale në biznes përbën një sfidë për rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve, prandaj edhe se është një politikë e re për Shqipërinë, duhet të përfshihet në axhendën e zhvillimit të qëndrueshëm të biznesit²⁷¹.

Transparenca dhe informimi. Është e rëndësishme që ndërgjegjësimi të shprehet dhe në përkthimin e PSK si pjesë integrale të jetës së një shoqëri tregtare, që do të thotë në të njëjtën kohë të jetë subjekt i transparencës, informimit dhe raportimit në formën dhe mënyrën e duhur.

Krijimi i një mjedisi favorizues me stimuj të përshtatshëm për përfshirjen e praktikave të PSK-së në sjelljet e biznesit dhe në raportet vjetore si pjesë integrale, duke përcaktuar të paktën detyrueshmëri të raportimit si dhe duke përcaktuar fusha sensitive të detyrueshme për raportim për çdo industri.

²⁷¹ Shih http://aida.gov.al/images/ckeditor/fletore_zyrtare_157_2014.pdf faqe 8054, Fletore Zyrtare numër 157 -2014, datë 13.10.2014, faqe 8054.

Shpërblime apo lehtësira për shoqëritë në rastet e progresit në lidhje me PSK-në²⁷², të cilat mund të shpërbejnë dhe si një shtysë për t'u angazhuar në PSK por në çdo rast, pjesë e rëndësishme të jetë dhe monitorimi për të shmangur abuzimet.

Studime kanë sugjeruar që kriteret e PSK-së të jenë të integruara në procedurat e prokurimeve publike si dhe të krijohet një system grantesh për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme që ndërmarrin praktikatat e PSK-së²⁷³. Ashtu si dhe në pikën më lart, duhet që transparenca dhe monitorimi të funksionojnë në mënyrë eficiente për të shmangur abuzimet.

Nisur nga historiku i së drejtës tregtare së aplikueshme, modelet e qeverisjes së korporatës, sistemet e qeverisjes së vetë shoqërisë, përmasa e shoqërisë (korporatat e mëdha vs. SME), kategorizimi i shoqërive, gjykohet me interes se përfundimet e arritura, kërkojnë kërkime të mëtejshme. Kjo do të jetë dhe pikësynimi i mëtejshëm i këtij studimi: vlerësimi i lidhjes mes PSK dhe performancës së shoqërisë për shoqëritë në Shqipëri.

²⁷² Shih dokumentin “Analiza e situatës së përgjegjësisë sociale të korporatave në Shqipëri. Praktikatat dhe Sfidat Aktuale të Industrive Nxjerrëse”, që gjendet në <https://www.osce.org/sq/albania/106221?download=true>, faqe 49.

²⁷³ Shih shënimin më lart.

SHTOJCA 1

Nr.	Shteti	Modeli i qeverisjes
1	Austri	Sistem detyrues me dy nivele
2	Belgjikë	Sistem me një nivel
3	Bullgari	Mundësi zgjedhjeje mes dy modeleve. Sistem me një dhe dy nivele. Mbizotëron sistemi me një nivel.
4	Kroaci	Mundësi zgjedhjeje mes dy modeleve. Sistem me një dhe dy nivele. Mbizotëron sistemi me dy nivele.
5	Qipro	Sistem me një nivel
6	Republika Çeke	Sistem detyrues me dy nivele
7	Danimarka	Mundësi zgjedhjeje mes modelit Nordik dhe modelit (sistemit) gjerman me dy nivele.
8	Estonia	Sistem detyrues me dy nivele
9	Finlandë	Mundësi zgjedhjeje mes modelit Nordik dhe modelit (sistemit) gjerman me dy nivele.
10	Francë	Mundësi zgjedhjeje mes dy modeleve. Sistem me një dhe dy nivele. Mbizotëron sistemi me një nivel.
11	Gjermani	Sistem detyrues me dy nivele
12	Greqi	Sistem me një nivel
13	Hungari	Mundësi zgjedhjeje mes dy modeleve. Sistem me një dhe dy nivele. Mbizotëron sistemi me dy nivele.

14	Irlandë	Sistem me një nivel
15	Itali	Mundësi zgjedhjeje mes tre formave: sistemi me një/dy nivele dhe modeli 'tradicional" me bord drejtorësh dhe bord audituesish.
16	Letoni	Sistem detyrues me dy nivele
17	Lituani	Dominon modeli me një nivel. Ofron mundësi për të zgjedhur mes bordit mbikqyrës dhe /ose bordit të drejtorëve
18	Luksemburg	Mundësi zgjedhjeje mes dy modeleve. Sistem me një dhe dy nivele. Mbizotëron sistemi me një nivel
19	Malta	Sistem me një nivel
20	Holanda	Mundësi zgjedhjeje mes dy modeleve. Sistem me një dhe dy nivele. Mbizotëron sistemi me dy nivele.
21	Poloni	Sistem detyrues me dy nivele
22	Portugali	Mundësi zgjedhjeje mes tre formave: istemi me një/dy nivele dhe modeli 'tradicional" me bord drejtorësh dhe bord audituesish.
23	Rumani	Mundësi zgjedhjeje mes dy modeleve. Sistem me një dhe dy nivele. Mbizotëron sistemi me dy nivele.
24	Sllovaki	Sistem detyrues me dy nivele
25	Slloveni	Mundësi zgjedhjeje mes dy modeleve. Sistem me një dhe dy nivele. Mbizotëron sistemi me dy nivele.

26	Spanja	Sistem me një nivel
27	Suedia	Modeli Nordik
28	Mbretëria e Bashkuar	Sistemi me një nivel ndonëse e drejta tregtare nuk përmban parashikime detyruese në lidhje me strukturën e bordit.
I	Shqipëria	Mundësi zgjedhjeje mes sistemit me një / dy nivele, si dhe sistem me dy nivele sipas modelit italian ku këshilli mbikqyrës dhe administratorët emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme.
II	Kosova	Sistem detyrues me një nivel.

BIBLIOGRAFIA

Burime parësore

Legjislacioni në vend

Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 28, faqe 1073.

Kodi Tregtar i Ahmet Zogut, 932, botuar në Gazetën Zyrtare numër 1, të vitit 1932.

Ligji “*Mbi aplikimin e Kodit Tregtar*”, botuar në Gazetën Zyrtare numër 4, të vitit 1932.

Dekret rregullorja “*Mbi aplikimin e dispozitave të Kodit Tregtar që u përkasin shoqërive me aksione*” (1934).

Dekrete nr. 7406 për “*Mbi mbrojtjen e investimeve të huaja në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë*”.

Dekrete nr. 7407 “*Mbi aktivitetin ekonomik të ndërmarrjeve me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë*”.

Ligjin 7850, datë 29/7/1994 “*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*”.

Ligji numër 8116, datë 29/3/1996 “*Kodi i Procedurës Civile*”.

Ligji numër 7895, datë 27/1/1995, “*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*”.

Ligji nr. 7632, datë 4.11.1992, “*Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregëtar*”.

Ligji nr. 7638, datë 19.1.1992 “*Për shoqëritë tregtare*”.

Ligji nr. 7667, datë 28.1.1992, “*Për regjistrin tregëtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare*”.

Ligjin Nr.7926, datë 20.4.1995 “*Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare*”, i ndryshuar.

Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006 “*Për ratifikimin e Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit ndërmjet Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare*”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.87, datë 14.8.2006, faqe 2955.

Ligji numër 9723, datë 3 maj 2007, “*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*”.

Ligji nr.9901, datë 14.4.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”.

Ligji Nr. 10 236, datë 18.2.2010 “*Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike*”.

Ligji Nr.10475, datë 27.10.2011 botuar në Fletoren Zyrtare nr.152/2011, faqe 6979.

Ligji numër 129/2014 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*.

Ligji Nr.9879, datë 21.2.2008 *“Për titujt”*.

Ligji Nr.10 091, datë 5.3.2009 *“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”*.

Ligji 9662/2006 *“Për bankat në Republikën e Shqipërisë”*.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.93, datë 28.2.1994 *“Për bashkimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëritë tregtare me ortakë të tjerë”*.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.642, datë 11.10.2005 *“Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”*.

Vendimi e Këshillit të Ministrave Nr. 570, datë 3.10.2018 *“Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”*.

Vendimi nr. 1, datë 2 dhjetor 2011 i Këshillit Konsultativ të Biznesit, *“Për miratimin e Kodit të Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Tregtare në Shqipëri, jo të regjistruara në bursë”*.

Legjislacioni në BE

Numri CELEX: 31977L0091, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr. 26, datë 31.1.1997, faqe 1-13.

Nr. Celex: 32009L0109, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L, nr.259, datë 2.10.2009, faqe 14–21.

Nr. Celex 32009L0101, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L, nr.258, datë 1.10.2009, faqe 11–19.

Legjislacioni në SHBA

Ligji për Reformën dhe Mbrojtjen e Konsumatorëve të Dodd-Frank, 2010, gjendet në <https://legcounsel.house.gov/Comps/Dodd-Frank%20Wall%20Street%20Reform%20and%20Consumer%20Protection%20Act.pdf>

Libra

Anastasi A. “*Historia e institucioneve*”, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë 2004, ISBN 99927-0-297-4.

Borkowski A. & du Plessis Paul, “*E drejta Romake*”, UET press, ISBN 978-99956-39-10-5.

du Plessis Jean Jacques, Hargovan Anil, Bagaric Mirko “*Principles of Contemporary Corporate Governance*”, Second edition, Cambridge University Press, 2011, ISBN 978-0-521-13803-1

Gordon Jeffrey N. and Ringe Wolf-Georg “*The Oxford Handbook of Corporate Law and Governance*”, 2015, ISBN 978-0-19-874368-2

Friedman M., “*Kapitalizmi dhe liria*”, ISBN: 9994372785, Shtëpia Botuese Dita 2000, 2005

Mallin Christine A., “*Corporate Governance*”, 4th edition, Oxford University Press, 2011, ISBN 978-0-19-964466-7

Mandro Arta, “*E drejta romake*”, Shtëpia Botuese Ermal 2007, ISBN 978-99956-05-00-1

Malltezi Argita, Rystemaj Jorida, Kromici Armela, “Gjykatat shqiptare mbi shoqëritë tregtare dhe veprimtarinë tregtare”, Shtëpia Botuese Mediaprint 2015, ISBN 978-9928-08-174-2

Malltezi A. “*E drejta shqiptare e shoqërive tregtare*”, Shtëpia Botuese Mediaprint 2011;

Monks, Robert A.G. dhe Minow N. “*Corporate Governance*”, Blackwell Publishing, 2003, botimi i tretë

Morck R., Steier L., “*A History of Corporate Governance around the World: Family Business Groups to Professional Managers*”: University of Chicago Press, ISBN: 0-226-53680-7, nëntor 2005, gjendet në <http://www.nber.org/books/morc05-1>

Porter Michael, “*On competition*”, A Harvard Business Review book, 2008, ISBN 978-1-4221-2696-7;

Monografi, komentare

Dine J, Bletcher M. “*Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, teksti me shpjegime, version i rishikuar, prill 2016, botim GIZ

Dine J, & Blecher M., Hoxha Sh, & Raca B., (2008), “*Ligji i ri për shoqëritë tregtare – komentare*”,

Bachner T., Schuster Philipp E., & Martin W. “*Ligji i ri Shqiptar për Shoqëritë Tregtare*”, interpretuar sipas burimeve të tij në të drejtën europiane, Tiranë, shkurt 2009;

Ecares M., Bolton P., Röell A., “*Corporate Law and Governance*”, gjendet në <https://pdfs.semanticscholar.org/373a/af506071a83e1e5c52c1ded6d4d1acf4cb4c.pdf>

Gorezi A., (2011) “*Shareholder rights, Executive compensation and stakeholder protection: A comparative overview of United States of America and chosen European Union Jurisdiction*”, CEU, Electronic thesis and dissertations collection

Gribizi Irena, Rrëmbeci Ilir, OSCE, Ambasada e Kanadasë “*Analiza e situatës së përgjegjësisë sociale të korporatave në Shqipëri, Praktikë dhe Sfidat Aktuale të Industrive Nxjerrëse*”, ISBN 978-92-9235-245-5,

Kribbe H. “*Corporate personality: a political theory of association*”, PhD thesis, London School of Economics and Political Science, UMI Number: U615608, Published by ProQuest LLC 2014, gjendet në <https://etheses.lse.ac.uk/2659/1/U615608.pdf>

Xhepa S., “*Miti mbi krizat dhe “Fundin e Tregut”*”, ese, Fondacioni për Liri Ekonomike, ISBN 999563931-9, Tiranë 2010

Revista

Revista Juridike, nr.1, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë, Qershor, 1999, Shtëpia Botuese “*Horizont*”.

Revista “*Jus & Justicia*”, Pranverë 2010, Universiteti Europian i Tiranës.

Revista “*Monitor*”, 2014.

Fortune Magazine, 1993.

Harward Business Review, April 2013.

The Economist, October 16th – 22nd 2010.

The Economist, December 11th – 17th 2010.

The Economist, January 29th – February 4th 2011.

The Economist, October 22nd – 28th 2011.

The Economist, December 5th – 11th 2015.

The Economist, August 27th - September 2nd 2016.

Artikuj

Abdullah Al Mamun, Shazali Abu Mansor, “*EVA as a Superior Performance Measurement Tool*”, Modern Economy, 2012, 3, 310 – 318, at www.SciRP.org./journal/me), 310.

Adnan M. Abdeen, G Timothy Haight, “*A Fresh look at Economic Value Added: Empirical Study of the Fortune five hundred companies*”, The Journal of Applied Business Research, Vol. 18, No. 2, page 28 - 29;

Aliu B. “*Co-determination politics on commercial companies in Albania: a comparative study*”, CBU international conference on integration and innovation in science and education April 7-14, 2013, Prague, Czech Republic;
[www.cbuni.cz, ojs.journals.cz/index.php/CBUConference2013/article/download/20/22](http://www.cbuni.cz/ojs/journals.cz/index.php/CBUConference2013/article/download/20/22);

Albareda L., Lozano J., Tencati A., Midtun A., Perrini F., “*The changing role of governments in corporate social responsibility: drivers and responses*”, Business Ethics: A European review, Volume 17, Number 4, October 2008;

Barbullushi Erjola (Sakti), “*Implications and application of economic value added in banking sector in Albania*”, International Journal of Economics, Commerce and Management, United Kingdom Vol. III, Issue 2, Feb 2015 gjenet në <http://ijecm.co.uk/> ISSN 2348 0386;

Boatright John, “What’s wrong – and what is right – with stakeholder management”, Journal of Private Enterprise, Volume XXI, Number 2, Spring 2006;

Brandeis Louis D., “*Other people’s money and how the bankers use it*” (1914).

Braendle, U. C., and Noll, J. (2004). *The Societas Europaea - A Step Towards Convergence of Corporate Governance Systems*. Working Paper. Manchester University, UK.

Dignam, Alan J., Galanis M., “*The globalization of corporate governance*”, ISBN 978-0-7546-4625-9, Ashgate Publishing Limited, 2009

Donaldson Thomas, Preston Lee E., “*The stakeholder theory of the corporation: concepts, evidence and implications*”, Academy of Management Review, 1995, Vol. 20, N.1, 65 -91.

Du Plessis J., Hargovan A., Bagaric M., and Harris J. “*Principles of Contemporary Corporate Governance*”, Third Edition Cambridge University Press, 978-1-107-43242-0, 2015

Fana Mirela, Gorezi Arnisa, “*Aspekte ligjore të qeverisjes së korporatave në Shqipëri: Një qasje kritike*”, KDU: 33 (05) 34 (05) REFORMA, 2/2015;

Farrar H. J., “*A Brief Thematic History of Corporate Governance*”, Bond Law Review, Volume 11, issue 2, Article 9,
<https://epublications.bond.edu.au/cgi/viewcontent.cgi?article=1171&context=blr>

Farzad Farsio, Joe Degel, and Julia Degner, “*Economic value added (EVA) and stock returns*”, the Financier, vol. 7;

Freeman R. E., “*The politics of stakeholder theory: some future directions*”, Business Ethics Quarterly 4:4 (1994): 409-421

Freeman R.E., “*Stakeholder theory of the modern corporation*”, General Issues in Business Ethics;

Friedman M., “*The Social Responsibility of Business is to Increase its Profits*”, The New York Times Magazine, September 13, 1970. Copyright @ 1970 by The New York Times Company, aksesuar në <http://www.colorado.edu/studentgroups/libertarians/issues/friedman-soc-resp-business.html>

Gilson R., “*Controlling Shareholders and Corporate Governance: European corporate governance institute (ECGI) Complicating the Comparative Taxonomy*”, Law Working Paper Series, Working Paper No. 49/2005, gjendet nw <http://ssrn.com/abstract=784744>

Hansmann H., Kraakman R. “*The end of history for corporate law*”, Discussion Paper No. 280, 3/2000, Harvard Law School, ISSN 1045-6333
gjendet në http://www.law.harvard.edu/programs/olin_center/papers/pdf/280.pdf

Hopt K., Leyens P. “*Board Models in Europe. Recent developments of Internal Corporate Governance Structures in Germany the United Kingdom, France and Italy*”. Law working paper, no. 18/2004, gjendet në www.ssrn.com/abstract=487944

Hopt K., “*Comparative Corporate Governance: The State of the Art and International Regulation*”, Law Working Paper N°.170/2011, January 2011, gjendet në: http://ssrn.com/abstract_id=1713750

Kallanxhi V. “*Një këndvështrim mbi Përgjegjësisë Sociale të Korporatave në mjedisin Shqiptar*”, <http://iipcccl.org/wp-content/uploads/2015/05/BJIR-Vol.-1-No.-1-Full.pdf> (31/8/2017, ora 1:47) ISSN 2410-759X Balkan Journal of Interdisciplinary Research Vol 1 No 1 Acces online at www.iipcccl.org IIPCCCL Publishing, Tirana-Albania May 2015

Langbroek P., van den Bos K., Thomas M. S., Milo M., van Rossum W., “*Methodology of Legal Research: Challenges and Opportunities*”, www.utrechtlawreview.org Volume 13, Issue 3, 2017 <http://doi.org/10.18352/ulr.411>

Levit Jr. A. “*How to boost Shareholder Democracy*”, Wall Street Journal, Korrik 2008.

Lipton M., Savitt W. “*The many myths of Lucian Bebchuk*”, 93VA.L. (2007).

Lawrence e. Mitchell, “*Corporate irresponsibility: America's newest export* “ 208 (2001).

Lewis Robie, Leavel W. Hadley, Center for business and economic development at Sam Houston State University, Huntsville, Texas, August 1995, no 95- 17G,

Malmendier U. “*Law and Finance at the Origin*”, 2008, gjendet në <https://eml.berkeley.edu/~ulrike/Papers/JELDraft70.pdf>

Malltezi A., “*Tradita e qeverisjes së Shoqërive Aksionere në Shqipëri për periudhën 1992 – 2007*”, Jus &Justicia, Pranverë 2010, Universiteti Europian i Tiranës.

McCahery J., Vermeulen E., “*Corporate Governance and Innovation Venture Capital, Joint Ventures, and Family Businesses*”, Law Working Paper N°.65/2006, March 2006, Tilburg University, gjendet në <http://ssrn.com/abstract=894785>

McLaren Josie, University of Newcastle, “*Research Report, Implementing the EVA Business Philosophy: Management Accounting Evidence from New Zealand*”, 2005, accessed at http://www.cimaglobal.com/Documents/ImportedDocuments/tech_resrep_implementing_eva_business_philosophy_jun05.pdf, faqe 2

Michael Welters, “*Towards a singular concept of legal personality*”, La revue du barreau Canadien, 2013, vol.92.

Nesteruk, J. J Bus Ethics (1991) 10: 723. <https://doi.org/10.1007/BF00705878>

The Birth of Corporate Governance, *Harwell Wells, 2010, Seattle University Law Review* [Vol. 33:4], faqe 1265 – 1270. Gjendet te <https://digitalcommons.la.seattleu.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1017&context=sulr>

Oman C.H., “*Corporate governance and national development*”, Technical Papers 180, OECD Development Center, Paris, 2001

Papajorgji E., Alikaj G. “*The historical development of property-, and commercial Law in Albania until 1976*”, ISSN 2410-3918, Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences, IIPCCL Publishing, Tirana-Albania, Vol. 2 No. 2, July 2016, gjendet në www.iipccl.org

Porter Michael, “*The five forces that shape strategy*”, Harward Business Review, January 2008, www.hbrreprints.org;

Rustemaj J. *The new legal regime on minority shareholder protection in Albania*, aksesuar më 23.12.2014, ora 15.30 në <http://ojs.journals.cz/index.php/EJBE/article/view/142/147>

Waldkirch Rüdiger W., “*The Shareholder vs. Stakeholder Debate reconsidered*”, *DISCUSSION PAPER NR. 2008-2*, ISSN 1862-6289, ISBN 978-3-86829-042-4, gjendet nw https://www.wcge.org/images/wissenschaft/publikationen/DP_2008-2_Ruediger_W._Waldkirch_-_The_Shareholder_vs._Stakeholder_Debate_reconsidered.pdf

Sale H. Delaware’s Good Faith, 89 CORNELL L. REV. 456, 460 (2004).

Schömann I. “*ISO 26000: The new face of corporate social responsibility?*”, ETUI Policy Brief N° 1/2012, European Economic, Employment and Social Policy

Sternberg, E. (1998). “*The Stakeholder Concept: a Mistaken Doctrine*”. Working Paper. University of Leeds & Analytical Solutions, UK.

Stillo S., Llaci S., (2008) *Qeverisja e korporatave në ekonomitë në tranzicion*, Ekonomia dhe Biznesi, Vëllimi 1 117 – 128

Tahiraj R., Llozana A. “The impact of the constitutional and supranational limitations to the reformation of the Albanian commercial law”, *Perspectives of Business Law Journal* Volume 1, Issue 1, November 2012, faqe 366, gjendet në <http://www.businesslawconference.ro/revista/articole/an1nr1/41%20R.%20Tahiraj%20&%20A.%20Llozana%20Eng.pdf>

Tsuk D. “*Corporations without labor: the politics of progressive corporate law*”, *University of Pennsylvania Law Review*, VOL. 151 JUNE 2003 No. 6, gjendet në https://scholarship.law.upenn.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=3227&context=penn_law_review

Velasco J., *The fundamental rights of the shareholder*, aksesuar më 23.12.2014, ora 16.25 në http://lawreview.law.ucdavis.edu/issues/40/2/articles/DavisVol40No2_Velasco.pdf

Velasco J., *Shareholder Owner and Primacy*, aksesuar më 23.12.2014, ora 16.26, më <http://illinoislawreview.org/wp-content/ilr-content/articles/2010/3/Velasco.pdf>

Worthington, Andrew and West, Tracey (2001) “*Economic Value-Added: A Review of the Theoretical and Empirical Literature*”. *Asian Review of Accounting* 9(1):pp. 67-86

Wells H. “*The Birth of Corporate Governance*”, *Seattle University Law Review* [Vol. 33:4, 2010, gjendet në <https://digitalcommons.law.seattleu.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1017&context=sulr>

Smith Terry, “*What exactly do we mean by “Shareholder value?”*”, January 9, 2015, accessed at www.ft.com/content/463abec2-9721-11e4-845a-00144feabdc0

K. A. Sharma, S. Kumar, “*Economic Value Added (EVA) – Literature review and relevant issues*”, *International Journal of Economics and Finance*, Vol.2, No 2, 2010, 200 – 202.

Shimin Chen and James L. Dodd, “*Economic Value Added (EVA™): An Empirical Examination Of A New Corporate Performance Measure*”, *Journal of Managerial Issues*, Vol. 9, No. 3 (Fall 1997), pp. 318-333, Published by [Pittsburg State University](http://www.pittsburgstate.edu/), Stable URL: <http://www.jstor.org/stable/40604150>;

ACCA *Economic value added versus profit-based measures of performance*, accessed at http://www.accaglobal.com/content/dam/acca/global/pdf/sa_july11_perfmeasurement.pdf

IFC 2015:37 (*A Guide to Corporate Governance Practices in the European Union* http://www.ifc.org/wps/wcm/connect/c44d6d0047b7597bb7d9f7299ede9589/CG_Practices_in_EU_Guide.pdf?MOD=AJPERES)

Corporate Governance of Non-Listed Companies in Emerging Markets, 2006 gjendet te <https://www.oecd.org/corporate/ca/corporategovernanceprinciples/37190767.pdf>

Corporate Governance in Europe, Report of a CEPS Working Party, CEPS Working Report No. 12, june 1995, gjendet në http://www.ecgi.org/codes/documents/ceps_june1995.pdf
Commercial laws of Albania, January 2013, an assessment by the EBRD;

Commission for Labor, Social Issues and Health, Parliamentary Document report, Datë 21.06.2011, ora 11:00, retrieved at www.parlament.al/.../shendetesia_21_06_2011_9806, aksesuar në 18 nëntor, 2015, ora 1:28.

GTZ “*Reforma e Ligjit për Shoqëritë Tregtare të Republikës së Shqipërisë*”, 2007, Dokument për politikat;

IFC, “*Qeverisja e korporatave*”, Manual, IFC, Tiranë 2009,

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Dokument parlamentar, procesverbal, Datë 10.09.2014, ora 10:00, marrë në www.parlament.al

AMF, E Periodik, Publikimi mujor numri 106, korrik 2017 gjendet në www.amf.gov.al

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim me mbështetjen e Balkan Trust for Democracy, “*Aktiviteti filantropik i ndërmarrjeve në Shqipëri*”, gjendet në https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2017/02/Aktiviteti_filantropik_i_ndermarrjeve_ne_Shqiperi_web.pdf

2017 BKT – Compliance Report with Albanian Corporate Governance Code, gjendet në http://www.bkt.com.al/doc/2017_BKT.PDF

Business Philosophy: Management Accounting Evidence from New Zealand", 2005,
[http://www.cimaglobal.com/Documents/ImportedDocuments/tech_resrep_implementing_e
va_business_philosophy_jun05.pdf](http://www.cimaglobal.com/Documents/ImportedDocuments/tech_resrep_implementing_e_va_business_philosophy_jun05.pdf)

Worldwide Guide to Trade Unions and Works Councils, 2009, Baker & McKenzie,
<http://digitalcommons.ilr.cornell.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1048&context=lawfirms>,
accessed on November 05, 2015, 10:52:39 PM;

Vendime të Gjykatës

Vendimi nr. 4490, datë 8.4.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Vendimi nr. 4848, datë 14.05.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Vendime të Gjykatës së Lartë

Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Nr.11115-02459-00-2008 i Regj. Themeltar,
Nr.00-2014-1016 i Vendimit (163);

Vendimi i Kolegjit Civil Nr.11241-01597-00-2009 i Regj. Themeltar

Vendimi i Kolegjit Civil Nr.00-2012-469

Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Nr.36 i Regj. Themeltar, Nr.25 i
Vendimit;

Vendimi Unifikues Nr.36 i Regj. Themeltar, Nr.25 i Vendimit, date 28.03.2003 për çështjen
civile nr.36

Faqe interneti

<https://www.bankofalbania.org/>

<https://www.akep.al/>

<http://amf.gov.al/>

<http://www.qkr.gov.al>

<http://www.qbz.gov.al/>

<https://www.parlament.al>

<http://www.monitor.al>

<http://infrastruktura.gov.al>

<http://aida.gov.al>

<http://arsimi.gov.al>

<http://www.mapo.al>

<http://www.bkt.com.al>
<http://www.alphabank.al>
<https://www.intesasanpaolobank.al>;
<https://www.fibank.al>;
<https://www.societegenerale.al>
<https://www.tiranabank.al>
<https://www.bankacredins.com>
<https://www.raiffeisen.al>
<https://www.unionbank.al>
<https://www.intesasanpaolobank.al>
https://albcontrol.al/al/?page_id=459
<https://www.albtelecom.al>
<https://www.vodafone.al/>
<https://www.telekom.com.al/>
<http://appa.al>
<http://www.kesh.al>
<https://www.ost.al>
<http://www.sicred.com.al/>
<http://www.eurosig.al>
<http://www.sivig.al>
<http://intersig.al>
<https://www.postashqiptare.al/>
<http://ujesjellesitirane.al/>
<http://www.shqiptarja.com>
<http://ec.europa.eu>
<https://eur-lex.europa.eu>
<https://www.cftc.gov>
<http://www.ifc.org>
<http://business-ethics.com>
<https://www.stlouisfed.org>
<https://www.forbes.com>
<https://www.prnewswire.com>
<https://insight.kellogg.northwestern.edu>
<https://insight.kellogg.northwestern.edu>
<http://fortune.com>
<https://papers.ssrn.com>
<https://www.gsb.stanford.edu>
<http://www.fee.org>
<https://h2o.law.harvard.edu>
<http://open.data.al>
<http://fortune.com/going-private/>
<https://www.iso.org/obp/ui/#iso:std:42546:en>
https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=229529
https://www.gsb.stanford.edu/sites/gsb/files/rust-john-theory-and_inference.pdf